PANELI KËSHILLËDHËNËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT

HISTORIKU DHE TRASHËGIMIA KOSOVË, 2007-2016

Raport final

30 qershor 2016

Parathënie

Ky Raport final i Panelit i dedikohet në mënyrë specifike OKB-së dhe në përgjithësi komunitetit ndërkombëtar si të tërë- profesionistëve të angazhuar, aktivistëve, akademikëve dhe të gjithë të interesuarve për përgjegjësinë e OKB-së për shkeljet e të drejtave të njeriut.

Më shumë se tetë vjet pas seancës së vet të parë në nëntor të vitit 2007, puna e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (UNMIK) ka ardhur në përfundim. Paneli, i themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12, ishte njëri nga mekanizmat e parë për ankesa për të drejtat e njeriut i krijuar që t'i shqyrtojë shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga një mision ndërkombëtar-në këtë rast UNMIK-u – me qëllim të ofrimit të një mekanizmi implementues për obligimet e veta për të drejtat e njeriut.

Pavarësisht nga sfidat dhe pengesat që i hasi, PKDNJ ishte në gjendje të arrijë shumë për sa i përket trashëgimisë së vet ligjore. Në mënyrë specifike, Paneli i kontribuoi të menduarit ndërkombëtar lidhur me çështje të shumta të rëndësishme që kanë të bëjnë me standardet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, veçanërisht ato të ndërlidhura me përgjegjësinë për të drejtat e njeriut të organizatave ndërkombëtare, në këtë rast të OKB-së. Për herë të parë, UNMIK-u, një mision i OKB-së, mori rolin e një "shteti surrogat", në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999). Detyrat e UNMIK-ut përfshinin *"*mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut*"* në Kosovë në kontekstin që doli atje pas fundit të veprimeve ushtarake të hapura në vitin 1999. Në lidhje me këtë detyrë kryesore, Paneli qartësoi shpesh në mendimet e veta se "*Karakteri i përkohshëm i UNMIK-ut dhe vështirësitë e ngjashme duhet marrë parasysh në lidhje me një numër situatash, por në asnjë rrethanë këto elemente nuk mund të merren si arsyetim për uljen e standardeve të respektimit të të drejtave të njeriut, të cilat u inkorporuan sipas rregullit në mandatin e UNMIK-ut.*"

Si pasojë, kryesisht e të qenit të Kosovës nën administrimin e përkohshëm ndërkombëtar, ankesat e pranuara dhe shqyrtuara nga PKDNJ shpesh paraqisnin në detaje rrethanat dhe çështjet që më parë nuk ishin hasur nga organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, apo së paku jo në një nivel të tillë. Prandaj, ishte e vështirë të gjenden përgjigje adekuate në jurisprudencën apo mendimet ekzistuese. Paneli duhej të gjente përgjigje në çështjet që i shqyrtonte duke përshkruar (siç ishte i mandatuar të bënte) vargun më të gjerë të instrumenteve relevante ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë Deklaratë Universale për të Drejtat e Njeriut dhe traktatet e OKB-së për të drejtat e njeriut. Në shumicën e rasteve, megjithatë, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përbënin bazën e arsyetimit të Panelit dhe shumicës së mendimeve të veta. *Acquis* aq të zhvilluara duhet të konsiderohen një kontribut material për krijimin e standardeve ndërkombëtare në këtë fushë.

Aspekt tjetër të rëndësishëm të trashëgimisë ligjore të Panelit paraqesin përvojat dhe mësimet e marra nga të vepruarit si organ kuazi-gjyqësor për të drejtat e njeriut, që as nuk ishte konsideruar plotësisht e as që ishte përgatitur tërësisht nga OKB-ja; siç tregon historia, ndoshta PKDNJ ishte madje i padëshiruar nga shumë brenda OKB-së dhe ishte iniciuar vetëm nën presion ndërkombëtar. Pavarësisht të gjitha këtyre pengesave, megjithatë, Paneli krijoi mënyrat e veta të veprimit dhe procedurat të cilat i mundësuan atij përmbushjen e mandatit të vet deri në shtrirjen më të gjerë të mundshme.

Siç përshkruhet në detaje në Raport, kjo përvojë ofron një shtysë të fortë për diskutime të mëtejme rreth asaj se çfarë do të ishte model optimal i organit për shqyrtim të të drejtave të njeriut për të vepruar brenda një konteksti të veçantë të një misioni ndërkombëtar që administron një territor të përcaktuar. Për këtë qëllim, Raporti ofron përfundime për sa i përket strukturës përkatëse dhe

mënyrës së veprimeve që një organ i tillë mund t'i ketë, në rast se ka nevojë për një mision tjetër të tillë në të ardhmen. Ato, po ashtu, duhet të jenë me rëndësi për organet e tjera sikur paqeruajtësit apo organet e OKB-së që administrojnë kampet e refugjatëve. Analizat, reflektimet dhe konkluzionet e Raportit bazohen në një llojllojshmëri burimesh të shqyrtuara nga Paneli: dokumente arkivore të ndërlidhura, në veçanti, me debatin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për të drejtat e njeriut në Kosovë që kulmoi në vitin 2005, si dhe përpjekjet dhe diskutimet që i paraprinë miratimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 dhe procesit pasues që çoi te themelimi i PKDNJ-së. Raporti përmban informata të çmueshme në lidhje me këtë, të cilat u morën përmes intervistave me shumë persona të përfshirë në këto zhvillime. Mendimet e anëtarëve të Panelit dhe përvojat e tyre personale gjatë ekzistencës së Panelit, po ashtu, ishin të dobishme.

Ne duam t'iu shprehim mirënjohjen tonë të thellë atyre që kontribuuan dhe ndihmuan në këtë Raport, në veçanti z. Brandon Gardner.

Pavarësisht lëndës shumë të dhimbshme dhe sfidave të diskutuara në këtë Raport, ne duam po ashtu të themi se të qenit pjesëtar i PKDNJ-së ka qenë një përvojë e dobishme, dhe madje e kënaqshme, që shoqërohej me ngrohtësi, miqësi dhe kolegialitet.

Marek Nowicki
Christine Chinkin
Françoise Tulkens

Prishtinë, qershor 2016

Përmbajtja

Parathënia **3**
Përmbledhje ekzekutive **7**
Shkurtesat dhe akronimet **21**
I. Hyrje **23**
II. Konteksti i Kosovës **26**
A. UNMIK-u si autoritet suprem 26
B. Institucioni i Ombudspersonit 28
III. Parahistoriku i Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut **30**
A. AP e KiE-së dhe Komisioni i Venedikut 30
B. UNMIK-u dhe PKDNJ 32
C. Pikëpamjet e OSBE-së 34
D. Rregullorja e PKDNJ-së dhe hartimi i saj 36
E. Miratimi i Rregullores 38
IV. Historiku i hershëm i Panelit **39**
A. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12 39
B. Përbërja e parë e Panelit 41
C. Viti i parë: Përmirësimi i defekteve 43
D. Rregullorja e punës 44
E. Qasja në Panel 45
F. Stafi shtesë 46
V. Urdhëresa Administrative dhe pasojat e saj **49**
A. Seanca dëgjimore *Balaj dhe të tjerët* 49
B. Rezultatet nga seanca dëgjimore 51
C. Riemërimi dhe zëvendësimi i anëtarëve të Panelit 56
D. Reagimet ndaj Urdhëresës Administrative 58
VI. Sekretariati i Panelit **59**
VII. Trashëgimia ligjore **62**
A. Pamje e përgjithshme 62
B. Lëndët që kanë të bëjnë me pronën 64
C. Lëndët për persona të zhdukur dhe të vrarë (PZHV) 65
i. Historiku 65
ii. Ankesat e pranuara 68
iii. Neni 2 i KEDNJ-së 69
iv. Neni 3 i KEDNJ-së 74
D. Diskriminimi 76
E. Qasja në drejtësi 78
F. Të drejtat ekonomike dhe sociale 79
G. Dhuna ndaj grave 80
H. Helmimi nga plumbi në kampet për PZHB 81
I. Lënda *Balaj dhe të tjerët* 84
VIII. Vlerësimi i përvojës së PKDNJ-së **85**

A. Rekomandimet e Panelit 86
B. Veprimi i UNMIK-ut 88
C. Kufizimet tjera 92
IX. Përfundime 96
X. Shtojcat 100
A. Profilet e anëtarëve të PKDNJ-së 102
i. Përbërja përfundimtare e Panelit 102
ii. Ish-anëtarët e Panelit 103
B. Profilet e anëtarëve të stafit të Sekretariatit të PKDNJ-së 104
i. Stafi përfundimtar i Sekretariatit 104
ii. Ish-stafi i Sekretariatit 105
C. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12 108
D. Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2009/1 114
E. Rregullorja e Punës e PKDNJ-së 118
F. Bibliografia 128
G. Tabela statistikore 132
H. Vendimet dhe mendimet e PKDNJ-së që përmenden në këtë Raport 133
I. Raportet apo mendimet në të cilat diskutohet PKDNJ-a 135
J. Përmendjet e PKDNJ-së nga Sekretari i Përgjithshëm në KSKB 137

Përmbledhje ekzekutive

1. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ) është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi "Themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut", për t'i shqyrtuar shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga Administrata e Përkohshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Themelimi i tij paraqet një zhvillim të pashembullt në kontekst të misioneve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në këtë drejtim, Paneli është një mekanizëm nismëtar dhe unik që ka të bëjë me ngarkueshmërinë dhe përgjegjësinë, në lidhje me të drejtat e njeriut, për veprimet e organizatave ndërkombëtare.

2. Ky Raport final i PKDNJ-së u shtohet raporteve vjetore të Panelit që janë publikuar që nga viti 2008. Raporti ofron të dhëna për historikun dhe evolucionin e Panelit, praktikës së tij, ngarkesës me lëndë dhe kontributit për jurisprudencën që ka të bëjë me të drejtat e njeriut. Ai, po ashtu, paraqet kufizimet në të cilat veproi Paneli. Në fund, ai sugjeron se ka mësime për të marrë nga përvoja e Panelit që mund ta krijojnë bazën e të menduarit rreth mekanizmave të ardhshëm për sigurimin e përgjegjësisë së OKB-së, një proces që duhet të vazhdojë.

Konteksti i Kosovës

3. Konflikti i armatosur gjatë vitit 1998 dhe 1999, ndërmjet forcave serbe në njërën anë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe grupeve të tjera të armatosura të shqiptarëve të Kosovës në anën tjetër, është mirë i dokumentuar. Pas dështimit të përpjekjeve ndërkombëtare për të zgjidhur konfliktin, më 23 mars 1999, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) shpalli fillimin e sulmeve ajrore kundër Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ-së), të cilat përfunduan më 8 qershor 1999, kur RFJ-ja u pajtua t'i tërheqë forcat e veta nga Kosova. Më 9 qershor 1999, Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (KFOR), RFJ-ja dhe Republika e Serbisë nënshkruan një "Marrëveshje Tekniko-Ushtarake" përmes së cilës u pajtuan mbi tërheqjen e të gjitha autoriteteve të RFJ-së nga Kosova, duke përfshirë ato ushtarake, gjyqësore dhe policore, dhe praninë e një force ndërkombëtare të sigurisë.

4. Më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1244 (1999). Duke vepruar sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB-së, Këshilli i Sigurimit i OKB-së mori vendim për vendosjen e pranisë ndërkombëtare të sigurisë dhe civile-përkatësisht të KFOR-it dhe UNMIK-ut, në territorin e Kosovës. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP-ja) u ngarkua me kompetenca të plota legjislative dhe ekzekutive, duke përfshirë kompetencat mbi gjyqësinë. Prandaj, UNMIK-u, si një shtet surrogat, kishte në thelb kompetencat e njëjta si një shtet.

5. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit nr. 1244 mandatoi UNMIK-un që t'i "promovojë dhe mbrojë të drejtat e njeriut" në Kosovë në pajtim me standardet e pranuara ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në të vërtetë, kredibiliteti dhe legjitimiteti i një misioni të OKB-së për të kryer detyra për ndërtim të paqes në një shoqëri të shkatërruar nga lufta rrezikohet pa respektim të përpiktë të të drejtave të njeriut. Prandaj, pasi u themelua, UNMIK-u nxori Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/1 të 25 korrikut të vitit 1999 "Mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë", në të cilën thuhej se "të gjithë personat që marrin përsipër detyra publike ose mbajnë funksione publike në Kosovë duhet t'i respektojnë standardet e pranuara ndërkombëtare të të drejtave të njeriut." UNMIK-u, po ashtu, nxori Rregulloren nr. 1999/24 të 12 dhjetorit të vitit 1999 "Për Ligjin në Fuqi në Kosovë", në të cilën përmenden instrumentet e pranuara specifike ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që do të zbatohen.

6. U bë shpejt e qartë se gjatë ushtrimit të këtyre autorizimeve, UNMIK-u përballej me presionin në mes kërkesave për siguri në Kosovë dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Në rrethana

të trendëve të reja në të drejtën ndërkombëtare në lidhje me përgjegjësinë për shkelje të të drejtave të njeriut, në fillim të qershorit të vitit 1999, PSSP-ja paralajmëroi një mekanizëm të jashtëm përgjegjësie, krijimin e Institucionit të një Ombudspersoni për t'i pranuar dhe hetuar ankesat në lidhje me abuzimin, nëse ka, me autoritet nga Administrata e Përkohshme Civile, institucionet e reja lokale dhe aktorët joshtetërorë që pretendojnë apo ushtrojnë autoritet. Më pas, më 30 qershor 2000, UNMIK-u nxori Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/38 mbi "Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë".

7. Institucioni i Ombudspersonit u themelua për të qenë i lirë nga UNMIK-u dhe si i tillë paraqiste eksperimentin e parë për përgjegjshmërinë e OKB-së. Ai u mandatua të "sigurojë që të gjithë personat në Kosovë të mund t'i gëzojnë efektivisht, për aq sa lejojnë rrethanat, të drejtat e tyre të njeriut dhe liritë fundamentale që mbrohen me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut". Autorizimet e Institucionit të Ombudspersonit përfshinin ofrimin e këshillave dhe rekomandimeve çdo personi apo entiteti lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve vendore me instrumentet e pranuara ndërkombëtare. Ai, po ashtu, u autorizua t'i hetojë rastet lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe abuzimin me autoritet të organeve ndërkombëtare dhe lokale të UNMIK-ut, si dhe u ngarkua me autoritetin për të inspektuar objektet e paraburgimit dhe vizituar personat në paraburgim. Megjithatë, Institucioni i Ombudspersonit nuk kishte autoritetin të lëshojë vendime detyruese.

Parahistoriku i PKDNJ-së

8. Deri në vitin 2004, shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u tërhiqnin vëmendjen e organizatave të OKB-së nënshkruese të traktateve për të drejtat e njeriut, organizatave rajonale sikur Organizatës për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë (OSBE) dhe organizatave joqeveritare (OJQ-ve) sikur Amnesty International (AI) dhe Human Rights Watch (HRW). Kritika më e madhe për situatën që ka të bëjë me mungesën e përgjegjësisë adekuate të UNMIK-ut për të drejtat e njeriut erdhi nga Këshilli i Evropës (KiE). Tanimë në shtator të vitit 2003, Asambleja e tij Parlamentare (AP e KiE-së) diskutoi një mocion mbi të drejtat e njeriut në Kosovë. Si pjesë e procesit të përgatitjes së debatit për AP të KiE-së (Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës) lidhur me të drejtat e njeriut në Kosovë, në maj të vitit 2004 Komiteti i AP të KiE-së i kërkoi Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit ("Komisionit të Venedikut") që të japë një mendim mbi "gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë".

9. Në mendimin e miratuar në tetor të vitit 2004, Komisioni i Venedikut paraqiti një pasqyrë të gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë në atë kohë. Ata vërejtën një gamë të gjerë të problemeve që kishin të bënin me të drejtat e njeriut nën administrimin e UNMIK-ut: një mungesë të sigurisë për komunitetet joshqiptare; një mungesë të lirisë së lëvizjes për komunitetet joshqiptare, të cilat kishin ndikim në të pasurit qasje në shërbimet elementare publike; mbrojtje e pamjaftueshme e të drejtave në pronë; mungesë hetimesh për rrëmbimet, vrasjet dhe krimet e tjera serioze; mungesë e drejtësisë dhe zgjatje e tepërt e procedurave gjyqësore; qasje e vështirë në gjykatë; paraburgime pa hetim të pavarur; korrupsion; trafikim me qenie njerëzore; mungesë e sigurisë ligjore, shqyrtimit gjyqësorë dhe të drejtës për mjet efektiv juridik për shkelje të të drejtave të njeriut.

10. Në këto rrethana, iu bë shpejt e qartë komunitetit ndërkombëtar se ishte e papranueshme të lihet, në mes të Evropës, një territor pa garanci dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut. Për ta plotësuar këtë boshllëk, ishin në shqyrtim tri opsione: të zgjerohet juridiksioni i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) për të përfshirë territorin e Kosovës; të themelohet një Gjykatë për të drejtat e njeriut në Kosovë, e ngjashme me Dhomën për të Drejtat e Njeriut e themeluar më herët në Bosnjë e Hercegovinë; të krijohet një komitet këshillues i cili nuk do të kishte autoritetin të lëshojë vendime detyruese. Me anën e një marrëveshje reciproke në mes Zyrës së këshilltarit ligjor të

UNMIK-ut (ZKL) dhe Zyrës në Selinë e OKB-së (Selia e OKB-së) për Çështje Ligjore në Nju Jork, ishte përzgjedhur opsioni i fundit (minimal).

11. Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMiK) menjëherë bëri disa komente, të cilat mbesin esenciale deri më tani. Ai theksoi që "themelimi i një institucioni kuazi-gjyqësor, i cili nuk mund të nxjerrë vendime detyruese është në kundërshtim me parimet e sundimit të ligjit në të cilat thuhet se askush, veçanërisht një autoritet qeveritar (UNMIK-u), nuk është mbi ligjin. Kjo qartas do t'u dërgonte mesazh të gabuar popullit dhe institucioneve të Kosovës." OMiK, po ashtu, mendoi që në Rregulloren e UNMIK-ut mbi themelimin e Panelit duhet të thuhet në mënyrë të qartë se cilat lloje të vendimeve Paneli do të ishte i autorizuar t'i nxjerrë. Në lidhje me këtë, OMiK konsideroi se vendimet e Panelit duhet të përfshijnë mundësinë që t'i ndahet një shumë specifike e kompensimit të drejtë viktimës (ve), duke përfshirë dëmshpërblimin.

Historiku i hershëm i Panelit

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12

12. Teksti kryesor legjislativ për funksionimin e UNMIK-ut është Rregullorja nr. 2006/12 e 23 marsit të vitit 2006 mbi "Themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut". Por disa komentues vërejtën që themelimi i tij shtatë vjet pas vendosjes së UNMIK-ut, ishte me vonesë edhe për shtatë vjet. Kjo nënkuptonte se që nga fillimi, përveç kufizimeve të qenësishme në modelin e përzgjedhur, Paneli përballej me shumë sfida në rolin e vet si një mekanizëm efektiv për sa i përket përgjegjësisë së OKB-së për funksionimin e një misioni në terren.

13. Sa i përket kompetencës së vet *ratione materiae*, Rregullorja i jep Panelit juridiksionin të shqyrtojë një gamë të gjerë të ankesave për të drejtat e njeriut që i atribuohen UNMIK-ut, sipas të gjitha instrumenteve ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale e 4 nëntorit të vitit 1950 dhe protokollet me të (KEDNJ), Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike e 16 dhjetorit të vitit 1966 dhe protokollet me të (KNDCP), Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e 16 dhjetorit të vitit 1966 (KNDESK), Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor e 21 dhjetorit të vitit 1965 (KNEDR), Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave e 17 dhjetorit të vitit 1979 (KEDKG), Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Tjetër Mizor, Jonjerëzor dhe Degradues e 17 dhjetorit të vitit 1984 (KKT) dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijëve e 20 dhjetorit të vitit 1989 (KDF).

14. Kompetenca *ratione personae* e Panelit, sipas Rregullores, ishte e kufizuar në shqyrtimin e ankesave të paraqitura para tij nga individët apo grupet që pohonin se kanë qenë viktimë (a) të një shkelje të të drejtave të njeriut. Veç kësaj, ajo ka të bëjë vetëm me shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera nga UNMIK-u e jo KFOR-i.

15. Sa i përket kompetencës së vet *ratione temporis*, Rregullorja vendos kompetencën e juridiksionit të përkohshëm të Panelit për ankesat që kanë të bëjnë me "shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur jo më herët se 23 prill 2005 apo që rrjedhin nga faktet të cilat kanë ndodhur para kësaj date, ku këto fakte shkaktojnë një shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut." Pasi përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me drejtësinë dhe policinë në Kosovë më 9 dhjetor 2008 iu bart Bashkimit Evropian (BE-së), i cili themeloi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX), kompetenca e Panelit ishte e kufizuar në faktet të cilat kanë ndodhur para asaj date.

16. Neni 3 i Rregullores së përmendur ka përcaktuar një numër kriteresh për pranueshmëri të ankesave. Këto kritere korrespondonin në esencë me ato të cekura në nenin 35 të KEDNJ-së.

17. Për sa i përket rezultatit të procedurave para Panelit, neni 17 i Rregullores siguroi që Paneli "paraqet të gjeturat nëse ka pasur një shkelje të të drejtave të njeriut dhe, ku është e nevojshme, jep rekomandime". Ai siguroi, po ashtu, që PSSP-ja të ketë autoritetin dhe lirinë përfundimtare të veprimit që të vendosë për të vepruar lidhur me të gjeturat e Panelit. Në fund, të dyja, të gjeturat dhe rekomandimet e Panelit dhe vendimi i PSSP-së do të publikohen shpejt, që nënkupton se procedurat para Panelit, ndërsa vetvetiu janë konfidenciale, duhet përfunduar në një mënyrë plotësisht transparente.

Rregullorja e punës

18.Në nenin 18 të Rregullores parashihet që Paneli ta miratojë Rregulloren e punës për procedurat e veta. Në fakt, Rregullorja u frymëzua në Rregulloren e punës të Dhomës për të Drejtat e Njeriut në Bosnjë e Hercegovinë, një organ gjyqësor i themeluar sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kornizë për Paqe në Bosnjë e Hercegovinë. Për dispozita të caktuara, Rregullorja e punës e GJEDNJ-së, po ashtu, shërbeu si një burim frymëzimi.

19. Paneli synonte t'i japë një kuptim konkret natyrës kuazi-gjyqësore të mekanizmit të krijuar me Rregullore, veçanërisht duke formalizuar procedurën, duke theksuar faktin që kontrollonte udhëheqjen e procedurave, duke theksuar se pikëpamjet e Panelit do të bazohen në norma ligjore, duke ofruar një lloj të procedurave adversariale dhe duke qartësuar se vendimet e veta (mbi pranueshmërinë) dhe mendimet (mbi bazueshmërinë) do të hartohen në mënyrën që zakonisht hartohen vendimet e gjykatës.

Urdhëresa Administrative nr. 2009/1 e 17 tetorit të vitit 2009

20. Në fakt, UNMIK-u nuk u duk se e kuptoi se çfarë shkaktoi një mekanizëm i pavarur për ankesa, siç tregohet me kundërshtimin e vendimit të Panelit për të mbajtur një seancë dëgjimore publike në rastin *Balaj dhe të tjerët*. Kundërshtimi i PSSP-së, i cili çoi tek anulimi i seancës dëgjimore, e përshpejtoi procesin që çoi te miratimi i Urdhëresës Administrative (UA) nr. 2009/1 më 17 tetor 2009, e cila në thelb e kufizon veprimin e PKDNJ-së.

21. Dy dispozita kryesore të UA kishin një ndikim të rëndësishëm. E para, mbi funksionimin e Panelit, ai theksonte se çështjet e pranueshmërisë shqyrtohen "në çdo fazë të procedurave", që nënkupton se çështjet e pranueshmërisë mund të ngritën në çdo moment, madje edhe pasi një ankesë është shpallur e pranueshme. Neni 2.3 i UA konfirmoi këtë interpretim ku ai siguroi që: "Nëse çështjet e pranueshmërisë së një ankese adresohen në çfarëdo kohe, pasi Paneli Këshillëdhënës ka marrë një vendim mbi pranueshmërinë e ankesës dhe ka filluar me shqyrtimin e bazueshmërisë, Paneli Këshillëdhënës do të suspendojë shqyrtimin e vet për bazueshmëri deri në një kohë të tillë që për pranueshmërinë e ankesës është bërë rivlerësim i plotë dhe vendosur përsëri". Kjo nënkuptonte që kjo dispozitë mund të çonte në situatat ku një vërejtje mbi pranueshmërinë e një ankese që më parë është shpallur e pranueshme rezultoi në vonesa të konsiderueshme të procedurave. E dyta, neni 5 i UA ofronte datë të fundit për dorëzimin e ankesave te Paneli: 31 marsin e vitit 2010. Ankesat e pranuara pas asaj date do të refuzoheshin.

Trashëgimia ligjore e Panelit

22. Trashëgimia ligjore e Panelit qëndron në kontributin e tij drejt progresit të jurisprudencës për të drejtat e njeriut.

Pamje e përgjithshme

23. Numri i rasteve të pranuara nga Paneli u ngrit kur ekzistenca e tij u bë më mirë e njohur. Dy ankesa janë pranuar në vitin 2006, 12 në vitin 2007, 69 në vitin 2008, 352 në vitin 2009 dhe 89 në vitin 2010. Janë paraqitur gjithsej 527 ankesa. Për sa i përket identitetit të ankuesve, shumica e tyre ishin serbë të Kosovës, vetëm disa nga ta shqiptarë të Kosovës. Disa ankues u takonin grupeve minoritare, kryesisht romë, ashkali dhe egjiptianë (RAE). Shumë nga ankesat kishin të bënin me vdekjen dhe zhdukjen e të afërmve të moshuar. Në fakt, ankesat e paraqesin një pamje jashtëzakonisht të qartë të pasojave për të drejtat e njeriut, ku konflikti ishte bazuar në ndarje etnike si dhe ku është i kombinuar me tranzicion nga një regjim socialist – dy karakteristika që ishin të pranishme në kontekstin e Kosovës. Në sfond të kësaj, aspekti kryesor i trashëgimisë ligjore të Panelit qëndron në kontributin e tij për jurisprudencën për të drejtat e njeriut.

24. Vendimi i Panelit që të mbështetet në KEDNJ-në dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së e vendosi thellë PKDNJ-në në Evropë, në një kontekst që tanimë ishte i njohur mirë dhe i vendosur. Megjithatë, ekziston një numër i rasteve ku Paneli shtyri kufijtë e jurisprudencës së GJEDNJ-së, duke bërë që rastet e tij të ndryshojnë (apo zgjerohen) nga ato të GJEDNJ-së. Ato kishin të bënin, veçanërisht, me përcaktimin e standardeve të aplikueshme ligjore ku keqbërjet ishin kryer nga aktorë joshtetërorë; aplikueshmërinë e mbrojtjeve esenciale të nenit 2 të KEDNJ-së në një organ të OKB-së në kontekst të kundërshtimit publik; zgjerimin e *ratione temporis* të Panelit përmes obligimeve procedurale të nenit 2 të KEDNJ-së, në veçanti natyrës së vazhdueshme të obligimit për t'i hetuar vdekjet në rrethana të dyshimta dhe zhdukjet; aplikueshmërinë e nenit 3 të KEDNJ-së në një organ të OKB-së duke përfshirë shkeljet në lidhje me trajtimin jonjerëzor dhe degradues të të afërmve të personave të zhdukur dhe/apo vrarë; aspektin procedural të nenit 5 të KEDNJ-së.

25. Por Paneli ishte unik në atë se ai nuk ishte lidhur vetëm me GJEDNJ-në. Përfshirja e një game të gjerë të traktateve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në instrumentet themelore të Panelit, i lejoi atij një fleksibilitet për të qenë inovativ – një mundësi unike për të zhvilluar jurisprudencën si një organ kuazi-gjyqësor duke kërkuar burime të ndryshme. Prandaj, Paneli e shfrytëzoi praktikën gjyqësore dhe komentet e përgjithshme të organeve të tjera sikur komitetet e OKB-së për traktatet për të drejtat e njeriut apo të institucioneve të sistemit ndër-amerikan për të drejtat e njeriut. Ky diversitet i burimeve i lejoi Panelit, ta përshtatë, ku ishte e mundshme, jurisprudencën më relevante për të drejtat e njeriut me kontekstin e Kosovës, duke përfshirë madje marrjen parasysh të raporteve të raportuesve, për shembull lidhur me të drejtën në të vërtetën. Kjo u dëshmua veçanërisht e dobishme në kontekst të lëndëve të Panelit që kanë të bëjnë me dhunën kundër grave, ku Paneli shfrytëzoi KEDKG-në dhe jurisprudencën e saj.

Lëndët që kanë të bëjnë me pronën

26. Duke pasur parasysh numrin e personave të cilët u larguan nga Kosova gjatë dhe pas dhunës, duke braktisur pronat e tyre në proces dhe lënë të cenueshme për t'u marrë nën kontroll, nuk është befasi se, nga fillimi i vitit 2008, një pjesë e rëndësishme e ankesave të trajtuara nga Paneli ishte me një natyrë pronësore. Duke pasur parasysh se në shumicën e rasteve shkeljet esenciale për pronë ndodhën para fillimit të juridiksionit të Panelit (p.sh. 23 prill 2005), nuk ishte e mundshme të shqyrtohet dëmi apo dëmtimi aktual i shkaktuar nga ato shkelje të hershme. Megjithatë, në shumicën e rasteve pezullimi i procedurave gjyqësore me urdhër të Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut (DD) rezultoi me vonesë prej së paku katër vjetësh në madje fillimin e procedurave dhe një pjesë substanciale e asaj vonese i takoi periudhës nën juridiksionin e përkohshëm të Panelit. Prandaj, Paneli ka marrë qëndrimin se këto raste duhet shqyrtuar sipas nenit 6 të KEDNJ-së, për të qenë specifik çështjet e qasjes në drejtësi dhe vonesat në procesin gjyqësor.

27. PSSP-ja e ka argumentuar, në emër të UNMIK-ut, se duhet pasur konsideratë të veçantë për rrethanat e jashtëzakonshme me të cilat ai u përball në sfidën e balancimit të administrimit të përgjithshëm të drejtësisë me të drejtat e njeriut. Paneli konsideroi se në asnjë rrethanë këto elemente nuk mund të merren si arsyetim për uljen e standardeve të respektimit të të drejtave të njeriut, të cilat u inkorporuan sipas rregullit në mandatin e UNMIK-ut.

28. Për të gjitha "14,000 rastet" e shpallura të pranueshme, Paneli rekomandoi që UNMIK-u duhet bërë përpjekje, me të gjitha mjetet në dispozicion të tij *vis-à-vis* autoriteteve të Kosovës, të marrë siguri që rastet e paraqitura nga ankuesit do të trajtohen si duhet. Paneli, po ashtu, rekomandoi që UNMIK-u t'iu ndajë kompensim adekuat secilit nga ankuesit për dëmin jomaterial të shkaktuar si rezultat i pezullimit të gjatë të procedurave të nisura nga ata.

Lëndët për persona të zhdukur dhe të vrarë (PZHV)

29. Shumica e ankesave të paraqitura në vitin 2009 kishin të bënin me mungesën e pretenduar të hetimit nga Policia e UNMIK-ut dhe autoritetet gjyqësore për ngjarjet që çuan te rrëmbimet, zhdukjet dhe/apo vrasjet e të afërmve të ngushtë të ankuesve në Kosovë.

Neni 2 i KEDNJ-së

30. Për sa i përket kualifikimit ligjor të ankesave, Paneli u mbështet në obligimin procedural sipas nenit 2 të KEDNJ-së. Ky koncept i obligimit procedural kryesisht doli nga situatat e humbjes së jetës në situata kërcënimi me jetë, ku asnjë dëshmi e fortë nuk mund të gjendej në bazë të materialit hetimor për të konstatuar një shkelje substanciale. Ai u bë një mjet shumë efektiv për të siguruar që autoritetet nuk do të jenë në gjendje ta shmangin përgjegjësinë sipas nenit 2 përmes kryerjes së hetimit të dobët. Paneli, po ashtu, theksoi që GJEDNJ-a ka gjetur shkelje të vazhdueshme të nenit 2 të KEDNJ-së, ku ka pasur dështim të autoriteteve për të kryer hetim efektiv, efektet e të cilit vazhdojnë me kalimin e kohës e që lejon shqyrtim të rasteve kur zhdukja e hershme apo vrasja ndodhën para juridiksionit të Panelit. Vonesa për të ndërmarrë hapa vendimtarë apo mosndërmarrja e hapave të nevojshëm mund të shkaktojë më pas shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së. Në fund, Paneli konsideron se obligimi procedural nuk kufizohet në rastet ku është vërtetuar se vrasja është shkaktuar nga një "agjent i shtetit" por vlen, po ashtu, për aktorët joshteterorë dhe ai zgjeron nenin 2 për t'i mbuluar rastet e zhdukjeve.

31. Për sa i përket aplikueshmërisë së nenit 2 për UNMIK-un në kontekstin e Kosovës, ndërsa kuptohet që vendosja dhe organizimi i policisë dhe aparatit të drejtësisë ndodhi gradualisht, Paneli thekson se ky proces ka përfunduar në vitin 2003, kur sistemi i policisë dhe drejtësisë në Kosovë është përshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së si sistem që "funksionon mirë" dhe "i qëndrueshëm". Prandaj, ai mendon se, madje edhe nëse karakteri i përkohshëm i UNMIK-ut dhe vështirësitë e ngjashme duhet marrë parasysh siç duhet, në asnjë rrethanë këto elemente nuk mund të merren si arsyetim për uljen e standardeve të respektimit të të drejtave të njeriut, të cilat u inkorporuan sipas rregullit në mandatin e UNMIK-ut.

32. Lidhur me situatat e konfliktit apo dhunës së përgjithësuar, Paneli rikujton që GJEDNJ dhe KDNJ provuan se obligimi procedural për të mbrojtur jetën, dhe më pas, hetimin e ndonjë humbje jete vazhdon të vlejë në situatat pas konfliktit, duke përfshirë kushtet e vështira të sigurisë. Është e kuptueshme, po ashtu, se hetuesit mund të hasin pengesa dhe kufizimet konkrete mund të detyrojnë përdorimin e masave më pak efektive të hetimit apo mund të bëjnë që ndonjë hetim të shtyhet. Megjithatë, e drejta për jetë, duke përfshirë garancitë e veta procedurale, konsiderohet si e drejtë supreme nga e cila nuk lejohet kurrfarë shmangie, madje edhe në kohën e emergjencave publike të cilat kërcënojnë jetën e kombit.

33. Siç është identifikuar nga Paneli, çështjet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me procesin hetimor dhe që çojnë te një shkelje e obligimit procedural sipas nenit 2 të KEDNJ-së mund të ndahen në tri kategori kryesore. Disa kanë të bëjnë me vetë procesin hetimor, si për shembull vonesat e rëndësishme në veprime fillestare apo mungesa e mbrojtjes së dëshmitarëve nga kërcënimet dhe frikësimi. Të tjerat janë çështje strukturore, si për shembull të metat në bashkërendim dhe bashkëpunim në mes UNMIK-ut dhe TNPJ-së, apo mungesa e shqyrtimit të duhur prokurorial. Në fund, të tjerat janë çështje të politikave, si për shembull mosveprimi i autoriteteve sepse hetimet e tilla nuk konsideroheshin prioritet.

Neni 3 i KEDNJ-së

34. Në shumë raste ankuesit, po ashtu, pretendojnë për mungesë të një hetimi adekuat penal për incidentet që çuan te humbja e të afërmve të tyre dhe mungesën e informatave nga autoritetet e UNMIK-ut në lidhje me hetimet që u shkaktoi atyre dhimbje dhe vuajtje mentale, në shkelje të pjesës esenciale të nenit 3 të KEDNJ-së.

35. Paneli i shqyrtoi periudhat e mosveprimit të plotë (apo pothuaj të plotë) të autoriteteve, veçanërisht në situatat kur kishte në dispozicion informata minimale të nevojshme për të ndjekur hetim. Mendimi i parë ku çështjet e nenit 3 janë marrë parasysh së bashku me nenin 2 është miratuar nga Paneli më 23 prill 2013, në rastin *Jociq*.

36. Kur afërsia e lidhjeve familjare në mes viktimës (e) dhe ankuesve është provuar, Paneli plotësisht e mori parasysh atë nëse ankuesit ishin mbajtur rregullisht të informuar për procesin e hetimit, apo nëse ishin kontaktuar fare nga autoritetet e UNMIK-ut. Për shembull, në shumë raste ankuesit janë lënë pa ndonjë informatë dhe disa nga ta i kanë kryer hetimet vetë. Po ashtu, Paneli verifikoi nëse ankuesi ishte informuar nga policia, si palë e dëmtuar apo dëshmitar. Ndodhi në disa raste që ata të kontaktohen me telefon, por në shumicën e rasteve deklaratat e tyre nuk janë regjistruar zyrtarisht.

Diskriminimi kundër pjesëtarëve të komuniteteve minoritare

37. Tensionet dhe diskriminimi ndëretnik kanë mbetur të përhapura në Kosovë pas konfliktit. Megjithatë, Paneli pranoi drejtpërdrejt vetëm një numër të kufizuar të ankesave për diskriminim, kryesisht nga anëtarët e komuniteteve joshumicë të Kosovës në kontekst të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore (NSH). Megjithatë, Paneli ishte gjithmonë vigjilent për diskriminimin themelor të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë.

38. Nga lënda *Ristiq* doli se UNMIK-u kishte krijuar me sa duket një kornizë neutrale ligjore për të rregulluar shpërndarjen e të ardhurave por e cila, paevitueshëm, krijoi pabarazi në mesin e punëtorëve në bazë të etnisë, për shkak të ambientit pas lufte. Paneli theksoi se rregulla të caktuara, si dhe interpretimi dhe implementimi i tyre praktik nga AKM-ja dhe Dhoma e Posaçme, dështuan t'i marrin parasysh nevojat specifike dhe situatën e cenueshme të atyre punëtorëve.

39. Rast tjetër kyç për diskriminim ishte *N.M. dhe të tjerët*, të gjeturat e të cilit janë shqyrtuar më poshtë. Ky rast solli në vëmendje të Panelit çështjen e margjinalizimit historik të romëve në Evropë, së bashku me çështjen e diskriminimit të shumëfishtë dhe shumëdrejtimësh që përjetuan ankuesit si persona të zhvendosur së brendshmi (PZHB), si pjesëtarë të komunitetit RAE në Kosovë dhe, për ankueset femra, si gra, të vendosur në kampet e kontaminuara me plumb në Mitrovicën veriore.

40. Paneli konstatoi se dështimi i UNMIK-ut në situatën e ankuesve ishte i përcjellë me paragjykim racor kur, për shembull, për krizat shëndetësore në kampe gjendej fajtori te mënyra "jo e shëndetshme" e jetës e PZHB-ve RAE dhe argumenti që UNMIK-u nuk mundi t'i largojë ata në një

vend alternativ të sigurt ishte "i pranueshëm" për të gjitha palët. Paneli theksoi që UNMIK-u e kishte, përveç obligimit të mos diskriminojë, për obligim ta shmangte zgjatjen e praktikave diskriminuese të autoriteteve lokale në Kosovë ndaj komunitetit RAE.

41. Paneli, po ashtu, theksoi dështimin e UNMIK-ut për të pasur një qëndrim të ndjeshëm sa i përket gjinisë për situatën, duke përjashtuar të shqyrtuarit e asaj se si helmimi me plumb ndikonte ndryshëm dhe në mënyrë joproporcionale në shëndetin dhe mirëqenien e grave RAE në kampe. Prandaj, Paneli gjeti se dështimi për t'i ndërmarrë veprimet e kërkuara korrigjuese – për shembull duke mos iu ofruar kontroll të rregullt dhe përkujdesje adekuate shëndetësore grave shtatzëna – rezultoi me diskriminim shtesë të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë, në shkelje të nenit 12 të KEDKG-së dhe Rekomandimit të përgjithshëm të Komitetit të KEDKG-së nr. 24.

Qasja në drejtësi

42. Kategori tjetër e rëndësishme e ankesave të dorëzuara Panelit përfshinte çështjet e lidhura me qasjen në drejtësi, siç përkufizohet me nenin 6 të KEDNJ-së. E kaluara tregon se pas konfliktit në Kosovë në qershor të vitit 1999 përafërsisht 225,000 serbë me etni, romë, goranë dhe etnitete tjera ikën për arsye sigurie në pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë. Menjëherë më pas, një numër i madh i pronave të banimit, atyre bujqësore dhe komerciale ishte zënë ilegalisht dhe shkatërruar. Me qëllim të krijimit të një mekanizmi ligjor për t'i kthyer këto prona dhe të mos bëhen grumbullime të panevojshme lëndësh në gjykatat lokale, UNMIK-u themeloi organe kuazi-gjyqësore që u specializuan në raste të pronave, përkatësisht Drejtorinë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB) dhe Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB).

43. Në rastin *Vuçkoviq*, ankuesi solli prova se KKPB, si një organ më i lartë për zgjidhjen e kontesteve lidhur me të drejtat e banimit dhe pronës, shkeli të drejtën e tij për një gjykim të drejtë për një numër arsyesh. Paneli u ndesh kështu me çështjen e aplikueshmërisë së nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, meqë kjo dispozitë në parim vlen vetëm për procedurat para një tribunali i cili përcakton të drejtat dhe obligimet civile. Në këtë kontekst, Paneli theksoi se megjithëse KKPB nuk ishte një gjykatë klasike, ai ishte një organ që trajtonte numër të madh kërkesash dhe i cili lëshoi vendime detyruese dhe imponuese. Në këtë bazë, Paneli përfundoi që KKPB ishte së këndejmi i ligjshëm në funksion të tillë që neni 6 i KEDNJ-së u zbatua në procedurat para tij.

44. Në rastin *Mitroviq*, ku PKDNJ-së iu kërkua të vendosë nëse KKPB ishte një tribunal i paanshëm, ai bëri një test objektiv për të përcaktuar nëse kishte fakte të konstatuara, të cilat do të mund të ngritin dyshime për paanësinë, nëse kishte një arsye legjitime për t'u frikësuar se mungoi paanshmëria dhe nëse frika mund të konsiderohej të jetë e arsyeshme objektivisht. Paneli shqyrtoi jurisprudencën relevante të GJEDNJ-së, e cila ka konsideruar se pjesëmarrja në procedura apelimi të gjykatësve, të cilët janë marrë me rastin në procedurat e shkallës së parë mund, të përbëjë shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së.

45. Rastet e tjera që i janë dorëzuar Panelit kishin të bënin me të drejtën për t'i zbatuar vendimet përfundimtare vendore, sipas nenit 6 të KEDNJ-së. Në rastin *Kushiq*, Paneli duhej të vendoste nëse mosekzekutimi i implementimit të një vendimi të KKPB për më shumë se nëntë vjet kishte shkelur të drejtën e ekzekutimit të një vendimi brenda një kohe të arsyeshme. Ai përfundoi që vonesa në ekzekutimin e vendimit të KKPB-së ishte paarsyeshëm e gjatë dhe se ishte bërë një shkelje e nenit 6 të KEDNJ-së.

Të drejtat ekonomike dhe sociale

46. Paneli shqyrtoi dy raste për shkelje të pretenduar të së drejtës në sigurim social për të qenë i mbrojtur nga rreziqet sociale dhe pasiguritë në të ardhmen, siç janë mosha e vjetër dhe papunësia

madje edhe ne kohën e kufizimeve në burime apo ristrukturimit të ekonomisë. Në rastin *Krasniqi*, Paneli vlerësoi përpjekjet e bëra nga UNMIK-u për të zgjidhur situatën e atyre pensionistëve të cilët kishin kontribuuar dhe fituar të drejtat e pensionit në kuadër të skemës pensionale të ish-Jugosllavisë dhe pensionet e tyre ishin ndalur nga autoritetet e Beogradit si pasojë e konfliktit. Në pajtim me shqetësimet e shprehura nga Komiteti i OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, dhe duke marrë në konsideratë nevojat e veçanta dhe cenueshmërinë e personave të moshuar, Paneli konsideroi që pensioni mujor prej 45 eurosh që i është ofruar ankuesit gjatë juridiksionit të Panelit, nuk ishte i mjaftueshëm për të garantuar qasjen e tij në shërbimet dhe të mirat themelore dhe esenciale.

47. Në rastin *Punëtorët e minierave Kishnicë dhe Novobërdë të Kombinatit Trepça*, Paneli e rikonfirmoi parimin se autoritetet shtetërore e kanë për obligim sipas KNDESK-së të rregullojnë sipas ligjit dhe mbikëqyrin sigurimin e përfitimeve të sigurimit social. Në të dyja këto raste, Paneli përfundoi që, pasi ankuesit janë lënë pa mjete adekuate për të mbështetur veten dhe familjet e tyre, e drejta e tyre për standard adekuat të jetesës, si pasojë, ishte shkelur.

48. Në rastin *B.K.*, lidhur me riatdhesimin me forcë të ankuesit në Kosovë në vitin 2008, Paneli e vlerësoi ankesën sipas standardeve të KEDNJ-së dhe KNDESK-së. Ai konstatoi se dështimi nga ana e UNMIK-ut për ta implementuar politikën e kthimit e kishte vendosur ankuesin në një situatë të varfërisë dhe nevojës ekstreme që është në mospërputhje me dinjitetin njerëzor, e cila përbën një shkelje të obligimeve minimale bazë të UNMIK-ut sipas neneve 9 dhe 11 të KNDESK-së, si dhe një shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së që ndalon trajtimin jonjerëzor dhe degradues.

Dhuna kundër grave

49. Në rastin *Kostiq*, Paneli konstatoi se UNMIK-u nuk kishte kujdesin e duhur në hetimin për shkelje kundër grave dhe tregoi që dështimi i vet për të kryer hetime të ndjeshme sa i përket gjinisë, mund t'i ketë kontribuuar mungesës së përgjithshme të dokumentacionit për dhunën seksuale të ndërlidhur me konfliktin në Kosovë dhe kjo vështirësoi qasjen në drejtësi dhe marrjen e dëmshpërblimeve nga viktimat. Paneli iu referua jurisprudencës së Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut (KDNJ), që një obligim pozitiv ekziston sipas nenit 9 të KNDCP-së *vis-à-vis* mbajtjes arbitrare të grave gjatë konfliktit të armatosur, e cila i bën ato veçanërisht të ekspozuara nga dhuna seksuale. Ai iu referua po ashtu instrumenteve ndërkombëtare, siç janë KEDKG-ja dhe Deklarata e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (AP e OKB-së) për Eliminimin e Dhunës Kundër Grave, duke e cilësuar mbajtjen arbitrare të grave si një formë të dhunës kundër grave, e që shtetet e kanë për obligim ta parandalojnë, hetojnë dhe dënojnë atë pavarësisht nëse kryhet nga agjentët e tyre apo persona privatë.

50. Në rastin *S.M.*, Paneli, në pajtim me jurisprudencën e GJEDNJ-së, KKT-së së OKB-së dhe Komitetin e KEDKG-së konstatoi se përdhunimi dhe vrasja nga ana e UÇK-së në qershor të vitit 1999 e një gruaje të re me paaftësi në praninë e nënës së saj, përbënte një akt të torturës si dhe të dhunës seksuale të bazuar në gjini dhe që UNMIK-u kishte shkelur obligimet e veta ndërkombëtare për ta hetuar dhe ndjekur atë me kujdesin e duhur.

51.Përveç dhunës të lidhur me konfliktin, Paneli gjeti që kushtet për vetabortim të PZHB-ve femra në kampet e kontaminuara me plumb për të shmangur lindjen e fëmijëve të prekur nga abnormaliteti, po ashtu, paraqisnin një formë të dhunës të bazuar në gjini.

Kontaminimi me plumb në kampet për PZHB

52. Rasti *N.M. dhe të tjerët*, që ka të bëjë me vendosjen e PZHB-ve RAE në kampet e kontaminuara me plumb, ngriti çështjet shumë të ndjeshme në lidhje me instrumentet e ndryshme për

të drejtat e njeriut. Paneli ishte i shqetësuar që përgjigjja joadekuate e UNMIK-t ndaj kësaj situate mund të jetë nxitur nga stereotipat diskriminues më parë sesa nga dëshmia shkencore, pasi kjo e fundit ka treguar që afërsia me Shkritoren e Trepçës dhe digat me mbetje paraqitnin burimin kryesor të kontaminimit me plumb. Duke marrë parasysh të gjeturat, Paneli e konsideroi të turpshme që një e dhënë e tillë i atribuohet veprimit dhe/apo mosveprimit të një entiteti të Organizatës së Kombeve të Bashkuara – UNMIK-ut – në thelb të mandatit të të cilit ishte mbrojtja e personave të shpërngulur nga konflikti.

53. Për sa i përket të drejtës në jetë, Paneli konsideroi se të dhënat treguan se ekspozimi i rëndë në kontaminim, i shoqëruar me kushtet e rënda të jetës në kampe, një situatë që zgjati për më shumë se dhjetë vjet, ishte i tillë që paraqiste kërcënim real dhe të drejtpërdrejtë për jetën dhe integritetin fizik të ankuesve. Në vakuumin rregullues dhe institucional në Kosovë pas konfliktit, të gjeturat dhe rekomandimet e ekspertëve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH-së) si dhe organeve tjera të specializuara, është dashur të udhëheqin veprimet e UNMIK-ut në përgjigje ndaj krizës shëndetësore në kampe. Në veçanti, Paneli vërejti se shumica e masave të rëndësishme preventive siç ceken nga OBSH nuk ishin implementuar, apo ishin implementuar për vetëm një periudhë shumë të kufizuar kohore.

54. Paneli, po ashtu, rikujtoi që GJEDNJ ka vendosur që obligimet pozitive sipas nenit 2 në kontekst të aktiviteteve të rrezikshme dhe çështjeve ambientale, përfshijnë obligimin e autoriteteve kompetente që të sigurojnë qasje në informata esenciale, që u mundësojnë individëve të vlerësojnë rrezikun për shëndetin dhe jetët e tyre. Në lidhje me këtë, Paneli konsideroi që UNMIK-u nuk u ofroi informata adekuate ankuesve në lidhje me rreziqet për shëndetin dhe jetët e tyre që buronin nga prania e tyre e përhershme në kampe.

55. Për sa i përket ndalimit të torturës dhe trajtimit jonjerëzor dhe degradues, Paneli nuk e nënvlerësoi barrën, me të cilën UNMIK-u duhej të përballej menjëherë pas arritjes së tij në Kosovë pas konfliktit dhe vlerësoi përpjekjet e tij për rindërtim. Në këtë drejtim, Paneli nuk e përjashton përgjegjësinë e UNMIK-ut ndaj ankuesve, veçanërisht kur merret parasysh se situata për të cilën bëhet ankesë, zgjati për më shumë se dhjetë vjet.

56. Për më tepër, Paneli nuk mundi ta pranojë as argumentimin e PSSP-së se romët historikisht jetuan në kushte jetese nën standarde, madje edhe para konfliktit. Ky koment mund të jetë diskriminues dhe përulës, meqë ai sugjeron që margjinalizimi social dhe ekonomik i romëve bazohet në racë dhe në vetë veprimet e tyre, dhe si i tillë, mund të përjetësohet pa përgjegjësi.

57. Për sa i përket të drejtës në shëndet dhe standard adekuat të jetesës, Paneli konstatoi se UNMIK-u dështoi të bëjë monitorim sistematik të kontaminimit nga plumbi në kampe, përmes testeve të rregullta të gjakut si dhe theksoi se terapia përkatëse ishte ofruar vetëm për pak muaj, me rezultat që shumica e PZHB-ve ishin lënë pa trajtim mjekësor.

58. Lidhur me diskriminimin ndaj ankueseve femra, Paneli konsideroi se ka pak hapësirë për dyshim se, *de facto*, ankueset femra ishin prekur gjithashtu dhe në mënyrë joproporcionale nga gjendja jashtëzakonisht jo e shëndetshme në kampe. Paneli vërejti se që nga ditët e veta të hershme, UNMIK-u ishte në dijeni për rrezikun e madh që shkakton helmimi me plumb te gratë shtatzëna dhe fëmijët.

59. Paneli theksoi që, në këto rrethana, UNMIK-u e kishte obligimin sipas KEDKG-së që të miratojë masa pozitive për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate situatës së tyre veçanërisht të pafavorshme. Këto përfshinin: obligimin për të siguruar që gratë shtatzëna të mund të mbajnë shtatzëninë e tyre në një ambient të sigurt, për të siguruar qasje të lehtë për ekzaminim të rregullt dhe përkujdesje adekuate shëndetësore për gratë shtatzëna, qasje adekuate në higjienë dhe ushqim,

mbledhje të të dhënave për lindjet e fryteve të vdekura dhe dështimet me qëllim të monitorimit, sigurimit të shërbimeve psikologjike dhe mbështetëse për ato gra që kanë pasur dështim, abort apo lindje të frytit të vdekur.

60. Për sa u përket të drejtave të fëmijëve, Paneli konsideroi se jetët dhe shëndeti i fëmijëve, siç mbrohen nga KDF, është dashur të jenë të një konsiderate thelbësore që do të udhëhiqte përgjigjen e UNMIK-ut ndaj situatës. Megjithatë, Paneli theksoi se UNMIK-u nuk sqaroi apo ofroi ndonjë dokumentacion në lidhje me këtë se, si interesat më të mira të fëmijëve ishin marrë parasysh, vlerësuar dhe përcaktuar kur janë vendosur dhe miratuar masa në përgjigje ndaj situatës.

61. Si pasojë, Paneli konstatoi se përmes veprimeve dhe lëshimeve të veta, UNMIK-u ishte përgjegjës për rrezikimin në mënyrë të pakthyeshme të jetës, shëndetit, dhe potencialit zhvillimor të ankuesve që kanë lindur dhe janë rritur si fëmijë në kampe.

Rasti *Balaj dhe të tjerët*

62. Paneli duhej të vlerësonte nëse UNMIK-u kishte shkelur obligimin esencial dhe obligimin procedural sipas nenit 2 të KEDNJ-së në lidhje me të drejtën për jetë. Në rastin *Balaj dhe të tjerët*, ankuesit u ankuan se Policia e UNMIK-ut përdori forcë të tepruar gjatë një operacioni për kontroll të turmës në Kosovë më 17 shkurt 2007, që rezultoi me vdekje të dy viktimave dhe plagë të rënda trupore të tjerëve. Ky rast e kishte një historik të komplikuar procedural si rezultat i drejtpërdrejtë i UA.

63. Në fazën e bazueshmërisë, Paneli konstatoi se forca e përdorur për t'i shpërndarë demonstruesit nuk ishte "absolutisht e nevojshme" në kuptim të nenit 2(2) të KEDNJ-së. Përveç kësaj Paneli konstatoi se, megjithëse hetimi për rrethanat që çuan tek ato pasoja tragjike ishte i shpejtë, ai nuk dha garanci të mjaftueshme për pavarësi dhe paanshmëri dhe nuk përmbushi kërkesën për përpikëri. Në fund, ai konstatoi se intervenimi me forcë i policëve ishte joproporcional dhe jo i nevojshëm në një shoqëri demokratike për parandalimin e trazirës në kuptim të nenit 11(2) të KEDNJ-së.

Vlerësim kritik i përvojës së PKDNJ-së

Rekomandimet e Panelit

64. Deri më tani, kufizimi më i madh në krejt përvojën e Panelit ishte fakti se UNMIK-ut nuk ndoqi ndonjë nga rekomandimet e Panelit. Me gjithë procesin e gjatë të Panelit për të mbledhur informata nga ankuesit dhe UNMIK-u, lëshimit të vendimeve mbi pranueshmërinë, mendimeve dhe rekomandimeve, asgjë esencialisht e prekshme nuk doli nga ky aktivitet, pasi UNMIK-u dështoi të ndërmarrë ndonjëherë ndonjë veprim kuptimplotë në lidhje me rekomandimet e Panelit.

65. Në rastet e PZHB-ve, të cilat paraqitën të dyja grupin më të madh të ankesave që Paneli i pranoi si dhe disa nga shkeljet më serioze të të drejtave të njeriut, në lidhje me rekomandimet e Panelit që UNMIK-u t'u kërkojë ankuesve dhe familjeve të tyre falje publike, duke përfshirë mediet, PSSP-ja vetëm dërgoi një letër standarde në të cilën theksoi: "Unë shpreh keqardhjen e thellë se kishte një mungesë të hetimit efektiv për rrëmbimin dhe vdekjen e [të dashurit] tuaj, e cila ka shkaktuar shqetësim shtesë dhe vuajtje mentale." Paneli konstatoi se vetëm të shprehurit e "keqardhjes" nuk mund të paraqiste kërkim falje kuptimplotë.

66. Për sa i përket rekomandimit të Panelit për t'ua dhënë ankuesve kompensimin adekuat për dëmin e përjetuar moral, PSSP-ja nënvizoi se udhëzimet e tanishme mbi kompensimet të AP të OKB-së, sipas Rezolutës 52/247 (1998), nuk i lejojnë Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe misioneve të saj të paguajnë kompensim përveç dëmit material apo dëmtimit fizik.

67. Në maj të vitit 2015, PSSP-ja e alarmoi AP të OKB-së për situatën, duke mbrojtur krijimin e një mekanizmi të përshtatshëm për të kompensuar për dëmin moral, si dhe për hetim të mëtejmë nga autoritetet përkatëse gjyqësore, të rasteve të papërfunduara. PSSP-ja e përsëriti çështjen e njëjtë afërsisht një vit më vonë, por, pavarësisht kërkimit të informatave për këtë çështje, Paneli nuk është vënë kurrë në dijeni për ndonjë rezultat.

68. Për shkak të dështimit të UNMIK-ut për të ndjekur ndonjërin nga rekomandimet e Panelit, procesi i PKDNJ-së nuk ka ofruar asnjë dëmshpërblim për ankuesit. Si të tillë, ata janë viktimizuar dy herë nga UNMIK-u: nga shkeljet e hershme të të drejtave të njeriut të kryera kundër tyre dhe përsëri duke mos marrë asnjë kompensim gjatë këtij procesi. Për shumë vite, Paneli ka bërë analiza të detajuara të ankesave të sjella para tij dhe e ka nxitur UNMIK-un dhe OKB-në të përfshihen në disa aktivitete të dobishme në interes të ankuesve para se të përfundohet mandati i PKDNJ-së; për turp, kjo nuk ndodhi.

Kufizimet tjera

69. Paneli, po ashtu, është i vetëdijshëm se përvoja e vet është dëmtuar nga një numër faktorësh shumica e të cilëve janë përmendur më parë, në lidhje me mënyrën se si Paneli është themeluar dhe me kufizimet që janë paraqitur nga UNMIK-u për juridiksionin dhe funksionimin e tij që nga fillimi. Paneli ishte më tutje i kufizuar të trajtojë bazueshmërinë e ankesave nga UA.

70. Marrëdhënia e Panelit me UNMIK-un ishte, po ashtu, një faktor që ndikoi në efikasitetin e vet. Në përgjithësi, por veçanërisht në rastet e PZHV-e, kishte probleme në lidhje me qasjen e Panelit në dosjet hetimore. Në të vërtetë, u provua të jetë e vështirë të merren këto dosje, dhe në këtë mënyrë kjo i kontribuoi vonesës në punën e Panelit.

71. Veç kësaj, Paneli është formuar me insistimin e organeve të jashtme, kryesisht KiE-së, OSBE-së dhe Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë. Historiku i hershëm i PKDNJ-së e bënë të qartë se ai ishte i padëshiruar nga shumë brenda OKB-së dhe ishte iniciuar vetëm nën presion ndërkombëtar. Fakti që Paneli, në fakt, nuk u bë funksional deri pothuaj dy vjet pas miratimit të Rregullores nr. 2006/12, ishte një burim i vështirësive serioze.

Përfundime

72. Rëndësia e PKDNJ-së ishte vetë fakti i ekzistencës së tij dhe mandatit të tij për t'i vlerësuar veprimet e UNMIK-ut kundrejt instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Kur u themelua një organ i tillë kuazi-gjyqësor, i dukej qartë komunitetit ndërkombëtar i angazhuar për të drejtat e njeriut se legjitimiteti dhe kredibiliteti i OKB-së është i rrezikuar ku nuk ka përgjegjësi të tillë ligjore. Veç kësaj, sistemi për të drejtat e njeriut si i tërë dobësohet kur shtetet mund të shohin OKB-në– njërën nga mbrojtësit kryesorë të sistemit të të drejtave të njeriut në botë – që vetë të dështojë në përmbushjen e obligimeve që i ka promovuar. Kështu, Paneli është krijuar kryesisht për të qenë komponent kontribuues i përgjegjësisë së OKB-së – i pari i këtij lloji; së dyti, është shpresuar gjithashtu që Paneli do të jetë në gjendje të ofrojë disa përfitime në sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë.

73. Për sa i përket ndikimit të Panelit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në kuadër të hapësirës territoriale që është nën varësinë e një misioni të OKB-së, çështja kryesore relevante për secilin mekanizëm të ardhshëm të tillë është pesha që duhet t'u jepet mendimeve të Panelit. Në veçanti mospagesa e kompensimit për dëmin jomaterial mbetet një problem i vazhdueshëm. Ky thuhet të jetë një problem strukturor i OKB-së dhe si rrjedhim jashtë kontrollit të UNMIK-ut, por kjo është dashur të merret parasysh në kohën e themelimit të Panelit. Nëse OKB-ja nuk synon ndjekjen e rekomandimeve të Panelit, ajo e rrezikon krejt procesin.

74. Aktualisht ka akoma më së paku mbi 400 familje të personave të zhdukur apo vrarë në Kosovë në kohën e "Autoritetit të UNMIK-ut". Megjithatë, pas mbylljes së PKDNJ-së, nuk ka asnjë mekanizëm i cili mund t'i trajtojë ankesat e tyre. GJEDNJ nuk do të vendosë për asnjë rast kundër OKB-së dhe KFOR-it/NATO-s, për shkak të statusit të tyre; e njëjta qëndron për "procedurat speciale" të OKB-së. Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i EULEX-it, për shkak të kufizimeve të mandatit të vet, është në pozitë të vendosë vetëm për shkeljet e kryera nga strukturat e EULEX-it dhe është madje edhe më i kufizuar në rekomandimet e veta. Dhomat Speciale dhe Prokuroria Speciale që do të themelohen së shpejti, janë duke u krijuar vetëm për hetimin dhe ndjekjen e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, të cilat janë kryer në mes 1 janarit të vitit 1998 dhe 31 dhjetorit të vitit 2000. Institucioni i tanishëm i Ombudspersonit në Kosovë nuk ka asnjë juridiksion mbi praninë ndërkombëtare në terren. Ky vakuum është tepër problematik.

75. Nëse ne marrim në konsideratë ndonjë mekanizëm të ardhshëm të përgjegjësisë së OKB-së dhe formën optimale që një mekanizëm i tillë duhet të marrë, ai duhet të dizajnohet në mënyrë holistike dhe të përshtatet për gjendjen faktike të njerëzve në terren dhe kontekstin politik të misionit. Në veçanti, tri elemente kryesore duhet marrë parasysh: (i) si ai mund të funksionojë efektivisht nga fillimi për t'i marrë parasysh shqetësimet për të drejtat e njeriut të një popullate të cenueshme në një situatë pas konflikti; (ii) si të sigurohen rekomandime të duhura nga Paneli për sa u përket ankesave; dhe (iii) si të sigurohet një përgjigje e duhur nga misionin në fjalë i OKB-së.

76. Paneli identifikoi disa nga faktorët më të rëndësishëm për t'u marrë parasysh në çdo institucion të ardhshëm që themelohet për qëllimin e njëjtë apo të ngjashëm. Në mesin e tyre: një Panel për të drejtat e njeriut, jo një Panel "këshillëdhënës"; të themeluar nga Selia e Përgjithshme e OKB-së, jo nga misioni (organ i OKB-së, jo organ i UNMIK-ut); i aplikueshëm në gjithë praninë ndërkombëtare; i themeluar menjëherë pas mandatimit të misionit dhe i përfshirë në mandatin e tij; me procedura të bazuara në parimet e proceseve të drejta, transparente dhe adversariale; me mekanizma efektivë për dëmshpërblime, përfshirë pagesën e kompensimit, duke përfshirë dëmin jomaterial.

77. Në fund, planifikimi i duhur ligjor dhe i politikave do t'i trajtonte mënyrat për të siguruar pavarësi nga misioni i OKB-së por, po ashtu, bashkëpunimin e tij. Është, po ashtu, e nevojshme të miratohen masa për të siguruar të drejtën e vetëdijesimit publik nga fillimi ndërsa po ashtu sigurohet që realiteti dhe pritja janë të pajtueshme. Në fund, OKB-ja duhet të sigurojë jo vetëm pajtueshmërinë me rekomandime në rastet individuale. Shpresohet, më përgjithësisht, se OKB-ja do të miratojë ndryshime në praktikën dhe operacionet e misioneve të veta relevante për të respektuar premtimin e vet për të "promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut".

Shkurtesat dhe akronimet

AD – Udhëzimi Administrativ nr. 2009/1 i 17 tetorit të vitit 2009
ADL – Ligji i Kosovës kundër Diskriminimit
AI – Amnesty International
CAT – Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Tjetër Mizor dhe Jonjerëzor apo Degradues
CCIU – Njësiti Qendror për Hetim Penal
CCPR – Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
CEDAW – Konventa për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave
CESCR – Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
CoE – Këshilli i Evropës
Convention on Immunities –Konventa mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara
CRC – Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
DOJ – Departamenti i Drejtësisë
DPI – Departamenti për Informim Publik i UNMIK-ut
DRC – Këshilli Danez për Refugjatë
DSRSG – Zëvendësi i PSSP-së së UNMIK-ut
ECHR – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
ECtHR – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
EU – Bashkimi Evropian
EULEX – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
FRY – Republika Federale e Jugosllavisë
HPCC – Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore
HPD – Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore
HRAP – Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut
HRC – Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
HRW – Human Rights Watch
IACtHR – Gjykata Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut
ICCPR – Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
ICERD – Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor
ICESCR – Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore
ICMP – Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur
ICRC – Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
ICTY – Tribunali Ndërkombëtar për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi
IDP – Person i zhvendosur së brendshmi
ILC – Komisioni Ndërkombëtar për të Drejtën
KFOR – Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (zakonisht e njohur si Forca e Kosovës)
KLA – Ushtria Çlirimtare e Kosovës
KPA – Agjencia Kosovare e Pronës
KTA – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
MMP – Personat e zhdukur dhe të vrarë
MoU – Memorandum i Mirëkuptimit
MPU – Njësiti për Persona të Zhdukur
NGO – Organizatë joqeveritare
OHCHR – Zyra e Komisarit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut
OLA – Zyra për Çështje Ligjore
OMiK – Misioni i OSBE-së në Kosovë
OMPF – Zyra për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore
OSCE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSRSG – Zyra e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm
PACE – Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës
PAK – Agjencia Kosovare e Privatizimit
P-DSRSG – Zëvendësi kryesor i PSSP-së së UNMIK-ut

PISG – Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
RAE – Romë, ashkali dhe egjiptianë
SOE – Ndërmarrje shoqërore
SRSG – Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
UDHR – Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
UN – Kombet e Bashkuara
UNCTAD – Konferenca e Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi Tregtinë dhe Zhvillimin
UNDP – Programi për Zhvillim i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
UN HQ – Selia e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara
UN GA – Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara
UNMIK – Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNSC – Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
UNV – Vullnetarët e Organizatës së Kombeve të Bashkuara
WCIU – Njësiti për Hetim të Krimeve të Luftës
WHO – Organizata Botërore e Shëndetësisë

I. Hyrje

1. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ) në Kosovë është themeluar me Rregulloren e Administratës së Përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-ut) nr. 2006/12, "Mbi Themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut", për t'i shqyrtuar shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 e 10 qershorit të vitit 1999 (Rezoluta e KS të OKB-së 1244)[1], parashihte që prania civile ndërkombëtare, të cilën Sekretari i Përgjithshëm ishte i autorizuar ta themelojë, do të kishte kompetenca me ndikim të gjerë në Kosovë. Këto janë formalizuar në Rregulloren e parë që UNMIK-u e nxori, e cila vendosi që "[i]gjithë autoriteti legjislativ dhe ekzekutiv në Kosovë, duke përfshirë administrimin e drejtësisë, i jepet UNMIK-ut dhe ushtrohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm."[2] Në thelb UNMIK-u, një mision i OKB-së në Kosovë, kishte autoritetet e një shteti në pritje "të zhvillimit të institucioneve të përkohshme demokratike të vetëqeverisjes" në Kosovë. Rezoluta e KS të OKB-së 1244, po ashtu, përcaktoi që përgjegjësitë e pranisë ndërkombëtare civile, të cilat Sekretari i Përgjithshëm ishte i autorizuar t'i krijojë, do të përfshinin "Mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut." Kjo përgjegjësi nënkupton që misioni do t'i mbikëqyrë standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në operacionet dhe aktivitetet e veta si dhe të sigurojë që të tjerat janë në përputhje.

2. Vendosja e UNMIK-ut në qershor të vitit 1999 solli në plan të parë trendët në marrëdhëniet ndërkombëtare që çuan nganjëherë në drejtime të kundërta. Prandaj, ka pasur një përkushtim ndërkombëtar për sundimin e ligjit dhe të drejtat e njeriut si komponente kryesore në rindërtimin e paskonfliktit, duke i vënë në zbatim në një numër rastesh me mandatimin e një pranie ndërkombëtare. Ndërsa detyrat që kërkohen nga organizatat ndërkombëtare, për shembull si paqeruajtës, si paqendërtues në një mision administrativ civil, sikur ato përgjegjëse për refugjatë, janë shumëfishuar, janë shumëfishuar po ashtu mundësia dhe nevoja për kontakt të drejtpërdrejtë me banorët e një territori në të cilin ata janë vendosur. Në rastin e UNMIK-ut, këto detyra ishin të larmishme dhe të gjera: administrata e UNMIK-ut preku të gjitha aspektet e jetës – të dyja politike dhe institucionale –; nga komuna më e vogël deri te vendimet për atë se çfarë marrëdhëniesh do të ketë me fqinjët e vet, pra të gjitha vendimet mbi territorin e Kosovës janë marrë nga UNMIK-u.

3. Kontrolli i plotë i UNMIK-ut në Kosovë, po ashtu, kishte për pasojë rritjen e potencialit për kryerjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut, siç janë burgosjet arbitrare, ndërhyrja në lirinë e shprehjes si dhe ndërhyrja në drejtësi. Shkeljet e tilla mund të shihen nga organizata ndërkombëtare si të arsyetueshme me nevojën për t'i shtypur elementet armiqësore apo ndarëse dhe neutralizuar kërcënimet për siguri në një ambient të trazuar pas konfliktit, por kredibiliteti dhe legjitimiteti i një misioni të OKB-së i mandatuar të kryejë detyra për ndërtimin e paqes në një shoqëri të shkatërruar nga lufta, rrezikohet pa respektimin e përpiktë të të drejtave të njeriut.

[1] Rezoluta e KS të OKB-së 1244 mbi situatën në Kosovë, S/RES/1244 (1999), 10 qershor 1999.
[2] Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/1 "Mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë", 25 korrik 1999.

4. Situata u rëndua nga imuniteti i gjatë nga juridiksioni në vendin e caktuar që i ishte dhënë personelit të OKB-së që nga miratimi i Konventës së vitit 1946 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi Privilegjet dhe Imunitetet (Konventa mbi Imunitetet).[3] Në Kosovë kjo është plotësuar me Rregulloren nr. 2000/47 "Mbi Statusin, Privilegjet dhe Imunitetet e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe Personelit të tyre në Kosovë", e nxjerrë në gusht të vitit 2000 nga UNMIK-u dhe që siguron që, *inter alia* "Personeli i UNMIK-ut do të jetë i përjashtuar nga çdo formë e arrestimit apo mbajtjes", përveç kur hiqet dorë nga kjo e drejtë nga Sekretari i Përgjithshëm në rrethana të jashtëzakonshme. Prandaj, nuk kishte asnjë mënyrë për t'i mbajtur ata në UNMIK përgjegjës për shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera në Kosovë. Kjo ishte po ashtu kundër trendit të një numri më të madh shtetesh që tërhiqeshin nga imuniteti absolut i shtetit dhe pranonin imunitet kufizues. Duket disi e gabuar që shtetet sovrane janë të përgatitura të pranojnë përgjegjësinë më lehtë sesa institucionet ndërkombëtare që ato i mandatuan të kryejnë funksione në emër të tyre.

5. Megjithatë, shqetësimi rreth mungesës së përgjegjësisë për kryerjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut të kryera nga organizatat ndërkombëtare nuk ishte i kufizuar në Kosovë. Abuzimet e bëra nga personeli i OKB-së ishin bërë çështje për shqetësim pas zbulimit të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual dhe përfshirjes në krim të organizuar dhe trafikim në misionet në Afrikë, Ballkan dhe vende tjera. Dhe këto, po ashtu, ishin duke ndodhur pasi nevoja për të garantuar përgjegjësi ligjore për kryerjen e akteve ndërkombëtare të paligjshme nga aktorë të ndryshëm, duke përfshirë personelin e organizatave ndërkombëtare, po bëhej fokus i vëmendjes së konsiderueshme dhe praktikës së re. Për shembull, gjatë dekadës së fundit të shekullit të 20[të], institucionet ndërkombëtare financiare kishin nisur rrugën me institucionin e Panelit për Inspektim të Bankës Botërore në vitin 1993, të ndjekur nga bankat tjera rajonale për zhvillim. Krijimi i tribunaleve ndërkombëtare penale *ad hoc* për ish-Jugosllavinë dhe Ruandën, dhe gjykata hibride për Sierra Leonen ofroi një aplikim praktik – megjithëse të kufizuar –në nivel ndërkombëtar të konceptit të përgjegjësisë individuale penale për kryerjen e krimeve ndërkombëtare. Këto tribunale të kufizuara në aspektin territorial dhe kohor ishin pasuar me miratimin e Statutit të Romës në vitin 1998 dhe themelimin e Gjykatës Permanente Ndërkombëtare Penale në vitin 2002. Përgjegjësia e organizatave ndërkombëtare ka nisur në vitet e hershme të shekullit të 21-të. Në vitin 2001 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së (AP e OKB-së) miratoi nenet e Komisionit Ndërkombëtar për të Drejtën (KND) mbi Përgjegjësinë e Shteteve për Aktet e Paligjshme Ndërkombëtare, të cilat thuhej të ishin "pa paragjykim për ndonjë çështje të përgjegjësisë sipas të drejtës ndërkombëtare të një organizate ndërkombëtare."[4] KND konsideroi, në dritë të numrit ekzistues të organizatave ndërkombëtare dhe funksioneve të tyre gjithmonë në rritje, këto çështje të jenë të rëndësisë së veçantë. Në vitin 2002 KND nisi punën e vet në draft nenet mbi Përgjegjësinë e Organizatave Ndërkombëtare, të cilat u miratuan në vitin 2011.[5] Mundësitë për garantimin e

[3] *Konventa mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Organizatës së Kombeve të Bashkuara*, e miratuar nga AP e OKB-së më 13 shkurt 1946.
[4] Aneksi në Rezolutën e AP të OKB-së 56/83 të 12 dhjetorit të vitit 2001, neni 57.
[5] *Draft-nenet mbi Përgjegjësinë e Organizatave Ndërkombëtare*, miratuar nga KND më 3 qershor 2011, A/66/10 (2011).

përgjegjësisë së organizatave ndërkombëtare janë shqyrtuar, po ashtu, gjerësisht nga një komitet ndërkombëtar i Asociacionit për të Drejtën Ndërkombëtare. Në vitin 2005, AP e OKB-së miratoi "Strategjinë Gjithëpërfshirëse për të Eliminuar Shfrytëzimin dhe Abuzimin Seksual në të Ardhmen në Operacionet Paqeruajtëse të OKB-së"[6] që trajtonte të dyja, përgjegjësinë organizative dhe individuale.

6. Kundrejt këtij sfondi të trendëve në rritje në të drejtën dhe institucionet ndërkombëtare, në fillim të qershorit të vitit 1999, Sekretari i Përgjithshëm paralajmëroi një mekanizëm të jashtëm të përgjegjësisë, krijimin e një institucioni të Ombudspersonit për t'i pranuar dhe hetuar ankesat "në lidhje me abuzimin, nëse ka, me autoritet nga Administrata e Përkohshme Civile dhe ndonjë institucion lokal i ri dhe ndonjë aktor joshtetëror që pretendojnë ushtrim autoriteti."[7] Më pas, më 30 qershor 2000, UNMIK-u nxori Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/38 "Mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë". Megjithatë, Ombudspersoni nuk kishte autoritet për të marrë vendime detyruese; rekomandimet e tij mund të injoroheshin nga PSSP-ja. Sipas fjalëve të Ombudspersonit të parë (dhe të vetëm) ndërkombëtar në Kosovë: "Ombudspersoni mundet, nëse ai konsideron se ka ndodhur një shkelje e të drejtave të njeriut, t'ia raportojë këtë drejtpërdrejt PSSP-së, dhe në këtë mënyrë t'ia paraqesë të gjeturat e tij drejtpërdrejt mbikëqyrësit përfundimtar të organit të njëjtë ndërkombëtar apo lokal, i cili ishte përgjegjës për shkelje në fillim. Është shumë e diskutueshme nëse një sistem i tillë mund të çojë te një mbrojtje efektive e të drejtave të njeriut, në veçanti në rastet e shkeljeve në fushat nën përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të PSSP-së."[8]

7. Nga viti 2004, shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u po tërhiqnin vëmendjen e Këshillit të Evropës (KiE), organeve të OKB-së për traktatet për të drejtat e njeriut, organizatave regjionale siç janë: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe organizatat joqeveritare (OJQ-të) siç janë Amnesty International (AI) dhe Human Rights Watch (HRW). Ishte bërë e pamundur për UNMIK-un që t'i injorojë kërkesat për përgjegjësi, të bëra pas dy dekadave të zhvillimeve ligjore në caktimin e përgjegjësisë për veprimet e paligjshme ndërkombëtare, përveç atyre të kryera nga shtetet, duke përfshirë organizatat dhe individët ndërkombëtarë. Në vitin 2006, u themelua më në fund PKDNJ me kompetencë për t'i "shqyrtuar ankesat nga çdo person apo grup që pretendon të jetë viktimë e një shkelje të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u"[9] të përcaktuar në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet me të, dhe konventat kryesore për të drejtat e njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Por themelimi i tij shtatë vjet pas vendosjes së UNMIK-ut ishte për shtatë vjet me vonesë dhe nënkuptonte se që nga fillimi Paneli do

[6] Rezoluta e AP së OKB-së 59/710, 25 mars 2005.
[7] Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12 "Mbi Themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut", 23 mars 2006, Pjesa 1.2.
[8] Marek A. Nowicki, "Gjendja e të drejtave të njeriut në Kosovë", Fjalimi në një takim të Komitetit mbi Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, të mbajtur në Paris më 16 mars 2004.
[9] KS i OKB-së, Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë i 12 korrikut të vitit 1999, S/1999/779, § 89.

të haste në shumë sfida në rolin e tij si një mekanizëm nismëtar në lidhje me përgjegjësinë e OKB-së për drejtimin e një misioni në terren.

8. Ky Raport shqyrton punën e PKDNJ-së që ka ardhur në përfundim nga perspektiva e anëtarëve të tij të tanishëm dhe ish-anëtarëve dhe Sekretariatit. Atij i shtohen raportet vjetore të Panelit që janë publikuar që nga viti 2008. Raporti ofron një përshkrim të themelimit dhe evoluimit të Panelit, praktikën e tij, ngarkesën me lëndë dhe kontributin për jurisprudencën. Ai paraqet vështirësitë në të cilat funksionoi Paneli dhe marrëdhënien e ndryshueshme të Panelit me UNMIK-un (dhe më gjerësisht OKB-në). Në fund, ai paraqet se ka mësime për t'i marrë nga përvoja e Panelit që mund të formojnë bazën e të menduarit për mekanizmat e ardhshëm për garantimin e përgjegjësisë së OKB-së, një proces që duhet të vazhdojë. Megjithëse autorët e këtij Raporti, si anëtarë të Panelit dhe Sekretariatit, kishin një pikëpamje të veçantë "insajderi", është lënë që të tjerët të bëjnë një vlerësim tjetër, për shembull efektiviteti për kosto i PKDNJ-së dhe implikimet politike të një organi të tillë.

II. Konteksti i Kosovës

A. UNMIK-u si autoritet suprem

9. Konflikti i armatosur gjatë vitit 1998 dhe 1999, ndërmjet forcave serbe në njërën anë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe grupeve të tjera të armatosura të shqiptarëve të Kosovës në anën tjetër, është mirë i dokumentuar. Pas dështimit të përpjekjeve ndërkombëtare për të zgjidhur konfliktin, më 23 mars 1999, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) shpalli fillimin e sulmeve ajrore kundër Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ-së). Sulmet ajrore filluan më 24 mars 1999 dhe përfunduan më 8 qershor 1999, kur RFJ-ja u pajtua t'i tërheqë forcat e veta nga Kosova. Më 9 qershor 1999, Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (KFOR), RFJ-ja dhe Republika e Serbisë nënshkruan një "Marrëveshje Tekniko-Ushtarake", përmes së cilës u pajtuan mbi tërheqjen e të gjitha autoriteteve të RFJ-së nga Kosova, duke përfshirë ato ushtarake, gjyqësore dhe policore, dhe praninë e një force ndërkombëtare të sigurisë pas miratimit të rezolutës përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Në të vërtetë, i gjithë sistemi qeveritar serb dhe jugosllav u tërhoq nga Kosova në Serbi, që la një vakuum për t'u plotësuar nga administrata e përkohshme e OKB-së. Përveç kësaj, për momentin, e la vetëm UÇK-në dhe grupet e saj të afërta dhe të armatosura në kontroll operacional të shumë zonave brenda Kosovës, megjithëse shteti serb ushtroi një kontroll mbi pjesën veriore të Kosovës dhe enklavat serbe për shumë vjet.

10. Më 10 qershor 1999, KS i OKB-së miratoi Rezolutën 1244 (1999). Duke vepruar sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB-së, KS i OKB-së mori vendim për vendosjen e pranisë ndërkombëtare të sigurisë dhe civile-përkatësisht të KFOR-it dhe UNMIK-ut në territorin e Kosovës. Në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit nr. 1244 (1999), OKB-ja u ngarkua me kompetenca të plota legjislative dhe ekzekutive për administrimin e përkohshëm të Kosovës, duke përfshirë administrimin e drejtësisë. KFOR-i u ngarkua për krijimin e "një ambienti të sigurt, në të cilin refugjatët dhe

personat e zhvendosur mund të kthehen në shtëpi të sigurt" dhe përkohësisht të sigurojë "rendin dhe sigurinë publike", derisa prania ndërkombëtare civile të mund të marrë përsipër përgjegjësinë për këtë detyrë. Në fillim, UNMIK-u përbëhej nga katër komponentë kryesorë të udhëhequra nga OKB-ja (administrata civile), Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (ndihma humanitare, e cila u hoq më vonë), OSBE-ja (ndërtimi institucional) dhe BE-ja (rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik).[10] Secila komponentë u vendos nën autoritetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP-së). Përmes Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244, UNMIK-ut i jepet mandati që t'i "promovojë dhe mbrojë të drejtat e njeriut" në Kosovë në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtarisht për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

11. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP-ja) u ngarkua me kompetenca të plota legjislative dhe ekzekutive, duke përfshirë kompetencat mbi gjyqësinë.[11] Prandaj, UNMIK-u në esencë kishte autoritetet e njëjta si një shtet. Megjithatë, ndërsa bëhej një shtet surrogat, kjo u bë pa respektim të njëjtë të parimeve demokratike siç janë ndarja e autoriteteve dhe atyre kontrolleve e balancave dhe mekanizmave të pavarur mbikëqyrës që janë të njohur në kuadër të sistemeve kushtetuese. Së shpejti u bë e qartë se në ushtrimin e këtyre autoriteteve, kishte një tension në mes kërkesave për siguri brenda Kosovës dhe respektimit të të drejtave individuale të njeriut.

12. Megjithatë, menjëherë pas themelimit, UNMIK-u nxori Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/1 të 25 korrikut të vitit 1999 "Mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë", në të cilën thuhej se "të gjithë personat që kryejnë detyra publike apo mbajnë pozita publike në Kosovë do t'i zbatojnë standardet e njohura ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut …".[12] Menjëherë pas kësaj, UNMIK-u nxori Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24 të 12 dhjetorit të vitit 1999 "Mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë", që përmend standardet specifike për të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht, të cilat të gjithë personat që kryenin detyra publike apo mbanin pozita publike në Kosovë duhej t'i zbatonin, duke përfshirë:

    - Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të 10 dhjetorit të vitit 1948 (DUDNJ)
    - Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale të 4 nëntorit të vitit 1950 dhe protokollet me të (KEDNJ)
    - Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të 16 dhjetorit të vitit 1966 dhe protokollet me të (KNDCP)
    - Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të 16 dhjetorit të vitit 1966 (KNDESK)
    - Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor të 21 dhjetorit të vitit 1965 (KNEDR)

[10] KS i OKB-së, Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Administratës së Përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë i 16 shtatorit të vitit 1999, S/1999/987.
[11] KS i OKB-së, Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Administratës së Përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë i 12 korrikut të vitit 1999, S/1999/779, § 35.
[12] Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/1 "Mbi Autoritetin e Ligjit të Aplikueshëm në Kosovë", 25 korrik 1999, pjesa 2.

- Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave të 17 dhjetorit të vitit 1979 (KEDKG)
- Konventën Kundër Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Tjetër Mizor, Jonjerëzor dhe Degradues të 17 dhjetorit të vitit 1984 (KKT)
- Konventën për të Drejtat e Fëmijëve të 20 dhjetorit të vitit 1989 (KDF).

13. Megjithatë, pasi supremacia e të drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ndaj ligjeve vendore nuk ishte shprehur qartë në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24, e as në versionin e saj të ndryshuar si Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/59,[13] ajo krijoi një ambiguitet lidhur me statusin e këtyre normave, veçanërisht ato që zbatohen për ushtrimin e autoritetit ekzekutiv dhe legjislativ në UNMIK.

14. Ngjashëm, nga fillimi, mundësitë për ta mbajtur UNMIK-un përgjegjës për ndonjë shkelje të pretenduar të të drejtave të njeriut ishin të kufizuara; në esencë PSSP-ja nuk mund të kundërshtohej. Personeli i UNMIK-ut gëzonte imunitet para gjykatave të Kosovës në pajtim me praktikën e rregullt në harmoni me Konventën e vitit 1946 mbi Imunitetet, dhe më pas rregulloret e UNMIK-ut.

B. Institucioni i Ombudspersonit

15. Shqetësimet rreth përgjegjësisë për shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë u shfaqën herët. Megjithëse Rezoluta e KS të OKB-së 1244 nuk përmendi ndonjë institucion të tillë, marrëveshjet e vitit 1998 të Rambujesë (të sjella në Rezolutë) mundësuan krijimin e një Ombudspersoni në Kosovë, për të ofruar "një mekanizëm të qasshëm dhe në kohë për shqyrtim të pavarur, për korrigjim dhe apelim të veprimeve jogjyqësore" dhe për të pranuar, *inter alia*, "ankesat lidhur me abuzimin, nëse ka, të autoritetit nga Administrata e Përkohshme Civile apo ndonjë institucion i ri lokal dhe ndonjë aktor joshtetëror që pretendon apo ushtron autoritet".[14]

16. Shpresohej se disa nga këto ankesa do të trajtoheshin nga Ombudspersoni, të cilin UNMIK-u e themeloi në vitin 2000.[15] Ombudspersoni u themelua që të jetë i pavarur nga UNMIK-u dhe si i tillë paraqiti eksperimentin e parë për përgjegjësinë e OKB-së. Ombudspersoni u mandatua të "sigurojë që të gjithë personat në Kosovë të jenë në gjendje t'i ushtrojnë efektivisht, sa lejojnë rrethanat, të drejtat e tyre të njeriut dhe liritë fundamentale të mbrojtura nga standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut". Autoritetet e Ombudspersonit përfshinin ofrimin e këshillimit dhe dhënien e rekomandimeve çdo personi apo entiteti lidhur me pajtueshmërinë e ligjeve dhe rregulloreve vendore me standardet e njohura ndërkombëtare.

17. Për këtë qëllim Ombudspersoni ishte në gjendje t'i hetojë ankesat e çdo personi apo entiteti lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe abuzimin me autoritet të organeve ndërkombëtare dhe lokale, si dhe kishte autoritetin t'i inspektojë objektet e

[13] Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/59 "Për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosove", 27 tetor 2000.
[14] *Marrëveshjet e Rambujesë: Marrëveshje e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë*, S/1999/648, 7 qershor 1999, neni III (e) 89.
[15] Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/38 "Mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë", 30 qershor 2000.

paraburgimit dhe t'i vizitojë personat në paraburgim. Ai pranoi një numër të madh ankesash në të cilat pretendohej për një gamë të gjerë abuzimesh me të drejtat e njeriut. Ombudspersoni bëri vizita në terren, vizitoi vendet e paraburgimit dhe rregullisht sfidoi administratën e UNMIK-ut (dhe më vonë, po ashtu, institucionet lokale të vetëqeverisjes), por përgjigjja nga UNMIK-u ishte shpesh ajo për mosbashkëpunim dhe një dështim për t'i zbatuar rekomandimet e tij.

18. Në vitin 2001, UNMIK-u nxori Rregulloren nr. 2001/9 të 15 gushtit të vitit 2001 "Mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë". Kjo Kornizë inkorporoi shumicën e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në dokumentet e ndryshme për të drejtat e njeriut, të bazuara në të drejtat që gjendeshin në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/1 dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24. Megjithatë, duke nxjerrë Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/47 "Mbi Statusin, Privilegjet dhe Imunitetet e KFOR-it dhe UNMIK-ut", UNMIK-u siguroi imunitetet për personelin e vet. Rregullorja siguron që: "UNMIK-u, prona e tij, fondet dhe asetet do të përjashtohen nga çdo proces ligjor … personeli i UNMIK-ut do të përjashtohet nga procesi ligjor për sa i përket asaj çka flasin dhe akteve të kryera nga ta në kapacitetin e tyre zyrtar."

19. Kjo e drejtë e dhënë e imunitetit për UNMIK-un ngriti kambanat e alarmit në Kosovë. Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMiK) theksoi në atë kohë se privilegjet dhe imunitetet e tilla e bënë përgjegjësinë e atyre aktorëve të vështirë dhe e bënë pothuaj të pamundur për individët që t'i mbrojnë të drejtat e tyre kundrejt këtyre autoriteteve qeveritare.[16] Ombudspersoni në Kosovë theksoi se qëllimi kryesor i dhënies së imunitetit organizatave ndërkombëtare është t'i mbrojë ato nga ndikimi i njëanshëm i qeverive përkatëse të vendit në të cilin gjenden. Por ky shpjegim nuk vlente për UNMIK-un, pasi ata vepronin si një shtet surrogat. Ombudspersoni theksoi që "[a]snjë shtet që funksionin duke u bazuar në sundimin e ligjit nuk i jep vetes imunitet të plotë nga ndonjë përgjegjësi administrative, civile apo penale. Një mungesë e tillë e përgjithshme e përgjegjësisë hap rrugën për pandëshkueshmëri të shtetit."[17] Për këto arsye, Ombudspersoni vazhdoi që Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/47 ishte në mospajtueshmëri me standardet e njohura ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut.

20. Ombudspersoni në Kosovë vazhdoi të kritikojë UNMIK-un për kryerjen e shkeljeve të ndryshme të të drejtave të njeriut ndërsa në esencë përjashtohej nga çdo përgjegjësi. Në një Raport të vitit 2003, Ombudspersoni theksoi që kjo situatë në vazhdim, katër vjet pas përfundimit të konfliktit, "çon në shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut dhe abuzime me autoritetin nga ana e UNMIK-ut, duke pasqyruar kështu indiferencën e vet ndaj sundimit të ligjit për çka është e lidhur pjesa tjetër e Evropës".[18]

21. Veç kësaj, më 17 mars 2004, kishte një shpërthim të madh të dhunës në Kosovë që rezultoi me 19 persona të vdekur, afërsisht 1,000 njerëz të lënduar, dhe shumë më

[16] Didier Pacquée & Steven Dewulf, "Administrimet Ndërkombëtare Territoriale dhe Sundimi i Ligjit: Rasti i Kosovës", 4 *Shqyrtim për të drejtat e njeriut i Eseksit* (2007), fq. 1-14.
[17] Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë, *Raporti Special nr. 1*, 26 prill 2001.
[18] Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë, *Raporti i tretë vjetor*, 30 qershor 2003.

shumë njerëz të zhvendosur. Qindra shtëpi që u takonin serbëve të Kosovës dhe minoriteteve të tjera joshqiptare janë djegur, sikurse kishat dhe manastiret ortodokse.[19] Kjo ishte pasuar nga largimi tjetër nga Kosova i shumë serbëve të Kosovës dhe joshqiptarëve të tjerë. UNMIK-u dukej të jetë plotësisht i papërgatitur për këtë shpërthim të dhunës; ai kishte dështuar ta ndalë dhunën dhe e kishte mbajtur rendin me vështirësi të konsiderueshme.

III. Parahistoriku i Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut

A. AP e KiE-së dhe Komisioni i Venedikut

22. Kritika më e madhe për situatën lidhur me mungesën e përgjegjësisë adekuate të UNMIK-ut për të drejtat e njeriut erdhi nga KiE. Në shtator të vitit 2003, Asambleja e tij Parlamentare (AP e KiE-së) diskutoi një mocion për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Më 16 mars 2004, Komiteti i saj mbi Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut (Komiteti i AP-së) organizoi një debat mbi këtë çështje. Si pjesë e procesit të përgatitjes për debatin e AP-së mbi të drejtat e njeriut në Kosovë, në maj të vitit 2004, Komiteti i AP-së kërkoi nga Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit ("Komisioni i Venedikut") të paraqesë një mendim mbi "gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë".

23. Në Mendimin e miratuar më 8 dhe 9 tetor 2004[20], Komisioni i Venedikut së pari dha një pasqyrë të gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë në atë kohë. Ai theksoi një gamë të gjerë problemesh për të drejtat e njeriut nën administrimin e UNMIK-ut: një mungesë të sigurisë për komunitetet joshqiptare; një mungesë të lirisë së lëvizjes për komunitetet joshqiptare, e cila ndikoi në qasjen në shërbimet themelore publike; mbrojtje të pamjaftueshme të të drejtave pronësore; mungesë e hetimit për rrëmbimet dhe krimet serioze; mungesë e paanësisë dhe zgjatje e tepërt e procedurave gjyqësore; qasje e vështirë në gjykata; paraburgime pa shqyrtim të pavarur; korrupsion; trafikim të njerëzve; mungesë e sigurisë ligjore, shqyrtimit gjyqësor dhe të drejtës për mjet efektiv juridik për shkeljet e të drejtave të njeriut. Disa nga këto çështje të njëjta, veçanërisht ato që përfshijnë të drejtat pronësore, po ashtu, ndikuan në shqiptarët e Kosovës të cilët jetuan në pjesën veriore të Kosovës që kontrollohej nga serbët.

24. Një nga çështjet që Komiteti i AP-së i kërkoi Komisionit të Venedikut ta adresojë ishte që "[n]ë vend të sjelljes së autoriteteve të përkohshme ndërkombëtare dhe lokale brenda juridiksionit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, a do të ishte e preferuar të themelohet një lloj i 'dhomës për të drejtat e njeriut', ndoshta e ngjashme si ajo e themeluar në Bosnjë e Hercegovinë?" Komisioni i Venedikut konsideroi që një Panel i Pavarur Këshillëdhënës, madje i themeluar në kuadër të UNMIK-ut, do të ishte mekanizmi i përkohshëm i preferuar për të shqyrtuar pajtueshmërinë e UNMIK-ut me standardet për të drejtat e njeriut (përmes veprimeve apo mosveprimeve), në

[19] KS i OKB-së, Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Administratës së Përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë i 30 prillit të vitit 2004, S/2004/348, § 3.
[20] Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit ("Komisioni i Venedikut"), *Mendim mbi të Drejtat e Njeriut në Kosovë: Themelimi i mundshëm i mekanizmit për shqyrtim*, Mendimi nr. 280/2004, CDL-AD (2004)033, Strasburg, 11 tetor 2004.

pritje të themelimit të Gjykatës për të Drejtat e Njeriut në Kosovë. Ky Panel i Pavarur Këshillëdhënës do të ishte kompetent që të shqyrtojë "çdo ankesë të paraqitur nga ndonjë person që pretendon se të drejtat dhe liritë e tij fundamentale janë shkelur nga ndonjë ligj, rregullore, vendime, veprime apo dështime për të vepruar që burojnë nga UNMIK-u, por vetëm në rastet ku Ombudspersoni ka gjetur shkelje të të drejtave të njeriut, pa raportim të tij/saj e duke rezultuar me UNMIK-un që pranon përgjegjësinë e vet për shkeljen e të drejtave të njeriut."

25. Mendimi i Komisionit të Venedikut vuri në dukje se "mundësia për individin (apo Ombudspersonin në emër të ankuesve, me pajtimin e tyre) që të paraqitet në Panelin Këshillëdhënës, do t'i ofronte UNMIK-ut "mundësinë që të marrë konfirmim-përmes organit të vet të ekspertëve të pavarur – që një situatë vërtet paraqet shkelje të standardeve për të drejtat e njeriut." Komisioni konsideroi që "UNMIK-u duhet të zotohet vetë për të pranuar të gjeturën nëse ekspertët e Panelit shprehin qëndrimin se UNMIK-u vërtet është duke i shkelur të drejtat e njeriut."

26. Disa komponentë nga të cilët më vonë do të krijohet korniza ligjore e PKDNJ-së, siç është krijuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/28, tanimë ishin formuluar në Mendimin e Komisionit të Venedikut. Për shembull, në Mendim rekomandohej që Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të përbëhej nga tre ekspertë të pavarur ndërkombëtarë, me ekspertizë të dëshmuar në fushën e të drejtave të njeriut (veçanërisht sistemin evropian), të cilët zyrtarisht do të emëroheshin nga PSSP-ja, me propozimin e kryetarit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Mendimi, po ashtu, e ka bërë të qartë që Paneli do të ketë funksione këshillëdhënëse. Megjithatë, "UNMIK-u do të zotohet vetë të pranojë të gjeturat e tij, përveç nëse PSSP-ja personalisht vendos se ekzistojnë arsye të jashtëzakonshme që e pamundësojnë këtë."

27. Në Mendimin e Komisionit të Venedikut theksohej që "ky Panel Këshillëdhënës nuk do të ofronte garancitë e njëjta si një organ i pavarur gjyqësor, siç është Gjykata për të Drejtat e Njeriut për Kosovën. Në të konsiderohet, megjithatë, se ai do të paraqiste një përmirësim të rëndësishëm pasi do t'i ofronte publikut një shenjë të dukshme që UNMIK-u nuk mbron veprimet e veta nga shqyrtimi i një organi pjesëtarësh të pavarur të një Paneli për të Drejtat e Njeriut." Ai theksoi që "[n]ë këtë drejtim, duket esenciale që, siç sugjerohet më lart, vendimet e Panelit Këshillëdhënës duhet … shpejt të bëhen publike. Do të ishte njëjtë e rëndësishme që UNMIK-u të zotohet të ofrojë arsye – në kohën e duhur dhe publikisht – se pse ai përjashtimisht nuk do të merret me të gjeturën e Panelit."

28. Një rekomandim i Komisionit të Venedikut që nuk arriti të shndërrohej në Rregullore të UNMIK-ut, lidhur me dëmshpërblimin, do të ndikonte në mënyrë kritike në funksionalitetin e PKDNJ-së. Në Mendimin e Komisionit të Venedikut thuhej që, nëse PKDNJ gjen se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut, "UNMIK-u duhet të ofrojë dëmshpërblim të duhur (që sillet nga njohja publike e shkeljes, deri te *restitutio in integrum*, dhe kompensimi i mundshëm). Në lidhje me këtë, Komisioni konsideron se

Rregullorja e UNMIK-ut që themelon Panelin Këshillëdhënës duhet, po ashtu, të ofrojë qartë mundësinë për parashtruesit e ankesave të kërkojnë masa të duhura individuale nga UNMIK-u, pas gjetjes së Panelit për shkelje të të drejtave të njeriut në rastin e tyre."

29. Në Raportin e Komitetit të AP të KiE-së mbi Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, i cili ishte përgatitur për debatin plenar të AP të KiE-së mbi "Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Kosovë" dhe të miratuar nga Komiteti i AP të KiE-së më 6 janar 2005,[21] raportuesi i Komitetit të AP të KiE-së kryesisht u pajtua me rekomandimet e Komisionit të Venedikut. Megjithatë, raportuesi dëshiroi që të sigurohet që Rregullorja e propozuar nuk do t'ia ngarkojë Panelit për të Drejtat e Njeriut si dublikatë ndonjërin prej funksioneve të Ombudspersonit në Kosovë. Pas debatit, që u mbajt më 25 janar 2005, AP e KiE-së rekomandoi që UNMIK-u, në pajtim me Rezolutën e KS të OKB-së 1244, "të krijojë një Panel Këshillëdhënës/Komision për të Drejtat e Njeriut që do të përbëhej prej ekspertëve të pavarur ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, të caktuar nga kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara." Paneli Këshillëdhënës do të ngarkohej kryesisht me "shqyrtimin e (draft) rregulloreve të [UNMIK-ut] dhe instrumenteve ndihmëse për pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut … dhe do t'i trajtonte mendimet e [UNMIK-ut] mbi çështjet, përveç ankesave individuale, të sjella në vëmendjen e tij nga Ombudspersoni."[22]

B. UNMIK-u dhe PKDNJ

30. Në ndërkohë, të tjerët jashtë Kosovës po shprehnin shqetësimin rreth mungesës së ndonjë mekanizmi adekuat për banorët e Kosovës që të kërkojnë dëmshpërblim për shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut gjatë administrimit të UNMIK-ut. Në shtator të vitit 2004, UNMIK-u pranoi një letër nga kryesuesi i Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut (KDNJ), që kërkonte një raport për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Këshilltari ligjor i UNMIK-ut theksoi që UNMIK-u ishte i përgatitur t'i përgjigjet kërkesës së KDNJ-së si dhe ta "konsiderojë bërjen e aranzhimeve të tilla që mund të jenë të nevojshme për të siguruar që procedurat e vendosura në nenin 40 të KNDCP-së[23] ndiqen sa më shumë që është e mundshme në Kosovë".[24] Në tetor të vitit 2004, zyrtarët e UNMIK-ut filluan diskutimet në vazhdim me anëtarët e Komisionit të Venedikut lidhur me mundësinë e krijimit të mekanizmit

[21] Komiteti i AP-së të KiE-së për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut (Raportuesi: z. Tony Lloyd), Raport mbi "Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Kosovë", Dok. 10393, 6 janar 2005.
[22] Rezoluta e AP-së 1417 (2005), 25 janar 2005.
[23] Neni 40 (1) i KNDCP-së siguron që "Palët shtetërore në Konventën aktuale zotohen të dorëzojnë raporte mbi masat që ata i kanë miratuar, të cilat i bëjnë efektive të drejtat e njohura këtu dhe për progresin e bërë në gëzimin e atyre të drejtave."
[24] Shih KDNJ, *Raport i paraqitur nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë për Komitetin për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut mbi Gjendjen e të Drejtave të Njeriut në Kosovë që nga qershori i vitit 1999*, KDCP/C/UNK/1, 13 mars 2006; dhe KDNJ, *Shqyrtimi i raporteve të paraqitura nga palët shtetërore sipas nenit 40 të Konventës, Observime përfundimtare të Komitetit për të Drejtat e Njeriut, Kosovë (Serbi)*, KDCP/C/UNK/CO/1, 14 gusht 2006.

tjetër, përveç Ombudspersonit të Kosovës, për të kërkuar dëmshpërblim për shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut në Kosovë.

31. Në kuadër të UNMIK-ut vazhdoi të ketë mendime të ndryshme rreth mekanizmit të propozuar. Pas shqyrtimit të Mendimit të Komisionit të Venedikut, Zëvendësi kryesor i PSSP-së (Z-K i PSSP-së), theksoi me shqetësim se më shumë se gjysma e mendimit i ishte kushtuar themelimit të Gjykatës për të drejtat e njeriut në Kosovë, e cila do të kishte juridiksion mbi stafin e UNMIK-ut dhe KFOR-in, një mundësi që ai e pa si të papranueshme. Z-K i PSSP-së theksoi se "ndërsa e falënderoj Këshillin e Evropës për ndihmën e vet të vazhdueshme dhe të çmueshme për ndërtimin e kapaciteteve në Kosovë … unë nuk e fsheha faktin se implementimi i konkluzioneve të tyre nuk do të jetë prioritet për UNMIK-un".[25] Z-K i PSSP-së theksoi se Komisioni i Venedikut e ka bazuar tepër shumë mendimin e vet në qëndrimet e Ombudspersonit në Kosovë dhe AI pa vënë në pyetje pohimet e tyre të gabuara. Ai ishte veçanërisht energjik meqë kundërshtohet fakti që pjesëtarët e stafit të UNMIK-ut përjashtohen nga ndjekja. Ai theksoi se në një numër të konsiderueshëm rastesh, imuniteti i pjesëtarëve të stafit të UNMIK-ut është hequr nga Sekretari i Përgjithshëm. Ai ishte kundër themelimit të ndonjë mekanizmi të ri për shqyrtim gjyqësor.

32. Të tjerët në kuadër të UNMIK-ut ishin më shumë të hapur për idenë. Për shembull, këshilltari ligjor i UNMIK-ut shprehu mospajtim me vlerësimin e Z-K të PSSP-së për propozimet për mekanizma të mundshëm institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, duke e quajtur atë "tepër negativ".[26] Ai, po ashtu, theksoi se arsyeja që Komisioni i Venedikut propozoi themelimin e mekanizmave të rinj për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, ishte për shkak të "mungesës aktuale të një mekanizmi adekuat dhe konsistent për shqyrtimin e shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u dhe KFOR-i, dhe në veçanti mungesën e një mekanizmi ndërkombëtar për t'i shqyrtuar veprimet e UNMIK-ut dhe KFOR-it." Megjithatë, këshilltari ligjor u pajtua me ZPSSP-së se OKB-ja nuk do të lejojë mbikëqyrje dhe sanksionim nga një organ i jashtëm. Por ai mendoi se do të mbështeste një Panel të pavarur këshillëdhënës, si një marrëveshje e përkohshme; një organ i tillë do të siguronte një bazë të fortë për adresimin e boshllëkut ligjor për shkak të mungesës së juridiksionit të GJEDNJ-së mbi UNMIK-un.

33. Pas disa muajsh debati të brendshëm në kuadër të UNMIK-ut rreth formës dhe juridiksionit të organit të propozuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë, më 12 janar 2005 PSSP-ja i UNMIK-ut informoi Nën-Sekretarin e Përgjithshëm në Selinë e OKB-së (Selia e OKB-së), duke përshkruar tri sugjerimet kryesore nga KiE dhe duke paraqitur atë çfarë ai mendonte të jetë zgjidhja më e mirë. Thënë më së thjeshti, tri opsionet për të trajtuar çështjen e boshllëkut ligjor në Kosovë ishin: një marrëveshje me anën e së cilës UNMIK-u do t'i nënshtrohej juridiksionit të GJEDNJ-së; themelimi i një Gjykate për të drejtat e njeriut në Kosovë në bazë të marrëveshjes

[25] Memorandumi i Zëvendësit kryesor të PSSP-së për PSSP-në "Mbi Komisionin e Venedikut", 11 tetor 2004.
[26] Shkresë e ZÇL-së për PSSP-në "Mbi Sesionin e 60-të të Komisionit të Venedikut dhe krijimin e një mekanizmi të ri për të drejtat e njeriut", 13 tetor 2004.

në mes të UNMIK-ut dhe KiE, që do të kishte autoritetin të marrë vendime detyruese apo themelimin e një Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut, i cili nuk do të kishte autoritetin të marrë vendime detyruese. Nga këto zgjidhje, PSSP-ja argumentoi se opsioni i tretë duhet zgjedhur për shkak se dy të parët do të ishin problematikë, duke pasur parasysh privilegjet dhe imunitetet e UNMIK-ut dhe personelit të vet, si dhe duke pasur parasysh se opsionet e tjera mund të shkaktojnë kufizime në lirinë e veprimit të institucioneve të OKB-së, për të interpretuar mandatin e UNMIK-ut sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244. PSSP-ja theksoi se ky Panel këshillëdhënës për të drejtat e njeriut mund të themelohej relativisht shpejt, me ekspertë ligjorë të njohur ndërkombëtarë të emëruar me ndihmën e KiE-së. Ai, po ashtu, theksoi që PKDNJ do t'i shqyrtonte pretendimet për shkeljet e KEDNJ-së nga UNMIK-u dhe t'i paraqesë të gjeturat dhe përfundimet zyrtare si dhe rekomandimet që konsiderohen të duhura.

34. Në shkurt të vitit 2005, Selia e Përgjithshme e OKB-së i shkroi përsëri UNMIK-ut, duke u pajtuar që themelimi i PKDNJ-së do të ishte i pranueshëm dhe, më 15 shkurt 2005, ZÇL e UNMIK-ut hartoi një shkresë, në të cilën paraqiten natyra dhe funksionimi i PSSP-së. Kjo shkresë përfshiu shumë nga çështjet ligjore që më vonë do të miratoheshin në Rregulloren e UNMIK-ut mbi themelimin e PKDNJ-së. Për shembull, ky është dokumenti i parë i OKB-së që vendos parametra të caktuar: përbërja prej tre anëtarësh (dhe shërbimi i tyre i pritur të jetë për "pak ditë në muaj"), emërimi i anëtarëve të Panelit nga PSSP-ja për afat dyvjeçar në konsultim me kryetarin e GJEDNJ-së, mundësia e seancave dëgjimore publike me gojë dhe autoriteti për t'i detyruar personat t'i ndjekin dhe, çfarë është më e rëndësishmja, natyra jodetyruese e rekomandimeve të Panelit, e cila do t'i nënshtrohet vendimit të PSSP-së se a të ndërmerret veprim.[27]

C. Pikëpamjet e OSBE-së

35. Kur UNMIK-u ia dërgoi shkresën e lartpërmendur Misionit të OSBE-së në Kosovë (OmiK) për koment, Misioni i OSBE-së përgatiti një dokument për diskutim mbi themelimin e një Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut, i cili gjeti shumë të meta në gjuhën e draftit të UNMIK-ut lidhur me themelimin e një mekanizmi të përgjegjësisë për të drejtat e njeriut.[28] Më e rëndësishme në mesin e atyre të metave ishte karakteri i propozuar këshillëdhënës i Panelit. Në dokumentin e Misionit të OSBE-së në Kosovë theksohej "se shqetësimet e UNMIK-ut rreth imunitetit të vet nuk duhet ta përjashtojnë atë nga zbatimi i standardeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të aplikueshme përgjithësisht." Në të, po ashtu, thuhet që "GJEDNJ ka konsideruar që imuniteti shtetëror si kufizim i nënkuptuar i të drejtës për qasje në një gjykatë është i pranueshëm vetëm për aq sa është i nevojshëm për të arritur qëllimin e standardit të imunitetit. Prandaj, nuk do të dukej e arsyeshme të thuhet që themelimi i

[27] Shkresa e ZÇL-së "Mbi natyrën dhe funksionimin e një Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut në Kosovë", 15 shkurt 2005.
[28] Dokumenti për diskutim i OSBE-së "Mbi themelimin e një Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut", 28 shkurt 2005.

një mekanizmi efektiv dhe të pavarur për të drejtat e njeriut si të tillë do të pengonte UNMIK-un apo personelin e vet t'i kryejë detyrat e veta përkatëse."

36. Misioni i OSBE-së në Kosovë ishte i brengosur që PKDNJ nuk mund të merrte vendime detyruese, dhe ai kryesisht do të dyfishonte punën e Ombudspersonit. Ai gjeti dallimin në mes të dyve të dhënë nga ZÇL– fakti që, ndryshe nga Ombudspersoni, PKDNJ do të ketë autoritetin të mbajë seanca dëgjimore publike dhe t'u kërkojë personave t'i ndjekin ato, si dhe do të ketë qasje në të gjitha dosjet relevante– nuk ishte i mjaftueshëm, sipas mendimit të Misionit të OSBE-së në Kosovë, për të përligjur themelimin e një organi për të drejtat e njeriut që nuk ushtronte autoritet detyrues. Për këtë qëllim, Misioni i OSBE-së në Kosovë theksoi se "themelimi i një institucioni kuazi-gjyqësor, i cilin nuk mund të marrë vendime detyruese, është në kundërshtim me parimet e sundimit të ligjit në të cilat thuhet se askush, veçanërisht një autoritet qeveritar (UNMIK-u), nuk është mbi ligjin. Kjo qartas do t'u dërgonte mesazh të gabuar njerëzve dhe institucioneve të Kosovës."

37. Misioni i OSBE-së në Kosovë rekomandoi që Rregullorja e UNMIK-ut mbi themelimin e Panelit duhet të theksojë qartë se çfarë lloj vendimesh do të jetë i autorizuar t'i marrë Paneli. Për shembull, Misioni i OSBE-së në Kosovë sugjeroi që vendimet e Panelit duhet të përfshijnë autoritetin për t'ia dhënë një shumë specifike kompensimi të arsyeshëm viktimës (ve), duke përfshirë dëmshpërblimin. Ai, po ashtu, konsideroi se Rregullorja duhet ta bëjë të qartë se çdo devijim që PSSP-ja dëshiron ta bëjë nga një vendim i PKDNj-së për dhënien e kompensimit, duhet të bëhet vetëm si përjashtim. Misioni i OSBE-së në Kosovë ishte i qartë se një PKDNJ që nuk nxjerr vendime detyruese, mund të jetë efektiv vetëm nëse mosekzekutimi i rekomandimeve të veta do të ishte saktësisht një përjashtim nga rregulla. Për ta arritur këtë, "[n]ë aspektin praktik, qëndrimet e Panelit këshillëdhënës duhet të bëhen efektive brenda një hapësire të caktuar kohore veç nëse PSSP-ja vendos të intervenojë. Vendimet e PSSP-së që nuk ndjekin rekomandimet e Panelit këshillëdhënës duhet të bëhen publike duke përfshirë arsyetimin e dhënë."

38. Për sa i përket juridiksionit të Panelit, Misioni i OSBE-së në Kosovë rekomandoi zgjerimin e juridiksionit të përkohshëm të Panelit përtej shkeljeve që ndodhën pas hyrjes në fuqi të Rregullores, e cila është ajo çfarë UNMIK-u e ka përkrahur. Një marrëveshje e tillë, argumentoi Misioni i OSBE-së në Kosovë, do të përjashtonte ankesat për shkelje të të drejtave të njeriut për periudhën në mes themelimit të UNMIK-ut, d.m.th. 10 qershor 1999, dhe hyrjes së mundshme në fuqi, e cila do të llogaritej të arrinte një periudhë deri në më shumë se gjashtë vjet. Misioni i OSBE-së në Kosovë përfundoi duke theksuar se nëse një PKDNJ është themeluar që vetëm të marrë vendime jodetyruese, kjo duhet të shihet si një mekanizëm i përkohshëm, afatshkurtër, i cili duhet të zëvendësohet apo shndërrohet për një afat të mesëm nga një Gjykatë e të drejtave të njeriut për Kosovën që do të kishte autoritetin të marrë vendime detyruese.

39. Kjo doli të jetë këshillë shumë vizionare dhe ndoshta e gjithë përvoja e PKDNJ-së do të mund të ishte shumë më efektive dhe e dobishme nëse disa sugjerime të Misionit të OSBE-së në Kosovë do të ishin marrë parasysh. Në vend të kësaj, shumica e zyrtarëve në UNMIK vazhduan me përgatitjen e Rregullores që kishte të bënte me punën e PKDNJ-së të bazuar kryesisht në planin e parë të ZÇL-së, duke injoruar sugjerimet e OSBE-së. Gjatë kësaj kohe, ZÇL-ja e vuri në qarkullim draft-rregulloren në mesin e zyrave të ndryshme ligjore të UNMIK-ut për komente. Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut (DD) nuk ndihej rehat me Rregulloren e propozuar. Ata ishin të shqetësuar që PKDNJ mund të hiqte imunitetin e UNMIK-ut, madje edhe me vendime jodetyruese. DD, po ashtu, ishte i prerë në atë se PKDNJ nuk duhet të ketë autoritet të komentojë nëse draft-rregulloret e UNMIK-ut ishin në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.[29]

D. Rregullorja e PKDNJ-së dhe hartimi i saj

40. Në maj të vitit 2005, ZÇL-ja përgatiti një draft të korrigjuar të shkresës së vet të 15 shkurtit të vitit 2005 mbi themelimin e PKDNJ-së.[30] Teksti i ri kishte pothuaj gjuhën pikërisht të njëjtë, përveç që hoqi mundësinë e PKDNJ-së të shqyrtojë pajtueshmërinë e draft-rregulloreve të UNMIK-ut, e cila kishte qenë një pjesë e madhe e juridiksionit dhe autoritetit të propozuar të Panelit. ZÇL-ja, po ashtu, sqaroi se megjithëse Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe pjesë të DD-së vazhduan të preferojnë një Gjykatë për të drejtat e njeriut me autoritet detyrues, kjo nuk do të jetë e mundshme, pasi ZÇL-ja në Selinë e Përgjithshme të OKB-së do të miratonte vetëm modelin jodetyrues. U bë tanimë e qartë se, duke ndalur juridiksionin dhe autoritetin e PKDNJ-së, UNMIK-u e kishte hequr mundësinë që PKDNJ të jetë në gjendje të korrigjojë ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut, së paku pa një pajtim të shprehur nga UNMIK-u.

41. Nga korriku i vitit 2005, ZÇL e informoi KiE-në se ajo e kishte përgatitur një draft-rregullore mbi themelimin e PKDNJ-së, pasi kishte marrë parasysh komentet e ofruara nga Komisioni i Venedikut, në mes tjerash.[31] Në mënyrë specifike, për këshillën e Komisionit të Venedikut, ZÇL-ja i kishte përfshirë të gjitha nga instrumentet për të drejtat e njeriut të aplikueshme në Kosovë në draft-rregulloren e PKDNJ-së. Ky doli të jetë një zhvillim kyç, pasi kjo do t'i lejonte Panelit t'i marrë parasysh instrumentet e tjera për të drejtat e njeriut përveç KEDNJ-së, duke e bërë atë, së bashku me Ombudspersonin në Kosovë, unik në mesin e organeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të një rëndësie më të gjerë sesa vetëm me përfshirjen e KEDNJ-së në Kosovë. Në të njëjtën kohë, PSSP-ja ia dërgoi draft-rregulloren Selisë së Përgjithshme të OKB-së "për shqyrtim përfundimtar" dhe theksoi synimin e tij për ta nxjerrë atë deri në fund të gushtit. Kjo kornizë kohore optimiste përfundoi me ngadalësimin e konsiderueshëm të Selisë së Përgjithshme të OKB-së, e cila nuk deshi ta shihte draft-rregulloren të lëvizë në drejtimin e planifikuar nga KiE-a dhe Misioni i OSBE-së në

[29] Memo nga DD për ZÇL "Mbi themelimin e PKDNJ-së", 4 mars 2005.
[30] Shkresa e ZÇL-së mbi "Natyrën dhe funksionimin e një Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut në Kosovë", 25 maj 2005.
[31] Shkresa e ZÇL-së për KiE në Kosovë duke bashkëngjitur shkresën "Themelimi i PKDNJ-së në Kosovë", 19 korrik 2005.

Kosovë. Në fakt, Departamenti i saj për Operacionet Paqeruajtëse, kishte vendosur, në gusht të vitit 2005, që të përfshijë një grup më të gjerë të OKB-së në procesin e draftimit, duke përfshirë Zyrën e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (ZKLDNJ) në Gjenevë.

42. Në shtator të vitit 2005, me kërkesën e UNMIK-ut, kryetari i GJEDNJ-së kontribuoi me qëndrimet e veta mbi draft-rregulloren dhe paraqiti dy pika të rëndësishme. E para, ai u pajtua t'i nominojë anëtarët e Panelit, por që ai kuptoi se PSSP-ja nuk do të ketë ndonjë liri veprimi për sa u përket emërimeve pasi anëtarët të jenë nominuar. E dyta, ai deshi më shumë qartësim për atë se si PSSP-ja do të shfrytëzojë "autoritetin dhe lirinë e tij të veprimit" në lidhje me rekomandimet e Panelit.[32] Ai theksoi në një letër në vazhdim të tetorit të vitit 2005, se autoriteti i tillë duhet të ushtrohet "duke pasur parasysh statusin dhe autoritetin e Panelit"; me fjalë të tjera, ai supozoi se PSSP-ja përgjithësisht do t'i ndiqte rekomandimet e Panelit.[33] Të dyja këto çështje do të bëhen shumë të diskutueshme pas pak.

43. Në fund, në janar të vitit 2006, Selia e Përgjithshme e OKB-së ia paraqiti analizën e vet ligjore UNMIK-ut lidhur me PKDNJ-në, që përmbante vërejtje esenciale. Për shembull, ZÇL në Selinë e Përgjithshme të OKB-së kundërshtoi propozimin që një organ këshillëdhënës duhet të "marrë vendime të një natyre 'kuazi-gjyqësore"; ai duhet të "autorizohet vetëm që t'i shqyrtojë pretendimet dhe t'ia paraqesë PSSP-së të gjeturat dhe rekomandimet e veta". Kjo, në fakt, tashmë ishte trajtuar: gjuha e përdorur në draft përcaktonte që "[P]SSP-ja do të ketë autoritetin dhe lirinë ekskluzive të vendosë nëse do të veprojë për një vendim".[34] E dyta, ZÇL në Selinë e Përgjithshme të OKB-së e filloi çështjen me ofrimin e një drafti, që autorizonte Panelin të sigurojë dëshmi (duke përfshirë dosjet dhe dokumentet në posedim të UNMIK-ut) dhe përgjithësisht kërkoi nga zyrtarët e UNMIK-ut që të bashkëpunojnë, duke u shfaqur para tij dhe duke ofruar dëshmi me gojë në interes të drejtësisë. ZÇL në Selinë e Përgjithshme të OKB-së mendoi që Panelit nuk duhet dhënë ndonjë autoritet "për të dhënë urdhër për t'u paraqitur në gjykatë". "Autoriteti për të detyruar paraqitjen e personelit të OKB-së … është i barasvlershëm me ushtrimin e funksioneve gjyqësore apo ekzekutive. Ai është, po ashtu, i papajtueshëm me statusin e UNMIK-ut, privilegjet dhe imunitetet e tij …".

44. Siç theksohej në një koment, "Ky koment është i rëndësishëm pasi ai dëshmon përcaktimin e Selisë së Përgjithshme të OKB-së që jo vetëm të vonojë inaugurimin e Panelit, por ta bëjë atë praktikisht joefektiv. Nga një pikëvështrim i pavarur, ZÇL-ja dështoi që t'i marrë parasysh praktikat më të mira që udhëheqin punën e institucioneve nacionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, disa nga të cilat kanë kompetenca kuazi-gjyqësore në fushën e administrimit të drejtësisë, duke përfshirë kompetencat e drejtpërdrejta për intervenim. Duke qenë plotësisht e vetëdijshme se marrja e

[32] Letra e kryetarit të GJEDNJ-së për PSSP-në, 20 shtator 2005.
[33] Letra e kryetarit të GJEDNJ-së për PSSP-në, 13 tetor 2005.
[34] Shkresa e ZÇL-së për ZÇL-në e OKB-së, "UNMIK-Themelimi i një Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut", 19 janar 2006.

informatave nga zyrtarët dhe qasja në dokumentacion është esenciale për të siguruar një hetim të plotë, ZÇL suksesshëm parandaloi shpalosjen e plotë dhe rrjedhimisht ofrimin e mjeteve të duhura juridike."[35] Në versionin tjetër të Rregullores thuhej që "të gjitha kërkesat për paraqitjen e personelit të UNMIK-ut dhe për dorëzimin e dokumenteve duhet t'i dorëzohen PSSP-së i cili, gjatë të vendosurit nëse do të veprojë, duhet të marrë parasysh interesin e drejtësisë, promovimin e të drejtave të njeriut dhe interesat e UNMIK-ut dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara në tërësi." Me këtë rregullimin e fundit dhe pas prerjes së bërë tjetrit, të fundit, të fushës së autoritetit të pavarur të Panelit, dhe duke lejuar në këtë mënyrë pajtueshmërinë me kërkesat e PKDNJ-së për informata që të qëndrojnë vetëm te PSSP-ja, më 23 mars 2006, UNMIK-u nxori Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 "Mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut." Duke përcaktuar rregullat dhe zvogëluar pavarësinë e Panelit, UNMIK-u deshi që ta dobësojë Panelin nga fillimi.

E. Miratimi i Rregullores

45. Siç është pritur, Rregullorja specifikonte datën 23 prill 2006 për dorëzimin e ankesave te Paneli, dhe vendosi juridiksionin e Panelit mbi ankesat në lidhje me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut që kishin ndodhur jo më herët se më 23 prill 2005 – saktësisht një vit më herët. Në një shkresë të ZÇL-së për PSSP-në, shpjegimi ngushëllues për këtë zgjedhje ishte elaboruar si pasqyrim "i një balance në mes shqetësimit që shkeljet e pretenduara para nxjerrjes së Rregullores duhet të përfshihen sa më shumë që është e mundshme dhe nevojës për të përjashtuar shkeljet e pretenduara për të cilat dëshmia nuk është më mjaftueshëm e qëndrueshme për shkak të kalimit të kohës."[36] Çfarë është lënë pa u thënë duke zgjedhur këtë datë – 23 prill 2005 – si pikë të fillimit të juridiksionit të Panelit, është se UNMIK-u përjashtoi trazirat e 17 marsit të vitit 2004 nga mandati i PKDNJ-së, kur qindra, nëse jo mijëra, shkelje të të drejtave të njeriut ndodhën në Kosovë para syve të UNMIK-ut. Kjo datë përjashtoi, po ashtu, një pjesë të madhe të shkeljeve që kishin ndodhur në gjashtë vjetët e mëparshme nën administrimin e UNMIK-ut.

46. Me vendosjen e kësaj date shumë të vonë për fillimin e juridiksionit të Panelit, UNMIK-u në esencë bllokoi arsyen kryesore që KiE propozoi për Panelin në rend të parë: themelimin e forumit tjetër që do t'u lejonte banorëve të Kosovës të kërkojnë dëmshpërblim për shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut në Kosovë gjatë administrimit të UNMIK-ut. Efekti i këtij zvogëlimi të juridiksionit të përkohshëm të Panelit ishte madje edhe më evident, duke marrë parasysh se deri në kohën e hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut, planet tanimë ishin duke qarkulluar për përfundimin e administrimit të UNMIK-ut: shumëkush brenda dhe jashtë UNMIK-ut prisnin që mandati i tij të përfundojë deri në vitin 2008 më së voni, duke nënkuptuar që PKDNJ ndoshta do të ekzistonte vetëm për një vit apo dy vjet.

[35] Bernard Knoll dhe Robert-Jan Uhl, "Tepër pak, tepër vonë: Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut në Kosovë", 7 *Shqyrtim i së drejtës evropiane për të drejtat e njeriut* (2007), fq. 534-549.
[36] Shkresa e ZÇL-së për PSSP-në, "Lidhur me Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut", 14 qershor 2006.

IV. Historiku i hershëm i Panelit

A. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12

47. Teksti kryesor legjislativ për funksionimin e PKDNJ-së është Rregullorja nr. 2006/12, e cila e ngarkon Panelin me juridiksion për të shqyrtuar një gamë të gjerë ankesash për të drejtat e njeriut që me sa duket i atribuohen UNMIK-ut sipas instrumenteve vijuese ndërkombëtare: DUDNJ, KEDNJ, KEDCP, KNDESK, KNEDR, KEDKG, KKT dhe KDF.[37] Prandaj, Paneli, përmes ligjit të vet të aplikueshëm, ishte mandatuar në mënyrë unike që të aplikojë koleksionin e plotë të instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

48. Kompetenca e Panelit, sipas Rregullores, ishe e kufizuar në shqyrtimin e ankesave të sjella para tij nga individët apo grupet, të cilët pohojnë se kanë qenë viktimë (a) të një shkelje të të drejtave të njeriut. Me kusht që ankesa të ishte e pranueshme, shqyrtimi i saj duhej të rezultonte me "të gjetura" që do t'i dorëzoheshin PSSP-së. Këto të gjetura ishin "të një natyre këshilluese" dhe mund të "përfshinin rekomandime" (Neni 1.3).

49. Rregullorja hyri në fuqi më 23 mars 2006, *d.m.th.* me datën e miratimit të saj (Neni 21). Megjithatë, ishte e mundshme të dorëzohen ankesa vetëm prej 23 prillit të vitit 2006, *d.m.th.* një muaj më vonë (Neni 21). Ajo datë me sa duket ishte, po ashtu, baza për përcaktimin e juridiksionit të përkohshëm të Panelit: ankesat në të vërtetë duhej të kishin të bënin me "shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur jo më herët se më 23 prill 2005 apo që rrjedhin nga faktet që kanë ndodhur para kësaj date, ku këto fakte kanë sjellë te një shkelje e vazhdueshme e të drejtave të njeriut" (Neni 2). Prandaj juridiksioni i Panelit kishte fuqi ligjore nga 23 prilli i vitit 2005, *d.m.th.* një vit para datës nga e cila mund të dorëzoheshin ankesa. Ndërsa juridiksioni i Panelit ishte zgjatur në një periudhë të caktuar kohore para se të bëhej ekzistent, duhet rikujtuar që, përveç "shkeljeve të vazhdueshme", kjo zgjatje nuk shkoi aq gjatë prapa deri në fillimin e administrimit të UNMIK-ut apo madje trazirat e 17 marsit të vitit 2004.

50. Një numër dispozitash duhet përmendur lidhur me organizimin e Panelit. Neni 4.2 siguronte që Paneli "do të përbëhej nga tre anëtarë, nga të cilët njëri do të caktohet si kryesues. Së paku një anëtar i … Panelit duhet të jetë femër".[38] Neni 4.3 siguronte që "anëtarët e … Panelit do të jenë juristë ndërkombëtarë me një karakter të lartë moral, paanësi dhe integritet dhe me një ekspertizë të dëshmuar në fushën e të drejtave të njeriut, veçanërisht sistemin evropian". Sipas nenit 5.2, siç është zëvendësuar me Rregulloren nr. 2007/3 të 12 janarit të vitit 2007, anëtarët ishin emëruar me një mandat prej një viti, por emërimi i tyre mund të ripërtërihej për një apo më shumë mandate. Ndonëse pavarësia e Panelit nuk është garantuar në mënyrë të qartë, ajo rezultoi nga kombinimi i dispozitave vijuese: Neni 5.1, i cili siguronte që anëtarët emërohen nga PSSP-ja "me propozimin e kryetarit të Gjykatës Evropiane për të

[37] Shih më lart, § 12.
[38] Është interesante se, formulimi në nenin 4.2 nuk e përjashtonte që Paneli do të mund të përbëhej ekskluzivisht nga femrat. Me sa duket hartuesit supozuan se një apo dy burra do të jenë zakonisht pjesë e Panelit.

Drejtat e Njeriut", duke e vendosur kështu procesin e përzgjedhjes në duart e një organi të pavarur që nuk ishte i lidhur me UNMIK-un; Neni 7.2, i cili u ofronte anëtarëve të Panelit imunitetet e njëjta si personelit të UNMIK-ut.

51. Neni 3 i Rregullores nr. 2006/12 cekte një numër kriteresh për pranueshmërinë e ankesave. Këto kritere korrespondonin në esencë me ato të cekura në nenin 35 të KEDNJ-së. Kriteret më të rëndësishme të pranueshmërisë – për sa i përket numrit të ankesave që Paneli duhej t'i shpallte të papranueshme – ishte neni 3.1, në të cilin thuhej që "Paneli mund të trajtojë një çështje vetëm pasi të ketë konkluduar se janë ndjekur të gjitha rrugët e tjera të mundshme, për shqyrtimin e shkeljes së supozuar dhe brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data kur është marrë vendimi i formës së prerë."

52. Kishte disa dispozita që kishin të bënin me procedurën para Panelit. Neni 10.1 parashihte që ankesat të dorëzohen me shkrim, dhe neni 10.5 parashihte që nuk do të ketë asnjë pagesë për parashtrimin e një ankese. Neni 11 parashihte shqyrtimin e ankesave në dy faza. E para, Paneli do të vendoste nëse ankesa ishte e pranueshme. Ai do ta bënte këtë duke u bazuar në informatat e ofruara nga ankuesi dhe në kërkesën për informata shtesë nga Paneli (Neni 11.2). Pastaj, kur një ankesë shpallet e pranueshme, Paneli duhej ta njoftonte për atë PSSP-në me qëllimin që të marrë një përgjigje në emër të UNMIK-ut në lidhje me bazueshmërinë e ankesës (Neni 11.3). Ai mund të kërkonte nga ankuesi dhe UNMIK-u që të bëjnë parashtresa të tjera me shkrim, "nëse këto parashtresa janë në interes të drejtësisë" (Neni 11.4). Neni 14 parashihte si në vijim: "Kur është në interes të drejtësisë … Paneli mban seanca me verbale"; Neni 16.1 specifikoi më tutje që seancat e Panelit janë "publike përveç nëse … Paneli në rastet e jashtëzakonshme vendos ndryshe". Neni 15 parashihte mundësinë që Paneli të "kërkojë… parashtrimin e çdo dokumenti, përfshirë dosjet dhe dokumentet që i posedon UNMIK-u" (Neni 15.1), dhe obligimin e PSSP-së për të "bashkëpunuar me … Panelin dhe (t'i) ofrojë atij ndihmën e nevojshme gjatë ushtrimit të pushtetit dhe kompetencave të tij, duke përfshirë, në mënyrë të veçantë lëshimin e dokumenteve dhe informatave që janë të rëndësishme për ankesën" (Neni 15.2).

53. Për sa i përket rezultatit të procedurave para Panelit, në rastet ku ankesa është shpallur e pranueshme dhe ku është shqyrtuar për bazueshmërinë, neni 17.1 parashihte që Paneli "sjell të gjeturat mbi atë se, a ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut dhe, ku është e nevojshme, jep rekomandime". Natyra e rekomandimeve të tilla nuk është specifikuar. Neni 17.3 parashihte që PSSP-ja "të ketë autoritetin dhe lirinë ekskluzive të vendosë nëse do të veprojë për të gjeturat e … Panelit". Nuk janë përcaktuar rregulla tjera për sa i përket ushtrimit nga ana e PSSP-së të autoritetit të lirë për të vepruar që të reagojë në të gjeturat dhe rekomandimet e Panelit. Në fund, të dyja, të gjeturat dhe rekomandimet e Panelit dhe vendimi i PSSP-së duhej të "publikoheshin menjëherë" (Nenet 17.2 dhe 17.4). Kjo nënkuptonte që procedurat para Panelit, ndonëse ishin vetvetiu konfidenciale (shih nenin 12), duhej përfunduar në një mënyrë plotësisht transparente.

54. Në përfundim, siç theksoi Paneli në Raportin e tij të parë vjetor, Paneli ishte "plotësisht i pavarur", dhe organizimi dhe mandati i tij ishin të tilla që do të mund të cilësohej më së miri si "organ kuazi-gjyqësor".[39]

B. Përbërja e parë e Panelit

55. Më 6 prill 2006, PSSP-ja informoi kryetarin e GJEDNJ-së se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12 ishte nxjerrë dhe e ftoi atë t'i propozojë tre anëtarë të Panelit. Më 14 qershor 2006, kryetari i GJEDNJ-së propozoi z. Paul Lemmens, z. Marek Nowicki dhe znj. Michèle Picard, që të jenë anëtarët e parë të Panelit. Tre anëtarët e propozuar të Panelit pritën një letër të emërimit nga PSSP-ja, në pajtim me Rregulloren, dhe filluan përgatitjet ta kalojnë rregullisht kohën në Kosovë për seancat e Panelit. Brenda UNMIK-ut, u hartuan plane nga ZÇL-ja për ta zbatuar një plan veprimi që ta bëjë PKDNJ-në funksionale duke përfshirë: gjetjen e një adrese të përkohshme për pranimin e ankesave drejtuar Panelit, përfundimin e faqes së tij të internetit, lëshimin e një deklarate për shtyp dhe largimin e stafit nga zyrat e tjera për t'ia ofruar Panelit me Sekretariatin e tij me qëllim që Paneli të mund të mbajë seancën e vet të parë më 1 qershor 2006.[40]

56. Megjithatë, nuk ka pasur planifikim për PKDNJ-në në vitin buxhetor 2006-2007, i cili filloi më 1 korrik 2006. Kur drejtori i Administratës së UNMIK-ut u pyet për çështjen, ai theksoi se me qëllim që të themelohet Sekretariati i Panelit, rregullat e OKB-së kërkonin që çdo pozitë e re e sapokrijuar duhet të shpallet në mënyrë transparente me një përshkrim të plotë të punës pas procesit normal garues të rekrutimit. Ai theksoi "[k]jo, së bashku me përshkrimin e projektit, funksionet e Panelit/Sekretariatit, skemën relevante organizative dhe përshkrimet e plota të punës për pozitat e kërkuara që sot e tutje duhet t'i dorëzohen Administratës."[41] Natyrisht, ky është një proces intensiv dhe është e habitshme se këto pyetje, lidhur me atë nëse funksionimi i PKDNJ-së dhe Sekretariatit të tij do t'i ndjekë protokollet normale të OKB-së apo disa procese speciale, me sa duket nuk kanë dalë derisa Paneli dhe Sekretariati kishin planifikuar të fillojnë operacionet e tyre. Do të marrë shumë më shumë muaj para se UNMIK-u të jetë në gjendje t'i zgjidhë mospajtimet e brendshme. Në rrethana të tilla, PSSP-ja vonoi emërimin e anëtarëve të Panelit për gjashtë muajt vijues të vitit 2006, dhe tre të nominuarit nuk pranuan lajm zyrtar nga UNMIK-u rreth asaj se kur ata do të emërohen.

57. Më 12 janar 2007, PSSP-ja emëroi tre të nominuarit si anëtarë të Panelit. Ata pritën për udhëzime nga UNMIK-u rreth detajeve teknike të mandatit të tyre; për shembull, sa shpesh ata duhet të planifikojnë të vijnë në Kosovë dhe çfarë përkrahje administrative do të kenë. Por përsëri, me javë, asnjë informatë nuk ishte në dispozicion. Të gjithë tre anëtarët e Panelit shkruan email-a për ta kontaktuar

[39] PKDNJ, *Raport Vjetor 2008*, § 1.
[40] Shkresa e ZÇL-së për PSSP-në, "Strategjia për bërjen funksional të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut", 21 prill 2006.
[41] Memorandum i brendshëm nga udhëheqësi i Departamentit të Administratës të UNMIK-ut drejtuar ushtruesit të detyrës të shefit të personelit të UNMIK-ut, 23 gusht 2006.

UNMIK-un për të provuar që të marrin përgjigje. Më 28 shkurt 2007, anëtarit të Panelit z. Lemmens iu tha në një email se Sekretariati i PKDNJ-së ishte akoma në proces të formimit dhe që më shumë detaje do të ofrohen së shpejti. Pastaj përsëri, kishte qetësi nga UNMIK-u. Më 12 prill 2007, të tre anëtarët e Panelit i shkruan një letër të përbashkët PSSP-së, duke shprehur shqetësimin e tyre se "ne nuk do të jemi në gjendje të përmbushim mandatin që na është besuar, nëse nuk fillojmë me ushtrimin e tij në të ardhmen shumë të afërt." Paneli po ashtu theksoi që, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12, PKDNJ ka qenë ligjërisht i hapur për të pranuar ankesa për pothuaj një vit në atë kohë, nga 23 prilli i vitit 2006, dhe akoma Paneli nuk ka qenë në gjendje të mblidhet dhe të fillojë punë e vet.[42]

58. I nxitur pjesërisht nga një rrjedhë e vazhdueshme e pyetjeve nga anëtarët e Panelit dhe nga udhëheqësi i ZKLDNJ në Kosovë rreth asaj se kur Paneli do të fillojë punën e vet, UNMIK-u kërkoi këshillë nga Selia e Përgjithshme e OKB-së më 15 qershor 2007. Pasi UNMIK-u tanimë ishte duke filluar të planifikojë për skadimin e mandatit të vet dhe përfundimin e misionit të vet, disa brenda UNMIK-ut argumentuan në Selinë e Përgjithshme të OKB-së se ndoshta ishte tepër vonë të mblidhet fare Paneli, apo në fund të fundit, Paneli nuk mund të bëhej funksional pa një afat të fundit për dorëzimin e ankesave. Më 5 korrik 2007, Selia e Përgjithshme e OKB-së kërkoi veprim nga UNMIK-u, duke e përgjëruar atë të mbledhë PKDNJ-në pa vonesë dhe thënë që vendosja e një afati të fundit për dorëzimin e ankesave nuk ishte një parakusht për gjykim zytar për ngarkesën e tanishme me lëndë.

59. Seanca inauguruese e Panelit më në fund u mbajt në nëntor të vitit 2007; madje edhe atëherë Paneli gjeti se shumë nga gjërat e nevojshme për t'i mundësuar Panelit të funksionojë ose nuk ishin kryer ose ishin bërë kuturu, duke filluar me sigurimin joadekuat të stafit të Sekretariatit, i cili në atë kohë përbëhej vetëm nga një zyrtar ekzekutiv[43] dhe një asistente administrative. Në dhjetor të vitit 2007, Sekretariati u shtua pak për të përfshirë një zyrtar ligjor dhe një asistente tjetër administrative.

60. Më 10 mars 2008, AI, HRW dhe Komiteti Norvegjez i Helsinkit shpërndanë një deklaratë të përbashkët për shtyp në të cilën thuhej se "UNMIK-u kishte marrë hapa në kohën e fundit për të përmirësuar përgjegjësinë e vet … UNMIK-u, po ashtu, mori hapa për të themeluar Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut … pas pothuaj një vonese dyvjeçare … [ky hap nuk ofron] megjithatë, dëmshpërblim efektiv për abuzimet që ndodhën gjatë periudhës pothuaj dyvjeçare në të cilën Institucioni i Ombudspersonit nuk ishte në gjendje të pranojë ankesa kundër UNMIK-ut dhe Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut akoma duhej të fillonte me punën e vet."[44]

61. Në retrospektivë, njeriu mund të zbulojë (nga vetë fillimi) qasjen e njëjtë që rrjedh nga UNMIK-u lidhur me PKDNJ-në. Së pari, UNMIK-u do të luftonte për ta dobësuar

[42] Letra e përbashkët e anëtarëve të Panelit z. Marek Nowicki, z. Paul Lemmens dhe znj. Michèle Picard drejtuar PSSP-së z. Joachim Rücker, 12 prill 2007.
[43] Zyrtar ekzekutiv ishte z. John J. Ryan. Biografia e tij është përfshirë në Shtojcën B.
[44] AI, HRW dhe Komiteti Norvegjez i Helsinkit, "Kosovë: BE-ja duhet të sigurojë që misioni ndërkombëtar është i përgjegjshëm", deklarata për shtyp, 10 mars 2008.

autoritetin ligjor të Panelit, me qëllim të minimizimit të mundësisë që Paneli të mund të bëjë mbikëqyrjen e duhur. Më pas, UNMIK-u do të rrezikonte funksionalitetin e Panelit duke bërë pak apo aspak përpjekje dhe bashkërendim me strukturat mbështetëse të Panelit. Në çdo rast, Paneli do të harxhojë një sasi të konsiderueshme të energjisë gjatë vitit të parë për të provuar që të korrigjojë mungesën e planifikimit adekuat të UNMIK-ut dhe ekzekutimit.

C. Viti i parë: Përmirësimi i defekteve

62. Kur anëtarët e Panelit u mblodhën për seancën e tyre të parë në Prishtinë, në nëntor të vitit 2007, PKDNJ tanimë kishte pranuar rreth 15 ankesa, me gjithë punën e dobët që UNMIK-u e kishte bërë për ta bërë të njohur PKDNJ-në te popullata e Kosovës dhe ata që ishin zhvendosur jashtë. Fillimisht, më 10 maj 2006 dhe jo gjatë pas hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, Departamenti i UNMIK-ut për Marrëdhënie me Publikun (DMP) kishte organizuar një konferencë me gazetarë rreth PKDNJ-së që, po ashtu, ishte mbuluar nga mediet lokale. Duke pranuar se kjo ishte e pamjaftueshme, Paneli menjëherë e kuptoi që marrëdhëniet me publikun duhej ndërtuar në kohën e shkurtër të caktuar që ata kishin gjatë vizitave të tyre mujore në Kosovë. Ata nuk mund të mbështeteshin në strukturat dhe kapacitetin operacional të UNMIK-ut për të kryer këtë detyrë.

63. Pavarësisht kapacitetit të vet të kufizuar, Paneli dhe Sekretariati i tij organizuan një fushatë të kufizuar të vetëdijesimit publik dhe u angazhuan në dialog me organizata të ndryshme nacionale dhe ndërkombëtare gjatë gjithë vitit 2008, me qëllim të informimit të plotë të publikut rreth ekzistencës dhe mandatit të Panelit si një mekanizëm i ankesave për të drejtat e njeriut. Kjo fushatë përfshinte takimet publike, intervistat për medie, deklaratat për shtyp, takimet me OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare, në veçanti ato të përfshira në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Paneli dhe Sekretariati kishin një takim në fillim më 13 mars 2008 me përfaqësuesit e OJQ-ve, shoqërisë civile, zyrave për ndihmë ligjore dhe komuniteteve minoritare, të angazhuara aktivisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë.

64. Paneli dhe Sekretariati i tij u angazhuan më tutje në disa paraqitje për medie, duke përfshirë intervistat në radio dhe TV në zonat e ndryshme minoritare për të theksuar punën e Panelit, për shembull në mediet serbe Radio KiM në Çagllavicë dhe TV Ura në Mitrovicë. Transmetimi i një njoftimi në një shërbim publik mbi operacionet e Panelit ishte bërë në TV-të shqipfolëse dhe serbishtfolëse më 2 qershor 2008. Veç kësaj, kishte një spot të TV-së të prodhuar nga DMP i UNMIK-ut në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, por versioni shqip nuk u transmetua kurrë. Në praktikë, shpërndarja e spotit ishte e kufizuar vetëm në TV Ura, i cili ishte pajtuar ta transmetojë atë falas. Por TV Ura, një kanal në gjuhën serbe, kishte një shtrirje relativisht të vogël të transmetimit. Megjithëse DMP i UNMIK-ut e prodhoi spotin e TV-së, me sa duket UNMIK-u nuk kishte buxhet të paguajë për kohën që ai do të transmetohej. Zyrtari

ekzekutiv i Sekretariatit bëri përpjekje të mëdha për të gjetur një mënyrë për UNMIK-un të paguajë, por pa dobi. Si i tillë, spoti i TV-së u shfaq vetëm disa herë.

65. Sekretariati i Panelit, po ashtu, organizoi një fushatë të informimit publik në rajon. UNMIK-u përgatiti fletëpalosje informuese në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, të cilat u shpërndanë në ndërtesat e gjykatave, ndërtesat komunale dhe qeveritare, dhe përmes OJQ-ve. Në shtator të vitit 2008, Sekretariati i paraqiti informatat mbi mandatin dhe operacionet e Panelit te Paneli i Komisionit të Kosovës për Ndihmë Ligjore. Kjo u pasua në tetor të vitit 2008 nga një takim me përfaqësuesit e Programit për asistencë ligjore institucioneve të Qeverisë së Serbisë, i cili merret me refugjatët dhe personat e zhvendosur së brendshmi (PZHB-të) në Serbi.

66. Sekretariati i Panelit vazhdoi me fushatën e informimit publik gjatë një vizite në Serbi më 26 dhe 27 nëntor 2008, ku ai takoi Asociacionin e Familjeve të Personave të Rrëmbyer dhe të Vrarë në Prokuple dhe takoi në Beograd udhëheqësin e ekipit të Projektit për ndihmë ligjore të financuar nga BE-ja (dhe të implementuar nga Këshilli Danez për Refugjatë (KDR). Sekretariati, po ashtu, takoi përfaqësuesit e Ministrisë për Kosovë dhe Metohi, Komisarin e Lartë të OKB-së për Refugjatë, KDR-në, Organizatën Ndërkombëtare për Migrim, OJQ-në Praxis, Qendrën Ndërkombëtare për Zhvillim të Migrimit, Iniciativën për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Qendrën e Ballkanit për Migrim dhe Aktivitete Humanitare dhe përfundoi fushatën me një takim me ndihmës ministrin serb në Ministrinë për Kosovë dhe Metohi.

67. Në përgjithësi, fushata e vetëdijesimit publik për Panelin, në të cilën UNMIK-u duhej të bënte një planifikim dhe të përdorte resurse, është bërë, në vend të kësaj, kuturu dhe pa një buxhet të mjaftueshëm. Nuk kishte asnjë strategji të përgjithshme të implementuar nga UNMIK-u: ndoshta, për shkak se duke qenë që UNMIK-u planifikoi që Paneli të ketë jetëgjatësi relativisht të vogël të dobishme – një apo dy vjet- nuk ishte bërë investim i duhur në vetëdijesimin publik për PKDNJ-në. Në pjesën më të madhe, Paneli ishte i panjohur për ankuesit e mundshëm, që në fund të fundit rezultoi në atë se ata persona nuk i paraqitën ankesa Panelit. Ky problem mund të jetë rënduar më tutje nga rrethanat specifike kulturore në kuadër të shoqërisë së Kosovës, në atë që njerëzit nuk janë të prirë për të marrë veprim ligjor dhe kanë një mosbesim të përgjithshëm ndaj policisë, gjykatave dhe strukturave të tjera institucionale.

D. Rregullorja e punës

68. Neni 18 i Rregullores nr. 2006/12 siguroi që Paneli "do të miratojë rregulla të punës për procedurat e tij". Hartimi i këtyre rregullave ishte detyra kryesore e Panelit në fillim të funksionimit të vet. Rregullat e punës janë miratuar më 5 shkurt 2008. Ato janë ndryshuar pak më vonë më 11 shtator 2009 dhe 21 nëntor 2009 (përfshirja e

Rregullës 39*bis* dhe 39*ter*). Amendamente më substanciale janë miratuar më 12 shkurt 2010, pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ (UA) nr. 2009/1.[45]

69. Gjatë hartimit të Rregullores së vet të punës, Paneli kërkoi informata në rregulloret ekzistuese të organeve të një natyre të ngjashme, veçanërisht Rregulloren e punës të Dhomës për të Drejtat e Njeriut për Bosnjë e Hercegovinën,[46] një organ gjyqësor i themeluar sipas Aneksit 6 në Marrëveshjen e Përgjithshme Kornizë për Paqe në Bosnjë e Hercegovinë (Marrëveshja e Paqes e Dejtonit). Për dispozita të caktuara, Rregullorja e punës e GJEDNJ-së, po ashtu, shërbeu si një burim i frymëzimit.

70. Është e qartë që, duke pranuar këto dhe rregulloret e tjera të punës, Paneli synonte t'i japë kuptim konkret natyrës kuazi-gjyqësore të mekanizmit të themeluar me Rregulloren nr. 2006/12: duke e zyrtarizuar procedurën, duke theksuar se e kishte në kontroll administrimin e procedurave, duke theksuar që qëndrimet e Panelit do të bazohen në norma ligjore e jo në vlerësime politikash, duke siguruar një proces adversarial dhe duke qartësuar se vendimet e veta (mbi pranueshmërinë) dhe mendimet (mbi bazueshmërinë) do të hartoheshin në një mënyrë ligjore dhe juridike.

E. Qasja në Panel

71. Çështje tjetër e hershme që kurrë nuk ishte korrigjuar vërtet kishte të bënte me vendosjen fizike të Panelit. Nga seanca e tij e parë në nëntor të vitit 2007, Paneli ishte i vendosur në qendër të Prishtinës, brenda kompleksit të rrethuar me mur të UNMIK-ut pa qasje publike. Por ky lokacion konsiderohej kalimtar dhe i përkohshëm, së paku në fillim. Paneli, duke pasur parasysh natyrën e organit dhe nevojën për publikun që të ketë qasje në të, konsideroi se vendosja e Sekretariatit të tij duhet të bëhet në qendër të qytetit, jashtë kompleksit të UNMIK-ut. Sekretariati i Panelit e ngriti këtë çështje me personelin e ndryshëm të UNMIK-ut gjatë vitit të parë dhe duke mos pasur sukses me administratën e UNMIK-ut, Paneli përfundimisht kontaktoi vetë PSSP-në për çështjen. Kryesuesi i Panelit ia paraqiti shqetësimet e tij PSSP-së se ishte planifikuar shpërngulja e Panelit, së bashku me pjesën tjetër të UNMIK-ut, nga kompleksi i UNMIK-ut në qendër të Prishtinës në një kompleks tjetër të rrethuar me mur të UNMIK-ut jashtë qytetit që ishte madje edhe më i paqasshëm.

72. Ngjashëm, Komiteti i OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në Raportin e vet mbi seancën e 41^{të} të 10 nëntorit të vitit 2008 lidhur me UNMIK-un rekomandoi "që UNMIK-u t'i sigurojë Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut hapësirë adekuate me zyra jashtë objekteve të veta, për të garantuar plotësisht

[45] Në mënyrë specifike, rregulla 33 § 1 dhe rregulla 33 § 2 janë ndryshuar për të inkorporuar drejtpërdrejt kërkesën e vendosur në nenin 2.3 të UA në Rregulloren e punës.
[46] Dhoma për të Drejtat e Njeriut për Bosnjë e Hercegovinë ishte funksionale në mes marsit të vitit 1996 dhe 31 dhjetorit të vitit 2003.

pavarësinë e tij si dhe burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore …".[47] Megjithatë, PSSP-ja me sa duket nuk ishte bindur dhe e refuzoi kërkesën.

F. Stafi shtesë

73. Njëri nga problemet më kronike me të cilin Paneli do të përballej ishte sigurimi i stafit të Sekretariatit; nga fillimi i tij e deri së paku në vitin 2012, UNMIK-u nuk i siguroi atij zyrtarë të mjaftueshëm ligjorë. Kur Paneli u mblodh për seancën e vet të parë në nëntor të vitit 2007, Sekretariati përbëhej vetëm nga një zyrtar ekzekutiv dhe një asistent administrativ.[48] Në dhjetor të vitit 2007, një zyrtare ligjore[49] dhe një asistente administrative më shumë[50] iu bashkuan Sekretariatit, por duke pasur parasysh listën e Panelit të çështjeve gjyqësore lidhur me ankesat, e cila shpejt u rrit në 50 dhe ishte në rritje në muajt e parë të vitit 2008, Paneli kishte nevojë të gjejë më shumë ndihmë. Pasi UNMIK-u dukej jo i gatshëm apo nuk ishte në gjendje të caktojë juristë më me eksperiencë në Panel, kryesuesi apo zyrtari ekzekutiv duhej të kërkonin ndihmë nga të gjitha anët: në regjistrin e GJEDNJ-së si dhe në ambasadat e ndryshme në Kosovë, duke përfshirë ato të Finlandës, Suedisë, Belgjikës, Austrisë, Zvicrës, Norvegjisë, në Misionin e OSBE-së në Kosovë, Vullnetarët e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (VeOKB-së) dhe ZKLDNJ në Kosovë. Disa nga këto aktivitete janë paraqitur në formë kronike më poshtë, për të theksuar kohën që shpenzuan dhe përpjekjen që bënë anëtarët e Panelit duke punuar në çështjet që kishin të bënin me ndihmën, përveç punës së tyre në rast.

Zëvendësimi nga regjistri i GJEDNJ-së

74. Në shkurt të vitit 2008, anëtarët e Panelit iu qasën regjistrit të GJEDNJ-së, duke kërkuar ndihmë urgjente për të dërguar një jurist me kualifikim të lartë për të drejtat e njeriut me ekspertizë për t'u marrë me raste të tilla. Zyra përkatëse përgjegjëse për regjistrin akomodonte dhe madje la të kuptohet se ishte e gatshme të ndante barrën financiare me UNMIK-un për zëvendësimin e njërit nga anëtarët e tij të stafit. Megjithatë, kur Paneli kërkoi ndihmë nga UNMIK-u lidhur me ndarjen e shpenzimeve administrative, UNMIK-u nuk pranoi. Pavarësisht nga papajtueshmëria e UNMIK-ut, Zyra përkatëse përgjegjëse për regjistër vendosi se ishte imperative të ndihmohet Paneli që të funksionojë dhe kështu vendosi të mbajë mbi supe krejt peshën e zëvendësimit. Megjithatë, për shkak të shpenzimit, Zyra përkatëse përgjegjëse për regjistër mund të vazhdonte marrëveshjen vetëm për një periudhë dymujore, e cila zgjati nga maji deri në korrik të vitit 2008. Kjo përfundoi me të qenit një zhvillim i rëndësishëm në jetën e Panelit, pasi juristja[51] solli dije shtesë institucionale të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe ndihmoi forcimin e operacioneve të Sekretariatit të Panelit.

---

[47] KNDESK e OKB-së, *Shqyrtimi i raporteve të paraqitura nga palët shtetërore sipas neneve 16 dhe 17 të Konventës, Dokument i dorëzuar nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Observime përfundimtare të Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*, E/C.12/UNK/CO/1, 1 dhjetor 2008, § 11.
[48] Asistent administrativ ishte z. Ruzvelt Frrokaj. Biografia e tij është përfshirë në Shtojcën B.
[49] Zyrtare ligjore ishte znj. Leanne Ho. Biografia e saj është përfshirë në Shtojcën B.
[50] Asistente administrative ishte znj. Snezhana Martinoviq. Biografia e saj është përfshirë në Shtojcën B.
[51] Juriste ishte znj. Magda Mierzewska. Biografia e saj është përfshirë në Shtojcën B.

Ndihma e Qeverisë së Finlandës

75. Zyrtari ekzekutiv i Panelit, z. John Ryan, shpenzoi kohë të rëndësishme gjatë gjithë verës dhe vjeshtës së vitit 2008 për t'u ndërlidhur me diplomatët që përfaqësonin ambasadat e ndryshme në Kosovë, duke provuar të ndihmojë në gjetjen e një lokacioni dhe në financimin e zyrtarëve ligjorë të specializuar në të drejtën për të drejtat e njeriut për të punuar në Sekretariat. Rreth asaj kohe, zyrtari ekzekutiv kishte takime produktive me përfaqësuesit e Zyrës së Finlandës në Kosovë dhe Qeveria e Finlandës premtoi se do të jetë në gjendje të sigurojë një zyrtare ligjore për Panelin. Përsëri, me pak apo aspak ndihmë nga UNMIK-u, anëtarët e Panelit negociuan me finlandezët për të marrë pëlqim zyrtar për një zyrtare ligjore të Sekretariatit të Panelit. Në ndërkohë, pjesërisht për shkak të zvogëlimit të UNMIK-ut, Sekretariati pranoi një zyrtar shtesë ligjor nga shtatori i vitit 2008 deri në dhjetor të vitit 2008.[52] Nevoja për staf u bë edhe më e theksuar në nëntor të vitit 2008 kur zyrtari tjetër ligjor i Panelit dha dorëheqje, duke mos lënë asnjë zyrtar ligjor afatgjatë në staf. Në janar të vitit 2009, zyrtarja ligjore finlandeze më në fund filloi punën e saj në Panel si zëvendësim për kohë të caktuar; rreth kohës së njëjtë, Paneli pranoi ankesën e tij të 100^{të} . Fatkeqësisht, ajo ishte në gjendje të kalojë vetëm gjashtë muaj në Panel para se të largohej për një punë tjetër, dhe nuk ishte e mundshme për Qeverinë e Finlandës të dërgojë zyrtarë të tjerë ligjorë për të ndihmuar Panelin. Kjo ndihmë e Finlandës i mundësoi Sekretariatit të Panelit të vazhdojë punën gjatë një periudhe jashtëzakonisht të vështirë.[53]

Vullnetarët e OKB-së / Stafi i OKB-së

76. Një bashkim faktorësh çuan te më shumë çrregullim në Sekretariatin e PKDNJ-së gjatë vitit 2009. Për shkak të zvogëlimit të përgjithshëm dhe rikonfigurimit në gjithë UNMIK-un deri në qershor të vitit 2009, pasi UNMIK-u filloi të përshtatej me rolin e vet të ri më të vogël në Kosovë për shkak se "Autoritetet e Kosovës vazhduan [veprimin] në bazë të 'Kushtetutës së Republikës së Kosovës'",[54] kishte shumë lëvizje të stafit në mes zyrave të ndryshme të UNMIK-ut. Një përfitim për Sekretariatin e PKDNJ-së nga kjo lëvizje ishte caktimi i tre zyrtarëve ligjorë nga Vullnetarët e OKB-së për të ndihmuar Sekretariatin. Megjithëse secili nga ta qëndroi pak muaj, PKDNJ vlerësoi ndihmën me të cilën ata kontribuuan.[55] Ngjashëm, Paneli është ndihmuar shumë nga zyrtarja tjetër ligjore, e cila ishte caktuar përkohësisht në Panel për një periudhë gjashtëmujore deri në qershor të vitit 2009.[56]

77. Si pasojë e rikonfigurimit të UNMIK-ut, zyrtari ekzekutiv i Sekretariatit u largua nga UNMIK-u. Përsëri, UNMIK-u mori kohën e vet për të gjetur një zyrtar të ri ekzekutiv– tjetri iu bashkua Sekretariatit vetëm në shkurt të vitit 2010.[57] Në ndërkohë,

[52] Ky zyrtar ligjor ishte z. Martin Clutterbuck. Biografia e tij është përfshirë në Shtojcën B.
[53] Kjo zyrtare ligjore ishte znj. Elina Castren. Biografia e saj është përfshirë në Shtojcën B.
[54] KS i OKB-së, Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë i 10 qershorit të vitit 2009, S/2009/300.
[55] Këta zyrtarë ligjorë të Vullnetarëve të OKB-së ishin znj. Jerina Dampier, znj. Sarah Enright, z. Butera Mpira dhe znj. Chiara Rojek. Biografitë e tyre janë përfshirë në Shtojcën B.
[56] Kjo zyrtare ligjore ishte znj. Bernadette Foley. Biografia e saj është përfshirë në Shtojcën B.
[57] Ky zyrtar ekzekutiv ishte z. Rajesh Talwar. Biografia e tij është përfshirë në Shtojcën B.

ndërsa pozita e zyrtarit ekzekutiv ishte e lirë nga fundi i qershorit të vitit 2009, detyrat e zyrtarit ekzekutiv ishin marrë përsipër nga dy zyrtarë ligjorë.[58] Në total, stafi i Sekretariatit sillej nga një lartësi prej dhjetë anëtarësh të stafit në maj të vitit 2009 deri në katër anëtarë të stafit me orar të plotë deri në fund të qershorit të vitit 2009, kur përbëhej vetëm prej dy zyrtarëve ligjorë dhe dy asistenteve administrative. Problemi i shkaktuar nga lëvizja e stafit, kombinuar me ndryshimet legjislative të ofruara në Udhëzimin Administrativ (UA),[59] kufizuan Sekretariatin gjatë gjysmës së dytë të vitit 2009, megjithëse ai akoma ia arrinte t'i shqyrtojë rastet dhe t'i përgatisë ato për vendim të Panelit.

Ndihma e ZKLDNJ, Qeverisë së Suedisë dhe stafi tjetër i përkohshëm shtesë nga brenda OKB-së.

78. Madje edhe në vitin 2010, Sekretariati i PKDNJ-së akoma po shpenzonte një pjesë të madhe të kohës për të kërkuar zyrtarë ligjorë me përvojë nga ZKLDNJ në fushën e së drejtës që ka të bëjë me të drejtat e njeriut, për të provuar që t'i rregullojë problemet me staf të Sekretariatit që nuk ishin trajtuar si duhet nga UNMIK-u. Zyrtari ekzekutiv e bëri të qartë që, megjithëse Sekretariati ishte më në fund në numër të plotë sipas buxhetit të ndarë të UNMIK-ut, me tre juristë në staf (duke përfshirë zyrtarin ekzekutiv) për herë të parë në vitin 2010 – më shumë se tre vjet pasi ishte themeluar Paneli – duke u bazuar në numrin e rasteve që kishin mbetur për t'u shqyrtuar dhe zgjeruar parashikimet e tanishme, do të marrë disa vite që Paneli ta përfundojë mandatin e vet. Fatkeqësisht, pavarësisht një dialogu të gjatë për këtë çështje, Selia e Përgjithshme e ZKLDNJ –së në Gjenevë nuk ishte në gjendje ta plotësojë Sekretariatin me juristë shtesë.

79. Në mars të vitit 2010, kryesuesi po ashtu kërkoi ndihmë financiare apo zëvendësim të një zyrtari ligjor nga Qeveria e Suedisë. Pasi u informua se Qeveria e Suedisë ishte e gatshme të ofrojë financim për një zyrtar ligjor shtesë, Paneli u informua nga UNMIK-u se ai nuk ishte në gjendje të pranojë financim të tillë dhe nuk ishte në gjendje të paguajë një anëtar të stafit në atë mënyrë. Kjo pengesë e detyroi Panelin t'i kontaktojë organet e tjera dhe Programi për Zhvillim i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP) ishte në gjendje të shfrytëzojë njërin nga projektet e veta për të pranuar paratë suedeze dhe përkrah Panelin përmes emërimit të një specialisti për të drejtat e njeriut.[60] Megjithatë, ky komplikim shtesë e shtyu datën e fillimit të punës së specialistit për të drejtat e njeriut në Sekretariatin e PKDNJ-së deri në maj të vitit 2011. Pavarësisht kësaj, Qeveria e Suedisë me mirësjellje ofroi ndihmë, duke i mundësuar Sekretariatit të Panelit të punësojë një juriste në këtë pozitë për pothuaj dy vjet, derisa UNMIK-u përfundimisht rregulloi pozitën e saj si një zyrtare ligjore.[61]

[58] Këta dy zyrtarë ligjorë ishin z. Nedim Osmanagiq dhe z. Ravi K Reddy. Biografitë e tyre janë përfshirë në Shtojcën B.
[59] Shih më poshtë, V. Urdhëresa Administrative dhe pasojat e saj.
[60] Shih PKDNJ, *Raporti Vjetor 2011*, § 3.
[61] Kjo specialiste për të drejtat e njeriut dhe më vonë zyrtare ligjore ishte znj. Anna Maria Cesano. Biografia e saj është përfshirë në Shtojcën B.

80. Paneli, po ashtu, është ndihmuar nga një zyrtare ligjore[62] duke u bazuar në huazimin e dhënë nga Konferenca e OKB-së për Tregti dhe Zhvillim (UNCTAD) në Gjenevë, nga tetori i vitit 2010 deri në shtator të vitit 2011.

V. Urdhëresa Administrative dhe pasojat e saj

A. Seanca dëgjimore *Balaj dhe të tjerët*

81. Më 19 mars 2009, është mbajtur seanca dëgjimore për rastin *Balaj dhe të tjerët*[63] që ishte e mbyllur për publikun. Me kërkesën e ankuesve, Paneli vendosi po të njëjtën ditë që një seancë tjetër dëgjimore do të mbahet, këtë herë publike, më 4 qershor 2009. Ky vendim e përshpejtoi një proces i cili përfundoi me miratim nga PSSP-ja të Udhëzimit Administrativ (UA) nr. 2009/1 më 17 tetor 2009. Para se të përshkruhet përmbajtja e UA-së, është e dobishme të ofrohen disa informata për historikun e hartimit të tij.

82. Lënda *Balaj dhe të tjerët* u bë një nga çështjet më të diskutueshme në mes të PKDNJ-së dhe UNMIK-ut. Ky rast kishte të bënte me vrasjen e dy demonstruesve dhe plagosjen serioze të dy të tjerëve, gjatë një demonstrate politike në Prishtinë në mars të vitit 2004 nga policët e Njësiteve të Policisë Rumune nën autoritetin komandues të UNMIK-ut duke shtënë me plumba vdekjeprurës gome. Ankuesit pretendonin se këto veprime të UNMIK-ut përbënin shkelje të së drejtës së tyre në jetë, shkelje të së drejtës në ndalim të torturës dhe trajtimit jonjerëzor dhe degradues dhe shkelje të së drejtës për tubim publik. Ndryshe nga shumica e ankesave të tjera në Panel, ankuesit në rastin *Balaj dhe të tjerët* kishin përfaqësim ligjor.[64] Duke pasur parasysh kompleksitetin e rastit, në fund të vitit 2008 Paneli filloi me planifikimin për të mbajtur një seancë të dëgjimit publik dhe të gjejë një hapësirë të duhur për këtë.

83. Pasi i inspektoi objektet në dispozicion, Sekretariati i Panelit përfundoi që Gjykata e Qarkut e Prishtinës do të ishte vendi më i mirë, pasi ishte objekti i vetëm që kishte pajisje për përkthim simultan, akomodim adekuat dhe të duhur për Panelin, si dhe për përfaqësuesit ligjorë dhe ankuesit dhe ishte e hapur dhe lehtë e qasshme për publikun. Më 15 dhjetor 2008, PSSP-ja informoi Panelin se "vendi për ndonjë seancë të dëgjimit publik në rastin [*Balaj dhe të tjerët*] nevojitet t'i përjashtojë gjykatat lokale e në veçanti Gjykatën e Qarkut të Prishtinës. Një vend i tillë është jo i përshtatshëm për seancat e dëgjimit publik të PKDNJ-së, meqë PKDNJ nuk është organ gjyqësor apo kuazi-gjyqësor, por thjesht një Panel këshillëdhënës … rekomandimet e [tij] janë jodetyruese dhe PSSP-ja i UNMIK-ut e ka autoritetin e vetëm të vendosë nëse do të veprojë për të gjeturat e Panelit Këshillëdhënës. Mbajtja e një seance të dëgjimit publik në një ndërtesë gjykate do t'i dërgojë sinjal të gabuar publikut dhe do ta lë një përshtypje plotësisht jo të duhur që një gjykatë është mbledhur mbi UNMIK-un. Kjo

[62] Kjo zyrtare ligjore ishte znj. Anila Premti. Biografia e saj është përfshirë në Shtojcën B.
[63] *Balaj dhe të tjerët*, nr. 04/07.
[64] Ankuesit janë përfaqësuar nga z.Halim Sylejmani nga Kosova dhe kishte po ashtu përfaqësim nga agjencia angleze për përfaqësim ligjor Tooks Chambers**,** duke përfshirë z. Michael Mansfield QC dhe z. Paul Troop.

duhet shmangur në çdo rast."[65] Pas sqarimit për PSSP-në se, pse Sekretariati e kishte zgjedhur Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, më 10 mars 2009 zyrtari ekzekutiv i Sekretariatit të Panelit i shkroi ZÇL-së së UNMIK-ut duke theksuar që "Paneli po vepronte për interesin më të mirë të të gjitha palëve" dhe që pas diskutimit të plotë të çështjes me PSSP-në ata ishin pajtuar për një vend alternativ për seancë të dëgjimit publik për rastin *Balaj dhe të tjerët*.

84. Në fakt, pas një muaj korrespondence me personelin relevant nga zyrat e UNMIK-ut të inxhinierisë, ligjore dha asaj të sigurisë dhe zyrat e PSSP-së, Paneli kishte vendosur që seanca e dëgjimit publik të mbahet më 19 mars 2009 në sallën kryesore në Selinë e Përgjithshme të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX) në qendër të Prishtinës. Të gjitha palët ishin njoftuar dhe UNMIK-u kishte zgjedhur dhe përgatitur instalimin e pajisjes përkatëse për përkthim simultan. Përveç kësaj, Policia e UNMIK-ut dhe Sigurimi i EULEX-it ishin ndërlidhur për çështjen: Sigurimi i UNMIK-ut kishte informuar se ata do të jenë përgjegjës për sigurimin fizik të dhomës ku mbahet seanca dëgjimore.[66] Por papritmas, vetëm pak ditë para kohës së caktuar të dëgjimit, EULEX-i kishte shqetësime tjera që me sa duket nuk mund të lehtësoheshin;[67] UNMIK-u informoi Panelin me anën e një letre më 17 mars 2009 se nuk do të ishte e mundshme të mbahet seancë e dëgjimit publik kudo në Prishtinë në atë kohë. Kjo befasoi shumë anëtarët e Panelit dhe ata pyetën veten nëse UNMIK-u do t'u lejojë ndonjëherë atyre të mbajnë seancë të dëgjimit me gojë, pavarësisht asaj se dëgjimet e tilla ishin pjesë e Rregullores qeverisëse të Panelit.[68] Paneli pastaj u përball me një zgjedhje të vështirë: ta anulojë seancën dëgjimore, apo ta mbajë atë si një seancë të mbyllur, vetëm në mes palëve.

85. Pa dëshirë, Paneli u përcaktua për seancë të mbyllur, dhe Sekretariati informoi agjencinë ligjore të ankuesve se "një dëgjim [i]tillë do t'i ofrojë akoma Panelit një mundësi të marrë një qartësim për çështjet e përfshira faktike dhe ligjore, dhe kështu do të vazhdojë t'iu shërbejë interesave të drejtësisë. Paneli nuk ka alternativë përveç marrjes parasysh të ekzistencës së rrethanave të jashtëzakonshme, që ia bëjnë atij të pamundur të mbajë dëgjim publik."[69]

86. Më 19 mars 2009, Paneli mbajti një seancë të mbyllur dëgjimore në lëndën *Balaj dhe të tjerët*, në vendin e vetëm që Sekretariati kishte besim se UNMIK-u do të merrte pjesë – në kontejnerin e PKDNJ-së, në objektet e Selisë së Përgjithshme të UNMIK-ut. Pas marrjes parasysh të argumenteve nga të dyja palët, Paneli vendosi ta shtyjë dëgjimin publik deri më 4 qershor 2009, duke supozuar që UNMIK-u nuk do të

[65] Letër e PSSP-së drejtuar zyrtarit ekzekutiv të Sekretariatit të PKDNJ-së, 15 dhjetor 2008.
[66] Memorandum nga këshilltari i lartë i Policisë së UNMIK-ut drejtuar udhëheqësit të kontingjentit të Policisë së EULEX-it, 13 mars 2009.
[67] Email nga udhëheqësi i Zyrës përkatëse të EULEX-it drejtuar zyrtarit ekzekutiv të PKDNJ-së. Në email thuhej që "[p]as reflektimit është vendosur që EULEX-i nuk është në gjendje të akomodojë seancën dëgjimore në objektet e EULEX-it … [sepse] EULEX-i në mungesë të ndonjë alternative do të përfundonte si i lidhur me një pjesë shumë të ndjeshme të trashëgimisë së UNMIK-ut, i cili asociim do të mund ta rrezikonte, potencialisht marrëdhënien, në kohën tonë të brishtë, me bashkëbiseduesit vendorë."
[68] Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 14, thotë: "[k]u është në interes të drejtësisë … Paneli do të mbajë seanca të dëgjimit publik me gojë."
[69] Letër nga zyrtari ekzekutiv i PKDNJ-së drejtuar avokatit të ankuesve, 18 mars 2009.

kontestojë një seancë të dëgjimit publik në të ardhmen, me kusht që të gjitha shqetësimet e tij sa i përket sigurisë të jenë adresuar. Megjithatë, seanca dëgjimore kurrë nuk u mbajt.

B. Rezultatet nga seanca dëgjimore

87. Më 16 prill 2009, Paneli u thirr në një takim me PSSP-në, në të cilin ai e bëri të ditur pakënaqësinë e tij me mënyrën kuazi-gjyqësore të seancës së mbyllur dëgjimore të Panelit në rastin *Balaj dhe të tjerët* më 19 mars 2009. Pastaj ai shkoi një hap më tutje dhe shpalli se ishte qëllimi i tij mos ta lejojë UNMIK-un fare të përfaqësohet në seancën e dëgjimit publik në rastin *Balaj dhe të tjerët*.

88. Më 8 maj 2009, ai i dërgoi Panelit një letër duke theksuar që: "[u] bë e qartë për mua si dhe për palët e tjera në këtë proces se, seanca dëgjimore e kohës së fundit për ankesën në rastin Mon Balaj qartas tregon nevojën për të shmangur që seancat e ardhshme dëgjimore të keqpërdoren haptas nga avokatët e ankuesve si një forum që mban gjykata për UNMIK-un apo OKB-në. Megjithëse një korrigjim i hapur dhe i menjëhershëm i keqperceptimeve për natyrën e Panelit si një organ këshillimor do të mund të shmangte dëmin për qëllimin e mirë të krijimit të mjeteve efektive juridike për të drejtat e njeriut, është e qartë për mua se seancat e tilla dëgjimore gjithmonë e kanë dinamikën e tyre që nuk është e lehtë të kontrollohet." Prandaj, me qëllim të qartësimit të natyrës së ndonjë seance të mëvonshme dëgjimore që do të mbahet nga Paneli si dhe "të metave tjera funksionale që janë perceptuar në procesin e përdorimit të mjeteve juridike për të drejtat e njeriut", ai do të nxjerrë një UA.[70]

89. Në letër, PSSP-ja theksoi se UA i ri do t'i përcaktojë parametrat e duhur për seanca dëgjimore, duke kërkuar që ato të mbahen duke u bazuar në një sistem ndjekës, të tillë që Paneli do të zvogëlohej deri në atë që vetëm të bëjë hetime faktike dhe të marrë dëshmi. Në kontrast, çdo shqyrtim i argumenteve ligjore do të duhej kufizuar në vlerësimin e Panelit, dhe parashtresat me shkrim të bëra me kërkesën e Panelit. Çfarë në këtë mënyrë duhej të shmangej, ishte që seanca e dëgjimit publik të mbahej "në një mënyrë adversariale." PSSP-ja, po ashtu, informoi Panelin për qëllimin e tij ta qartësojë se në të gjitha rastet Paneli duhet t'i shqyrtojë të gjitha çështjet e pranueshmërisë para se të ndodhë ndonjë shqyrtim material i shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njeriut. Përveç kësaj, PSSP-ja njoftoi se ai e kishte për qëllim të vendosë një datë përmbyllëse për dorëzimin e ankesave para Panelit, duke pasur parasysh faktin që UNMIK-u nuk ishte më në gjendje të ushtrojë efektivisht autoritetin ekzekutiv në shumë fusha nga të cilat kishin dalë ankesat për të drejtat e njeriut. Në fund, PSSP-ja i kërkoi Panelit ta shtyjë seancën dëgjimore në rastin *Balaj dhe të tjerët* derisa urdhëresa administrative ta ketë qartësuar natyrën e saj.

90. Duke reaguar në letrën e PSSP-së, më 12 maj 2009, Paneli informoi ankuesit në rastin *Balaj dhe të tjerët* se ai kishte vendosur ta anulojë seancën dëgjimore të caktuar për datën 4 qershor 2009; Paneli konsideroi se një seancë dëgjimore me qëllim të

[70] Letër nga PSSP-ja drejtuar kryesuesit të PKDNJ-së, 8 maj 2009.

kufizuar, siç ishte paraparë nga PSSP-ja, nuk do t'u shërbejë më interesave të drejtësisë.

91. Më vonë gjatë vitit 2009, Paneli pranoi drafte të njëpasnjëshme të UA-së. Gjatë procesit, më shumë çështje u filluan. Derisa Paneli formalisht konsultohej, ai kishte pak apo aspak ndikim në rezultatin final. Dhe në këto drafte të njëpasnjëshme, Paneli mund të shihte shenja se diçka nuk do të ekzistojë më. PSSP-ja po e kufizonte më tutje juridiksionin dhe autoritetin e Panelit, me qëllim të minimizimit të mbikëqyrjes (apo formës së mbikëqyrjes) që Paneli e kishte pohuar më parë ta ushtrojë. Paneli pranoi ndihmë nga ZKLDNJ, Komisionari për të Drejtat e Njeriut i KiE-së dhe mbrojtësit e tjerë ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut. Në një përpjekje përfundimtare për të sqaruar pse kufizimet e reja do të jenë në kundërshtim me interesat e drejtësisë, më 27 shtator 2009, Paneli i dërgoi një letër PSSP-së duke përshkruar përmes faqeve me argumente të arsyetuara se si shumë nga dispozitat e reja do të jenë të papajtueshme me të dyja, dokumentin dhe frymën e Rregullores së UNMIK-ut mbi themelimin e Panelit.[71]

92. Megjithatë, i gjithë ky aktivitet kundër kufizimeve të sapoplanifikuara ishte i padobishëm. Urdhëresa Administrative nr. 2009/1 është miratuar më 17 tetor 2009. Ajo ndryshoi kriteret e pranueshmërisë dhe procedurat për shqyrtimin e ankesave, si dhe mënyrën e kryerjes së seancave të dëgjimeve publike dhe procedurën e emërimit të anëtarëve të Panelit; ajo rregulloi mënyrën e publikimit të deklaratave për shtyp dhe shpalljeve të Panelit; ajo ofroi një datë të fundit për dorëzimin e ankesave te Paneli.[72]

93. Çështja e parë procedurale e përcaktuar me UA kishte të bënte me mundësinë për PSSP-në që të komentojë pranueshmërinë e një ankese. Në të vërtetë, përveç nëse një ankesë menjëherë është shpallur e papranueshme (*de plano*), Paneli e ka njoftuar për ankesën PSSP-në për komentet e tij mbi pranueshmërinë. Meqë njëra nga kërkesat mbi pranueshmërinë ishte që ankesa nuk duhet të jetë qartë e pabazuar,[73] ajo ka qenë një praktikë standarde për të ftuar PSSP-në që të komentojë në të njëjtën kohë pranueshmërinë dhe bazueshmërinë. Megjithatë, neni 2.3 i UA-së tani siguronte që "komentet mbi bazueshmërinë për një shkelje të pretenduar të të drejtave të njeriut duhet bërë vetëm pasi Paneli Këshillëdhënës të ketë përfunduar shqyrtimin e vet dhe vendosur për pranueshmërinë e një ankese të tillë."

94. Në disa raste, ku Paneli gjeti se pranueshmëria e ankesës ishte ngushtë e lidhur me bazueshmërinë, *p.sh.* në raste ku ankesa kishte të bënte me mosefektivitetin e një mjeti apo një hetimi, apo mungesën e qasjes në gjykatë, ai e kishte të bashkuar, në vendimin e vet mbi pranueshmërinë, çështjen e pranueshmërisë me shqyrtimin e bazueshmërisë. Neni 2.1 i UA duket të ketë reaguar ndaj kësaj praktike, ku ai siguroi që Paneli "do t'i shqyrtojë të gjitha çështjet e pranueshmërisë para shqyrtimit të bazueshmërisë."

[71] Letër nga anëtarët e Panelit drejtuar PSSP-së, 27 shtator 2009.
[72] Për informata të tjera, shih PKDNJ, *Raporti Vjetor 2009*, §§ 35-45.
[73] Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 3.3.

95. Neni 2.1 i UA, po ashtu, theksonte që çështjet e pranueshmërisë do të shqyrtohen "në secilën fazë të procedurave", duke nënkuptuar që çështjet e reja të pranueshmërisë mund të ngritën në çdo moment, madje edhe pasi një ankesë është shpallur e pranueshme. Neni 2.3 i UA-së konfirmoi këtë interpretim: "Nëse çështjet e pranueshmërisë së një ankese trajtohen në çdo kohë pasi Paneli Këshillëdhënës ka marrë vendim mbi pranueshmërinë e një ankese dhe ka filluar shqyrtimin e vet mbi bazueshmërinë, Paneli Këshillëdhënës do të pezullojë shqyrtimin e tij mbi bazueshmërinë deri në një kohë të tillë që pranueshmëria e ankesës është rivlerësuar plotësisht dhe vendosur përsëri." Paneli kishte të drejtë të jetë i shqetësuar që dispozita e fundit do të çonte te situatat ku një vërejtje e re mbi pranueshmërinë e një ankese që më parë është shpallur e pranueshme, do të rezultonte me vonesë të konsiderueshme në procedura.[74]

96. Për sa u përket kritereve të pranueshmërisë, neni 2.2 i UA-së ishte i rëndësisë më të madhe. Në të thuhej: "Çdo ankesë që është apo mundet të bëhet në të ardhmen subjekt i procesit të OKB-së për ankesa nga pala e tretë[75] … duhet konsideruar e papranueshme për arsyet që procesi i OKB-së për ankesa nga pala e tretë … paraqet rrugët në dispozicion në pajtim me nenin 3.1 të [Rregullores nr. 2006/12]."[76] Kjo dispozitë ia hoqi Panelit kompetencën për të vlerësuar efektivitetin e procesit të OKB-së për ankesa nga pala e tretë, në dritë të kërkesës që "të gjitha … rrugët në dispozicion për shqyrtim të shkeljeve të pretenduara të jenë ndjekur."[77] UA vlente jo vetëm për ankesat e dorëzuara pas nxjerrjes së tij, por po ashtu për të gjitha ankesat që ishin në zhvillim e sipër.

97. Efekti konkret i këtyre dispozitave ishte i thellë, veçanërisht në disa nga rastet e profilit më të lartë, duke përfshirë *Balaj dhe të tjerët*[78] dhe *N.M. dhe të tjerët*[79]. Duke u bazuar në UA, Paneli ishte i detyruar t'i shpallë këto raste të papranueshme, sepse ankuesit kishin ankesa në vazhdim e sipër në kuadër të procesit të OKB-së për ankesa të palës së tretë.[80] Siç është treguar më lart, një çështje e pranueshmërisë në bazë të nenit 2.2 të UA mund të ngritët madje në rastet ku Paneli e ka shpallur ankesën të pranueshme dhe ku ai është duke e shqyrtuar bazueshmërinë.

98. UA, po ashtu, rregulloi organizimin e seancave të dëgjimit publik. Në nenin 1.1 thuhej që "seancat dëgjimore publike … duhet mbajtur në një mënyrë dhe ambient të tillë që

[74] Në fakt, këto dy ndryshime nga neni 2.1 dhe 2.3 i UA mund të kenë zgjatur jetëgjatësinë e Panelit për dy apo tre vjet, pavarësisht se nuk kanë sjellë asnjë përfitim të prekshëm për Panelin, ankuesit, UNMIK-un apo OKB-në.
[75] Procesi i OKB-së për ankesa të palës së tretë është objekt i Rezolutës së AP të OKB-së 52/247 mbi "Përgjegjësinë e palës së tretë: Kufizimet e përkohshme dhe financiare" të 17 korrikut të vitit 1998. Neni i lartpërmendur 7 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 paraqet implementimin e Rezolutës së përmendur në kontekst të UNMIK-ut.
[76] UA, po ashtu, përfshinte si të papranueshme ankesat sipas nenit 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 "Mbi statusin, privilegjet dhe imunitetet e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë" në të cilën thuhet si në vijim: "Ankesat e palës së tretë për humbje apo dëmtim të pronës dhe për lëndim personal, sëmundje apo vdekje që ka ardhur apo drejtpërdrejt i atribuohet KFOR-it, UNMIK-ut apo personelit të tyre përkatës dhe të cilat nuk vijnë nga 'nevoja operacionale' e secilës nga prezenca ndërkombëtare, do të zgjidhen nga Komisioni për Ankesa i themeluar nga KFOR-i dhe UNMIK-ut, në mënyrën e parashikuar."
[77] Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 3.1.
[78] *Balaj dhe të tjerët*, nr. 04/07.
[79] *N.M. dhe të tjerët*, nr. 26/08.
[80] Megjithatë, Paneli e la të hapur që ankesat të rishqyrtohen me përfundimin e procesit të OKB-së për ankesa nga pala e tretë (shih më poshtë, § 226).

mundëson një kuptim të qartë të procedurave joadversariale që do t'u bëhen të njohura plotësisht të gjithë pjesëmarrësve dhe publikut, duke përfshirë praninë e ndonjë medie në rast se një prani e tillë lejohet nga Paneli Këshillëdhënës." Karakteri joadversarial i procedurave përmendet prapë në nenin 1.4, sipas të cilit "marrëveshjet për vendin dhe rregullimin e ulëseve për seancat e dëgjimit publik të kryer nga Paneli Këshillëdhënës duhet të jenë në pajtim me natyrën joadversariale të procedurave." Megjithëse mund të jetë befasuese që PSSP-ja të japë udhëzime dhe mikromenaxhojë Panelin për sa i përket vendit të një seance dëgjimore dhe madje rregullimit të ulëseve në një seancë dëgjimore, është e qartë që qëllimi kryesor i dispozitës ishte të theksojë karakterin joadversarial, jo vetëm të seancës dëgjimore por edhe të procedurave para Panelit si të tëra.

99. Në këtë pikë, Paneli konsideroi se është vështirë të përputhet UA me frymën, nëse jo formulimin, e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12. Për shembull, neni 11.3 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 siguronte që PSSP-ja do të ketë mundësi që të japë një përgjigje në emër të UNMIK-ut në ankesë, sapo ajo të jetë shpallur e pranueshme, dhe neni 11.4 i lejoi Panelit që t'u kërkojë ankuesit dhe UNMIK-ut të bëjnë parashtresa shtesë me shkrim. Këto dispozita tregojnë se ishte synim i hartuesve të përfshijnë ankuesin dhe UNMIK-un në procedurë dhe në këtë mënyrë ata do të ishin në gjendje të paraqesin qëndrimet e tyre dhe t'i komentojnë qëndrimet e njëri-tjetrit**.** Prandaj, ishte detyrë e Panelit, sipas nenit 17.1, t'i paraqesë të gjeturat nëse ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut, të cilat domosdoshmërisht përfshijnë marrjen parasysh të parashtresave të paraqitura nga të dy, ankuesi dhe UNMIK-u. Në çdo kontekst tjetër ligjor, këto veprime do të përshkruheshin me përpikëri si adversariale.

100. Veç kësaj, UA zvogëloi konsiderueshëm dobishmërinë e ndonjë seance dëgjimore. Neni 1.2 në të vërtetë siguron që "gjatë seancave të dëgjimit publik, ankuesit apo përfaqësuesit e tyre, do të lejohen të japin deklaratë duke përmbledhur shkeljen e pretenduar të të drejtave të njeriut, siç gjendet në parashtresat me shkrim në Panelin Këshillëdhënës", dhe "Paneli Këshillëdhënës do t'u bëjë pyetje të tilla palëve apo përfaqësuesve të tyre, të cilat qartësojnë bazën faktike te ankesës dhe janë të nevojshme për Panelin Këshillëdhënës për të vlerësuar plotësisht pretendimin para tij për shkeljen e të drejtave të njeriut." Kjo dispozitë jo vetëm që konfirmoi se çdo seancë dëgjimore do të jetë joadversariale, duke pasur parasysh atë se palët nuk mund të komentonin parashtresat e njëri-tjetrit, por po ashtu kufizoi qëllimin e seancës dëgjimore në një qartësim të thjeshtë të fakteve (tanimë të përmendura në parashtresat me shkrim), duke përjashtuar kështu çdo diskutim për çështjet ligjore. Në dritë të dispozitave të UA-së, të cilat ndjeshëm e kufizuan qëllimin e mbajtjes së një seance dëgjimore, Paneli vendosi se nuk ishte e vlefshme të mbahet seancë e tillë dëgjimore në rastin *Balaj dhe të tjerët*. E as që është mbajtur seancë dëgjimore në ndonjë rast tjetër.

101. Çështja tjetër e rregulluar me UA ishte procedura e emërimit të anëtarëve të tij. Sipas nenit 5.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, "Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron anëtarët e Panelit Këshillëdhënës, me propozimin e kryetarit

të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut." Kjo dispozitë mund të shihet si garanci e pavarësisë (*vis-à-vis* UNMIK-ut dhe PSSP-së) së Panelit dhe anëtarëve të tij. Por neni 3.1 i UA ndryshoi atë proces ashtu që "kryetari i Gjykatës Evropiane do të propozojë në pajtim me rregullat e aplikueshme të prokurimit të OKB-së një numër të mjaftueshëm të kandidatëve të përshtatshëm për emërim … Nëse nuk është pranuar asnjë propozim apo është pranuar numër i pamjaftueshëm i propozimeve nga UNMIK-u brenda një periudhe prej një muaji kalendarik nga një kërkesë e tillë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të bëjë emërimin e nevojshëm pa propozimin e kërkuar dhe pas konsultimit me organet relevante ndërkombëtare për të drejtat e njeriut."

102. Ky amendament u dëshmua të jetë shumë i diskutueshëm. Nga perspektiva e UNMIK-ut, kjo qartë paraqiste thjesht një qartësim të kuptimit origjinal të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12. Nga perspektiva e Panelit dhe kryetarit të GJEDNJ-së, kjo kufizonte rolin e këtij të fundit në propozimin e anëtarëve të Panelit, e cila mund të ketë ndikim në pavarësinë e Panelit.

103. Neni 4 i UA-së urdhëroi Panelin që t'i bëjë publikimet, shpalljet dhe deklaratat për shtyp përmes Zyrës së zëdhënësit të UNMIK-ut dhe asaj për informim publik. Ndërsa Paneli e vlerësoi konfirmimin e disponueshmërisë së kësaj Zyre për të ndihmuar në shpalljet e tij, para UA-së Paneli kishte qenë në gjendje t'ua dërgojë raportin e vet vjetor dhe deklaratat e veta për shtyp (relativisht të rralla) drejtpërdrejt personave dhe organizatave në listën e vet të adresave të e-mailit. Megjithëse kjo nuk u bë një çështje e diskutueshme, pasi PSSP-ja kurrë nuk zgjodhi ta përdorë autoritetin e vet që ta censurojë Panelin, UA përsëri nënvizoi faktin që zëri publik i Panelit, jashtë vendimeve dhe mendimeve të veta, të shpërndahej nën diskrecionin dhe kontrollin e PSSP-së.

104. Në fund, neni 5 i UA ofroi një datë të fundit për dorëzimin e ankesave te Paneli: 31 marsin e vitit 2010. Ankesat e pranuara pas asaj date do të refuzoheshin. Sipas UNMIK-ut, kjo dispozitë duhet kuptuar në kontekst të rikonfigurimit të UNMIK-ut, për shkak të vështirësive me të cilat përballej në ushtrimin e mandatit të vet sipas Rezolutës së KS të OKB-së 1244.[81] Megjithatë, kjo ndalesë kohore shihet më mirë si një seri tjetër e kufizimeve që UNMIK-u i vendosi mbi juridiksionin e Panelit, të gjitha nga të cilat ishin kundër konceptit fillestar të Panelit.

105. Duke marrë parasysh të gjitha, Paneli e kuptoi këtë UA si një zbuluese të strategjisë së UNMIK-ut *vis-à-vis* vetvetes që ka qenë fshehurazi e pranishme që nga fillimi: UNMIK-i do të monitorohet vetëm në bazë të kushteve të veta. Me vite, efektiviteti i Panelit është kufizuar nga mungesa e planifikimit, ndarjes së burimeve dhe e stafit të duhur nga ana e UNMIK-ut. Dhe sapo Paneli kishte filluar t'i tejkalojë këto vështirësi dhe filloi të marrë vendim të pavarur, për shembull, si në rastin e përpjekjes për seancë dëgjimi publik në rastin *Balaj dhe të tjerët*, UNMIK-u u përgjigj duke ndryshuar

[81] KS i OKB-së, Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Përkohshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë i 24 nëntorit të vitit 2008, S/2008/692, § 21.

rregullat. Me nxjerrjen e UA-së, anëtarët e Panelit filluan ta kuptojnë se, sa sfiduese do të jetë për të përdorur këtë proces për të rritur përgjegjësinë për shkeljet e të drejtave të njeriut që i atribuohen UNMIK-ut dhe për të bërë ndryshim në gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

106. Për fat të keq të anëtarëve të Panelit, kur anëtarja e Panelit znj. Snezhana Botusharova dha dorëheqje në qershor të vitit 2009 dhe zëvendësimi duhej të gjendej, gjërat filluan të përkeqësohen. Amendamenti tjetër në UA ishte neni 3.2 i cili siguronte që, "në rast se një apo më shumë anëtarë të Panelit japin dorëheqje nga pozita e tyre, Paneli nuk merr vendime derisa të jenë bërë emërimet e reja …". Kjo dispozitë kishte si rezultat parandalimin e UNMIK-ut që të marrë ndonjë vendim mbi pranueshmërinë apo miratimin për bazueshmëri nga data e lëshimit të UA deri me datën e shpalljes solemne të anëtarit të tretë të ri të bërë nga Paneli.

C. Riemërimi dhe zëvendësimi i anëtarëve të Panelit

107. Në ndërkohë, duke filluar në janar të vitit 2009, një krizë tjetër po "krijohej" lidhur me Panelin. Anëtarët e Panelit filluan vitin pa qenë të emëruar nga PSSP-ja; tre nga ta erdhën në Prishtinë dhe filluan punën e tyre në rast pa dokumente të emërimit. Sipas nenit 5.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, "Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron anëtarët e Panelit Këshillëdhënës …", dhe afati në detyrë për anëtarët e Panelit u zvogëlua në një vit, i përtëritshëm, me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2007/3 të 12 janarit të vitit 2007. Në vitet paraprake, anëtarët e Panelit ishin riemëruar rreth fundit të emërimeve të tyre të tanishme, por këtë herë, nuk u bë kjo deri më 25 shkurt 2009, atëherë kur PSSP-ja ua dërgoi dokumentet për riemërim anëtarëve të Panelit, dhe ato riemërime ishin vetëm për një periudhë tremujore, retroaktive nga 1 janari 2009 deri më 31 mars 2009.

108. Kur kryesuesi i kërkoi PSSP-së sqarim rreth asaj se pse emërimet ishin përtërirë vetëm për tre muaj, në kundërshtim të qartë me rregulloret qeverisëse të UNMIK-ut, PSSP-ja u përgjigj me një interpretim të ri të dispozitave relevante. Sipas tij, zgjatjet tremujore ishin të lejueshme sepse pas afatit të parë të emërimit, "emërimet e [t]illa mund të përtërihen për një 'afat tjetër', duke iu nënshtruar vendimit të Këshillit të Sigurimit lidhur me mandatin e UNMIK-ut sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Siç do ta vëreni, Rregullorja i referohet afatit fillestar prej një viti (1), megjithatë, afatet e mëvonshme nuk definohen në mënyrë specifike. Prandaj, emërimi i tanishëm bëhet në pajtim me Rregulloren."[82] Ky interpretim e bëri zyrtarin ekzekutiv të Panelit që t'ia dërgojë urgjentisht dy letra ZÇL-së në Selinë e Përgjithshme të OKB-së, në të cilat ai paraqiti disa fusha ku UNMIK-u e ka penguar funksionimin e PKDNJ-së. Në letrën e dytë, pas kishte vërejtur se nuk ka asnjë bazë ligjore për të mbështetur zgjatjen e kontratave të anëtarëve të Panelit për tre muaj nga PSSP-ja, zyrtari ekzekutiv theksoi që "[m]u tani, nuk ka qartësi nëse Paneli mund të ketë apo jo një seancë në prill. Paneli është në mes të punës në përafërsisht

[82] Letër nga PSSP-ja për kryesuesin, 12 mars 2009.

njëqind raste, dy nga të cilat janë paksa voluminoze … Vazhdimësia është e një rëndësie kritike për punën e Panelit."[83]

109. Në muajin mars, Paneli u informua që PSSP-ja i kishte dërguar një letër kryetarit të GJEDNJ-së, duke i kërkuar atij të paraqesë pesë apo gjashtë emra për nominim, nga të cilët PSSP-ja mund t'i merrte tre. Kryetari i GJEDNJ-së u përgjigj që PSSP-ja duhet t'i riemërojë tre anëtarët në këtë pozitë, ashtu që Paneli të mund të përmbush mandatin e vet. Me sa duket, PSSP-së i ishte dhënë një mesazh i ngjashëm nga Selia e Përgjithshme e OKB-së, për t'i përtërirë kontratat e anëtarëve të Panelit për pjesën e mbetur të vitit dhe për t'i lënë ata që t'i bëjnë punët e tyre. Në vend të kësaj, PSSP-ja u dërgoi anëtarëve të Panelit zgjatjen tjetër tremujore deri më 30 qershor 2009, e cila përsëri ngriti shqetësimet e tyre se PSSP-ja do të vazhdojë aktivitetin e tij për t'i zëvendësuar ata sa më shpejt që të jetë e mundshme. Kjo çështje, e kombinuar me problemet në seancën dëgjimore *Balaj dhe të tjerët*, u dha anëtarëve të Panelit arsye për të dyshuar në përkushtimin e UNMIK-ut për të pasur një organ këshillëdhënës për të drejtat e njeriut që është funksional dhe i pavarur.

110. Situata lidhur me riemërimet e anëtarëve të Panelit u bë më e tensionuar kur anëtarja e Panelit, znj. Snezhana Botusharova dha dorëheqje nga data 15 qershor 2009 për t'u bërë gjykatëse e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. PSSP-ja informoi kryetarin e GJEDNJ-së se "dorëheqja e znj. Botusharova e bën të nevojshme që unë të emëroj një anëtar të ri në Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut, e cila kërkon që unë t'i pranojë propozimet e juaja përkatëse." Së bashku me letrën, PSSP-ja bashkëngjiti dokumentacionin relevant për konsulentët dhe kontraktorët e OKB-së.[84] Kryetari i GJEDNJ-së i tha PSSP-së se, anëtarët e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut nuk bien në kuadër të këtyre përkufizimeve. Ai konsideroi se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12 i përcaktoi ata si anëtarë të një Paneli dhe se roli i tyre nuk mund të krahasohej me atë të një konsulenti apo kontraktori por më parë të një gjykatësi ndërkombëtar. Kryetari i GJEDNJ-së paraqiti një kandidat tepër të kualifikuar, siç kishte bërë ish-kryetari i GJEDNJ-së për vendet e para të lira të punës për anëtar të Panelit.

111. Përgjigja e PSSP-së kristalizoi problemin që UNMIK-u e kishte me Panelin gjatë gjithë jetëgjatësisë së vet, një mospajtim rreth natyrës së rolit që Paneli duhet të luajë. Duke iu përgjigjur kryetarit të GJEDNJ-së, PSSP-ja shkroi "analiza juaj për kornizën rregulluese të OKB-së për konsulentët dhe kontraktorët individualë dhe aplikueshmëria e saj tek anëtarët e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut përkufizon gabimisht anëtarët e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut si gjykatës ndërkombëtarë, ndërsa roli i tyre është ai i këshilltarëve të PSSP-së. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, e ndryshuar, për themelimin e këtij Paneli, qartas thotë që Paneli është duke e këshilluar PSSP-në duke lëshuar mendime dhe rekomandime këshilluese jodetyruese … Unë, po ashtu, duhet t'ua largoj idenë juve

[83] Letër nga zyrtari ekzekutiv i Sekretariatit të PKDNJ-së drejtuar këshilltarit ligjor të Nënsekretarit të Përgjithshëm, 17 mars 2009.
[84] Letër nga PSSP-ja drejtuar kryetarit të GJEDNJ-së, 29 qershor 2009.

dhe paraardhësit tuaj nga e kaluara për t'i emëruar anëtarët e Panelit apo thirr për t'i emëruar. Ju do ta vëreni që Rregullorja nr. 2006/12, e ndryshuar, qartas thotë se PSSP-ja i UNMIK-ut është autoriteti që emëron anëtarët e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. Në këtë kontekst, unë pres t'i pranojë propozimet e tjera sa më shpejt që keni mundësi ta bëni këtë …".[85]

112. Ky problem do të përkeqësohet me nxjerrjen e UA-së në tetor të vitit 2009, pasi neni 3.2 siguron që, "në rast se një apo më shumë anëtarë të Panelit Këshillëdhënës japin dorëheqje nga pozita e tyre, Paneli nuk do të marrë asnjë vendim derisa të jenë bërë emërimet e reja …". Kjo siguroi që Paneli të mos mund të miratojë vendime apo mendime mbi pranueshmërinë, derisa situata të zgjidhej përfundimisht me emërimin e anëtares së Panelit znj. Christine Chinkin në shkurt të vitit 2010. Për t'u regjistruar faktet e vërteta, kryetari i GJEDNJ-së nuk ia propozoi PSSP-së ndonjë tjetër të nominuar; me sa duket PSSP-ja më në fund është bindur të pranojë nominimin e kryetarit të GJEDNJ-së.[86] Kjo periudhë tetëmujore, gjatë së cilës PKDNJ ende nuk ishte përzgjedhur në përbërje të plotë, ndikoi negativisht në punën e Panelit në këtë kohë.

D. Reagimet ndaj Urdhëresës Administrative

113. Si rezultat i hyrjes në fuqi të UA-së, Paneli duhej ta bënte përshtatjen e Rregullores së vet të punës në një numër pikash. Amendamentet janë miratuar më 12 shkurt 2010. Ajo çka është më e rëndësishme, në dritë të të gjitha pasojave negative nga miratimi i UA-së, në mënyrë specifike për ankuesit e mundshëm, Paneli ndërmori një iniciativë për informim publik në fillim të vitit 2010, për të informuar popullatën rreth afatit të vet të ri të fundit për pranimin e ankesave – 31 marsin e vitit 2010. Shpalljet ishin vendosur në gazetat rajonale (në *Danas* dhe *Politika* të botuara në Beograd në gjuhën serbe dhe në *Koha Ditore* të botuar në gjuhën shqipe në Prishtinë), për të siguruar që publiku i gjerë ishte në dijeni për afatin e fundit. Përveç kësaj, data e fundit tregohej në faqen e mirëseardhjes në faqen e internetit të Panelit. Paneli e kuptoi që pas 31 marsit të vitit 2010, personat më herët të kualifikuar ende do të dëshirojnë të paraqesin ankesa dhe tani nuk do të jenë në gjendje ta bëjnë këtë.

114. Më 6 prill 2010, ministri serb për Kosovë dhe Metohi i dërgoi një letër PSSP-së, duke theksuar që "[e]kzistojnë më shumë se 40,000 kërkesa për rastet për të drejtat në pronë që gjenden para Agjencisë Kosovare të Pronës … Implikimet negative vetëm mund të imagjinohen nëse ne e marrim parasysh se në momentin kur çështja e organit të apelimit në vendimet e shkallës së parë të Agjencisë së Pronës nuk është zgjidhur, ne hasim një vendim për të pamundësuar mbrojtje të mëtejshme ligjore pas 31 marsit të vitit 2010 para Panelit Këshillëdhënës … Prandaj, ne ju kërkojmë me mirësi ta

[85] Letër nga PSSP-ja drejtuar kryetarit të GJEDNJ-së, 28 korrik 2009.
[86] E njëjta ishte e vërtetë me emërimin e znj. Françoise Tulkens në Panel në shtator të vitit 2012: Kryetari i GJEDNJ-së nominoi vetëm atë dhe PSSP-ja e emëroi atë pa ndonjë ndodhi.

rishqyrtoni Udhëzimin Administrativ nr. 2009/1 dhe në pajtim me autoritetin tuaj të kaloni një vendim të ri që … do ta zgjasë ndjeshëm këtë limit kohor."[87]

115. Përveç kësaj, më 7 qershor 2010, AP e KiE-së publikoi një raport mbi situatën në Kosovë dhe rolin e KiE-së, në të cilin komentohej natyra unike e Panelit.[88] Raporti ishte bazë e Rezolutës 1739 të AP të KiE-së mbi situatën në Kosovë dhe rolin e KiE-së, i cili bëri disa rekomandime specifike lidhur me zhvillimet legjislative që prekën Panelin në vitin 2009.[89] Ngjashëm, më 21 dhjetor 2010, Komisioni i Venedikut publikoi mendimin e tij pasues mbi mekanizmat ekzistues për të shqyrtuar pajtueshmërinë e akteve të UNMIK-ut dhe EULEX-it në Kosovë.[90] Mendimi dha rekomandime lidhur me numrin e sfidave të hasura nga Paneli. Po ashtu, institucione të tjera të ndryshme, duke përfshirë AI[91] dhe HRW[92] shprehën publikisht shqetësimin e tyre.

116. Por këto dhe shqetësimet e tjera të OJQ-ve të ndryshme ndërkombëtare në esencë kaluan pa u vënë re nga UNMIK-u. UA do të ishte ndryshimi final në rregullat sipas të cilave duhej të funksiononte Paneli, dhe çdo sukses që Paneli e arriti më vonë ishte me punën e vet përmes këtyre ndryshimeve, përmes të trajtimit të tij të rasteve, metodës së vet të trajtimit të ankesave dhe formulimit të vet të rekomandimeve. Kjo përfshiu mënyrën në të cilën Paneli e interpretoi natyrën e vet kuazi-gjyqësore, të cilën e bazoi në *travaux préparatoires* që buronte nga debati inicial i AP të KiE-së dhe mendimeve të Komisionit të Venedikut të vitit 2004 dhe Rregullores. Prandaj, Paneli e përdori këtë kornizë në të lexuarit e vetë më të gjerë të bazuar në të drejtat e njeriut të Rregullores qeverisëse të UNMIK-ut dhe UA-së pasuese me qëllim të implementimit të mandatit të vet, pavarësisht nga qëllimet më kufizuese të UNMIK-ut.

117. Megjithëse disa vendime dhe mendime janë miratuar nga Paneli para UA-së, ndodhi kryesisht pas asaj kohë që ai zuri vend dhe ishte në gjendje t'i zhvillojë praktikat e veta të punës në pajtim me Rregulloren e punës, hap pas hapi.

VI. Sekretariati i Panelit

118. Përbërja përfundimtare e Sekretariatit të Panelit, dhe, siç e dëshmuan rezultatet e punës së tij, optimale dhe e vetëmjaftueshme, ishte nga një zyrtar ekzekutiv, tre zyrtarë ligjorë me orar të plotë, një asistent ligjor dhe një asistent ekipi. Mbajtja e dosjeve të Panelit për rastet, përgatitja e dosjes-kopjeve individuale për anëtarët e Panelit dhe juristët dhe shumë punë tjera administrative kryheshin nga asistentet vendore, nën mbikëqyrjen e përgjithshme të zyrtarit ekzekutiv.

---

[87] Letër nga ministri i Republikës së Serbisë për Kosovë dhe Metohi drejtuar PSSP-së, 6 prill 2010.
[88] Shih Komiteti i AP të KiE-së për Çështje Politike dhe Demokraci (Raportues: z. Björn von Sydow), Raport mbi "Situatën në Kosovë dhe rolin e Këshillit të Evropës", Dok. 12281, 17 qershor 2010, §§ 65-68 në veçanti.
[89] Shih Rezoluta e AP të KiE-së 1739 (2010), 22 qershor 2010, § 12 në veçanti.
[90] Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit ("Komisioni i Venedikut"), *Mendimi mbi mekanizmat ekzistues për të shqyrtuar pajtueshmërinë me standardet për të drejtat e njeriut të akteve të UNMIK-ut dhe EULEX-it në Kosovë*, Mendimi nr. 545/2009, CDL-AD(2010)051, Strasburg, 21 dhjetor 2010.
[91] AI "Kosovë: Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar", Deklaratë publike, EUR 70/001/2010, 8 shkurt 2010.
[92] HRW, *Raport botëror 2010*, f. 443-449.

119. Juristët e caktuar për rastet e veçanta përgatitën draftet, sipas udhëzimeve të raportuesve (anëtarë të Panelit të caktuar nga kryesuesi), e mendimeve dhe vendimeve të Panelit. Ata, po ashtu, kryen detyra të rëndësishme përgatitore. Puna e tyre përfshinte shqyrtimin e dosjeve të shumta dhe nganjëherë voluminoze hetimore, hulumtim për historikun, dhe analizë të dokumentacionit të gjykatës dhe dokumentacionit tjetër institucional. Sekretariati, po ashtu, kreu kontrollin e brendshëm të teksteve, mbajti statistika, monitoroi afatet e fundit dhe e mbajti faqen e internetit të azhurnuar në të tri gjuhët.

120. Sekretariati, po ashtu, kreu një numër të madh detyrash tjera. Për t'i cekur disa: ai komunikoi me PSSP-në dhe zyrat e tjera relevante të UNMIK-ut, institucionet ndërkombëtare dhe lokale; ofroi informata për raportin e SP-së për KS të OKB-së; u ndërlidh me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare dhe palët e tjera të interesuara për punën e Panelit. Sekretariati, po ashtu, mbajti kontaktin me organet e tjera siç janë ZKLDNJ, Sektorin për të Drejtat e Njeriut të EULEX-it, Zyrën përgjegjëse për regjistrin të GJEDNJ-së, si dhe institucionet rajonale që ofrojnë ndihmë ligjore falas, sikur projekti serb "Përkrahje e mëtejme për refugjatët dhe PZHB-të në Serbi" dhe KDR-në.

121. Sfida kryesore e Sekretariatit ishte se, si staf i UNMIK-ut ai duhej të negocionte boshllëkun në mes UNMIK-ut dhe Panelit të pavarur. Sekretariati ishte ngarkuar me detyrën që të ndihmojë punën e Panelit dhe t'i mbrojë interesat e tij, sidomos konfidencialitetin e procedurave të tij.

122. Nganjëherë, bashkëpunimi me UNMIK-ut nuk ishte i lehtë, me konflikte interesash të lidhura, për shembull, me ndarjen e hapësirës së zyrës dhe shpërndarjen e materialit. Sekretariati, po ashtu, duhej t'i aranzhonte nganjëherë çështjet e vështira logjistike. Në vitet e fundit të punës së Sekretariatit, numri i mosmarrëveshjeve ishte i vogël dhe shumica e nevojave operacionale të Panelit dhe Sekretariatit janë përmbushur.

123. Nga fillimi, Sekretariati u përball me vështirësinë e marrjes së dosjeve relevante kur dosjet e tilla, për arsye të ndryshme, nuk ishin paraqitur nga UNMIK-u. Homologe të Sekretariatit në këtë detyrë ishin gjykatat lokale, zyrat e prokurorëve, departamentet e policisë, Agjencia Kosovare e Pronës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme që ka të bëjë me AKP-në, organet e ndryshme komunale dhe administrative në Kosovë dhe në Serbi. Në përgjithësi, kishe një nivel të lartë të bashkëpunimit.

124. Nganjëherë, zyrtarët dhe asistentë shaheshin apo shoqëroheshin me britma nga njerëzit me të cilët flisnin në telefon. Shumë herë ata vetë ishin të prekur thellë nga tregimet që ata dëgjonin apo lexonin në dokumentet të cilat kaluan nëpër duart e tyre. Çfarë e bëri më të vështirë për stafin lokal ishte ajo se, kishte raste për të cilat ata kishin dëgjuar më parë apo kur ata madje kishin kaluar nëpër përvoja të ngjashme. Megjithatë, me gjithë tërë presionin, ata ia arritën ta mbajnë nivelin më të lartë të qëndrimit profesional.

125. Njohja e gjuhëve lokale ishte gjithmonë një sfidë për Sekretariatin. Megjithëse disa nga stafi i tij flisnin serbisht apo shqip, pesha më e madhe ishte gjithmonë në asistentet lokale të Sekretariatit, të cilat gjithmonë kryen punën e tyre në mënyrën më profesionale, të besueshme dhe me plot respekt. Pjesa më e madhe e punës që kishte të bënte me kontaktet me ankuesit, në baza ditore, nganjëherë madje edhe gjatë fundjavës, bëhej nga këto asistente.

126. Pasi pjesa më e madhe e materialit që iu dorëzua Panelit ishte në gjuhët lokale, përkthimi me shkrim i parashtresave ishte, po ashtu, një çështje problematike nga fillimi i punës së Panelit. Megjithëse Njësia Gjuhësore e UNMIK-ut ishte në gjendje të përballej me përkthimin nga gjuha serbe apo shqipe në gjuhën angleze, kur Paneli filloi t'i përgatisë vendimet dhe mendimet e veta *en masse*, situata u bë shumë më e keqe. Për ta zgjidhur çështjen, UNMIK-u kontraktoi dy kompani për të ofruar shërbime përkthimi; kështu u eliminua problemi i dokumenteve të mbetura prapa sa i përket përkthimit brenda një viti dhe nuk kishte vonesa tjera në përkthime.

127. Pasi Paneli pranoi një numër mjaft të madh të dosjeve konfidenciale hetimore, kishte nevojë të krijohet një mekanizëm i sigurt për ruajtjen e tyre. Në shumicën e rasteve, dosjet janë pranuar nga ZÇL-ja e UNMIK-ut, me garanci për moszbulim për ndonjë palë të jashtme dhe kthimin e tyre në fund të procesit. Sekretariati krijoi dhe mbajti nivelin më të lartë të sigurisë.

128. Siç lejohej me Rregulloren e punës, disa ankues dëshironin të mbesin anonimë. Të siguruarit se asnjëri nga dokumentet në dispozicion publik nuk përfshinte emrat dhe detajet për kontakt të këtyre personave, apo të afërmve të tyre, ishte një detyrë e ndjeshme e Sekretariatit. Veç kësaj, nganjëherë Sekretariati duhej t'i hartonte këto dokumente ashtu që të minimizohen rreziqet e zbulimit të identiteteve të tyre.

129. Puna e dorëzimit të vendimeve të PSSP-së për ankuesit dhe ndërlidhja me EULEX-in dhe palët e tjera relevante lidhur me implementimin e rekomandimeve të Panelit, bëhej nga Zyra Ndërlidhëse e UNMIK-ut për Sundim të Ligjit dhe Zyra e këshilltarit të lartë për të drejtat e njeriut. Sekretariati kërkoi informata të azhurnuara nga ato zyra për sa u përket veprimeve të ndërmarra. Megjithëse zyrat e UNMIK-ut zakonisht i dorëzuan ato me kohë tek EULEX-i apo autoritetet e tjera relevante, asnjë mekanizëm i duhur për monitorimin e mëtejmë të veprimeve nuk ishte themeluar ndonjëherë nga UNMIK-u.

130. Deri në fund të punës së Panelit, Sekretariati bëri një vëllim të madh të punës në lidhje me përfundimin gradual të gjithë operacionit, që përfshiu arkivimin dhe ruajtjen e dosjeve origjinale dhe elektronike, si dhe mbajtjen e vazhdueshme të faqes së internetit të Panelit. Derisa ndonjë nga ish-stafi i Sekretariatit të PKDNJ-së të punojë akoma në UNMIK, ata do të vazhdojnë të kryejnë punët e mbetura në lidhje me PKDNJ-në. Megjithëse për një periudhë të shkurtër këto çështje zgjidhen, është e paqartë se çfarë do të ndodhë me faqen e internetit dhe arkivin e Panelit në rast se UNMIK-u mbyll punën; kjo çështje do të trajtohet pas pak.

VII. Trashëgimia ligjore

131. Trashëgimia ligjore e Panelit është kontributi më i madh i tij drejt progresit të jurisprudencës për të drejtat e njeriut. Paneli është themeluar për të sjellë disa përgjegjësi për UNMIK-un për shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut. Përmes ekzistencës së tij, si dhe përmes rasteve të shumta ku Paneli konstatoi se UNMIK-u kishte kryer shkelje të të drejtave të njeriut, Paneli e forcoi pozitën që OKB-së dhe misioneve të saj, sikur UNMIK-u, u kërkohet ta kenë për të mbajtur standardet e njëjta për të drejtat e njeriut të cilat ato thonë se i respektojnë.

A. Pamje e përgjithshme

132. Është e rëndësishme të vendoset Paneli në kontekstin në të cilin funksionoi. Gjatë mandatit të Panelit, Kosova po lëvizte përpara nga të dyja, konflikti dhe e kaluara e saj socialiste. Si një rajon pas konflikti, ankesat të cilat iu paraqitën Panelit paraqisnin këtë realitet. Më saktë, shumica e ankesave që Paneli i pranoi përfshinin një dështim të UNMIK-ut që t'ia kompensojë dëmin popullatës që kishte dalë nga konflikti dhe pasojat e tij. Ato kishin të bënin me, për shembull, personat me anëtarë të familjes të zhdukur dhe të vrarë nga konflikti dhe si pasojë e tij për të cilët nuk ishte bërë hetim i duhur dhe personat të cilët e kishin humbur pronën apo punësimin, si rezultati i konfliktit dhe të cilët nuk ishin kompensuar kurrë. Pasi këto përbënin shumicën e ankesave që iu dorëzuan Panelit, këto janë fushat që jurisprudenca e Panelit kryesisht i mbulon.

133. Kosova ishte në fazën kalimtare nga të qenit pjesë e një sistemi qeverisës socialist, në ish-Jugosllavi. Si e tillë, entitetet e administruara nga UNMIK-u, duke përfshirë Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) dhe Dhomën e Posaçme, u ngarkuan me detyrën e mbikëqyrjes së privatizimit të pronës shoqërore. Ankesat me të cilat pretendohej se këto entitete të administruara nga UNMIK-ut kishin kryer shkelje të të drejtave të njeriut, kryesisht lidhur me dështimin për t'i mbrojtur të drejtat në pronë, paraqisnin pjesën tjetër të rëndësishme të ngarkesës me lëndë të Panelit.

134. Kosova, po ashtu, po bënte përpjekje për të lëvizur përpara nga një konflikt serioz etnik. Ish-gjendja multietnike e shqiptarëve, serbëve, turqve, romëve dhe minoriteteve të tjera ishte prishur për një kohë të gjatë. UNMIK-u ishte i mandatuar ta administrojë drejtësinë në një territor të fragmentuar. Kur UNMIK-u dështoi ta bëjë këtë në një mënyrë që ishte në pajtim me të drejtat e njeriut, ankesat iu paraqitën Panelit, lidhur me diskriminimin si të tillë, të dyja *de facto* dhe *de jure*. Aktivitetet dhe praktikat diskriminuese, po ashtu, ofruan një bazë të fortë për shumë nga shkeljet e tjera të pretenduara të të drejtave të njeriut.

135. Vendimi i Panelit që të mbështetet në KEDNJ-në dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së e vendosi thellë PKDNJ-në në Evropë, në një kontekst që tanimë ishte i njohur mirë dhe i vendosur. Natyrisht, kjo ishte një përshtatje natyrore, duke pasur parasysh rolin e kryetarit të GJEDNJ-së që kishte në nominimin e anëtarëve të Panelit, si dhe faktin që KEDNJ tanimë ishte ligj i aplikueshëm në Kosovë në pajtim me Rregulloren e

UNMIK-ut nr. 1999/24 dhe në juridiksionin e Panelit sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12. Përveç kësaj, kjo përshtatej mirë me të kuptuarit fillestar të Komisionit të Venedikut për atë se çfarë Paneli do të ishte, një organ kuazi-gjyqësor për të drejtat e njeriut për të funksionuar në boshllëkun ligjor në Kosovë, në pritje të themelimit të një Gjykate për të drejtat e njeriut dhe pranimit nga ana e Kosovës të traktateve për të drejtat e njeriut.

136. Megjithatë, ekzistojnë disa raste ku Paneli shtyri kufijtë e jurisprudencës së GJEDNJ-së, duke bërë që rastet e tij të ndryshojnë (apo zgjerohen) nga ato të GJEDNJ-së. Ato kishin të bënin, veçanërisht, me përcaktimin e standardeve të aplikueshme ligjore në kontekst të hetimit për zhdukjet dhe vrasjet ku keqbërja ishte kryer nga aktorë joshtetërorë; aplikueshmërinë e mbrojtjeve esenciale të nenit 2 të KEDNJ-së në një organ të OKB-së në kontekst të protestës publike; në rastet e personave të zhdukur dhe të vrarë (PZHV-ve), zgjerimin e juridiksionit *ratione temporis* të Panelit përmes obligimeve procedurale të nenit 2 të KEDNJ-së, në veçanti natyrës së vazhdueshme të obligimit për t'i hetuar vdekjet në rrethana të dyshimta dhe zhdukjet; në rastet e tjera të PZHV-ve, aplikueshmërinë e nenit 3 të KEDNJ-së në një organ të OKB-së, duke përfshirë shkeljet në lidhje me trajtimin jonjerëzor dhe degradues të të afërmve të personave të zhdukur dhe/apo vrarë; aspektin procedural të nenit 5 të KEDNJ-së dhe në marrjen parasysh të nevojës për hetime të ndjeshme sa i përket gjinisë.

137. Por, Paneli ishte unik në atë se ai nuk ishte lidhur vetëm me GJEDNJ-në. Përfshirja e një game të gjerë të traktateve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në instrumentet themelore të Panelit, i lejoi atij një fleksibilitet për të lëvizur përtej KEDNJ-se dhe për të qenë inovativ – një mundësi unike për të zhvilluar jurisprudencën si një organ kuazi-gjyqësor duke kërkuar një varg burimesh ligjore ndërkombëtare. Prandaj, Paneli i shfrytëzoi praktikën gjyqësore dhe komentet e përgjithshme të organeve të tjera, sikur komitetet e OKB-së për traktatet për të drejtat e njeriut apo të institucioneve të sistemit ndër-amerikan për të drejtat e njeriut. Ky diversitet i burimeve i lejoi Panelit, ta përshtatë, ku ishte e mundshme, jurisprudencën më relevante për të drejtat e njeriut me kontekstin e Kosovës, duke përfshirë madje marrjen parasysh të raporteve të raportuesve, për shembull lidhur me të drejtën në të vërtetën. Kjo u dëshmua veçanërisht e dobishme në kontekst të lëndëve të Panelit që kanë të bëjnë me dhunën kundër grave, ku Paneli shfrytëzoi KEDKG-në dhe jurisprudencën e saj.

138. Veç kësaj, kishte një numër rastesh ku ankesat e Panelit paraqisnin çështje të tjera që nuk përfshinin GJEDNJ-në, për shembull, përgjegjësia e përgjithshme e një misioni-të OKB-së (UNMIK-ut) kur autoriteti i vet u ishte hequr autoriteteve lokale. Në trajtimin e këtij lloji të çështjes, Paneli theksoi se megjithëse autoritetet lokale, duke përfshirë gjykatat lokale, Komisionin e Pavarur për Media dhe të tjerët, ishin pjesë e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ),[93] PSSP-ja ruajti mbikëqyrjen mbi IPVQ-të, zyrtarët e tyre dhe agjencitë e tyre. Pasi IPVQ-të duhej t'i observojnë dhe sigurojnë të drejtat dhe liritë të përcaktuara

[93] Në pajtim me Kronizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e 15 majit të vitit 2001, neni 1.5.

në një numër instrumentesh ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ishte në autoritetin e PSSP-së të ndërmarrë veprim nëse këto të drejta ishin shkelur.[94] Ky arsyetim ishte modifikuar më vonë për t'i përshtatur specifikat e llojeve tjera të rasteve dhe organeve të Kosovës, për shembull mbikëqyrjes së gjykatave komunale nga UNMIK-u.

B. Lëndët që kanë të bëjnë me pronën

139. Një numër i konsiderueshëm i ankesave dorëzuar Panelit përputheshin me një model të veçantë faktesh, kështu që Paneli i klasifikoi ato me emrin "14,000" apo rastet "14k". Në mënyrë specifike, këto raste përfshinin ankesat për pronën-në pronësi të serbëve etnikë, të cilët u larguan nga shtëpitë e tyre për shkaqe sigurie, gjatë dhe kryesisht në fund të konfliktit të armatosur në Kosovë në vitin 1999. Në shumë raste, pronat e tyre ishin dëmtuar apo shkatërruar më vonë. Me qëllim të marrjes së kompensimit për uzurpimin dhe/apo shkatërrimin e pronave të tyre, në mes 17,000-18,000 kërkesa për kompensim ishin paraqitur para gjykatave të Kosovës kundër UNMIK-ut, KFOR-it dhe/apo IPVQ-ve të Kosovës në vitin 2004. Kërkesat civile për kompensim ishin paraqitur në vitin 2004, sepse ligji relevant i kufizimeve ishte 5 vjet për këto lloje të kërkesave, dhe paditësit u përballën me mundësinë që atyre t'u kalojë koha për dorëzimin e kërkesave.

140. Me sa duket i shqetësuar për peshën që një vëllim aq i lartë i kërkesave paraqiste për sistemin gjyqësor të Kosovës, më 26 gusht 2004, drejtori i DD-së së UNMIK-ut u dërgoi një letër të gjitha gjykatave në Kosovë, duke iu kërkuar atyre që t'i pezullojnë të gjitha këto lëndë, derisa të vendoset se si të shqyrtohen ato më mirë.

141. Katër vjet më vonë, më 28 shtator 2008, DD-ja këshilloi gjykatat që lëndët, të cilat ishin pezulluar sipas kërkesës së tij, tani duhet të shqyrtohen. Kur ankuesit dorëzuan ankesat e tyre në Panel, në mes vitit 2008 dhe 2010, kërkesat e tyre për kompensim akoma ishin lënë pas dore – ata nuk ishin kontaktuar nga gjykatat dhe nuk ishte caktuar asnjë datë për shqyrtimin e tyre.

142. Paneli analizoi lëndët "14k" sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ-së. Në mënyrë specifike, Paneli mori parasysh se gjykatat komunale kishin ndalur procedurat në këto raste dhe që ato në përputhje me rrethanat nuk ishin përfunduar (apo madje filluar) brenda një kohe të arsyeshme.[95] Kjo përbënte shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë dhe të drejtës për të pasur procedura gjyqësore të kryera brenda një kohe të arsyeshme sipas nenit 6 të KEDNJ-së. Paneli, po ashtu, theksoi se për sa u përket "lëndëve 14k", më e rëndësishmja ishte veprimi i drejtpërdrejtë i autoritetit të UNMIK-ut, i cili i parandaloi efektivisht gjykatat nga trajtimi i lëndëve të ankuesve".[96]

143. Lidhur me çështjen e qasjes në gjykatë, Paneli vërejti që ankuesit kishin mundësinë e nisjes së procedurave ligjore në rastet e tyre në pajtim me legjislacionin relevant në fuqi. Ata e shfrytëzuan këtë mundësi për të paraqitur padi, duke i paditur për dëme

[94] Shih *Spahiu*, nr. 02/08, mendim i pjesshëm i 20 marsit të vitit 2009, §§ 25 dhe 28-29.
[95] Shih *Millogoriq dhe të tjerët*, nr. 38/08 *et al*, mendimi i 24 marsit të vitit 2010, §§ 42-46.
[96] *Ibid.*, § 18.

autoritetet e ndryshme para gjykatave komunale apo të qarkut. Megjithatë, për lëndët civile të ankuesve, në momentin e paraqitjes së padive të tyre, ishte i urdhëruar një pezullim me kërkesën e DD-së. Prandaj, nuk është bërë apo nuk ka ndodhur asnjë veprim për sa u përket këtyre padive. Gjykatat relevante nuk kanë lëshuar ndonjë vendim në lidhje me pezullimin e procedurave në rastet e ankuesve. Pjesa tjetër e rasteve në këtë kategori të veçantë të rasteve u përball me rrugën e njëjtë pa krye. Paneli përfundoi që e drejta e ankuesve për qasje në një gjykatë ishte kufizuar për shkak të një iniciative të marrë nga një organ i UNMIK-ut, DD.

144. Paneli u pajtua me arsyetimin e UNMIK-ut se kërkohej planifikim dhe organizim i madh për të siguruar qasje në drejtësi, për ata të cilët UNMIK-u pranoi të jenë "paditës të cenueshëm minoritarë". Paneli e konsideroi këtë të jetë një qëllim legjitim për përfshirjen e UNMIK-ut në çështje dhe përgjithësisht pranoi situatën me të cilën përballej UNMIK-u, duke provuar të mbikëqyrë funksionimin e duhur të gjykatave.

145. Megjithatë, në vlerësimin e të gjitha elementeve, Paneli gjeti se UNMIK-u nuk arriti të krijojë një raport të arsyeshëm të proporcionalitetit në mes mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohej të arrihej. Katër vjet të pasigurisë të përjetuara nga ankuesit lidhur me atë nëse dhe kur rastet e tyre do të shqyrtoheshin nga gjykatat, u bënë edhe më të rënda nga fakti se letra e gushtit të vitit 2004 nuk përmbante asnjë kornizë kohore për t'i mundësuar dikujt të parashoh arsyeshëm se kur gjykatat do të fillojnë me shqyrtimin e rasteve, nëse do të fillojnë fare. Për shembull, asnjë legjislacion i ri nuk është miratuar në ndërkohë, dhe as që ishte siguruar ndonjë mekanizëm për t'i ndihmuar gjykatat që t'u mundësojnë ankuesve të kenë vendim për ankesat e tyre. Për ta përmbledhur, në vend të sigurimit të qasjes në drejtësi për paditësit e cenueshëm minoritarë, Paneli konstatoi se UNMIK-u në fakt ua mohoi atyre këtë qasje në shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së.

146. Lidhur me zgjatjen e procedurave, Paneli vendosi se ai tanimë e kishte marrë parasysh atë aspekt gjatë shqyrtimit nga ana e tij të të drejtës së ankuesve për qasje në një gjykatë, dhe konstatoi se çështja e zgjatjes së procedurave duhet vlerësuar se është absorbuar nga çështja e qasjes në një gjykatë, në pajtim me jurisprudencën analoge të KEDNJ-së.

C. Lëndët për persona të zhdukur dhe të vrarë (PZHV)

147. Në rreth gjysmën e ngarkesës së përgjithshme të Panelit me lëndë, ankuesit pretendonin për mungesë të hetimit nga Policia e UNMIK-ut dhe autoritetet gjyqësore për rrëmbimet, zhdukjet dhe/apo vrasjet e të afërmve të tyre. Ngjarjet që ndërlidheshin me këtë lloj të ankesave kanë ndodhur në Kosovë më 1998-2000, disa para e disa pas themelimit të UNMIK-ut në qershor të vitit 1999.

i. Historiku

148. Vlerësimet lidhur me ndikimin e konfliktit në shpërnguljen e popullatës shqiptare të Kosovës sillen prej përafërsisht 800,000 deri 1.45 milion. Pas miratimit të Rezolutës

1244 (1999), shumica e shqiptarëve të Kosovës, të cilët ishin larguar, apo ishin dëbuar me forcë nga shtëpitë e tyre nga forcat serbe gjatë konfliktit, u kthyen në Kosovë. Pjesëtarët e komunitetit joshqiptar-kryesisht serbët, dhe jo vetëm ata, por edhe romët dhe myslimanët sllavë si dhe shqiptarët e Kosovës të dyshuar për bashkëpunim me autoritetet serbe, u bënë shënjestër e sulmeve shumë të përhapura të grupeve të armatosura të shqiptarëve të Kosovës. Vlerësimet e tanishme lidhur me numrin e serbëve të Kosovës të zhvendosur sillen përafërsisht prej 200,000 deri 210,000. Ndërsa shumica e serbëve të Kosovës dhe joshqiptarët e tjerë të Kosovës u larguan në Serbi dhe në vendet fqinje, ata që mbetën prapa u bënë viktima të vrasjeve sistematike, rrëmbimeve, mbajtjeve arbitrare, dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini, rrahjeve dhe frikësimit.

149. Siç është sqaruar më lart, UNMIK-u filloi një fazë të re në punën e OKB-së kur u thirr ta qeverisë një territor ku "kapacitetet lokale gjyqësore dhe ligjore u konstatua të jenë joekzistente, të paafta apo i nënshtroheshin frikësimit nga elementet e armatosura."[97] "Vakuumi ligjor" i krijuar në Kosovë pas tërheqjes së të gjitha shërbimeve të Qeverisë së Serbisë duhej plotësuar menjëherë. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së i raportonte komunitetit ndërkombëtar se "UÇK-ja ishte kthyer shpejt në të gjitha pjesët e Kosovës, në veçanti jugperëndim, dhe një numër i madh i serbëve të Kosovës u larguan nga shtëpitë e tyre për të shkuar në Serbi … [për shkak të] numrit në rritje të incidenteve të shkaktuara nga shqiptarët e Kosovës kundër serbëve të Kosovës. … Problemi i sigurisë në Kosovë është kryesisht si rezultat i mungesës së institucioneve dhe agjencive për zbatimin e ligjit dhe mbajtjen e rendit. … Grupet kriminale që janë duke garuar për kontroll të burimeve të pakta, tanimë e kanë shfrytëzuar këtë zbrazëti. … Mungesa e një force legjitime policore … duhet të trajtohet si çështje prioritare."[98]

150. Si pjesë e përpjekjeve për të rivendosur zbatimin e ligjit në Kosovë, OKB-ja vendosi të dërgojë personel ndërkombëtar policor në UNMIK, duke formuar atë që u bë e njohur si Policia e UNMIK-ut. Deri në shtator të vitit 1999, përafërsisht 1,100 policë ndërkombëtarë tanimë u vendosën në Kosovë. Deri në dhjetor të vitit 2000, vendosja e Policisë së UNMIK-ut pothuajse përfundoi me 4,400 policë nga 53 vende të ndryshme. UNMIK-u kishte marrë primatin sa i përket përgjegjësisë për zbatimin e ligjit në të gjitha rajonet e Kosovës, përveç Mitrovicës.

151. Policia e sapoformuar e UNMIK-ut, e papërvojë sa u përket specifikave të kryerjes së detyrave policore në këtë rajon pas konfliktit, duhej të përballej me një shkallë të lartë të krimit dhe me shumë vështirësi praktike. Sipas Raportit vjetor të Policisë së UNMIK-ut për vitin 2000, atyre u janë raportuar 675 vrasje, 115 dhunime dhe 351 rrëmbime për periudhën qershor 1999 - dhjetor 2000. Megjithatë, Policia e UNMIK-ut nuk kishte qasje në ndonjë burim të informatave, të cilat do të ishin në dorë të një

[97] *Shqyrtim gjithëpërfshirës i krejt çështjes së operacioneve paqeruajtëse në të gjitha aspektet e tyre*, Raport i Panelit mbi Operacionet e Paqes të Organizatës së Kombeve të Bashkuara ("Raporti i Brahimit "), A/55/305–S/2000/809, 21 gusht 2000, § 79.

[98] KS i OKB-së, Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë i 12 korrikut të vitit 1999, S/1999/799, §§ 5 dhe 6.

force policore nacionale që nuk është prekur nga konflikti, siç janë bazat e të dhënave të dosjeve penale, regjistrat e makinave apo armëve.

152. Paralelisht me rivendosjen e strukturave policore në Kosovë, UNMIK-u duhej po ashtu të rivendosë sistemin e administrimit të drejtësisë. Në fund të qershorit të vitit 1999, u themelua një Sistem emergjent i drejtësisë. Ai përbëhej nga një numër i kufizuar gjyqtarësh dhe prokurorësh vendorë dhe ishte operacional derisa sistemi i rregullt i drejtësisë u bë operacional në janar të vitit 2000. Megjithatë, deri në shkurt të vitit 2000, UNMIK-u autorizoi emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, fillimisht në rajonin e Mitrovicës dhe më vonë në gjithë Kosovën, për të forcuar sistemin lokal të drejtësisë dhe për të garantuar paanësinë. Prej tetorit të vitit 2002, sistemi lokal i drejtësisë përbëhej prej 341 gjyqtarëve dhe prokurorëve vendorë dhe 24 ndërkombëtarë. Në raportin e tij për KS të OKB-s, në janar të vitit 2003, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së sistemin e policisë dhe drejtësisë në Kosovë në atë kohë e definoi si sistem që "funksionon mirë" dhe "i qëndrueshëm".

153. Në korrik të vitit 1999, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së i raportoi Këshillit të Sigurimit që UNMIK-u e konsideronte çështjen e personave të zhdukur si një shqetësim veçanërisht të madh për të drejtat e njeriut në Kosovë. Megjithëse shifrat mbesin kontestuese, vlerësohet që më shumë se 15,000 vdekje apo zhdukje ndodhën si pasojë e drejtpërdrejtë e konfliktit të Kosovës dhe gjatë tij (1998-2000). Më shumë se 3,000 shqiptarë etnikë dhe rreth 800 serbë, romë dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera minoritare u zhdukën gjatë kësaj periudhe. Për më shumë se gjysmën e personave të zhdukur janë gjetur dhe identifikuar mbetjet e tyre mortore deri në fund të vitit 2010. Sipas të dhënave të muajit maj të vitit 2015, 1,653 persona gjenden ende si të zhdukur në listën e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK).

154. Në muajin nëntor të vitit 1999, u krijua Njësiti për Personat e Zhdukur (NJPZH) brenda Policisë së UNMIK-ut, me mandat që të hetojë vendndodhjen e mundshme të personave të zhdukur dhe/apo varrezave. NJPZH-ja, së bashku me Njësitin Qendror për Hetim Penal (NJQHP) të Policisë së UNMIK-ut, dhe më vonë Njësiti për Hetimin e Krimeve të Luftës (NJHKL), ishin përgjegjëse për aspektet penale të rasteve të personave të zhdukur në Kosovë. Prej qershorit të vitit 2002, Zyra e sapoformuar për personat e zhdukur dhe mjekësi ligjore (ZPZHML) në Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut (DD), u bë autoriteti i vetëm i mandatuar për të përcaktuar vendndodhjen e personave të zhdukur, t'i identifikojë mbetjet e tyre mortore dhe t'ua kthejë ato familjes së të zhdukurit. Duke filluar nga viti 2001, në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) ndërmjet UNMIK-ut dhe Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur me seli në Sarajevë (KNPZH), i plotësuar nga një marrëveshje tjetër në vitin 2003, identifikimi i mbetjeve mortore u krye nga KNPZH-ja përmes testit të ADN-së.

155. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me policinë dhe drejtësinë në Kosovë përfundoi me EULEX-in, i cili mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pasi që kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më

26 nëntor 2008,[99] nxori Deklaratën që mirëpriste angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

156. Po të njëjtën ditë, UNMIK-u dhe EULEX-i nënshkruan një MM mbi modalitetet dhe të drejtat dhe obligimet përkatëse që dalin nga transferimi prej UNMIK-ut tek EULEX-i, i lëndëve dhe dosjeve përkatëse të cilat përfshinin hetimet, ndjekjet penale në vijim dhe aktivitetet e tjera të ndërmarra nga prokurorët ndërkombëtarë të UNMIK-ut. Menjëherë pas kësaj, marrëveshje të ngjashme u nënshkruan në lidhje me dosjet e mbajtura nga gjyqtarët ndërkombëtarë dhe Policia e UNMIK-ut. Të gjitha marrëveshjet obliguan EULEX-in që t'i sigurojë qasje UNMIK-ut në dokumentet që ndërlidhen me veprimet që autoritetet e UNMIK-ut i kanë ndërmarrë më parë. Në periudhën 9 dhjetor 2008 deri më 30 mars 2009, të gjitha dosjet me lëndë penale të mbajtura nga DD i UNMIK-ut dhe Policia e UNMIK-ut, iu dorëzuan EULEX-it.

ii. Ankesat e pranuara

157. Ankesa e parë lidhur me rastet e PZHV-të është regjistruar nga Sekretariati i Panelit më 13 nëntor 2008.[100] N vitin 2009, Paneli pranoi pjesën më të madhe të rasteve të tilla dhe, vetëm gjatë muajit prill të vitit 2009, janë regjistruar më shumë se 200.

158. Mendimi i parë mbi bazueshmërinë nga ankesat për PZHV-të është miratuar nga Paneli më 8 dhjetor 2012, në lëndën *S.C.* [101] Nga 248 lëndët për PZHV që Paneli i shpalli të pranueshme, ai gjeti shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së në 233 nga to (93 %).

159. Për arsyet rreth të cilave Paneli mundet vetëm të spekulojë, përveç për pesë ankesa, ankuesit dhe viktimat ishin serbë të Kosovës e jo shqiptarë të Kosovës. Në dy raste të paraqitura nga shqiptarët e Kosovës,[102] viktimat dhe/apo ankuesit ose punuan për, apo ishin disi të lidhur me Policinë serbe apo forcat e sigurisë, me pjesëtarë të UÇK-së që përmendeshin me emër si të dyshuar. Paneli, po ashtu, e vërejti faktin që shumë nga ankesat kishin të bënin me vdekjet dhe zhdukjet e të afërmve të moshuar.

160. Shumica e ankuesve informuan Panelin rreth një incidenti, apo një numri të incidenteve (zakonisht të lidhura), gjatë apo pas të cilave të afërmit e tyre ishin rrëmbyer, zhdukur dhe/apo vrarë. Në një numër të konsiderueshëm të rasteve, nuk është paraqitur asnjë informatë mbi rrethanat specifike të zhdukjes dhe/apo vdekjes së viktimës.

161. Ankuesit ngritën shqetësimet e tyre lidhur me kryerjen e hetimeve nga autoritetet e UNMIK-ut, të cilat sipas mendimit të tyre ishin plotësisht joefektive. Ata, po ashtu, shprehën pakënaqësinë e tyre për të mos qenë në gjendje që të zbulojnë se çfarë u kishte ndodhur të afërmve të tyre të zhdukur dhe mungesën e kontakteve me autoritetet e UNMIK-ut në lidhje me hetimet.

---

[99] KS i OKB-së, Deklarata e kryetarit të Këshillit të Sigurimit, S/PRST/2008/44, 26 nëntor 2008.
[100] Shih *Zdravkoviq*, nr. 46/08.
[101] *S.C.*, nr. 02/09, mendimi i 12 dhjetorit të vitit 2013.
[102] Shih *Ibraj*, nr. 14/09 *et al*; dhe *X.*, nr. 326/09 *et al*.

162. Për të përcaktuar përgjegjësinë e UNMIK-ut në këto raste, Paneli së pari duhej të ofronte kualifikim ligjor për pretendimet e paraqitura kundër UNMIK-ut nga ankuesit. Për ta bërë këtë, Paneli u mbështet në jurisprudencën e Gjykatave Evropiane dhe Ndër-amerikane për të Drejtat e Njeriut si dhe KDNJ-në.

163. Pasi kufizimet juridiksionale *ratione temporis* nuk i lejonin Panelit që t'i marrë në konsideratë çështjet e lidhura me incidentet që kishin ndodhur para 23 prillit të vitit 2005, Paneli nuk ishte në gjendje të shqyrtojë ndonjë çështje esenciale që ka mundur të jetë, apo ishte ngritur sipas obligimit procedural të nenit 2 të KEDNJ-së, d.m.th. dështimit të pretenduar të UNMIK-ut për t'i mbrojtur jetët e personave brenda juridiksionit të vet.

iii. Neni 2 i KEDNJ-së

Obligimi procedural sipas nenit 2

164. Në vendimin e parë mbi pranueshmërinë për PZHV në rastin *Zdravkoviq*, të miratuar më 17 prill 2009, Paneli konsideroi se ankuesit pretenduan në thelb për mungesën e hetimit adekuat penal për ngjarjet që çuan te humbja e të afërmve të tyre (zhdukja, rrëmbimi dhe/apo vrasja), pra duke u mbështetur në obligimin procedural sipas nenit 2 të KEDNJ-së.[103] Koncepti i obligimeve procedurale sipas nenit 2 kryesisht doli nga situatat e humbjes së qartë të jetës në situata kërcënimi me jetë, ku materiali hetimor që u është paraqitur ekspertëve ishte tepër i pakët sa që thjesht nuk kishte baza të mjaftueshme për të vlerësuar nëse vdekja ishte në shkelje të obligimit esencial për të mbrojtur jetën. Ai u bë një mjet shumë efektiv për të siguruar që autoritetet nuk do të jenë në gjendje për të shmangur përgjegjësinë sipas nenit 2 përmes kryerjes së hetimit të dobët.

165. Për shkak se neni 2 i KEDNJ-së, i cili mbron të drejtën në jetë, renditet si njëra nga dispozitat më fundamentale në KEDNJ dhe ruan njërën nga vlerat themelore të shoqërive demokratike, Paneli vendosi ta ndjekë me vështrimin më të kujdesshëm qasjen e GJEDNJ-së dhe pretendimet e subjektit për shkelje të kësaj dispozite. Paneli, po ashtu, theksoi që Gjykata Evropiane ka gjetur shkelje të vazhdueshme të nenit 2 të KEDNJ-së kur ka pasur dështim të autoriteteve për të kryer hetim efektiv për vendndodhjen dhe fatin e personave të zhdukur, të cilët janë zhdukur në rrethana kërcënimi me jetë; kur janë vonuar hapat vendimtarë hetimorë apo nuk janë ndërmarrë hapa të nevojshëm hetimorë, që më pas mund të përbëjë një shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së. Në fund, Paneli theksoi që obligimi procedural sipas nenit 2 nuk kufizohet në raste ku është vërtetuar se vrasja është shkaktuar nga një "agjent i shtetit" dhe zgjerohet për t'i mbuluar rastet e zhdukjes.

166. Paneli e shqyrtoi tërësisht secilën ankesë me qëllim të sigurimit që autoritetet e UNMIK-ut ishin vërtet të informuara për një incident të caktuar. Ku ky nuk ishte rasti, Paneli i konsideroi ankesat sipas këtij neni si të papranueshme. Për shembull, në rastin

[103] Shih *Zdravkoviq*, nr. 46/08, vendimi i 17 prillit të vitit 2009, § 28.

Baraq, Paneli theksoi që "asgjë në informatat e paraqitura nga ankuesi nuk dëshmon se ai paraqiti ndonjëherë ankesë tek autoritete relevante të UNMIK-ut në lidhje me dyshimet e tij për rrethanat që ndërlidhen me vdekjen e vëllait të tij. Prandaj, Paneli konsideron se në rrethanat e rastit aktual, UNMIK-u nuk e kishte për obligim të kryejë një hetim efektiv për vdekjen e z. Tomisllav Baraq sipas nenit 2 të KEDNJ-së … Nga kjo rrjedh se kjo pjesë e ankesës është qartë e pabazuar … dhe rrjedhimisht e papranueshme."[104]

Aplikueshmëria e nenit 2 për UNMIK-un

167. Sa i përket aplikueshmërisë së nenit 2 për UNMIK-un, Paneli thekson që me miratimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1, më 25 korrik 1999, UNMIK-u mori përsipër obligimin që t'i zbatojë standardet e njohura ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut gjatë ushtrimit të funksioneve të veta. Ky zotim u detajua në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24, të 12 dhjetorit 1999, me të cilën UNMIK-u mori obligimet sipas instrumenteve të përmendura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë KEDNJ-ë. Në lidhje me këtë, Paneli theksoi kohën dhe tha përsëri se ndërsa karakteri i përkohshëm i UNMIK-ut dhe vështirësitë e ngjashme duhet marrë parasysh siç duhet, në asnjë rrethanë këto elemente nuk mund të merren si arsyetim për uljen e standardeve të respektimit të të drejtave të njeriut, të cilat u inkorporuan sipas rregullit në mandatin e UNMIK-ut.

168. Sa i përket aplikueshmërisë së nenit 2 në situatat e konfliktit apo dhunës së përgjithësuar, Paneli rikujton që GJEDNJ dhe KDNJ kanë vendosur që obligimi procedural për të mbrojtur jetën dhe, më pas të hetojë ndonjë humbje të jetës vazhdon të zbatohet në situata pas konflikti, duke përfshirë situatat e rënda të sigurisë. Është, po ashtu, e kuptueshme se pengesat mund të vendosen në rrugën e hetuesve dhe shtrëngesat konkrete mund të detyrojnë përdorimin e masave më pak efektive të hetimit apo mund të bëjnë që ndonjë hetim të shtyhet. Megjithatë, e drejta për jetë, duke përfshirë garancitë e veta procedurale, konsiderohet si e drejtë supreme nga e cila nuk lejohet kurrfarë shmangie, madje edhe në kohën e emergjencave publike të cilat kërcënojnë jetën e kombit.

169. Paneli u kushtoi vëmendjen e duhur vështirësive të cilat UNMIK-u i hasi gjatë fazës së parë të vendosjes së tij. Ai theksoi që rëndësia e duhur kushtuar çështjes së personave të zhdukur në Kosovë, nënkuptonte që UNMIK-u është dashur t'i marrë parasysh të dyja dimensionet humanitare dhe penale të situatës. Paneli, po ashtu, konsideroi se "rëndësia që u është kushtuar hetimeve penale dhe vështirësitë në Kosovë që kufizuan aftësinë e autoriteteve hetimore për t'i kryer hetimet e tilla... ishin vendimtare që UNMIK-u të krijojë nga fillimi një ambient të favorshëm për kryerjen e hetimeve kuptimplota. Kjo do të përfshinte krijimin e një sistemi ku do të hynin elementet e tilla, siç janë dhënia e përgjegjësisë së plotë për mbikëqyrjen dhe monitorimin e progresit në hetime, sigurimin e shqyrtimit të rregullt të gjendjes së hetimeve dhe një proces për pranim-dorëzim të duhur të rasteve ndërmjet nëpunësve

[104] Shih *Baraq*, nr. 149/09, vendimi i 1 tetorit të vitit 2012, §§ 15-16.

apo njësive të ndryshme të Policisë së UNMIK-ut. Një sistem i tillë, po ashtu, duhet t'i marrë parasysh nevojat për mbrojtje të viktimave dhe dëshmitarëve… si dhe të konsiderojë cenueshmërinë e veçantë të personave të zhvendosur në situatat pas konfliktit … Ndonëse kuptohet që vendosja dhe organizimi i organeve të policisë dhe drejtësisë ndodhi gradualisht, Paneli mendon që ky proces përfundoi në vitin 2003, kur sistemi i policisë dhe gjyqësisë në Kosovë nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së u përshkrua se "funksionon mirë" dhe është "i qëndrueshëm"."[105]

170. Paneli më tutje theksoi që ai nuk "do t'i shqyrtojë praktikat relevante apo pengesat e pretenduara për të kryer hetime efektive *in abstracto*, por vetëm në lidhje me aplikimin e tyre specifik në rrethana të veçanta të një situate që paraqet një çështje në një ankesë para tij", dhe që ai do të përdorë llojin dhe shkallën e nevojshme të shqyrtimit "për të përcaktuar nëse efektiviteti i hetimit e plotëson pragun minimal". Prandaj, qëllimi i Panelit ishte "që të vërtetojë në lidhje me secilin rast nëse janë ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të kryer një hetim efektiv siç përshkruhet nga neni 2, duke pasur parasysh realitetet e punës hetimore në Kosovë."[106]

171. Paneli e mori parasysh ndjeshmërinë e informatave në lidhje me hetimet e kryera nga UNMIK-u dhe autoritetet e tjera për rastet e PZHV-e. Prandaj, ishte jashtëzakonisht i kujdesshëm që të mos zbulojë në mendimet e veta ndonjë informatë, ku zbulimi do të ishte potencialisht në dëm të ankuesve apo palëve të treta, apo ndryshe nuk ishte e përshtatshme për t'u ditur nga publiku i gjerë. Prandaj, Paneli hoqi nga vendimet dhe mendimet të gjitha adresat dhe detajet e tjera për kontakt të ankuesve; emrat dhe adresat e dëshmitarëve; informatat që do t'u mundësonin autorëve të vlerësonin dëshminë në posedim të autoriteteve; informatat e konsideruara "konfidenciale" sipas rregullave të brendshme të OKB-së; si dhe informatat e tjera që Paneli i konsideronte si të ndjeshme.

172. Gjatë marrjes parasysh të këtij aspekti në ankesat për PZHV-të, Paneli u përqendrua në vlerësimin e të qenit adekuat dhe mjaftueshmërisë së veprimeve hetimore dhe të tjera të ndërmarra nga autoritetet e UNMIK-ut në secilin rast specifik, duke i krahasuar kundrejt standardeve të një hetimi efektiv të përcaktuara nga GJEDNJ sipas obligimit procedural të nenit 2 të KEDNJ-së.

Çështjet në procesin hetimor që çuan te gjetja e shkeljes së obligimit procedural sipas nenit 2

173. Në rastet kur një vrasje/rrëmbim/zhdukje kishte ndodhur para juridiksionit *ratione temporis* të Panelit, madje në disa raste para themelimit të UNMIK-ut, por kishte dëshmi se autoritetet e UNMIK-ut kanë qenë të informuara për to, Paneli theksoi se

[105] Shih *Stojkoviq*, nr. 87/09, mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2013, § 128.
[106] Shih *Zdravkoviq*, nr. 46/08, mendimi i 25 shkurtit të vitit 2013, §§ 107-115.

obligimi i vazhdueshëm për t'i hetuar çështjet e tilla penale në pajtim me nenin 2 të KEDNJ-së merret përsipër nga UNMIK-u.[107]

174. Më poshtë janë nënvizuar çështjet më të rëndësishme që ndikuan, në shkallë të ndryshme, në të qenit adekuat të hetimit. Ne mund t'i grupojmë ato në tri kategori.

175. *Çështjet në procesin hetimor*

- Kishte vonesa të konsiderueshme në regjistrimin e raporteve për PZHV-të nga Policia e UNMIK-ut, apo, në disa raste, dështim për t'i regjistruar fare ato. Nganjëherë, vonesat ishin me muaj dhe vite, pa dhënë sqarim. Ka të ngjarë që Policia e UNMIK-ut dështoi t'i informojë prokurorët rreth kallëzimeve penale në lidhje me rastet e PZHV-ve.

- Vonesat e rëndësishme në, apo mungesë e plotë, veprimet fillestare hetimore, sikur hetimi në vendin e krimit, "kontrolli" i zonave të afërta, mbledhja dhe ruajtja e dëshmisë fizike, regjistrimi i deklaratave të dëshmitarëve rrezikuan bazën e provave të hetimit nga vetë fillimi.

- Përpjekjet për t'i gjetur dëshmitarët në shumë raste nuk dukeshin të jenë të plota dhe të kujdesshme;[108] policia shpesh supozonte se një dëshmitar ishte i paanshëm para se të bisedonte me të.[109]

- UNMIK-u dështoi t'i kontaktojë ankuesit dhe dëshmitarët, të cilët u larguan nga Kosova për shkaqe sigurie. Cenueshmëria e veçantë e PZHB-ve në situatat pas konfliktit është dashur, po ashtu, të merret parasysh.[110]

- Vonesat në përpjekjet për t'i gjetur dhe intervistuar dëshmitarët dukej të kenë qenë mjaft të pranishme. Për shkak të vonesave të tilla, dëshmitarët vdiqën, të tjerët u zhvendosën dhe nuk mund t'u bihej në gjurmë.[111]

- Mungesa e mbrojtjes së dëshmitarëve në Kosovë nga kërcënimet apo frikësimi ka qenë, dhe mbetet, njëra nga sfidat më të mëdha për autoritetet e drejtësisë.[112]

- Kishte mungesë serioze të ndarjes së duhur të informatave në mes njësive relevante të Policisë së UNMIK-ut, e cila pengoi "një sistem të bashkërenduar si duhet që është në gjendje të kryejë një hetim adekuat dhe efektiv."[113]

---

[107] Shih *Pesë ankesat*, nr. 43/09 *et al*, mendimi i 31 korrikut të vitit 2013, § 100; *Antiq*, nr. 100/09, mendimi i 12 shtatorit të vitit 2013, §§ 61 dhe 64; *Angjellkoviq*, nr. 277/09, mendimi i 23 janarit të vitit 2014, §§ 70 dhe 73.
[108] Shih *Çunguroviq*, nr. 131/09, mendimi i 6 gushtit të vitit 2014, § 34; *Llaziq*, nr. 261/09, mendimi i 27 shkurtit të vitit 2015, § 35; *Ristiq*, nr. 224/09 et al., mendimi i 11 shtatorit të vitit 2015, § 45.
[109] Shih *Ristiq*, *ibid.*, § 109.
[110] Shih *Buleviq*, nr. 146/09, mendimi i 13 dhjetorit të vitit 2013, § 100.
[111] Shih *Kuzmanoviq*, nr. 262/09, mendimi i 21 janarit të vitit 2015, §§ 25 dhe 99.
[112] Shih *Miriq dhe të tjerët*, nr. 68/09 *et al*, mendimi i 10 shtatorit të vitit 2015, § 197; *Mlladenoviq*, nr. 99/09, mendimi i 26 qershorit të vitit 2014, § 200; *Nikoliq dhe të tjerët*, nr. 72/09 *et al*, mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2014, §§ 201-202.
[113] Shih *Stojkoviq*, nr. 87/09, mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2013, § 164. Për shembujt e dështimeve për të lidhur informatat e qarta, duke bërë që hetimet të mbesin të ndara, shih po ashtu *Vitosheviq*, nr. 90/09 dhe 103/09, mendimi i 27 nëntorit të vitit 2013, §§ 97, 98 dhe 102; *Mishlen dhe të tjerët*, nr. 58/09 *et al*, mendimi i 13 nëntorit të vitit 2015, §§ 142, 165 dhe 175; *Bucalo dhe të tjerët*, nr. 148/09 *et al*, mendimi i 4 shkurtit të vitit 2016, §§ 58 dhe 149.

- Kishte raste kur mbetjet mortore të viktimave ishin "humbur" nga autoritetet e UNMIK-ut dhe asnjë sqarim nuk u ishte dhënë familjeve me vite.[114]

- Në një shumicë dërrmuese të rasteve Paneli gjeti se familjeve të viktimave të zhdukura dhe të vrara, ose nuk u ishte ofruar asnjë informatë rreth gjendjes dhe progresit të hetimit, apo sasia e këtij informacioni ishte e pamjaftueshme për t'i mbrojtur interesat e tyre legjitime.[115]

- Hetimet policore ishin ndërprerë pas një shqyrtimi të brendshëm, pa informuar prokurorët përgjegjës dhe palët e dëmtuara. Në një numër rastesh hetimet ishin "ndalur" pa ndonjë vendim zyrtar dhe pa ndonjë arsye të qartë, pavarësisht pistave hetimore që akoma duhej të ndiqeshin. Veç kësaj, në shumë raste pistat hetimore dhe rekomandimet e identifikuara nga hetuesit/prokurorët që shqyrtonin rastin nuk ishin ndjekur.

176. *Çështjet strukturore*

- Një numër i dosjeve paraqitnin situatat kur viktimat ishin rrëmbyer para njësiteve të KFOR-it,[116] apo informatat mbi rrëmbimet i ishin bartur njësitit të KFOR-it.[117] Asnjë veprim hetimor nuk ishte bërë nga Policia e UNMIK-ut.

- Në një numër të madh të rasteve nuk kishte indikacione për ndonjë kontroll të shqyrtimit prokurorial apo ndonjë lloj të përfshirjes së prokurorëve publikë. Madje edhe në rastet ku ankuesit paraqitën kallëzime penale te prokurorët ndërkombëtarë publikë, ato kallëzime duket se vetëm janë përkthyer, pa u ndjekur me ndonjë hap të duhur.[118] Duket se ka të ngjarë që prokurorët ndërkombëtarë nuk ndërmorën asnjë veprim kuptimplotë për t'i hetuar vetë incidentet e raportuara, e as që ushtruan funksionin e tyre mbikëqyrës për sa u përket hetimeve të kryera nga Policia e UNMIK-ut.

- Autoritetet shtetërore serbe i dërguan UNMIK-ut informata esenciale që ofronin detaje për incidente të ndryshme, duke përfshirë vendet, datat dhe emrat e viktimave, të dyshuarit dhe dëshmitarët. Megjithatë, në shumicën e këtyre rasteve, nuk kishte bashkërendim të duhur në mes UNMIK-ut dhe autoriteteve serbe.[119]

- Mungesa e bashkërendimit në mes UNMIK-ut, TNPJ-së dhe KFOR-it shkaktoi probleme për hetuesit. Në disa raste, Policia e UNMIK-ut nuk hetoi sepse TNPJ-

---

[114] Shih *Milenkoviq*, nr. 255/09, mendimi i 26 qershorit të vitit 2015, §§ 81-82.
[115] Shih *Llaziq*, nr. 261/09, mendimi i 27 shkurtit të vitit 2015, § 125.
[116] Shih *Tomanoviq dhe të tjerët*, nr. 248 *et al*, mendimi i 25 prillit të vitit 2013, §§ 23.
[117] Shih *ibid.*, §§ 25 dhe 72; *Pejçinoviq*, nr. 89/09, mendimi i 13 marsit të vitit 2014, §§ 31, 40, 47 dhe 52; *Vitosheviq dhe Majmareviq*, nr. 139/09 *et al*, mendimi i 23 janarit të vitit 2014, §§ 32, 39, 40 dhe 119; *Miriq dhe të tjerët*, nr. 68/09 *et al*, mendimi i 10 shtatorit të vitit 2015, § 64.
[118] Shih p.sh.. *Llaziq*, nr. 261/09, mendimi i 27 shkurtit të vitit 2015, §§ 37, 115, 120 dhe 155; *Kostiq dhe të tjerët*, nr. 111/09 *et al*, mendimi i 23 tetorit të vitit 2015, §§ 115 dhe 265; *Mishlen dhe të tjerët*, nr. 58/09 *et al*, mendimi i 13 nëntorit të vitit 2015, §§ 65, 66, 164, 166 dhe 181.
[119] Shih *Kostiq dhe të tjerët*, *ibid.*, §§ 96-98; *Bucalo dhe të tjerët*, lëndët nr. 148/09 *et al*, mendimi i 4 shkurtit të vitit 2016, § 41.

ja i kishte marrë përsipër hetimet, por pa ofruar ndonjë dokumentacion.[120] Prandaj, Paneli nuk gjeti asnjë gabim në veprimet e organeve të UNMIK-ut, ndërsa nuk mund t'i vlerësonte veprimet e TNPJ-së për shkak të kufizimeve të veta juridiksionale *ratione personae*.[121] Megjithatë, Paneli shprehu qëndrimin e vet në lidhje me këtë, duke thënë se është dashur të ketë një gjurmë të shkresave në mes UNMIK-ut dhe TNPJ-së, që tregojnë për pranim-dorëzimin e akteve, por ajo mungonte.

177. *Çështjet policore*

- Disa hetime janë pezulluar pas marrjes të vetëm informatave fillestare. Mosveprimi i Policisë së UNMIK-ut është arsyetuar me argumentin se hetimet e tilla "nuk konsideroheshin një prioritet."[122]

- Në një memorandum të brendshëm të Policisë së UNMIK-ut dhe DD-së (2003) thuhej që, me qëllim që të ruhen burimet e kufizuara hetimore, Policia e UNMIK-ut koncentrohej vetëm në hetimin e krimeve "me gjasa të mëdha për identifikim të të dyshuarit."[123]

- Paneli, po ashtu, gjeti se nuk ishte bërë asnjë përpjekje substanciale nga autoritetet hetimore të UNMIK-ut për të hetuar në një mënyrë sistematike dhe të bashkërenduar zhdukjen dhe vrasjen e një numri të madh të serbëve të Kosovës, ku kishte pista të qarta të hetimit që çonin kah autorët e dyshuar të UÇK-së.[124]

iv. Neni 3 i KEDNJ-së

Obligimi esencial sipas nenit 3

178. Paneli konsideroi se ankuesit, po ashtu, pohuan që mungesa e një hetimi penal adekuat për incidentet që çuan te humbja e të afërmve të tyre dhe mungesa e informatave nga autoritetet e UNMIK-ut, në lidhje me hetimet u shkaktuan atyre dhimbje dhe vuajtje mentale, në shkelje të obligimit esencial të nenit 3 të KEDNJ-së.

179. Gjatë shqyrtimit të këtij aspekti të ankesave për PZHV-të, Paneli shqyrtoi gjendjen e secilit ankues të veçantë për të vërtetuar nëse me sjelljen e tij UNMIK-u i kontribuoi shqetësimit dhe vuajtjes mentale të ankuesit, në shkelje të obligimit esencial të nenit 3 të KEDNJ-së.

180. Shqyrtimi i çështjeve të nenit 3 gjithmonë bëhej në lidhje me të gjeturat e Panelit në lidhje me nenin 2. Në veçanti, Paneli shqyrtoi periudhat e mosveprimit të plotë (apo pothuaj të plotë) të autoriteteve, veçanërisht në situatat kur ishin në dispozicion informata të mjaftueshme të nevojshme për të bërë një hetim nga fillimi.

---

[120] Shih *Vitosheviq dhe Majmareviq*, lëndët nr. 139/09 *et al*, mendimi i 23 janarit të vitit 2014, §§ 72, 88, 98 dhe 127-132.
[121] Shih p.sh. *Remishtar*, nr. 245/09, mendimi i 14 tetorit të vitit 2014, §§ 104-118; *Mitroviq dhe të tjerët*, nr. 144/09 *et al*, mendimi i 13 nëntorit të vitit 2014, §§ 193-203.
[122] Shih *B.A.*, nr. 52/09, mendimi i 1 shkurtit të vitit 2013, §§ 26 dhe 46-49.
[123] Shih *Stevanoviq*, nr. 289/09, mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2014, § 42.
[124] Shih p.sh. *Nikoliq dhe të tjerët*, nr. 72/09 *et al*, mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2014, § 203; *Miriq dhe të tjerët*, nr. 68/09 *et al*, mendimi i 10 shtatorit të vitit 2015, § 204; *Kostiq dhe të tjerët*, nr. 111/09 *et al*, mendimi i 23 tetorit të vitit 2015, § 261.

181. Mendimi i parë ku çështjet e nenit 3 ishin shqyrtuar së bashku me nenin 2 është miratuar nga Paneli më 23 prill 2013, në rastin *Jociq*.[125]

182. Nga një numër i përgjithshëm prej 248 lëndësh për PZHV-të të shpallura të pranueshme, në 178 lëndë Paneli konsideroi se pretendimet, po ashtu, përfshinin çështjet sipas nenit 3 të KEDNJ-së. Nga ato 178 lëndë, në 163 sosh Paneli gjeti se UNMIK-u nuk kishte vepruar në pajtim me kërkesën esenciale të nenit 3.

Aplikueshmëria e nenit 3 për UNMIK-un

183. Duke shqyrtuar ankesat kundër UNMIK-ut të parashtruara para tij, Paneli përdori qasjen e njëjtë të cilën e kishte pasur për çështjet sipas nenit 2 të KEDNJ-së. Paneli theksoi se nuk "do t'i shqyrtojë praktikat relevante apo pengesat e pretenduara për kryerjen e hetimeve efektive *in abstracto*, por vetëm në lidhje me aplikimin e tyre specifik në ankesën para tij, duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të rastit."[126] Për këto arsye, Paneli konsideron që duhet të verifikojë për çdo rast, "nëse qëndrimi dhe reagimet e autoriteteve të UNMIK-ut për zhdukjen dhe kërkimin e informatave nga ankuesit në lidhje me fatin e të afërmve të tyre dhe hetimin penal, përbëjnë një shkelje të obligimit sipas nenit 3, duke pasur parasysh realitetet në Kosovë në kohën relevante."[127]

184. Analiza e reagimit të autoriteteve "nuk duhet të kufizohet në ndonjë manifestim specifik të qëndrimeve të autoriteteve, incidente të izoluara apo akte procedurale", por duhet të ketë një "vlerësim të përgjithshëm dhe të vazhdueshëm të mënyrës me të cilën autoritetet e shtetit të paditur iu përgjigjen pyetjeve të parashtruesve të ankesave."[128]

185. Shkeljet e nenit 3 të KEDNJ-së mund të gjenden në lidhje me zhdukjet, në të cilat shteti u gjet të jetë përgjegjës për rrëmbimet. Megjithatë, meqë UNMIK-u nuk është i implikuar në asnjë mënyrë në zhdukjen aktuale, UNMIK-u nuk mund të jetë përgjegjës për shqetësimin mental të parashtruesit të ankesës të shkaktuar nga kryerja e krimit.

186. Paneli rikujtoi "që sjellja e autoriteteve, megjithëse neglizhente deri në shkallën që e ka shkelur nenin 2 në aspektin e vet procedural, mund t'i ketë shkaktuar vetvetiu shqetësim mental parashtruesit të ankesës, më shumë sesa niveli minimal i ashpërsisë, i cili është i nevojshëm me qëllim që të konsiderohet që trajtimi bie brenda fushës së nenit 3."[129]

Çështjet që çuan te gjetja e shkeljes apo mosshkeljes të nenit 3

187. Gjatë vlerësimit nëse dispozitat esenciale të nenit 3 ishin shkelur, Paneli konsideroi afërsinë e lidhjeve familjare në mes viktimës (ave) dhe ankuesit(ve), nëse ankuesi ishte dëshmitar i zhdukjes, nëse ai/ajo ishte në kontakt me autoritetet hetimore të UNMIK-ut në

[125] Shih *Jociq*, nr. 34/09, mendimi i 23 prillit të vitit 2013.
[126] *Ibid.* §§ 81.
[127] *Ibid.* §§ 114-117.
[128] *Ibid.*, § 108.
[129] *Ibid.*, § 111.

lidhje me këtë, periudhën kohore e cila kaloi në mes zhdukjes, gjetjes së mbetjeve mortore, identifikimit të tyre, dhe kthimin e tyre përfundimtar te familja, dhe në rast të një vonese të paarsyeshme – nëse është paraqitur ndonjë sqarim për atë nga UNMIK-u. Në një numër shumë të vogël të rasteve, Paneli gjeti shkelje të nenit 2 për sa i përket të gjithë ankuesve, por të nenit 3 vetëm për sa u përket disave prej tyre.[130] Në situatat kur Paneli nuk e gjeti ndonjë dëshmi që tregonte se autoritetet e UNMIK-ut ishin informuar apo në një mënyrë tjetër ishin vënë në dijeni për zhdukjen e pohuar, Paneli nuk gjeti shkelje të nenit 3, pasi ai nuk ishte bindur se me sjelljen e tyre autoritetet e UNMIK-ut shkaktuan apo në ndonjë mënyrë i kontribuuan shqetësimit mental të ankuesve.[131]

188. Çështjet e veçanta vijuese ishin nënvizuar nga Paneli:

- Paneli e mori plotësisht parasysh nëse ankuesit ishin mbajtur të informuar për procesin e hetimit, apo nëse ishin kontaktuar fare. Për shembull, në shumë raste ankuesit ishin lënë pas asnjë informatë, dhe disa nga ta madje kishin ndërmarrë hetimet e veta.[132]

- Po ashtu, Paneli e verifikoi nëse ankuesi ishte intervistuar nga policia, si palë e dëmtuar apo dëshmitar. Doli se në disa raste ata ishin kontaktuar me telefon dhe çfarë ata thanë ishte paraqitur pastaj pak a më shumë me saktësi në raportet policore, por në shumicën e rasteve deklaratat e tyre nuk ishin regjistruar zyrtarisht.[133]

D. Diskriminimi

189. Tensionet ndëretnike dhe diskriminimi kanë qenë të përhapura në Kosovë menjëherë pas konfliktit. Megjithatë, Paneli pranoi një numër shumë të kufizuar të ankesave të lidhura drejtpërdrejt me diskriminim, kryesisht nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë të Kosovës, në kontekst të ristrukturimit dhe/apo privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore (NSH). Megjithatë, Paneli gjithmonë ka qenë në dijeni për diskriminimin e mbuluar të drejtpërdrejt dhe jo të drejtpërdrejtë.

190. Nga ankesat në lidhje me privatizimin e NSH-ve doli se UNMIK-u e kishte krijuar një kornizë ligjore me sa duket të paanshme për të rregulluar shpërndarjen e 20% nga të ardhurat e privatizimit i cili, megjithatë, krijoi paevitueshëm pabarazi në mesin e punëtorëve në bazë të etnisë, për shkak të rrethanave pas konfliktit. Paneli theksoi që rregulla të caktuara – kryesisht kërkesa që një punëtor është dashur të ketë qenë duke punuar në NSH në kohën e privatizimit me qëllim të përfitimit nga shitja e saj, apo, alternativisht, kërkesa për ta provuar në gjykatë që pozita e tij apo saj e pafavorshme nuk ishte për shkak të diskriminimit – si dhe interpretimi i tyre praktik nga organet e privatizimit, dështuan t'i marrin parasysh nevojat specifike dhe situatën e cenueshme të atyre punëtorëve që u takonin komuniteteve joshumicë të cilët, për arsye sigurie,

[130] Shih *Spasiq dhe të tjerët*, nr. 221/09 *et al*, mendimi i 31 korrikut të vitit 2013, §§ 141-142; shih po ashtu *Vitosheviq dhe Majmareviq*, nr. 139/09 *et al*, mendimi i 23 janarit të vitit 2014, §§ 178-179.
[131] Shih *Joviçiq*, nr. 233/09, mendimi i 24 qershorit të vitit 2015, §§ 79-88.
[132] Shih, p.sh., *Jociq*, *ibid.*, § 120; *Llaziq*, nr. 261/09, mendimi i 27 shkurtit të vitit 2015, § 125.
[133] Shih *Jociq*, *ibid.*, § 122.

ishin të detyruar t'i lënë vendet e tyre të punës dhe të jetojnë të zhvendosur me qasje të kufizuar apo pa qasje në gjykatë. Në këto raste, Paneli gjeti se kërkesat strikte dëshmuese të kërkuara për ankuesit si PZHB, si dhe vlerësimi jokonsistent i dëshmisë nga AKM-ja dhe Dhoma e Posaçme rezultuan me përjashtimin jo të drejtë nga të ardhurat e privatizimit dhe përbënin indirekt apo *de facto* diskriminim për sa u përket të drejtave të ankuesve në pronë dhe qasjes në gjykatë.[134]

191. Çështja tjetër që doli nga ankesat në Panel ishte se UNMIK-u nuk kishte bërë përpjekje të mjaftueshme për të siguruar implementimin e legjislacionit antidiskriminues, të miratuar më 2004 për t'i përmbushur standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Ligji kundër Diskriminimit në Kosovë (LKD)[135] parashihte, në mesin e dispozitave të tjera, aplikimin e ndryshimit të peshës së dëshmisë në të gjitha pretendimet për diskriminim. Sipas këtij Ligji – po ashtu të përdorur nga Paneli në shqyrtimin e tij të ankesave rreth diskriminimit – kur një ankues paraqet fakte nga të cilat mund të supozohet *prima facie* që ka pasur diskriminim direkt apo indirekt, pesha i bie palës së paditur që ta përgënjeshtrojë diskriminimin.[136] Pavarësisht nga interpretimi ligjor i dhënë nga PSSP-ja që LKD do të zëvendësonte gjithë legjislacionin e mëparshëm, Panelit theksoi që një numër rastesh AKM-ja dhe Dhoma e Posaçme nuk e kishin zbatuar drejt rregullën mbi peshën e dëshmisë. Nuk e kishte marrë parasysh pa ndonjë sqarim adekuat dëshminë *prima facie* të ofruar nga ankuesit dhe dështoi ta zhvendosë peshën e dëshmisë tek i padituri, e cila rezultoi me lloj tjetër të diskriminimit kundër ankuesve.[137] Në rastin *Guga*, Paneli po ashtu theksoi që një lloj tjetër i diskriminimit kundër ankuesit, një ish-punëtor i etnisë egjiptiane, kishte rezultuar nga mospërputhjet e thella dhe të gjata në praktikën gjyqësore të Dhomës së Posaçme, e cila në rastet e tjera të privatizimit që përfshinin ish-punëtorët nga grupet e tjera minoritare në një situatë të ngjashme me të ankuesit, përfundimisht e kishte pranuar të drejtën e tyre në një pjesë nga të ardhurat.[138]

192. Lënda *N.M. dhe të tjerët*[139] sollën në vëmendjen e Panelit çështjen e margjinalizimit historik, duke përfshirë segregacionin sa i përket banimit, të romëve në Evropë, së bashku me çështjen e diskriminimit të shumëfishtë apo ndërsektorial të përjetuar nga ankuesit si PZHB, si pjesëtarë të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian (RAE) në Kosovë dhe, për ankueset ferma, si gra të vendosura në kampet për PZHB të kontaminuara me plumb në Mitrovicën veriore. Paneli vlerësoi krijimin e kampeve për PZHB-të RAE nga UNMIK-u menjëherë pas shkatërrimit të Lagjes së Romëve në qershor të vitit 1999 me qëllim që të akomodojë fluksin prej mijëra PZHB-ve RAE.

---

[134] Shih *Guga*, nr. 47/08, mendimi i 24 janarit të vitit 2014; *Ristiq*, nr. 319/09, mendimi i 30 majit të vitit 2014; dhe rasti i mëhershëm *Parliq*, nr. 01/07, mendimi i 18 qershorit të vitit 2010, §§ 55-57, në të cilin Paneli së pari e elaboroi konceptin e diskriminimit indirekt, por nuk e konsideroi të nevojshme të shqyrtojë ankesën sipas nenit 14 të KEDNJ-së përveç nenit 6 të KEDNJ-së.

[135] Ligji nr. 2004/03 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 shkurt 2004 dhe i nxjerrë nga PSSP-ja më 20 gusht 2004 (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2004/32 "Mbi nxjerrjen e Ligjit kundër Diskriminimit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës").

[136] Neni 8(1) i LKD-së.

[137] Shih *Guga*, nr. 47/08, mendimi i 24 janarit të vitit 2014, §§ 68-81; *Ristiq*, nr. 319/09, mendimi i 30 majit të vitit 2014, §§ 53 dhe 73-78.

[138] Shih *Guga*, *ibid.*, §§ 68-81 dhe 86-87.

[139] Shih *N.M. dhe të tjerët*, nr. 26/08, mendimi i 26 shkurtit të vitit 2016. Të gjeturat e Panelit në këtë rast janë përmbledhur në detaje më poshtë, E. Qasja në drejtësi.

Megjithatë, ai theksoi se një zgjidhje e tillë që paraqiste rrezik, synohej të jetë e përkohshme për shkak të afërsisë së kampeve me burimet e kontaminimit me plumb, zgjati për më shumë se dhjetë vjet dhe se gjatë kësaj kohe ankuesit ishin lënë pa ndihmë mjekësore.

193. Paneli gjeti se përgjigjja e UNMIK-ut ndaj situatës së ankuesve ishte e shoqëruar nga paragjykimi racor, siç po ashtu doli nga argumenti i paraqitur nga UNMIK-ut dhe i kundërshtuar me dëshmi shkencore, që krizat shëndetësore në kampe vinin nga mënyra-stili "jo i shëndetshëm" i jetesës i PZHB-ve RAE, apo argumenti që UNMIK-u nuk mund t'i zhvendoste ata në një vend alternativ, të sigurt që ishte "i pranueshëm" për të gjitha palët. Paneli theksoi që UNMIK-u e kishte, përveç obligimit për të mos diskriminuar, edhe obligimin për të shmangur shtrirjen e praktikave diskriminuese kundër komunitetit RAE nga autoritetet lokale në Kosovë. UNMIK-u, po ashtu, e kishte për obligim t'u ofrojë mbrojtje të veçantë ankuesve si PZHB dhe si pjesëtarë të komunitetit RAE, në një situatë veçanërisht të cenueshme. Paneli, po ashtu, potencoi dështimin e UNMIK-ut për të pasur një qëndrim për gjendjen duke pasur parasysh gjininë. Ai nuk mori parasysh se si kontaminimi nga plumbi po ndikonte ndryshe dhe joproporcionalisht në shëndetin dhe mirëqenien e grave RAE në kampe, e as që ndërmori veprimet e nevojshme korrigjuese, për shembull ofrimin e qasjes në kontroll të rregullt dhe përkujdesjes adekuate shëndetësore për gratë shtatzëna. Këto lëshime rezultuan me diskriminim shtesë direkt dhe indirekt kundër grave RAE, në shkelje të nenit 12 të KEDKG-së dhe Rekomandimit të përgjithshëm të Komitetit të KEDKG-së nr. 24.

E. Qasja në drejtësi

194. Kategoria tjetër e rëndësishme e ankesave të dorëzuara Panelit përfshin çështjet e lidhura me qasjen në drejtësi, sipas nenit 6 të GJEDNJ-së (d.m.th. e drejta në gjykim të drejtë, e drejta në gjykatë të pavarur dhe të paanshme, etj.). Në shumicën e këtyre rasteve, ankuesit deklaruan se ata kishin një lloj të të drejtave pronësore deri në qershor të vitit 1999, kur ata u detyruan të largohen nga Kosova dhe u bënë të zhvendosur së brendshmi.

195. Pas arritjes së UNMIK-ut në Kosovë, Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB) dhe Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB) u themeluan nga UNMIK-u.[140] Mandati i DÇPB-së ishte që t'i rregullojë të drejtat pronësore dhe banesore në Kosovë. KKPB ishte një organ i pavarur i DÇPB-së përgjegjës për zgjidhjen e kontesteve lidhur me pronën rezidenciale që i referohen atij nga DÇPB-ja, derisa PSSP-ja vendosi se gjykatat lokale ishin në gjendje t'i kryejnë këto funksione.

196. Çështja nëse neni 6 i KEDNJ-së vlen për KKPB ishte shqyrtuar nga Paneli jo gjatë pas fillimit të tij. Në lëndën *Vuçkoviq*, Paneli përfundoi se megjithëse KKPB nuk ishte një gjykatë klasike, ai ishte një organ për trajtimin e pjesës më të madhe të kërkesave, i

[140] Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/23 "Mbi Themelimin e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore", 15 nëntor 1999.

cili pas një procesi adversarial nxori vendime detyruese dhe obligueshme. Në këtë bazë, ai vendosi se KKPB-ja ishte i ligjshëm në funksion ashtu që neni 6 i GJEDNJ-së vlen për procedurat para tij.[141]

197. Në disa raste, Paneli po ashtu duhej ta përcaktonte nëse AKP-ja ia kishte mohuar ankuesit të drejtën e zbatimit të vendimit përfundimtar të KKPB-së, në shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. Në rastin *Vuliq*, prona e paluajtshme e ankuesit në Komunën e Klinës ishte uzurpuar pas armiqësive që shpërthyen. Më 16 nëntor 2006, KKPB miratoi një vendim në favor të vënies nën riposedim nga ana e tij. Kaluan më shumë se dy vjet e shtatë muaj para se vendimi të zbatohej suksesshëm dhe ankuesi ta marrë në posedim pronën e tij. Ankuesi i kishte kontribuar, deri në një shkallë, vonesës duke mos i marrë çelësat e pronës dhe duke mos i ndjekur procedurat standarde operuese të AKP-së. Në këtë mënyrë, ankuesi ia kaloi obligimin policisë për të kryer dëbimin. Megjithatë, policia tregoi se ishte AKP-ja e cila duhet të veprojë për kërkesën për dëbim. Si rezultat, ankuesi në esencë e kishte vënë veten në një situatë ku as AKP-ja e as policia nuk u paraqitën si përgjegjëse për ekzekutimin e dëbimit.[142]

198. Në rastin *Kushiq*, Paneli po ashtu duhej ta përcaktonte nëse ekzekutimi i pazbatuar i vendimit të KKPB-së për më shumë se nëntë vjet e kishte shkelur të drejtën për ekzekutim të një vendimi brenda një kohe të arsyeshme, në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së. UNMIK-u nuk paraqiti ndonjë argument bindës se pse kishte ndodhur kjo vonesë. Prandaj, ankuesja u përball me pasiguri gjatë pritjes së papërcaktuar.[143]

F. Të drejtat ekonomike dhe sociale

199. Pasi KNDESK-ja ishte përfshirë në instrumentet ndërkombëtare që përbënin ligjin e aplikueshëm të Panelit, Paneli shqyrtoi ankesat nga pensionistët, punëtorët dhe të kthyerit në bazë të saj. Ai shqyrtoi tri raste të shkeljes së pretenduar të së drejtës për të qenë i mbrojtur nga rreziqet dhe pasiguritë sociale siç janë mosha e shtyrë, papunësia dhe kthimi, madje edhe në kohën e kufizimeve të burimeve apo ristrukturimit të ekonomisë.

200. Në rastin *Krasniqi*[144], Paneli vlerësoi përpjekjet e bëra nga UNMIK-u për të zgjidhur situatën e atyre pensionistëve, të cilin kishin kontribuuar dhe fituar të drejtat në pension në kuadër të skemës pensionale të ish-Jugosllavisë dhe pensionet e tyre ishin ndërprerë nga autoritetet e Beogradit si pasojë e konfliktit. Paneli e pranoi që, duke krijuar një sistem të ri pensional sipas sistemit ligjor të Kosovës, UNMIK-u përmbushi një pjesë të obligimeve të veta sipas KNDESK-së. Megjithatë, nga pikëpamja e të qenit adekuat të pensioneve të Kosovës Paneli konsideroi, në përputhje me shqetësimet e shprehura nga Komiteti i OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, dhe duke marrë në konsideratë nevojat dhe cenueshmërinë e veçantë të personave të vjetër, se pensioni mujor prej 45 eurosh që i ishte ofruar ankuesit gjatë

[141] Shih *Vuçkoviq*, nr. 03/07, mendimi i 13 marsit të vitit 2010, § 34.
[142] Shih *Vuliq*, nr. 05/07, mendimi i 18 marsit të vitit 2011, § 59.
[143] Shih *Kushiq*, nr. 08/07, mendimi i 15 majit të vitit 2010, § 65.
[144] Shih *Krasniqi*, nr. 08/10, mendimi i 17 majit të vitit 2016.

juridiksionit të Panelit, nuk ishte i mjaftueshëm për t'ia garantuar atij qasjen në shërbimet dhe të mirat esenciale themelore (neni 9 i KNDESK-së).

201. Në rastin e punëtorëve të Kombinatit Trepça, Miniera e Kishnicës,[145] të cilët kishin mbetur tepricë teknologjike nga mbyllja e minierave pas arritjes së UNMIK-ut, Paneli riafirmoi parimin që autoritetet shtetërore e kanë për obligim sipas Konventës të rregullojnë me ligj dhe mbikëqyrin sigurimin e përfitimit të sigurimeve sociale. Në rastin specifik para tij, lidhur me një grup të punëtorëve që nuk kishin marrë pagesat për tepricë që u ishin ofruar punëtorëve të tjerë joaktivë të Trepçës, Paneli gjeti se dështimi i UNMIK-ut për të krijuar një bazë të qartë ligjore për, dhe monitorimin e implementimit të, sistemin e pagesave rezultoi, siç është thënë më vonë nga Zyra e Auditorit Gjeneral të Kosovës, në përjashtim jo të drejtë të ankuesve në shkelje të së drejtës së tyre në sigurim social. Në të dy rastet e përmendura më lart, Paneli përfundoi që, pasi ankuesit ishin lënë pa mjete adekuate për të mbajtur veten dhe familjet e tyre, e drejta e tyre për standard adekuat të jetesës (neni 11 i KNDESK-së) ishte shkelur gjithashtu.

202. Në rastin *B.K.*, lidhur me riatdhesimin e detyruar të ankuesit në Kosovë në vitin 2008, pasi ai kishte jetuar dhe punuar për 23 vjet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Paneli gjeti se dështimi i UNMIK-ut për të implementuar një politikë të ripranimit për të siguruar kthim të sigurt dhe me dinjitet të të gjithë të kthyerve, veçanërisht më të cenueshmëve, dhe mungesa e ndonjë ndihme për t'ia ofruar ankuesit, i prekur nga një gjendje shëndetësore që nga lindja, e kishte vendosur atë në një situatë të varfërisë dhe nevojës ekstreme. Kjo ishte e papajtueshme me dinjitetin njerëzor, e cila përbënte një shkelje të obligimeve minimale bazike të UNMIK-ut sipas neneve 9 dhe 11 të KNDESK-së, si dhe shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së.[146]

G. Dhuna ndaj grave

203. Pasi KEDKG-ja është përfshirë në instrumentet ndërkombëtare që përbëjnë ligjin e aplikueshëm të Panelit, Paneli i shqyrtoi ankesat në bazë të saj.

204. Vetëm disa raste që i janë dorëzuar Panelit tregonin për shfaqje të dhunës seksuale dhe dhunës ndaj grave, megjithëse Paneli ishte në dijeni të rasteve të saj të shpeshta gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë.

205. Në dy raste që përfshinin ankesa dhe viktima të shumta, Paneli gjeti se UNMIK-u nuk ushtroi kujdesin e duhur në hetimin e dhunës kundër grave dhe tregoi se dështimi i tij për të kryer hetime të ndjeshme për sa i përket gjinisë, mund t'i ketë kontribuuar mungesës së përgjithshme të dokumentacionit për dhunën seksuale që ndërlidhet me konfliktin në Kosovë dhe pengoi qasjen në drejtësi nga, dhe dëmshpërblimet për, viktimat. Në rastin e një sulmi të UÇK-së në korrik të vitit 1998 në Rahovec dhe fshatrat përreth, ku gra civile ishin ndarë nga burrat dhe ilegalisht ishin mbajtur për disa ditë, Paneli përdori nenin 5 (e drejta në liri) të KEDNJ-së për të përfshirë një

[145] Shih *Punëtorët e minierave Kishnicë dhe Novobërdë të Kombinatit Trepça*, nr. 81/10, mendimi i 18 majit të vitit 2016.
[146] Shih *B.K.*, nr. 85/10, mendimi i 13 nëntorit të vitit 2015, § 52.

obligim procedural. Ai pohoi një obligim të autoriteteve relevante-këtu Policisë së UNMIK-ut- për të hetuar mbajtjen në paraburgim nga aktorët joshtetërorë në situatat ku ka mundësi që të ketë ndodhur dhunë seksuale. Për ta bërë këtë, Paneli iu referua jurisprudencës së KDNJ-së që një obligim pozitiv ekziston sipas nenit 9 të KNDCP-së *vis-à-vis* mbajtjes arbitrare të grave gjatë konfliktit të armatosur, i cili i bën ato veçanërisht të ekspozuara ndaj dhunës seksuale. Ai, po ashtu, u bazua në instrumentet ndërkombëtare[147] që e kualifikojnë mbajtjen arbitrare të grave si një formë të dhunës kundër grave që shtetet e kanë për obligim ta parandalojnë, hetojnë dhe dënojnë, pavarësisht nëse është shkaktuar nga agjentët e shtetit apo personat privatë.[148]

206. Në rastin *S.M.*, Paneli, në pajtim me jurisprudencën e GJEDNJ-së, Komitetit të OKB-së Kundër Torturës dhe Komitetit për KEDKG-në, konstatoi se përdhunimi dhe vrasja nga ana e UÇK-së në qershor të vitit 999 të një gruaje me paaftësi, në prani të nënës së saj, përbënte një akt të torturës si dhe dhunë seksuale të bazuar në gjini. Prandaj, UNMIK-u i kishte shkelur obligimet e veta ndërkombëtare për të hetuar kujdesshëm dhe në aspektin penal çështjen.[149]

207. Përveç dhunës në lidhje me konfliktin, në rastin e *N.M. dhe të tjerët* lidhur me vendosjen e PZHB-ve RAE nga UNMIK-u në kampet e kontaminuara me plumb, Paneli identifikoi se krijimi i kushteve për vetabortim nga PZHB-të femra të cilat frikësoheshin se do t'i lindnin foshnjat e tyre të prekura me të anomali, ishte po ashtu një formë e dhunës e bazuar në gjini dhe një manifestim i diskriminimit të bazuar në gjini,[150] nga i cili UNMIK-u ka dështuar t'i mbrojë gratë.[151]

H. Helmimi nga plumbi në kampet për PZHB

208. Mendimi në rastin *N.M. dhe të tjerët*, të cilin Paneli e miratoi më 26 shkurt 2016, ishte njëri nga mendimet më të rëndësishme gjatë gjithë ekzistimit të Panelit, dhe si i tillë, meriton më shumë analizë. Ankues ishin 138 anëtarë të komunitetit RAE në Kosovë. Gjatë konfliktit të vitit 1999 në Kosovë, shumë romë të cilët më parë kishin jetuar në vendbanimin Lagja e Romëve në Mitrovicën jugore, u larguan në Mitrovicën veriore si rezultat i dhunës ndëretnike dhe shkatërrimit të shtëpive të tyre. Përafërsisht 600 romë ishin vendosur në kampet për PZHB (Zhikoc, Cesminluke, Kablare, Leposaviq, dhe Osterode) afërt Shkritores Trepça dhe vendet e saj u shfrytëzuan për t'i lënë mbeturinat nga miniera. Shkritorja e Trepçës, prodhuesi më i madh i zinkut dhe plumbit në ish-Jugosllavi, me përafërsisht 15,000 punëtorë të punësuar në vitin 1999, nxori metale, duke përfshirë plumbin, nga produktet e minierave në afërsi nga vitet 1930-ta deri më 1999.

209. Përafërsisht gjysma e ankuesve ishin fëmijë. Rreth 75 ankues janë gra dhe vajza. Së paku 13 nga to i kanë lindur foshnjat në kampe dhe kanë paraqitur ankesë, po ashtu, në

[147] Shih Rekomandimi i përgjithshëm i Komitetit të KEDKG-së nr. 19 mbi dhunën kundër grave, A/47/38, 1992; Rezoluta e AP të OKB-së 48/104, Deklarata mbi eliminimin e dhunës kundër grave, 20 dhjetor 1993.
[148] Shih *Kostiq dhe të tjerët*, nr. 111/09 *et al*, mendimi i 23 tetorit të vitit 2015, §§ 322-334.
[149] Shih *S.M.*, nr. 342/09, mendimi i 18 marsit të vitit 2016, §§ 134-141 dhe 148-149.
[150] Shih Rekomandimi i përgjithshëm i Komitetit të KEDKG-së nr. 19 mbi dhunën kundër grave, A/47/38, 1992.
[151] Shih *N.M. dhe të tjerët*, nr. 26/08, mendimi i 26 shkurtit të vitit 2016, § 327.

emër të fëmijëve të tyre. Të gjithë ankuesit pohojnë të kenë vuajtur nga helmimi me plumb dhe më pas problemet shëndetësore të shkaktuara nga kontaminimi në lokacionet e kampit, për shkak të afërsisë së tyre me Shkritoren Trepça dhe kompleksin e minierave dhe për shkak të higjienës dhe kushteve jetësore në përgjithësi të këqija në kampe. Katër ankues theksuan se anëtarët e tyre të familjes vdiqën në kampe si rezultat i helmimit nga plumbi.

210. Ankuesit pohuan se UNMIK-u shkeli të drejtat e tyre të njeriut duke i vendosur ata në kampe për PZHB-të në vendin e njohur si të kontaminuar, duke mos u ofruar atyre informata në kohë rreth rreziqeve për shëndetin apo trajtimin e kërkuar mjekësor, si dhe duke dështuar për t'i zhvendosur ata në një vend të sigurt.

E drejta në jetë

211. Paneli theksoi obligimin pozitiv të shtetit për të ndërmarrë hapa të duhur për t'i mbrojtur jetët e atyre nën juridiksionin e tyre, me vëmendje të veçantë në personat vendës të cilët, për shkak të situatave të tyre specifike, sikur varfëria ekstreme apo përjashtimi, gjenden në mesin e më të cenueshmëve në shoqëri.

212. Paneli konsideroi se të dhënat treguan që ekspozimi i rëndë në kontaminim, i kombinuar me kushte të rënda të jetesës në kampe, të cilat zgjatën për më shumë se dhjetë vjet, tri nga to nën juridiksionin e Panelit, paraqisnin kërcënim real dhe të drejtpërdrejtë për jetën dhe integritetin fizik të ankuesve. Në vakuumin rregullues dhe institucional në Kosovë pas konfliktit, të gjeturat dhe rekomandimet e ekspertëve të OBSH-së si dhe organeve tjera të specializuara, duhet të kenë informuar për veprimet e UNMIK-ut në përgjigje ndaj krizës shëndetësore në kampe.

213. GJEDNJ-ja ka vendosur që obligimet pozitive sipas nenit 2 të KEDNJ-së në kontekst të aktiviteteve të rrezikshme dhe çështjeve ambientale, përfshijnë obligimin e autoriteteve kompetente që të sigurojnë qasje në informata esenciale, që u mundësojnë individëve të vlerësojnë rrezikun për shëndetin dhe jetët e tyre. Nga dokumentacioni në posedim të tij, Panel gjykoi që UNMIK-u nuk u ofroi informata adekuate ankuesve në lidhje me rreziqet për shëndetin dhe jetët e tyre që rrjedhin nga prania e tyre e përhershme në kampe.

Ndalimi i torturës dhe trajtimit jonjerëzor dhe degradues

214. Paneli nuk e nënvlerëson barrën me të cilën UNMIK-u duhej të përballej menjëherë pas arritjes së tij në Kosovë pas konfliktit dhe vlerëson përpjekjet e tij për rindërtim. Megjithatë, Paneli nuk e përjashton përgjegjësinë e UNMIK-ut ndaj ankuesve, veçanërisht kur merret parasysh se situata për të cilën bëhet ankesë, zgjati për më shumë se dhjetë vjet.

215. Paneli nuk mund ta pranojë as argumentimin se romët historikisht jetuan në kushte jetese nën standarde, një argument që tregon që margjinalizimi social dhe ekonomik i romëve bazohet në racë dhe në vetë veprimet e tyre, dhe si i tillë, mund të përjetësohet pa përgjegjësi. Margjinalizimi i romëve dhe përvojat traumatike të cilat i çuan ata te

statusi i tyre si PZHB në Kosovë, i bënë ankuesit veçanërisht të cenueshëm ndaj trajtimit jonjerëzor dhe degradues dhe UNMIK-un gjithashtu përgjegjës për mirëqenien e tyre.

E drejta për të respektuar jetën private dhe familjare

216. Mungesa e qasjes në informata relevante ndikoi negativisht në të drejtat reprodukuese të grave në kampe, në veçanti grave shtatzëna, siç janë ato të cilat thuhet se kishin vetabortim apo dështim si pasojë e helmimit me plumb. Ndikimet e tjera, siç janë çështjet politike dhe të sigurisë apo kufizimet ekonomike, janë paraqitur nga UNMIK-u për të justifikuar dështimin e vet që të ndërmarrë veprime të caktuara me qëllim të mbrojtjes së ankuesve nga rreziqet e ambientit, të cilave ata u ishin ekspozuar.

217. Për sa i përket vendosjes së ankuesve, Paneli i pranoi përpjekjet e UNMIK-ut për t'i akomoduar ankuesit, por konsideroi se nuk është paraqitur asnjë provë e mjaftueshme për të dëshmuar se vendosja e ankuesve në një zonë të sigurt ishte penguar nga vështirësitë e tjera emergjente që e bënë atë ngarkesë joproporcionale. Prandaj, Paneli konsideron se UNMIK-u nuk arriti të krijojë një balancë të drejtë në mes interesave të komunitetit dhe gëzimit nga ana e ankuesve të të drejtave të tyre për t'iu respektuar jeta private dhe familjare.

E drejta në shëndet dhe standard adekuat të jetesës

218. UNMIK-u dështoi të bëjë monitorim sistematik të kontaminimit nga plumbi në kampe, përmes testeve të rregullta të gjakut dhe ai ofroi terapinë e duhur për një kohë të kufizuar dhe vetëm disa njerëzve. Pas tetorit të vitit 2007, PZHB-të ishin lënë pa trajtim mjekësor që lufton efektet e helmimit nga plumbi. UNMIK-u nuk ndërmori të gjithë hapat e duhur drejt realizimit progresiv të të drejtës së ankuesve në shëndet në periudhën në kuadër të juridiksionit të vet.

219. Paneli është i shqetësuar që përgjigja joadekuate e UNMIK-ut ndaj krizës mund të jetë nxitur nga stereotipat diskriminues më parë sesa nga dëshmia shkencore, pasi kjo e fundit ka treguar që afërsia me Shkritoren e Trepçës dhe digat me mbetje paraqiste burimin kryesor të kontaminimit me plumb. Duke pasur parasysh të gjeturat, Paneli e konsideroi të turpshme që një e dhënë e tillë i atribuohet veprimit dhe/apo mosveprimit të një entiteti të Organizatës së Kombeve të Bashkuara – UNMIK-ut – në thelb të mandatit të të cilit ishte mbrojtja e personave të shpërngulur nga konflikti.

Diskriminimi shtesë kundër ankueseve femra

220. Paneli i kishte parasysh raportet dhe materialin tjetër, që ofrojnë dëshmi se gratë rome ka të ngjarë që historikisht kanë përjetuar diskriminim të shumëfishtë. Në këtë rast, ai konsideroi se ka pak hapësirë për dyshim se *de facto* ankueset femra ishin prekur gjithashtu dhe në mënyrë joproporcionale nga gjendja jashtëzakonisht jo e shëndetshme në kampe. Që nga ditët e veta të para, UNMIK-u ishte në dijeni për rreziqet e larta për shëndetin të shkaktuara nga helmimi me plumb për gratë shtatzëna dhe fëmijët.

221. Në këto rrethana, UNMIK-u e kishte obligimin sipas KEDKG-së që të miratojë masa pozitive për t'iu përgjigjur në mënyrë adekuate situatës veçanërisht të pafavorshme të ankueseve femra. Këto përfshinin obligimin për të siguruar që gratë shtatzëna të mund të mbajnë shtatzëninë e tyre në një ambient të sigurt, për të siguruar qasje të lehtë në kontroll të rregullt dhe përkujdesje adekuate shëndetësore, qasje adekuate në higjienë dhe ushqim, mbledhje të të dhënave për lindjet e fryteve të vdekura dhe dështimet me qëllim të monitorimit, sigurimit të shërbimeve psikologjike dhe mbështetëse për ato gra që kanë pasur dështim, abort apo lindje të frytit të vdekur.

Të drejtat e fëmijëve

222. Në fund, pasi KDF-ja është përfshirë po ashtu në instrumentet ndërkombëtare që përbëjnë ligjin e aplikueshëm të Panelit, Paneli e shqyrtoi situatën në bazë të saj.

223. Paneli i konsideron të pamjaftueshme dhe joadekuate veprimet e ndërmarra nga UNMIK-u për të përmbushur obligimin e vet sipas KDF-së. Jetët dhe shëndeti i fëmijëve është dashur të jenë të një konsiderate thelbësore që do t'i printe përgjigjes së UNMIK-ut ndaj situatës. Megjithatë, Paneli thekson se UNMIK-u nuk sqaroi se si interesat më të mira të fëmijëve ishin konsideruar, vlerësuar dhe përcaktuar kur janë vendosur dhe miratuar masa në përgjigje ndaj situatës në kampe.

224. Si pasojë, Paneli konstatoi se, përmes veprimeve dhe lëshimeve të veta, UNMIK-u ishte përgjegjës për rrezikimin në mënyrë të pakthyeshme të jetës, shëndetit, dhe potencialit zhvillimor të fëmijëve që kanë lindur dhe janë rritur në kampe.

I. Lënda *Balaj dhe të tjerët*

225. Paneli duhej të vlerësonte një rast tjetër nëse UNMIK-u kishte shkelur obligimin esencial dhe obligimin procedural sipas nenit 2 të KEDNJ-së në lidhje me të drejtën për jetë. Në rastin *Balaj dhe të tjerët*, Policia e UNMIK-ut përdori forcë të tepruar gjatë një operacioni për kontroll të turmës në Kosovë më 17 shkurt 2007, duke rezultuar me vdekje të dy viktimave dhe plagë të rënda trupore të dy personave tjerë. Në pajtim me Udhëzimin Administrativ, Paneli e shpalli ankesën të papranueshme.

226. Megjithatë, Paneli e la derën të hapur kur theksoi në vendimin mbi papranueshmërinë se "nëse ankuesve u kërkohet ta riparaqesin një ankesë pas përfundimit të procesit të ankesave të palës së tretë të OKB-së, ata në çdo rast do të bien në kundërshtim me afatin e 31 marsit të vitit 2010 për dorëzimin e ankesave të reja. Kërkesa për të shkuar përmes procesit të ankesave të palës së tretë të OKB-së në atë rast, në fakt, nuk do ta lente mundësinë që ankuesit t'ia paraqesin ankesën Panelit, pavarësisht nga fakti që … ankesa ishte e pranueshme sipas kornizës rregulluese të aplikueshme në kohën që është dorëzuar. Një rezultat i tillë do t'i cenonte nocionet elementare të drejtësisë". Në vitin 2012, kur procesi i ankesave të palës së tretë përfundoi, Paneli vendosi, për shkak të vërejtjes së UNMIK-ut, se ankuesit mund të kërkojnë nga Paneli t'i rihapë procedurat pa afatin e fundit më 31 mars 2010 si pengesë për shqyrtim të

vazhdueshëm të ankesës së tyre.[152] Ankuesit e shfrytëzuan këtë mundësi, të cilën ankuesit e tjerë me ankesa paralele në procesin e ankesave të palës së tretë të OKB-së po ashtu do ta shfrytëzonin, dhe e bënë të njohur si *Rasti Balaj si përjashtim.*

227. Paneli konstatoi, e para, se në rrethanat e këtij rasti forca e përdorur për t'i shpërndarë demonstruesit, e cila shkaktoi vdekjen e z. Mon Balajt dhe z. Arben Xheladinit dhe plagosjen e dy të tjerëve, nuk ishte absolutisht e nevojshme në kuadër të kuptimit të nenit 2(2) të KEDNJ-së. Prandaj, ai konsideroi se ka pasur shkelje të obligimit esencial të nenit 2 të KEDNJ-së. Përveç kësaj, Paneli konstatoi se, megjithëse hetimi për rrethanat që çuan tek ato pasoja tragjike ishte i shpejtë, ai nuk dha garanci të mjaftueshme për pavarësi dhe paanësi dhe nuk përmbushi kërkesat për plotësi. Prandaj, Paneli përfundoi që UNMIK-u dështoi të kryejë hetim efektiv për çështjen, në shkelje të obligimit procedural të nenit 2 të KEDNJ-së.

228. Në fund, Paneli konsideroi se intervenimi me forcë i policëve ishte joproporcional dhe jo i nevojshëm në një shoqëri demokratike për parandalimin e trazirës, në shkelje të nenit 11(2) të KEDNJ-së.[153]

VIII. Vlerësimi i përvojës së PKDNJ-së

229. Është e rëndësishme të kuptohet konteksti në të cilin Paneli e gjeti veten në lidhje me UNMIK-un. Paneli e pranoi që situata në lidhje me UNMIK-un ishte, sipas fjalëve të UNMIK-ut, "*sui generis*", që është e llojit të vet. Si një mision i OKB-së që vepron duke u bazuar në mandatin e KS të OKB-së, UNMIK-u nuk ishte saktësisht një shtet, madje edhe nëse ushtronte funksionet qeveritare mbi një territor me status të papërcaktuar. Veç kësaj, kur UNMIK-u hyri në Kosovë dhe filloi ushtrimin e autoritetit të vet, dhuna ishte endemike dhe strukturat e shtetit-sistemi ligjor dhe gjyqësor, organet për zbatimin e ligjit, të sigurisë- ishin shkatërruar të gjitha. Vakuumi që pasoi duhej të plotësohej dhe institucionet të rindërtoheshin. Prandaj, Paneli duhej të gjente mënyrën e duhur për t'i marrë parasysh vështirësitë dhe sfidat me të cilat përballej UNMIK-u, pa lejuar uljen e standardeve të të drejtave të njeriut.

230. Perspektiva e Panelit rreth asaj se si UNMIK-ut e kreu vetë punën në kontekste të ndryshme, për shembull, lidhur me hetimet e ndërmarra nga Policia e UNMIK-ut dhe prokurorët ndërkombëtarë në rastet për PZHV, ka evoluar me kalimin e kohës, pasi Paneli e kishte mundësinë të vlerësojë më shumë nga materialet hetimore. Në mënyrë specifike, ndodhi që vetëm përmes shqyrtimit të dosjeve hetimore në shumë raste për PZHV-të, Paneli filloi t'i kuptojë dështimet e përgjithshme sistemore në kuadër të UNMIK-ut dhe organeve për zbatimin e ligjit në atë kohë. Pasi Paneli u njoh më shumë me materialin, qasja e tij ndaj dështimeve të UNMIK-ut u bë më e qartë, që mund të shihet përmes evoluimit në mendimet e Panelit për PZHV-të.

[152] Shih *Balaj dhe të tjerët*, nr. 04/07, vendimi i 11 majit të vitit 2012, § 53.
[153] Shih *ibid.*, mendimi i 27 shkurtit të vitit 2015, §§ 188-190, 202-221 dhe 248-268.

231. Paneli miratoi 335 mendime mbi bazueshmërinë, ku gjeti shkelje të të drejtave të njeriut që i atribuohen UNMIK-ut dhe konsideroi se rekomandimet dhe një formë e dëmshpërblimit ishin të nevojshme.

232. Paneli e konsideronte problematike të vendosë se çfarë rekomandimesh ai duhet të bëjë në një situatë ku UNMIK-u nuk ishte më në gjendje të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në vendimet dhe politikat që bëheshin në Kosovë. Siç është theksuar më parë, UNMIK-u nuk kishte më mundësi të ndryshojë legjislacionin sipas nevojës (apo në çfarëdo rasti, dhe madje edhe nëse e kishte ndryshuar legjislacionin relevant ai nuk kishte mundësi më të sigurojë zbatimin), e as që mund t'i urdhëronte autoritetet e Kosovës apo EULEX-in që t'i korrigjojnë të metat e tjera të identifikuara nga Paneli. Paneli duhej të ishte i vetëdijshëm për kufizimet e tilla kur bënte rekomandime që do të kishin ndikim përfitues sa i përket gjendjes së të drejtave të njeriut të ankuesve të prekur.

233. Më poshtë është një përmbledhje e shkurtër e asaj se çfarë rekomandimesh Paneli ia ka bërë UNMIK-ut në kategori të veçanta të rasteve, ku Paneli konstatoi se UNMIK-u kishte kryer shumicën e shkeljeve të të drejtave të njeriut nga ana e tij, në mënyrë specifike lëndët "14k", lëndët për PZHV-të dhe disa lëndë tjera të rëndësishme.

A. Rekomandimet e Panelit

Lëndët pronësore

234. Në lëndët "14k" ku ishin gjetur shkelje, Paneli rekomandoi që UNMIK-u duhet bërë përpjekje, me të gjitha mjetet diplomatike në dispozicion të tij *vis-à-vis* autoriteteve të Kosovës, të marrë siguri që lëndët e paraqitura nga ankuesit do të shqyrtohen si duhet. UNMIK-u u pajtua në çdo rast, para së gjithash duke i dërguar EULEX-it një letër *pro forma* dhe kërkuar atij t'i monitorojë rastet. Kjo ilustron mosefektivitetin e Panelit që rrjedh nga themelimi i tij i vonë.

235. Paneli, po ashtu, rekomandoi që UNMIK-u t'iu japë kompensim adekuat secilit nga ankuesit për dëmin jomaterial të pësuar si rezultat i zgjatjes së procedurave të krijuara nga ta, por këtë rekomandim UNMIK-u nuk mund ta implementonte. Në të vërtetë, UNMIK-u u përgjigj vazhdimisht se ishte e pamundshme të paguhet kompensim i tillë në pajtim me Rezolutën e AP të OKB-së.

Lëndët për persona të zhdukur dhe të vrarë

236. Në 233 lëndët për PZHV Paneli gjeti se UNMIK-u kishte kryer shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së, në mënyrë specifike duke dështuar të kryejë hetim adekuat dhe efektiv për zhdukjen apo rrëmbimin dhe/apo vrasjen e të afërmve të ngushtë të ankuesve. Paneli mori një qëndrim më të gjerë për dëmshpërblimet dhe rekomandoi që UNMIK-u të marrë siguri nga EULEX-i që hetimet do të vazhdonin në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 2, obligimi procedural, që rrethanat që ndërlidhen me zhdukjen dhe vrasjen e viktimave do të tregohen dhe që autorët do të sillen para drejtësisë. Përveç kësaj, ankuesi dhe/apo më të afërmit, do të informohen për veprimet e tilla dhe dokumentet

relevante do t'u zbulohen atyre sipas nevojës. Paneli rekomandoi që UNMIK-u të pranojë publikisht, brenda një kohe të arsyeshme, përgjegjësinë për sa i përket dështimit të vet që të hetojë në mënyrë adekuate zhdukjen dhe vrasjen e viktimave dhe t'iu kërkojë falje publike ankuesve dhe familjeve të tyre në lidhje me këtë. Veç kësaj, Paneli rekomandoi që UNMIK-u t'i paguajë kompensim adekuat ankuesit për dëmin e shkaktuar jomaterial për shkak të dështimit të UNMIK-ut që të kryejë hetim efektiv.

237. Përveç kësaj, Paneli dha rekomandime në lidhje me sjelljen e OKB-së në të ardhmen. Ai rekomandoi që UNMIK-u të ndërmarrë hapa të duhur, përmes organizmave të tjerë të afërt me OKB-në që veprojnë në Kosovë, organeve lokale dhe OJQ-ve, për krijimin e një programi të plotë dhe gjithëpërfshirës dëmshpërblimi, duke përfshirë kthimin e kompensimit, rehabilitimin, përmbushjen dhe garancitë për mospërsëritje për viktimat nga të gjitha komunitetet që kanë qenë subjekt i shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut, të cilat ndodhën si pasojë e drejtpërdrejtë e konfliktit të Kosovës dhe gjatë tij.

238. Në fund, Paneli rekomandoi që UNMIK-u të ndërmarrë hapa të nevojshëm para organeve kompetente të OKB-së, duke përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, që të ndajë burime adekuate njerëzore dhe financiare për të siguruar që standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut mbështeten në çdo kohë nga OKB-ja, duke përfshirë kohën kur kryhen funksione administrative dhe ekzekutive mbi një territor, dhe të sigurojë monitorim efektiv dhe të pavarur. Prandaj, Paneli bëri rekomandime që i bëjnë thirrje UNMIK-ut të kërkojë zgjidhje sistemore për shkeljen e të drejtave të njeriut.

Lëndët e tjera të rëndësishme

239. Në lëndën *Balaj dhe të tjerët*, Paneli rekomandoi që UNMIK-u të ndërmarrë hapa të duhur për pagesën e kompensimit adekuat për ankuesit, për dëmin e shkaktuar jomaterial, për shkak të shkeljes nga ana e UNMIK-ut të neneve 2 dhe 11 të KEDNJ-së. Përveç kësaj, Paneli rekomandoi që, në rast se hetimi për këtë çështje rihapet, UNMIK-u të sigurojë se do t'i ofrohet e gjithë ndihma e nevojshme çdokujt me autoritet që të hetojë këtë çështje, në pajtim me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 66/93, e miratuar më 9 dhjetor 2011, mbi "Përgjegjësinë Penale të Zyrtarëve dhe Ekspertëve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Mision".

240. Në rastin *N.M. dhe të tjerët*, Paneli rekomandoi UNMIK-un që t'u kërkojë falje publike, duke përfshirë mediet, ankuesve dhe familjeve të tyre, për dështimin e vet për të vepruar në pajtim me standardet e aplikueshme për të drejtat e njeriut në përgjigje ndaj gjendjes së pafavorshme shëndetësore të shkaktuar nga kontaminimi me plumb në kampet për PZHB dhe dëmet pasuese që i përjetuan ankuesit. Veç kësaj, Paneli rekomandoi që UNMIK-u të ndërmarrë hapa të duhur drejt pagesës së kompensimit adekuat ankuesve për dëmin material dhe jomaterial në lidhje me gjetjen e shkeljeve të dispozitave për të drejtat e njeriut të përmendura në mendim. Rekomandim tjetër i Panelit ishte që UNMIK-u të ndërmarrë hapa të duhur për të siguruar që organet e OKB-së që punojnë me refugjatë dhe PZHB, të promovojnë dhe sigurojnë respektimin

e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe që të gjeturat dhe rekomandimet e Panelit në këtë rast të ndahen me organet e tilla, si një garanci për mospërsëritje. Paneli, po ashtu, rekomandoi që UNMIK-u t'i ndërmarrë hapat e duhur në organet e OKB-së për të siguruar shpërndarje efektive të informatave relevante për shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve nën autoritetin dhe kontrollin e tyre. Përveç kësaj, Paneli rekomandoi që UNMIK-u t'u kërkojë organeve të OKB-së dhe autoriteteve relevante në Kosovë që t'i mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e njeriut të popullatës rome, veçanërisht grave dhe fëmijëve.

B. Veprimi i UNMIK-ut

241. Deri më tani, dështimi më i madh në gjithë përvojën e PKDNJ-së ishte fakti që UNMIK-u nuk ndoqi rekomandimet e Panelit. Pavarësisht procesit të gjatë të Panelit për të mbledhur informata nga ankuesit dhe UNMIK-u, më pas marrjen e vendimeve mbi pranueshmërinë, mendimeve dhe rekomandimeve, në esencë asgjë e prekshme nuk doli nga gjithë ky aktivitet, pasi UNMIK-u dështoi të ndërmarrë veprim kuptimplotë në lidhje me rekomandimet e Panelit.

S'ka hetime të vazhdueshme

242. Në përgjigjen e tij ndaj njërit prej mendimeve të para të publikuara të Panelit për PZHV-të, *Paviq*[154], PSSP-ja sqaroi qasjen e tij ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut. Së pari, ai theksoi që do të vazhdojë t'i kërkojë EULEX-it dhe autoriteteve tjera kompetente të ndërmarrin të gjithë hapat për të siguruar që hetimet penale për zhdukjen dhe vrasjen e anëtarit të familjes të ankueses do të vazhdojnë dhe që autorët të sillen para drejtësisë. Paneli e kupton që PSSP-ja i dërgoi një letër EULEX-it në lidhje me këtë rast, dhe të gjitha rastet e tjera për PZHV, për t'iu kërkuar atyre t'i vazhdojnë hetimet.

243. Fillimisht, Paneli ishte plot shpresë se, duke u nxitur aq shumë nga PSSP-ja, EULEX-i do t'i rihapte këto hetime për PZHV-të. Mu kjo u pa të ndodhte: në vitin 2013, EULEX-i krijoi një Taskë Forcë, të udhëhequr nga një prokuror ndërkombëtar, i cili ishte i ngarkuar me shqyrtimin e këtyre hetimeve të papërfunduara për PZHV-të, me qëllim të dhënies së rekomandimeve prokurorëve të EULEX-it dhe policisë se si të vazhdojnë më tutje. Megjithatë, duke mos dëgjuar për asnjë rezultat të kësaj Task Force për më shumë se dy vjet, në vitin 2015 zyrtari ekzekutiv u lidh me përfaqësuesit nga EULEX-i, të cilët e sqaruan se si pjesë e juridiksioni të vet të zvogëluar, EULEX-i nuk do të rihapte ndonjërin nga rastet për PZHV-të, por në vend të kësaj ato do t'ua kalojë autoriteteve lokale. Deri me publikimin e këtij Raporti përfundimtar, Paneli nuk është në dijeni për ndonjë aktivitet tjetër hetimor të ndërmarrë nga EULEX-i apo autoritetet lokale lidhur me rastet për PZHV-të.

244. Bartja e juridiksionit për këto çështje tek autoritetet lokale është problematike për disa arsye, duke përfshirë atë se shumica e këtyre rasteve përfshinin viktimat serbë të

[154] Shih *Paviq*, nr. 98/09, mendimi i 26 prillit të vitit 2013, si dhe vendimin e PSSP-së të 24 korrikut të vitit 2013.

Kosovës, të cilët arsyeshëm ishin të shqetësuar për sigurinë e tyre kur ata qëllimisht i kishin sjell këto ankesa së pari tek UNMIK-u e më vonë te një Panel ndërkombëtar. Shumë nga ankuesit kanë kërkuar anonimitet.

245. Mungesa e vazhdueshme e hetimit për rastet për PZHV-të paraqet faktin që themelimi i Panelit erdhi tepër vonë, për të qenë në gjendje të ndikojë në veprimin e UNMIK-ut në lidhje me zbatimin e ligjit.

S'ka kërkimfalje publike

246. PSSP-ja u dërgoi një letër secilit nga ankuesit, duke thënë: "Unë shpreh keqardhje të thellë që mungoi hetimi efektiv për rrëmbimin dhe vdekjen e [të dashurit] tuaj, e cila u ka shkaktuar juve shqetësim dhe vuajtje mentale shtesë." Paneli e konsideroi këtë letër, të jetë e papranueshme, pa veprim konkret. Në Raportin e tij vjetor të vitit 2013, ai theksoi që "nëse letra e PSSP-së përfshinte deklarata të rëndësishme për të ndërmarrë veprim korrigjues për të provuar që të përmirësojë vuajtjen e ankuesit, atëherë kjo do të mund të përbënte një kërkimfalje kuptimplotë."[155]

247. Në Raportin e vet vjetor të vitit 2014, Paneli theksoi që "[p] ër sa i përket karakterit publik të kërkimfaljes, Paneli konstaton se kjo letër e vetme për ankuesin nuk paraqet një kërkimfalje publike, dhe nuk bëhet kërkimfalje publike vetëm duke e vendosur atë në faqen e internetit të Panelit në një format që nuk është lehtësisht i identifikueshëm, për personat që nuk janë të njohur me rastin specifik". Për këtë arsye, duke filluar nga tetori i vitit 2014, në rastet për PZHV-të ku Paneli ka konstatuar shkelje të të drejtave të njeriut që i atribuohen UNMIK-ut, rekomandimet e Panelit kanë përfshirë atë që PSSP-ja duhet "të pranojë publikisht, duke përfshirë mediet, dështimin e UNMIK-ut për të kryer hetim efektiv."[156]

248. Përveç kësaj, shumë ankues e konsideruan këtë kërkimfalje të jetë joadekuate. Në gazetën serbe *Vesti (Lajmet)*, në një tregim që kishte të bënte me reagimin publik në mendimin e Panelit në rastin *S.C.*, bashkërenduesi i Asociacionit të Familjeve të të Rrëmbyerve dhe të Zhdukurve në Kosovë dhe Metohi theksoi, "[t]ë gjithë pjesëtarët e familjeve të të rrëmbyerve dhe të zhdukurve janë të bindur se UNMIK-u nuk ka bërë absolutisht asgjë për t'i gjetur të dashurit tanë. Nëse UNMIK-u kërkon falje, si njerëz ne do ta vlerësonim atë, por tragjedia jonë nuk mund të harrohet me një kërkimfalje. Kërkimfalja e vetme është të hetohen krimet kundër të dashurve tanë."[157]

Asnjë kompensim nuk është paguar

249. Në lidhje me rekomandimin e përsëritur të Panelit që UNMIK-u të ndërmarrë hapa të duhur drejt krijimit të një programi të plotë dhe gjithëpërfshirës dëmshpërblimi, duke përfshirë kthimin e kompensimit, rehabilitimin dhe përmbushjen, PSSP-ja nxori një vendim duke thënë: "Në lidhje me këtë, unë dua ta rikujtoj se aktet në fjalë kanë të bëjnë me aktivitetet e ndërmarra nga institucionet e krijuara nën administrimin e

[155] Shih PKDNJ, *Raport Vjetor 2013*, §§ 97-104.
[156] Shih PKDNJ, *Raport Vjetor 2014*, §§ 73-74.
[157] "UNMIK-u mbylli sytë ndërsa UÇK-ja po vriste", *Vesti*, 7 mars 2013.

përkohshëm të Kosovës. Si të tilla, nëse UNMIK-u do të vazhdonte të ketë kontroll mbi këto institucione sot, UNMIK-u do të ishte në pozitë t'ua drejtojë rekomandimet e Panelit këtyre institucioneve për veprim të duhur. Unë jam i gatshëm të diskutoj mundësinë e krijimit të një mekanizmi që do të merrej me çështje të tilla me autoritetet relevante në momentin e duhur." Kjo e fundit nuk ka ndodhur kurrë. Fjalët e PSSP-së përbënin formulën përmes së cilës ai informonte ankuesit se nuk do të ketë kompensim të paguar nga UNMIK-u për shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e tij.

250. Në shtator të vitit 2013, AI nxori një raport të titulluar "Trashëgimia e UNMIK-ut në Kosovë: Dështimi për t'iu ofruar drejtësi dhe kompensime të afërmve të të rrëmbyerve", i cili dokumentoi faktet në përafërsisht njëzet prej mendimeve të para të Panelit për PZHV-të.[158] Raporti përputhej me të gjeturat e Panelit: "Amnesty International konsideron se në mes të qershorit të vitit 1999 dhe dhjetorit të vitit 2008 Policia dhe prokurorët ndërkombëtarë të UNMIK-ut, të cilët ishin të ngarkuar me hetimin e krimeve sipas të drejtës ndërkombëtare, dështuan të fillojnë hetime të shpejta, efektive, të pavarura, të paanshme dhe të plota për shumë, apo ndoshta madje shumicën e raporteve për zhdukje dhe rrëmbime me forcë." Raporti, po ashtu, nënvizon argumentet e UNMIK-ut që sqarojnë se, pse ai nuk u ka paguar kompensim ankuesve, të cilëve u ishin shkelur të drejtat e njeriut, në kundërshtim me rekomandimet e Panelit për UNMIK-un.

251. Raporti i AI-së e konsideroi qasjen e PSSP-së të papranueshme. "Ishte padyshim Policia e UNMIK-ut, më parë sesa autoritetet e Kosovës, që ishte e ngarkuar me përgjegjësinë për hetimin e rasteve të personave të zhdukur. Obligimi për të siguruar dëmshpërblim për dështimin për ta bërë këtë prandaj duhet të bie mbi UNMIK-un."[159] Në raport thuhet se kur AI-ja e pyeti UNMIK-un për këtë pikë, duke i kërkuar UNMIK-ut që t'i paguajë dëmshpërblimet, PSSP-ja tha: "është një fakt i pakundërshtueshëm se kapaciteti i UNMIK-ut për të paguar dëmet jomateriale nuk ekziston dhe [ajo] tani bie mbi autoritetet lokale të Kosovës që kanë marrë kontrollin ekskluziv mbi administratën publike në Kosovë". AI u përgjigj: "Amnesty International e konsideron këtë përgjigje…të përbëjë një përpjekje të pazakontë të UNMIK-ut për të mos pranuar përgjegjësinë e vet për shkeljet e shumë standardeve për të drejtat e njeriut, për të cilat ishte krijuar t'i mbështesë dhe respektojë."

252. Në Raportin vjetor të Panelit të vitit 2013, ai theksoi se nuk ishte e qartë pse kapaciteti i UNMIK-ut për t'i paguar dëmet jomateriale ka ndonjë lidhje me autoritetet lokale që kanë marrë kontrollin ekskluziv mbi administratën publike në Kosovë.[160] Meqë shkeljet e të drejtave të njeriut ishin bërë nga personeli i OKB-së, duhet të jetë përgjegjësi e OKB-së që të paguajë kompensim për këto shkelje. Komiteti i AP të OKB-së ngjashëm ia përkujtoi UNMIK-ut duke theksuar se: "[p]rej nëntorit të vitit

[158] AI, *Trashëgimia e UNMIK-ut në Kosovë: Dështimi për t'iu ofruar drejtësi dhe kompensime të afërmve të të rrëmbyerve*, 2013.
[159] *Ibid.*
[160] PKDNJ, *Raport Vjetor 2013*, §§ 36 dhe 100.

2013, UNMIK-u nuk ka ofruar kompensim për viktimat për shkeljet e të drejtave të njeriut siç rekomandohet nga Paneli …".[161]

253. Për sa i përket dëmit jomaterial, PSSP-ja dha një arsyetim shtesë për mospagesë: "[n]ë lidhje me rekomandimin e Panelit për t'iu dhënë kompensim adekuat ankuesve, Paneli është në dijeni se udhëzimet e Asamblesë aktuale të Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara nuk e lejojnë Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe misionet e saj të paguajnë kompensim përveç dëmit material apo dëmtimit fizik. Si pasojë, UNMIK-u nuk është në pozitë të paguajë kompensim për shkelje të të drejtave të njeriut që kanë mundur të ndodhin në këto raste. UNMIK-u do të vazhdojë të tërheqë vëmendjen e Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për nevojën që të shqyrtohen rregullat e tanishme të kompensimit, të cilat përjashtojnë kompensimin për dëmin jomaterial.[162]

254. Në maj të vitit 2015, PSSP-ja paralajmëroi KS të OKB-së për situatën në raportin e tij tremujor. Në raport theksohej: "[P]aneli ka rekomanduar vazhdimisht kompensim për dëmin moral. Megjithatë, rezolutat relevante të Asamblesë së Përgjithshme ndalojnë kompensimin nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për dëm joekonomik që rezulton nga operacionet paqeruajtëse. Megjithatë, në diskutimet e mia me bashkëbiseduesit tanë vendorë dhe ndërkombëtarë, unë kam përkrahur themelimin e një mekanizmi të përshtatshëm për të kompensuar për dëmet morale, si dhe për hetim të mëtejmë nga autoritetet përkatëse gjyqësore në rastet e papërfunduara."[163] PSSP-ja e përsëriti pikën e njëjtë afërsisht një vit më vonë se "asnjë progres nuk është bërë sa u përket rekomandimeve të Panelit në lidhje me pagesën e kompensimit adekuat për dëmet morale të përjetuara si rezultat i këtyre shkeljeve".[164]

255. Në përfundim të mandatit të Panelit, UNMIK-u mbetet po aq i papërgjegjshëm tani për shkeljen e të drejtave të njeriut siç ishte në vitin 2004, kur Komisioni i Venedikut propozoi krijimin e një mekanizmi për të mbikëqyrur respektimin nga ana e UNMIK-ut të standardeve për të drejtat e njeriut. Për shkak të dështimit të UNMIK-ut për t'i ndjekur rekomandimet e Panelit, procesi i PKDNJ-së nuk ka ofruar asnjë kompensim për ankuesit. Në esencë, ata janë viktimizuar dy herë nga UNMIK-u: nga shkeljet e hershme të të drejtave të njeriut të kryera kundër tyre dhe përsëri nga mosmarrja e kompensimit në këtë proces. Për shumë vjet, Paneli ka bërë analizë të detajuar të ankesave të sjella para tij dhe e ka nxitur UNMIK-un dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara të përfshihen në disa aktivitete të dobishme në interes të ankuesve para se të përfundohet mandati i PKDNJ-së; por kjo nuk ka ndodhur. Nuk është formuar as Gjykata për të Drejtat e Njeriut e paraparë nga Komisioni i Venedikut.

---

[161] Shih Komiteti i AP të KiE-së mbi Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut (Raportues: z. José María Beneyto), Raport mbi "Përgjegjësinë e Organizatave Ndërkombëtare për Shkeljet e të Drejtave të Njeriut", Dok. 13370, 17 dhjetor 2013, § 59.

[162] PSSP-ja i referohej Rezolutës së AP të OKB-së 52/247 mbi "Përgjegjësinë e palëve të treta: Kompensimi kohor dhe financiar" të 17 korrikut të vitit 1998.

[163] KS i OKB-së, Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë i 30 korrikut të vitit 2015, S/2015/579.

[164] KS i OKB-së, Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë i 1 shkurtit të vitit 2016, S/2016/99.

C. Kufizimet tjera

256. Paneli është i vetëdijshëm se puna e tij ishte kufizuar nga një numër faktorësh, shumica e të cilëve janë përmendur më parë, që kanë të bëjnë me mënyrën në të cilën është themeluar Paneli dhe nga kufizimet e vendosura nga UNMIK-u në juridiksionin e tij që nga fillimi. Operacionet e Panelit janë vështirësuar nga Urdhëresa Administrative, në mënyrë specifike kërkesa që Paneli duhej të merrte vendime mbi të gjitha çështjet e pranueshmërisë para se të merrej parasysh bazueshmëria, data e fundit arbitrare e juridiksionit 31 marsi i vitit 2010 dhe kërkesa e re që ankuesit duhej të kishin përfunduar procesin e ankesave të palës së tretë të OKB-së, para se ta dorëzonin ankesën e tyre në Panel. Këto kufizime nënkuptonin që ose Paneli kurrë nuk pranoi ankesa për disa çështje, apo se ai duhej t'i gjente ankesat të jenë të pranueshme ashtu që të mund të shqyrtojë përmbajtjen e pretendimeve, madje edhe kur ai ndiente se ishte fjala për të drejtat e njeriut.

Themelimi i Panelit

257. Marrëdhënia në mes Panelit dhe UNMIK-ut – dhe më gjerësisht Organizatës së Kombeve të Bashkuara në përgjithësi – ishte në mënyrë kruciale e dëmtuar që nga fillimi. Paneli është formuar tepër vonë. Madje edhe po të niste koncepti për Panelin nga aktivitetet në fund të vitit 2004 që përfundimisht çuan te Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, kjo ishte më shumë se pesë vjet pasi UNMIK-u ishte mandatuar të veprojë si autoritet ekzekutiv në Kosovë në pajtim me Rezolutën e KS të OKB-së 1244. Veç kësaj, pasi Paneli ishte themeluar dhe kishte filluar punën e vet, UNMIK-u nga qershori i vitit 2008 filloi të zvogëlojë operacionin e vet, që u dëshmua kundërproduktive për ta bërë Panelin plotësisht funksional.[165] Me sa duket ka të ngjarë që kishte pak vlerësim në kuadër të UNMIK-ut se për çfarë organizimi Paneli kishte nevojë apo kërkonte.

258. Përveç kësaj, Paneli ishte themeluar vetëm me insistimin e organeve të jashtme, KiE-së, OSBE-së Institucionit ndërkombëtar të Ombudspersonit në Kosovë, etj. Historiku i hershëm i PKDNJ-së e bën shumë të qartë se ishte i padëshiruar nga shumë brenda OKB-së dhe ishte iniciuar vetëm nën presionin ndërkombëtar.[166]

259. Kishte probleme të tjera në lidhje me themelimin e Panelit. Paneli në fakt nuk u bë funksional deri pothuaj dy vjet pas miratimit të Rregullores nr. 2006/12. Veç kësaj, kur Paneli filloi, kishte pak përpjekje për informim të publikut nga UNMIK-u.

260. Mungesa e një fushate adekuate publike e kombinuar me "rregullën për gjashtë muaj" në nenin 3.1 të Rregullores, e cila kërkonte që "të gjitha rrugët e tjera në dispozicion të jenë ndjekur, dhe brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data në të cilën është

[165] Në atë kohë Sekretari i Përgjithshëm z. Ban Ki Moon "udhëzoi Përfaqësuesin [e tij] Special të fillojë me rikonfigurimin e UNMIK-ut siç është vendosur në raportin [e tij] special, me qëllimin që UNMIK-u të përshtatet në realitetin e ndryshuar dhe t'i adresojë kërkesat operacionale të tanishme dhe ato që lindin në Kosovë." (shih KS i OKB-së, Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë i 15 korrikut të vitit 2008, S/2008/458, § 3).

[166] Shih më lartë, III. Historiku i hershëm i Panelit.

marrë vendimi i formës së prerë", nënkuptonte që shumë njerëz nuk ishin në gjendje të kenë qasje në Panel. Deri në kohën që ata mësuan për ekzistimin e Panelit, tashmë kishin kaluar gjashtë muaj. Kjo rregull e veçantë dukej veçanërisht e rreptë dhe e panevojshme në kontekstin e Kosovës. Origjina e rregullës me siguri është nga neni 35 i KEDNJ-së, i cili ofron një afat të ngjashëm gjashtëmujor. Megjithatë, GJEDNJ, ndryshe nga Paneli pas UA-së, nuk ka datë të fundit për pranimin e ankesave. Të qenit e një rregulle për gjashtë muaj dhe afati i fundit me datën 31 mars 2010 paraqisnin kufizime të panevojshme.

261. Rregulla për gjashtë muaj kishte madje edhe më pak kuptim kur kombinohej me të caktuarit, që rridhte nga fillimi i Panelit, të datës së fillimit të pranimit të ankesave, e cila, sipas Rregullores ishte 23 prilli i vitit 2006, por në fakt ishte nëntori i vitit 2007. Nëse rregulla strikte për gjashtë muaj do të zbatohej për të kufizuar qasjen e ankuesve në Panel, UNMIK-u do t'i kishte plotësuar obligimet e veta duke siguruar që ishte i gatshëm t'i pranojë ankesat në datën e fillimit të punës së Panelit.

262. Kjo çështje doli në pah në rastin *Demiroviq*. Në pajtim me rregullën për gjashtë muaj, për ankesën doli pengesa kohore në maj të vitit 2007, pasi vendimi përfundimtar i organit relevant ishte lëshuar gjashtë muaj më herët. Megjithatë, pasi Paneli e mbajti vetëm seancën e vet inauguruese në Prishtinë në muajin nëntor të vitit 2007, ankuesi u ankua se ai dhe qindra persona tjerë në situatë të ngjashme nuk kishin mundësi të dorëzojnë një ankesë para Panelit, meqë në fund të vitit 2007 Paneli ishte kryesisht i panjohur. Megjithëse Paneli i gjeti shqetësimet e ankuesve të jenë relevante, lënda duhej të shpallej e papranueshme pasi nuk kishte asnjë rrethanë të jashtëzakonshme.[167] Por në vendimin e vet, Paneli sugjeroi që ankuesi të kërkojë që PSSP-ja të ndryshojë Rregulloren qeverisëse për t'i mundësuar Panelit t'i shqyrtojë rastet e tilla, por kjo nuk ndodhi kurrë.

Juridiksioni Ratione Temporis dhe Ratione Personae

263. Një kufizim jashtëzakonisht i rëndësishëm te Paneli ishte juridiksioni i tij i kufizuar. Si rezultat i kësaj, mendimet e miratuara nga Paneli domosdoshmërisht tregojnë vetëm një pamje të pjesshme të trashëgimisë së UNMIK-ut *vis-à-vis* përgjegjësisë së vet për shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë. Kjo nënkuptonte që shumë çështje të rëndësishme të paraqitura dhe diskutuara në raportet e OJQ-ve dhe institucioneve të ndryshme ndërkombëtare rreth gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë, kurrë nuk gjetën rrugën e tyre për në regjistrin e çështjeve juridike të Panelit.

264. Sipas Rregullores qeverisëse, Paneli nuk kishte juridiksion kohor mbi ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut që ishte kryer para 23 prillit të vitit 2005. Kjo përjashtoi shkeljet e kryera kur UNMIK-u ishte vendosur së pari dhe dhunën në çrregullimin pas konfliktit që ishte në zenitin e vet. Vdekjet dhe zhdukjet që ndodhën në atë kohë ishin jashtë juridiksionit të Panelit, përveç dështimit në vazhdim për të hetuar. Kështu që Paneli nuk ishte në gjendje ta marrë parasysh obligimin e UNMIK-ut për të mbrojtur

[167] Shih *Demiroviq*, lënda nr. 57/08, vendimi i 17 prillit të vitit 2009, § 20.

popullatën. Kjo, po ashtu, përjashtoi ngjarjet e lidhura me trazirat e marsit të vitit 2004 në Kosovë. Prandaj, shumë nga këto çështje të të drejtave të njeriut janë përjashtuar nga shqyrtimi i Panelit.

265. E njëjta gjë vlen edhe për datën e fundit të juridiksionit të Panelit, e cila nuk ishte e lehtë të caktohej, pasi UNMIK-u hoqi dorë nga kompetencat ekzekutive gjatë gjithë vitit 2008. Paneli i përdori dy data lidhur me llojet e ndryshme të rasteve. Data e parë, 15 qershori i vitit 2008, ishte ajo e hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës, pas së cilës UNMIK-u nuk ishte më në gjendje të kryejë efektivisht pjesën dërrmuese të detyrave të veta si administratë e përkohshme dhe PSSP-ja nuk ishte në gjendje të zbatojë autoritetin ekzekutiv, me të cilin ishte ngarkuar zyrtarisht sipas Rezolutës së KS të OKB-së 1244. Data e dytë, 9 dhjetor 2008, ishte ajo e fundit të përgjegjësisë së UNMIK-ut në lidhje me policinë dhe drejtësinë në Kosovë, kur EULEX-i mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit.

266. Përveç kësaj, juridiksioni i Panelit kishte përfunduar tërësisht me UA-në, pasi Paneli nuk ishte në gjendje të shqyrtojë ndonjë ankesë të paraqitur pas 31 marsit të vitit 2010.

267. Që në fillim, Paneli ishte po ashtu i përjashtuar nga shqyrtimi i ndonjë ankese lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga KFOR-i, megjithëse Rezoluta e KS të OKB-së 1244 parashihte një mision prej dy degësh që përfshinte edhe KFOR-in dhe UNMIK-un. Gjatë ditëve të para të UNMIK-ut, KFOR-i kreu detyrën e policisë dhe Policia Ushtarake e KFOR-it fillimisht kreu shumë hetime në rastet për PZHV-të. Ankuesit në këto raste shpesh tregonin për personelin e KFOR-it që ishte aktiv në vendin e krimit, por meqë KFOR-i nuk ishte nën mandatin e Panelit, nuk kishte asnjë mënyrë për Panelin t'i detyrojë ata që të ofrojnë informata në lidhje me këto çështje.

268. Për arsyet e përmendura më lart në këtë dhe pjesët e tjera të Raportit, dhe si rezultat i zhvillimeve politike në Kosovë në ndërkohë (në mënyrë specifike, periudha pas Shpalljes së Njëanshme të Pavarësisë në shkurt të vitit 2008), Paneli e kishte mundësinë t'i shqyrtojë vetëm disa çështje dhe probleme të rëndësishme në lidhje me standardet për të drejtat e njeriut.

Qasja në Panel

269. Qasja në një organ kuazi-gjyqësor, sikur Paneli, kërkonte kushte të caktuara të cilat nuk ishin gjithmonë të pranishme. Për shembull, Paneli ishte fizikisht i izoluar nga popullata e Kosovës. Në të vërtetë, PKDNJ ishte i vendosur brenda objekteve të UNMIK-ut, në të cilat nuk mund të kishte qasje të lehtë nga ankuesit e mundshëm. Ndërtesat e UNMIK-ut, madje edhe kur gjendeshin në qendër të Prishtinës, ishin të rrethuara dhe të mbrojtura nga rojtarët dhe krijonin ndjenjën e një baze ushtarake. Të vendosurit e PKDNJ-së brenda UNMIK-ut mund të ketë pasur efektin që kosovarët të mendojnë se PKDNJ ishte pjesë e UNMIK-ut, dhe kështu të ndikojë në perceptimin e tyre të pavarësisë së tij. Paneli kërkoi të zhvendoset në një vend tjetër, duke u

frikësuar se prania e tij në UNMIK do të rrezikonte pavarësinë e tij, por UNMIK-u nuk e lejoi këtë.

270. Kufizim tjetër ishte mungesa e juristëve të përfshirë në proces. Ankuesit, shumë nga të cilët ishin PZHB, shpesh nuk kishin fare apo kishin përfaqësim joadekuat ligjor. Ku ndihma ligjore ishte siguruar përmes projekteve të financuara nga donatorët, ankuesit janë lënë pa ndihmën e tillë kur projektet kanë përfunduar para rasteve. Ndërtimi i një shoqërie pas konfliktit që është tolerante për të drejtat e njeriut, është një projekt afatgjatë që nuk mund të zgjidhet me projekte specifike afatshkurtra.

271. Në fund, personat e zhvendosur ishin në pozitë jashtëzakonisht të pafavorshme, "të ndarë" nga strukturat sociale, të margjinalizuar nga frika prej dhunës së mëtejshme, mosbesimi i autoriteteve dhe u mungonte qasja adekuate në institucione.

272. Në fund, Paneli theksoi që kompetenca e vet është shtrirë përtej ankesës individuale me Rregulloren 10.3 në të cilën thuhej: "Në mungesë të dorëzimit të një ankese nga [një ankues], Paneli Këshillëdhënës mund të emërojë një person të përshtatshëm si përfaqësues ex officio për të dorëzuar një ankesë dhe vepruar në emër të një viktime apo viktimave të dyshuar në procedurën e përcaktuar në Kapitullin aktual, nëse Paneli Këshillëdhënës ka informata të besueshme se ka ndodhur një shkelje e të drejtave të njeriut." Një dispozitë e tillë mund të ofronte një ndihmë të çmuar në procedurën individuale të ankesave nëse shoqërohet nga burimet dhe koha e nevojshme.

Marrëdhënia me UNMIK-un

273. I gjithë historiku i themelimit të Panelit dhe veçanërisht vitet e para të funksionimit, tregojnë për vështirësi në marrëdhënien në mes UNMIK-ut dhe Panelit.

274. Kishte më pas probleme në lidhje me qasjen e Panelit në dosjet hetimore në rastet e PZHV-ve. Me qëllim të përcaktimit nëse ka pasur hetim efektiv në pajtim me garancitë procedurale të përfshira në nenin 2 të KEDNJ-së për të drejtën në jetë, Paneli duhej t'i shqyrtonte dosjet hetimore dhe të shoh se çfarë aktivitetesh kishin ndërmarrë Policia e UNMIK-ut dhe prokurorët. Por, u provua se këto dosje ishte e vështirë të merren, dhe në këtë mënyrë puna e Panelit zgjatej në mënyrë të konsiderueshme. Megjithëse Paneli mund t'i kërkonte UNMIK-ut t'i dorëzojë dosjet, ai nuk mund ta detyronte atë ta bëjë këtë.[168]

275. Në veçanti, metoda e pranim-dorëzimit të dosjeve nga UNMIK-u tek EULEX-i dhe pastaj prapë tek UNMIK-u për shqyrtim nga Paneli, e bëri punën e tij më të vështirë dhe që kërkonte kohë. Në vitin 2013, Sekretariati kërkoi dhe mori qasje në një numër të dosjeve hetimore që nuk ishin në posedim të EULEX-it dhe në vend të kësaj ishin dërguar në arkivin e Selisë së Përgjithshme të OKB-së.

276. UNMIK-u dështoi t'i përfshijë në raportet e tij tremujore për KS të OKB-së çështjet dhe zhvillimet e rëndësishme që ishin duke ndodhur brenda Panelit, si për shembull të

[168] Megjithëse Marrëveshja UNMIK-EULEX për pranim-dorëzimin e dosjeve i lejonte UNMIK-ut t'i kërkojë dhe pranojë dosjet prapa nga EULEX-i.

gjeturat kryesore dhe rastet. Prandaj, në vend se të hidhej dritë mbi punën e Panelit, kjo parandaloi debatin mbi këto çështje në KS të OKB-së.

IX. Përfundimet

277. Paneli është themeluar në rrethana të veçanta sa i përket situatës në lidhje me UNMIK-un në Kosovë. UNMIK-u ishte mandatuar pas aksionit ushtarak të NATO-s në vitin 1999 të paautorizuar nga KS i OKB-së kundër RFJ-së, një aksion që u arsyetua nga përkrahësit e tij në emër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Misioni civil – UNMIK-u – kështu është dashur të jetë atje për t'i promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut. Veç kësaj, ai ishte i vendosur në zemër të Evropës; ku KEDNJ ishte kryesorja për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por GJEDNJ nuk kishte juridiksion në Kosovë. Kur u bë e qartë se UNMIK-u ishte indirekt përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut në Kosovë, kërkesa për përgjegjësi u bë e tillë saqë UNMIK-u duhej të përgjigjej. Rezultat ishte Paneli. Çfarë mbetet e pasigurt është nëse do të ketë mekanizëm të tillë në të ardhmen.

278. Nuk ka të bëjë vetëm me kontekstin e administrimit territorial që përgjegjësia e OKB-së për të drejtat e njeriut është relevante. Në çdo situatë ku OKB-ja e ka autoritetin dhe kontrollin mbi individët, ai duhet ushtruar në një mënyrë që është në pajtim me të drejtat e njeriut, për shembull në kampet për refugjatë apo për sa u përket operacioneve paqësore. Në rrethana të tilla një mekanizëm i përgjegjësisë do të ishte i duhur.

279. Rëndësinë e PKDNJ-së e paraqet vetë fakti i ekzistimit të tij si organ kuazi-gjyqësor i përbërë nga ekspertët e pavarur ligjorë, të cilët ishin mandatuar për t'i vlerësuar veprimet e UNMIK-ut kundrejt ligjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. U dukej e qartë organizmave ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut se legjitimiteti dhe kredibiliteti i OKB-së rrezikohet ku nuk ka përgjegjësi ligjore. Veç kësaj, sistemi i të drejtave të njeriut si i tërë është dobësuar kur mund të shihet se OKB-ja, njëra nga mbrojtëset kryesore të sistemit botëror të të drejtave të njeriut, është vetë duke dështuar t'i përmbushë obligimet që i ka promovuar. Prandaj, Paneli është krijuar kryesisht për të qenë një komponent kontribuues në përgjegjësinë e OKB-së – i pari i këtij lloji; është shpresuar po ashtu se Paneli do të jetë në gjendje të ofrojë disa të arritura në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Pamja për të ardhmen

280. Nëse ne marrim në konsideratë ndonjë mekanizëm të ardhshëm të përgjegjësisë së OKB-së dhe formën optimale që një mekanizëm i tillë duhet të marrë, ai duhet të dizajnohet në mënyrë holistike dhe të hartohet për gjendjen faktike të njerëzve në terren dhe kontekstin politik të misionit. Në veçanti, tri elemente kryesore duhet marrë parasysh: (i) si ai mund të funksionojë efektivisht nga fillimi për t'i marrë parasysh shqetësimet për të drejtat e njeriut të një popullate të cenueshme në një situatë pas konflikti; (ii) si të sigurohen rekomandime të duhura nga Paneli për sa u përket ankesave; dhe (iii) si të sigurohet një përgjigje e duhur nga misioni në fjalë i

OKB-së. Në rastin e PKDNJ-së asnjëra nga këto nuk është bërë nga fillimi dhe pozita është përkeqësuar nga ndryshimet e bëra me Udhëzimin Administrativ.

281. Në vijim janë paraqitur, çfarë ne i vlerësojmë nga përvoja e PKDNJ-së, disa nga faktorët minimalë për t'u marrë parasysh në rast të themelimit në të ardhmen të ndonjë institucioni për qëllimin e njëjtë apo të ngjashëm.

- Një Panel për të Drejtat e Njeriut me autoritet për të dhënë mendime detyruese, jo një Panel "këshillëdhënës".
- Të formohet nga Selia e Përgjithshme e OKB-së, jo nga misioni; kjo nënkupton një organ i OKB-së, jo një organ i UNMIK-ut.
- Të jetë i përfshirë në mandatin e misionit dhe i themeluar menjëherë pas mandatimit të misionit.
- Të jetë i aplikueshëm për gjithë operacionin e mandatuar të OKB-së, civil dhe të sigurisë, sikur në Kosovë KFOR-in dhe UNMIK-un.
- Të jetë i përbërë nga ekspertë të pavarur të nivelit të lartë, duke përfshirë sistemin e zëvendësimit të shpejtë të një anëtari të Panelit dhe të ekzistuarit e një dispozite për anëtar *ad hoc*.
- Të ketë staf të duhur profesional ndërkombëtar dhe lokal, si dhe shërbime ndihmëse (p.sh. përkthim) dhe planifikim adekuat buxhetor.
- Të ekzistojë së bashku dhe në harmoni me mekanizmat e tjerë për të drejtat e njeriut sikur Ombudspersoni, jo të themelohet si alternativë ndaj tyre.
- Të ketë juridiksion për të gjitha shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut duke shfrytëzuar ligjin e aplikueshëm, DUDNJ-në dhe të gjitha traktatet e tjera të OKB-së për të drejtat e njeriut si dhe traktatet relevante rajonale. Ato duhet të përcaktohen në mandat.
- Të ketë procedura të bazuara në procese të drejta, transparente dhe adversariale, dhe Paneli të ketë kompetencë që të ketë qasje në të gjithë dokumentacionin relevant dhe të nevojshëm.
- Të gjitha institucionet dhe strukturat relevante publike obligohen të bashkëpunojnë me Panelin.
- Të ketë garanci për qasje në Panel për ankuesit dhe vetëdijesim i duhur dhe fushatë edukative, veçanërisht para dhe gjatë periudhës së parë të ekzistencës.
- Të jetë obligim i OKB-së që ta shqyrtojë se si mund të pajtohet me rekomandime të tilla të Panelit, me qëllim të të bërit të tij efektiv dhe të sigurohet që asnjë pritje e rrejshme nuk është ngritur. Kjo duhet të përfshijë një procedurë adekuate në vazhdim.
- Mendimet dhe rekomandimet e Panelit duhet të përfshihen rregullisht në raportin e misionit për KS të OKB-së.

282. Planifikimi i duhur ligjor dhe i politikave duhet t'i trajtojë mënyrat e sigurimit të pavarësisë nga misioni i OKB-së si dhe bashkëpunimin e tij; kështu që kërkesat e pranueshmërisë të jenë në përputhje me realitetet në terren dhe jo panevojshëm restriktive; të sigurohen mekanizmat dhe gatishmëria politike për implementimin e rekomandimeve të Panelit; dhe në mënyrat për të siguruar jo vetëm pajtueshmëri me rekomandimet në rastet individuale por më gjerësisht, ashtu që të ketë ndryshime në praktikën dhe operacionet e misionit relevant për të siguruar pajtueshmërinë me të drejtat e njeriut. Ajo çfarë është më e rëndësishmja për OKB-në është vetëm të mbajë premtimin e vet për t'i "promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut".

X. Shtojcat

A. Profilet e anëtarëve të PKDNJ-së

i. Përbërja përfundimtare e Panelit

1. Tre anëtarët e Panelit, të emëruar nga kryetari i GJEDNJ-së dhe të (ri)emëruar nga PSSP-ja në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12, më 1 janar të vitit 2014 ishin z. Marek Nowicki (Poloni), znj. Christine Chinkin (Mbretëria e Bashkuar/Australi) dhe znj. Françoise Tulkens (Belgjikë)[1]. Paneli e zgjodhi z. Marek Nowicki si kryesues të tij në janar të vitit 2008 dhe e rizgjodhi atë si kryesues në vitin 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014,2015 dhe 2016[2].

2. Informatat për biografinë e anëtarëve të Panelit janë dhënë më poshtë.

3. **Marek A. Nowicki** (janar 2007- qershor 2016) shtetas polak, avokat i të drejtave të njeriut dhe anëtar i Odës së Avokatëve të Varshavës që nga viti 1987. Ai ishte Ombudsperson ndërkombëtar në Kosovë i emëruar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, prej korrikut të vitit 2000 deri në dhjetor të vitit 2005. Ai ishte anëtar i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, nga marsi i vitit 1993 deri më 31 tetor 1999. Ai shërbeu si ekspert për të drejtat e njeriut i Komisionit të Venedikut, në Drejtorinë e përgjithshme për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës dhe OSBE. Z. Nowicki është autor i dhjetëra librave dhe qindra artikujve mbi të drejtat e njeriut, të publikuara në Poloni dhe në vendet e tjera. Ai është anëtar i Komisionit përzgjedhës të Çmimit Vaclav Havel për të Drejtat e Njeriut të AP të Këshillit të Evropës.

4. **Christine Chinkin** (shkurt 2010-qershor 2016), me shtetësi të dyfishtë britanike/australiane, anëtare e Akademisë Britanike, është aktualisht profesoreshë e së Drejtës ndërkombëtare në Fakultetin Ekonomik të Londrës dhe drejtoreshë e Qendrës së sapokrijuar për Gra, Paqe dhe Siguri në FEL. Ajo është po ashtu profesoreshë e së Drejtës globale në Fakultetin e Drejtësisë William C. Cook të Universitetit të Miçigenit. Ajo është anëtare e Odës së Avokatëve të Anglisë dhe Uellsit dhe anëtare akademike e Matrix Chambers. Ajo është diplomuar në drejtësi në Universitetin e Londrës, Jelit dhe Sidnejit dhe ka mbajtur më parë poste akademike me orar të plotë në Universitetin e Oksfordit, Londrës, Sidnejit dhe Sauthemptonit, në Fakultetin e Drejtësisë në Nju Jork dhe në Universitetin Kombëtar të Singaporit. Znj. Chinkin është autore e librave dhe artikujve për të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut, kryesisht të drejtat e njeriut të grave.

5. **Françoise Tulkens** (shtator 2012-qershor 2016), shtetase e Belgjikës, ka një doktoratë në drejtësi, magjistraturë në penologji dhe ka diplomuar për mësimdhënie në arsim të lartë (*agrégation de l'enseignement supérieur*) në fushën e drejtësisë. Ajo ishte profesoreshë në Universitetin Louvain dhe ka dhënë mësim në Belgjikë si dhe jashtë vendit në fushën e Të Drejtës penale, Të Drejtës krahasuese dhe penale evropiane, Të Drejtës së të miturve dhe për sistemet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Nga nëntori i vitit 1998 deri në shtator të vitit 2012, ajo ishte gjyqtare në GJEDNJ, duke shërbyer si kryetare e sektorit nga janari i vitit 2007 dhe si nënkryetare e Gjykatës nga shkurti i vitit 2011. Ajo është anëtare me korrespondencë e Akademisë Mbretërore të Belgjikës që nga viti 2011. Në vitin 2013 ajo është emëruar si anëtare e Komisionit Shkencor të Agjencisë për të Drejta Themelore (ADTH) të Bashkimit Evropian, në të cilën aktualisht është si nënkryetare. Ajo është autore e shumë publikimeve në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtës penale, si dhe bashkautore e librave për referim. Znj. Tulkens mban doktorata nderi nga universitetet e Gjenevës, Limozhit, Otavës, Gentit, Liezhit dhe Brajtonit.

---

[1] Emërimi dhe riemërimi i znj. Tulkens nga PSSP-ja përfshin periudhën e njëjtë por ishte në fuqi prej 14 shtatorit të vitit 2012 deri më 13 shtator të vitit 2013, 14 shtator të vitit 2013 deri më 13 shtator të vitit 2014 dhe 14 shtator të vitit 2014 deri më 13 shtator të vitit 2015.

[2] Shih: Rregullorja e punës e PKDNJ-së (më poshtë, Shtojca E.), rregulla 6.

ii. Ish-anëtarët e Panelit

6. **Michèle Picard** (janar 2007-mars 2008), shtetase franceze, është emëruar gjyqtare në vitin 1982. Ajo u bë më vonë nënkryetare e Tribunal de Grande Instance (Tribunali i Shkallës së Lartë) në Paris. Në mars të vitit 1996 ajo është emëruar nga Komiteti i Ministrave i KiE-së si anëtare e Dhomës për të Drejtat e Njeriut për Bosnjë e Hercegovinë. Ajo ishte kryetare e Dhomës nga nëntori i vitit 1997 deri në dhjetor të vitit 2003. Znj. Picard ishte anëtare rezervë e Nënkomisionit të OKB-së për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut deri më 2006 dhe është emëruar nga kryetari i Komisionit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut për dy vjet në korrik të vitit 2005 si eksperte e pavarur për gjendjen e të drejtave të njeriut në Uzbekistan. Ajo është zgjedhur nga AP e OKB-së si Gjyqtare *ad litem* në TNPJ më 24 gusht 2005, një funksion që ajo e mori përsipër më 3 mars 2008.

7. **Snezhana Botusharova** (maj 2008-qershor 2009) doktoroi në fushën e drejtësisë në Universitetin Lomonosov të Moskës. Ishte profesoreshë e Të Drejtës kushtetuese në Universitetin e Sofjes Klementi i Ohrit, Universitetin e Ri të Bullgarisë në Sofje dhe Universitetin Neofit Rilski në Blagojevgrad. Ajo ishte anëtare e Kuvendit të Madh Kombëtar të Bullgarisë dhe një prej autorëve të Kushtetutës së re të Bullgarisë (duke qenë si zëvendëskryetare nga shtatori deri në nëntor të vitit 1992). Si anëtare e Parlamentit ajo mori pjesë në aktivitete të ndryshme legjislative në përgatitje të bazës ligjore për tranzicionin e Bullgarisë në demokraci dhe sundim të ligjit. Ajo, po ashtu, ishte anëtare e Komisionit të Venedikut (1991-1994). Nga viti 1994 deri më 1998, ajo shërbeu si ambasadore e jashtëzakonshme dhe fuqiplotë e Republikës së Bullgarisë në ShBA. Znj. Botusharova është autore e librave dhe artikujve mbi të drejtën kushtetuese dhe çështjet e të drejtave të njeriut. Ajo tani shërben si gjyqtare ndërkombëtare në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

8. **Paul Lemmens** (janar 2007-shtator 2012) është shtetas i Belgjikës. Ai ishte gjykatës në Këshillin e Shtetit të Belgjikës nga viti 1994 deri në shtator të vitit 2012. Ai ka shërbyer në të dyja seksionin e Këshillit të Shtetit që shqyrton pajtueshmërinë e draftlegjislacionit dhe draftrregulloreve me normat më të larta të së drejtës ndërkombëtare dhe nacionale dhe në seksionin për diskutime të kontesteve të Këshillit të Shtetit, i cili është në përbërje të Gjykatës Administrative Supreme të Belgjikës. Që nga viti 1986, ai është profesor në Universitetin e Leuven-it ku ai ligjëron mbi Të Drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ai, po ashtu, ka dhënë mësim mbi Të Drejtën kushtetuese, Procedurën civile dhe Procedurën administrative. Ai është autor i një numri librash dhe artikujsh mbi Të Drejtën evropiane për të drejtat e njeriut. Z. Lemmens mori mandatin e gjykatësit në GJEDNJ në shtator të vitit 2012.

B. Profilet e anëtarëve të stafit të Sekretariatit të PKDNJ-së

i. Stafi përfundimtar i Sekretariatit

9. Stafi i Sekretariatit përbëhet nga një zyrtar ekzekutiv, tre zyrtarë ligjorë dhe dy asistente administrative.

10. **Andrey Antonov**, shtetas rus, iu bashkua Sekretariatit në qershor të vitit 2011 si zyrtar ekzekutiv. Më herët, ai punoi për OKB-në (që nga viti 2000), duke shërbyer në Policinë e UNMIK-ut, si zyrtar ligjor në DD-në e UNMIK-ut, si këshilltar ligjor në Zyrën e integruar të Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone, si zyrtar për disiplinë dhe sjellje në misionin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Sudan dhe si hetues në Divizionin për hetime të Zyrës për Kontroll të Brendshëm në selinë e OKB-së. Z. Antonov mban gradën e doktoratës në drejtësi (PhD). Ai është autor i më shumë se 50 publikimeve në periodikët e ndryshëm në lidhje me të drejtën penale dhe hetimin, të drejtën ndërkombëtare humanitare, të drejtat e njeriut dhe paqeruajtjen.

11. **Anna Maria Cesano**, shtetase italiane, iu bashkua Sekretariatit si zyrtare ligjore në maj të vitit 2011. Më herët, znj. Cesano punoi si zyrtare për sundim të ligjit në Programin për qasje në drejtësi të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone, si zyrtare për ndërlidhje në Zyrën e Komisarit për Refugjatë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Tanzani dhe si zyrtare për të drejtat e njeriut në Zyrën e integruar të Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone. Para se t'i bashkohej OKB-së, ajo punoi në Universitetin e Sienës, si hulumtuese mbi sistemin evropian për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Znj. Cesano ka magjistruar për të drejtat e njeriut dhe menaxhimin e konflikteve në Universitetin e Pizës për studime të avancuara Sant' Anna dhe mban një magjistraturë në drejtësi nga Universiteti Katolik i Milanos.

12. **Brandon Gardner**, shtetas amerikan dhe ish-anëtar i Odës së Avokatëve të Pensilvanisë, iu bashkua Sekretariatit si zyrtar ligjor në tetor të vitit 2011. Më herët, ai shërbeu si zyrtar ligjor në Sektorin për marrëdhënie me jashtë të DD-së së UNMIK-ut dhe në Zyrën ndërlidhëse për sundim të ligjit të UNMIK-ut, dhe si këshilltar ligjor në Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në emër të Misionit të OSBE-së në Kosovë. Ai ka doktoruar në drejtësi në Universitetin e Pitsburgut si dhe ka diplomuar në shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare në Universitetin e Pitsburgut.

13. **R. Dule Vicovac**, shtetas kanadez dhe anëtar i Odës së Avokatëve të Manitobas (Kanada) dhe Odës së Avokatëve të Minesotës (ShBA), iu bashkua Sekretariatit si zyrtar ligjor në gusht të vitit 2014. Më herët z. Vicovac punoi si avokat në rastet penale dhe të refugjatëve në Kanada, si ekspert ligjor në një projekt të financuar nga BE-ja për ndihmë ligjore, nëpërmjet të cilit ndihmoheshin personat e zhvendosur nga Kosova dhe si udhëheqës ekipi/ekspert ligjor në një projekt të financuar nga BE-ja në Ministrinë për të Drejtat e Njeriut dhe Minoritetet të Serbisë. Para kësaj, ai shërbeu si zyrtar ligjor në UNMIK dhe Drejtorinë për Çështje Pronësore dhe Banesore, UN-Habitat. Z. Vicovac mban një titull doktorate në drejtësi nga Universiteti i Hamlinit për drejtësi në Minesota si dhe ndoqi Universitetin e Manitobas dhe Universitetin e Oksfordit.

14. **Adlije Muzaqi**, punonjëse e stafit vendor dhe asistente e ekipit, ka punuar në Sekretariat që nga shtatori i vitit 2010. Ajo filloi punën në OKB në tetor të vitit 1999, si asistente administrative në Administratën komunale të UNMIK-ut në Komunën e Vushtrrisë, rajoni i Mitrovicës.

15. **Larisa Barishiq**, punonjëse e stafit vendor dhe asistente ligjore, iu bashkua Sekretariatit në nëntor të vitit 2015. Para se t'i bashkohej UNMIK-ut, ajo ka shërbyer për shumë vjet në Misionin e OSBE-së në Kosovë. Znj. Barishiq ka diplomuar në shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare në Fakultetin e Shkencave Politike të Universitetit të Beogradit dhe ndjek studimet e saj të magjistraturës në të drejtën ndërkombëtare në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit.

ii. Ish-stafi i Sekretariatit

16. **John J. Ryan**, shtetas irlandez, ishte zyrtar ekzekutiv i Sekretariatit nga shtatori i vitit 2007 deri në qershor të vitit 2009. Më parë ishte avokat në Stephen MacKenzie dhe Co. Solicitors në Dablin dhe ai ishte po ashtu i punësuar si udhëheqës i Divizionit Ndërkombëtar për Përkrahje Gjyqësore të DD-së së UNMIK-ut dhe më pas zyrtar i lartë ligjor, Zyra e PSSP-së, UNMIK. Ai ka diplomuar në Universitetin e Limerick-ut, si i diplomuar në drejtësi (Hons) dhe studime evropiane si dhe ka diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë të Asociacionit të Inkorporuar për Drejtësi të Irlandës.

17. **Ruzvelt Frrokaj**, anëtar i stafit vendor, ishte asistent administrativ në Panel nga nëntori i vitit 2007 deri me përfundimin e punës së tij në UNMIK në qershor të vitit 2008. Ai iu bashkua UNMIK-ut në mars të vitit 2000 dhe ishte punësuar si zyrtar për siguri dhe asistent administrativ në Administratën e UNMIK-ut, dhe po ashtu si asistent administrativ në Zyrën për ndërmarrje shoqërore, Zyra e PSSP-së.

18. **Snezhana Martinoviq** qytetare me përkatësi nacionale serbe, iu bashkua Sekretariatit në dhjetor të vitit 2007 si asistente administrative. Para kësaj, ajo shërbeu si asistente administrative në Departamentin e Policisë së UNMIK-ut dhe asistente administrative në DD-në e UNMIK-ut. Në nëntor të vitit 2013 ajo u ngrit në detyrë për t'u bërë asistente ligjore e Sekretariatit. Znj. Martinoviq ka një diplomë universitare në mësimdhënie nga Akademia Pedagogjike e Universitetit të Beogradit, dhe Diplomë për Avancim në BTEC në punën e avokaturës (E drejta penale).

19. **Leanne Ho**, shtetase australiane, është emëruar si zyrtare ligjore në Panel në dhjetor të vitit 2007. Ajo filloi punën e saj në OKB si zyrtare ligjore në DD-në e UNMIK-ut në vitin 2003, ku ajo ishte e punësuar, *inter alia*, si menaxhere për operacione në Seksionin për Integrim Gjyqësor, këshilltare ligjore ndërkombëtare në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe si zyrtare ligjore në Divizionin Ndërkombëtar për Përkrahje Gjyqësore.

20. **Magda Mierzewska**, shtetase polake, është dërguar si zëvendësim nga GJEDNJ-ja në Panel për një periudhë dymujore nga muaji maj deri në korrik të vitit 2008. Ajo, po ashtu, është avokate në Zyrën përgjegjëse që mban regjistrin e GJEDNJ-së dhe i dha një kontribut të rëndësishëm Panelit për sa i përket hulumtimit, analizës dhe hartimit gjatë periudhës që shërbeu si zëvendësim.

21. **Martin Clutterbuck**, shtetas australian, ishte zyrtar ligjor në Panel nga shtatori deri në dhjetor të vitit 2008. Ai punoi më herët për UNMIK-un në pozita të ndryshme si p.sh. koordinator ndërkombëtar për ndihmë ligjore në DD dhe kryetar i Komisionit për Regjistrimin e Ankesave. Ai punoi në UNTAET/UNMISET në Timorin Lindor si zyrtar ligjor për zëvendësprokurorin special për krime serioze nga viti 2001 deri më 2003. Para kësaj, ai punoi në Australi si avokat/koordinator kryesor në një numër qendrash ligjore të komunitetit, si dhe ishte konsulent në Organizatën Ndërkombëtare për Zhvillim të së Drejtës. Ai u kualifikua si avokat në Australi në vitin 1995.

22. **Mimoza Arifi-Hoxha**, punonjëse e stafit vendor, ishte asistente administrative në Sekretariat nga nëntori i vitit 2008 deri në shtator të vitit 2010. Ajo e filloi punën në OKB në dhjetor të vitit 1999 si asistente administrative në UNMIK, DIP/Zyra për Shtyp.

23. **Elina Castren**, shtetase finlandeze, shërbeu si zyrtare për të drejtat e njeriut në Sekretariat nga dhjetori i vitit 2008 deri në qershor të vitit 2009 në një periudhë zëvendësimi e dërguar nga Qeveria e Finlandës.

24. **Bernadette Foley**, shtetase amerikane, shërbeu si zyrtare ligjore në Sekretariat nga dhjetori i vitit 2008 deri në qershor të vitit 2009. Ajo ishte punësuar më parë si inspektore e lartë gjyqësore në Zyrën e Këshillit Disiplinor të UNMIK-ut. Nga viti 2005 deri në vitin 2006 ajo

menaxhoi, dizajnoi dhe drejtoi një program trajnimi për hetuesit për keqadministrim gjyqësor dhe prokurorial në një projekt të përbashkët UNDP/UNMIK. Nga viti 2002 deri më 2004 ajo ishte bashkëpunëtore vizitore e fakultetit ku jepte mësim në fushën e së drejtës në një universitet rus në kuadër të Projektit për Arsimim Civil të Institutit për Shoqëri të Hapur. Nga viti 1986 deri më 2001, ajo ishte avokate në gjykime dhe për ankesa në ShBA në fushën e të drejtës penale dhe shëndetit mendor.

25. **Jerina Dampier**, shtetase amerikane dhe anëtare e Odës së Avokatëve të Nju Jorkut, shërbeu si zyrtare ligjore në Sekretariat nga shkurti i vitit 2009 deri në maj të vitit 2009. Më herët, ajo shërbeu si zyrtare ligjore në Departamentin e Administratës Civile të UNMIK-ut, Divizionin Penal të DD-së së UNMIK-ut dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e lidhura me AKM-në.

26. **Butera Mpira**, shtetas i Ruandës, shërbeu si zyrtar ligjor në Sekretariat nga marsi i vitit 2009 deri në qershor të vitit 2009. Më herët, ai shërbeu si zyrtar ligjor në Divizionin Ndërkombëtar për Përkrahje Gjyqësore të DD-së së UNMIK-ut dhe organizatën joqeveritare Forcë Paqësore të Padhunshme në Shri Lankë.

27. **Chiara Rojek**, shtetase franceze, shërbeu si zyrtare ligjore në Sekretariat nga marsi i vitit 2009 deri në qershor të vitit 2009. Më herët, ajo shërbeu si zyrtare ligjore në Divizionin Ndërkombëtar për Përkrahje Gjyqësore të DD-së së UNMIK-ut dhe si zyrtare ligjore në Dhomat e Veçanta të Gjykatave në Kamboxhë për hetimin e krimeve të kryera gjatë periudhës së Kampuçias Demokratike.

28. **Ravi K. Reddy**, shtetas amerikan dhe anëtar i Odës së Avokatëve të Nju Jorkut, iu bashkua Sekretariatit si zyrtar ligjor në maj të vitit 2009. Më herët, ai shërbeu si zyrtar ligjor në Zyrën e DD-së së UNMIK-ut dhe si nëpunës ligjor (zyrtar ligjor) në Programin e Avokimit të ShBA-së të HRW-së. Ai ka magjistruar në drejtësi përkatësisht Të Drejtën për të Drejta të njeriut në Universitetin e Notingemit, e ka doktoratën si jurist nga Universiteti i Pitsburgut dhe ka diplomuar në histori në Universitetin e Delaware-s. Në qershor të vitit 2011, ai iu bashkua Misionit të OKB-së në Timor-Leste, ku ai u punësua si zyrtar ligjor në ZÇL.

29. **Nedim Osmanagiq**, shtetas boshnjak, shërbeu si zyrtar ligjor nga qershori i vitit 2009 deri në shtator të vitit 2010 dhe ishte zyrtar përgjegjës i Sekretariatit dhe ushtrues i detyrës së zyrtarit ekzekutiv nga qershori i vitit 2009 deri në shkurt të vitit 2010. Ai i solli Sekretariatit përvojën e tij si zëvendës i Ombudspersonit për Bosnjë e Hercegovinë, zyrtar për të drejtat e njeriut në ZKLDNJ në Prishtinë, inspektor i lartë gjyqësor në UNMIK, zyrtar ligjor për Komisionin e Venedikut, UNMIK dhe Misionin e OKB-së në Bosnjë e Hercegovinë, dhe këshilltar për të drejtat e njeriut për Misionin e OSBE-së në Bosnjë e Hercegovinë dhe UNDP-në në Somali.

30. **Rajesh Talwar**, shtetas indian, punoi për OKB-në në pozita të ndryshme në Kosovë, Somali, Liberi dhe Afganistan para se të kthehej në Kosovë të merrte pozitën e zyrtarit ekzekutiv të Sekretariatit në shkurt të vitit 2010. Para punës për OKB-në, ai ushtori detyrë në drejtësi në Gjykatën Supreme të Indisë dhe gjykatat vartëse të saj. Si avokat, ai ishte i lidhur ngushtë me disa raste për të drejtat e njeriut duke përfshirë kërkesat në lidhje me vendimet e Gjykatës Supreme që kishin të bënin me çështjet që dalin nga HIV/AIDS. Në vitin 1996 ai shkoi në MB me një bursë britanike studimi, nga ku ai e mori kualifikimin në LLM në të Drejtën për të Drejtat e njeriut në Universitetin e Notingemit.

31. **Anila Premti**, shtetase shqiptare, iu bashkua Sekretariatit si zyrtare ligjore në tetor të vitit 2010, në një pozitë të përkohshme nga posti i saj i rregullt në UNCTAD në Gjenevë. Më herët, ajo po ashtu, punoi sy zyrtare ligjore në DD-në e UNMIK-ut, Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e lidhura me AKM-në, dhe në ZÇL-në e OKB-së në Nju Jork. Para se t'i bashkohej OKB-së, ajo punoi në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Shqipëri. Ajo ka magjistruar në drejtësi në Universitetin Tulan dhe mban gradë në drejtësi nga Universiteti i Tiranës.

32. **Sarah Enright**, shtetase irlandeze, shërbeu si UNV (vullnetare e OKB-së) në Sekretariat nga marsi deri në qershor të vitit 2012, me gjysmë orari të punës. Ajo shërbeu në të njëjtën kohë si zyrtare ligjore e UNV-së (vullnetare e OKB-së) në kuadër të Zyrës së UNMIK-ut për Sundim të Ligjit, nga tetori i vitit 2011 deri në shtator të vitit 2012. Më herët, ajo punoi si avokate në vendin e saj në Irlandë dhe në Gjykatën e Drejtësisë të Bashkimit Evropian në Luksemburg.

33. **Daniel Trup**, shtetas britanik/francez, iu bashkua Sekretariatit në qershor të vitit 2012 si zyrtar ligjor. Duke u kualifikuar si avokat në vitin 2000, ai ka punuar në fushën e të drejtës penale në MB dhe jashtë saj. Para se t'i bashkohej Sekretariatit, ai kishte punuar për EULEX-in si zyrtar i lartë ligjor në Zyrën e Prokurorit Special dhe si zyrtar ligjor në Zyrën e Prokurorit në Gjykatën Shtetërore të Bosnjë e Hercegovinës. Z. Trup mban gradën LLM në të Drejtën ndërkombëtare nga Universiteti i Kentit, dhe është i diplomuar në histori dhe politikë në Universitetin e Londrës.

C. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12

UNITED NATIONS
United Nations Interim Administration Mission in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration Intérimaire des Nations Unies au Kosovo

UNMIK/REG/2006/12
23 mars 2006

RREGULLORE NR. 2006/12

MBI THEMELIMIN E PANELIT KËSHILLDHËNËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke pasur parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të themelimit të Panelit këshillëdhënës për të drejtat e njeriut, si organ i përkohshëm gjatë mandatit të UNMIK-ut, për shqyrtimin e shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut nga ana e UNMIK-ut,

Me anë të kësaj shpall Rregulloren në vijim:

KAPITULLI 1: Themelimi dhe kompetencat e Panelit këshillëdhënës mbi të drejtat e njeriut

Neni 1
Themelimi i Panelit këshillëdhënës mbi të drejtat e njeriut

1.1 Me këtë themelohet Paneli këshillëdhënës mbi të drejtat e njeriut (Paneli këshillëdhënës).

1.2 Paneli këshillëdhënës shqyrton ankesat e çdo personi apo grupit të personave të cilët pohojnë se janë viktima të shkeljes së të drejtave të njeriut nga UNMIK-u sikur që është dhënë në njërën apo në më shumë instrumentet vijuese:

(a) Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e datës 10 dhjetor 1948;

(b) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e datës 4 nëntor 1950 bashkë me Protokollet e saj;

(c) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike e datës 16 dhjetor 1966 bashkë me Protokollet e saj;

(d) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e datës 16 dhjetor 1966;

(e) Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor e datës 21 dhjetor 1965;

(f) Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave e datës 17 dhjetor 1979;

(g) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese e datës 17 dhjetor 1984; dhe

(h) Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve e datës 20 dhjetor 1989.

1.3 Pas përfundimit të shqyrtimit të një ankese, Paneli këshillëdhënës ia dërgon konkluzionet e veta Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Konkluzionet e Panelit këshillëdhënës, të cilat mund të përfshijnë rekomandime janë të natyrës këshillëdhënëse.

Neni 2
Kompetencat e përkohshme dhe territoriale

Paneli këshillëdhënës ka kompetenca në gjithë territorin e Kosovës dhe për ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e supozuara të të drejtave të njeriut që janë bërë pas datës 23 prill 2005 apo që kanë rrjedh nga faktet e paraqitura para kësaj date dhe që këto fakte rrisin në vazhdimësi shkeljen e të drejtave njerëzore.

Neni 3
Kriteret për pranimin e ankesës

3.1 Paneli këshillëdhënës mund të trajtojë një çështje vetëm pasi të ketë konkluduar se janë ndjekur të gjitha rrugët tjera të mundshme për shqyrtimin e shkeljes së supozuar dhe brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga data kur është marrë vendimi i formës së prerë.

3.2 Paneli këshillëdhënës nuk shqyrton ankesën që është:

(a) anonime ose

(b) kryesisht e njëjtë me një çështje që tanimë është shqyrtuar nga Paneli këshillëdhënës dhe nuk përmban informata të reja përkatëse.

3.3 Paneli këshillëdhënës shpall si të papranueshme çdo ankesë të cilën e konsideron se nuk është në përputhshmëri me të drejtat e njeriut, të përcaktuara në një apo në më shumë instrumente të përmendura në nenin 1.2 më lart dhe e konsideron si të pabazë ose shpërdorim i së drejtës së ankesës.

KAPITULLI 2: Përbërja dhe statusi i Panelit këshillëdhënës mbi të drejtat e njeriut

Neni 4
Selia dhe përbërja

4.1 Paneli këshillëdhënës e ka selinë në Prishtinë.

4.2 Paneli këshillëdhënës përbëhet prej tre anëtarëve nga të cilët njëri emërohet kryesues. Së paku një anëtar i Panelit këshillëdhënës duhet të jetë femër.

4.3 Anëtarët e Panelit këshillëdhënës janë juristë ndërkombëtarë me karakter të lartë moral, paanshmëri dhe integritet, të dëshmuar si ekspertë në fushën e të drejtave të njeriut, në veçanti në sistemin evropian.

Neni 5
Emërimi i anëtarëve

5.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron anëtarët e Panelit këshillëdhënës pas propozimit të bërë nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

5.2 Anëtarët emërohen me mandat dy (2) vjeçar[1]. Emërimi mund të vazhdohet edhe për një mandat tjetër dyvjeçar (2).

Neni 6
Dhënia e betimit solemn

Me rastin e emërimit, çdo anëtar i Panelit këshillëdhënës e nënshkruan deklaratën në vijim para Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm ose para personit të caktuar nga ai:

" Solemnisht deklaroj se:

"Do t"i përmbahem ligjit gjatë gjithë kohës së ushtrimit të funksioneve në postin tim dhe do të veproj në pajtim me standardet më të larta profesionale e respektin më të lartë ndaj dinjitetit të postit tim dhe detyrave që më janë besuar.

Në ushtrimin e funksioneve të postit tim gjithmonë do të mbështes standardet më të larta të pranuara ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut, përfshirë ato të paraqitura në parimet e Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut, në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut bashkë me Protokollet e saj, në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike bashkë me Protokollet e saj, në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, në Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, në Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese dhe në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve."

Neni 7
Imuniteti dhe pacenueshmëria

7.1 Zyrat e shfrytëzuara nga Paneli këshillëdhënës janë të pacenueshme. Arkivi, lëndët, dokumentet, komunikimet, prona, fondet dhe pasuritë e Panelit këshillëdhënës kudo që të vendosen dhe nga kushdo që të mbahen janë të pacenueshme dhe të mbrojtura nga bastisja, marrja, sekuestrimi, konfiskimi, shpronësimi ose nga çfarëdo forme tjetër e ndërhyrjes përmes veprimit ekzekutiv, administrativ, gjyqësor a legjislativ.

7.2 Anëtarët e Panelit këshillëdhënës kanë imunitet të njëjtë si personeli i UNMIK-ut sipas neneve 3.3 dhe 3.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë.

[1] Qëndrimi në detyrë i anëtarëve të Panelit është zvogëluar në një vit, me ripërtëritje, sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.2007/3 të 12 janarit të vitit 2007.

7.3 Sekretari i Përgjithshëm ka të drejtë dhe përgjegjësi t'ia heqë imunitetin e anëtarit të Panelit këshillëdhënës në çdo rast që, sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengojë rrjedhat e drejtësisë dhe ai mund të hiqet pa cenuar interesat e UNMIK-ut.

Neni 8
Burimet financiare dhe njerëzore

Për funksionimin efikas të Panelit këshillëdhënës merren masat e duhura përmes sigurimit të burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore.

Neni 9
Sekretariati

Panelit këshillëdhënës ka sekretariatin me orar të plotë.

KAPITULLI 3: Procedura e punës së Panelit këshillëdhënës mbi të drejtat e njeriut

Neni 10
Parashtrimi i ankesave dhe përfaqësuesit sipas detyrës zyrtare

10.1 Ankesat i parashtrohen Panelit këshillëdhënës në formë të shkruar.

10.2 Ankesa mund të parashtrohet nga ankuesi ose në emër të tij nga anëtari i familjes, nga organizata joqeveritare ose nga sindikata.

10.3 Në mungesë të parashtrimit të ankesës sipas nenit 10.2, Paneli këshillëdhënës mund të emërojë një person të përshtatshëm përfaqësues sipas detyrës zyrtare për të parashtruar ankesën dhe për të vepruar në emër të viktimës ose viktimave të dyshuara në procedurën e përcaktuar në këtë kapitull nëse Paneli këshillëdhënës ka informacione të besueshme se është bërë shkelje e të drejtave të njeriut.
10.4 Me kërkesën e përfaqësuesit të caktuar sipas detyrës zyrtare, Paneli këshillëdhënës mund të përfundojë procedurën sipas nenit 10.3 nëse viktima ose viktimat e dyshuara nuk dëshirojnë që të vazhdojë procedura ose nëse vazhdimi i procedurës nuk është me interes publik për ndonjë person tjetër.

10.5 Për parashtrimin e ankesës nuk parashihet kurrfarë pagese.

Neni 11
Parashtresat me shkrim

11.1 Ankesa paraqet të gjitha faktet e rëndësishme mbi të cilat bazohet shkelja e supozuar e të drejtave të njeriut. Ankesës mund ti bashkëngjiten edhe dokumente të tjera si dëshmi.

11.2 Pas marrjes së ankesës Paneli këshillëdhënës përcakton se a është ankesa e pranueshme. Nëse informacionet e dhëna me ankesën nuk mundësojnë që të bëhet një konstatim i tillë, Paneli këshillëdhënës kërkon informacione shtesë nga ankuesi. Nëse Paneli këshillëdhënës konstaton se ankesa është e papranueshme, ai merr vendim me të cilin refuzohet ankesa.

11.3 Kur Paneli këshillëdhënës konstaton se ankesa është e pranueshme, ai ia referon ankesën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në mënyrë që të merret një përgjigje në emër të UNMIK-ut lidhur me ankesën. Përgjigjja e tillë i jepet Panelit këshillëdhënës brenda njëzet (20) ditësh nga dita e pranimit të ankesës nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

11.4 Paneli mund të kërkojë nga ankuesi dhe UNMIK-u që të bëjnë parashtresa tjera me shkrim brenda afateve kohore që ai mund ti caktojë nëse këto parashtresa janë në interes të drejtësisë.

Neni 12
Fshehtësia e komunikimeve

12.1 Komunikimet ndërmjet Panelit këshillëdhënës dhe ankuesit ose personit që vepron në emër të tij janë të fshehta.

12.2 Fshehtësia e komunikimit siç paraqitet në nenin 12.1 zbatohet në tërësi kur ankuesi ose personi që vepron në emër të tij është në paraburgim.

Neni 13
Pjesëmarrja e një *Amicus Curiae* dhe e avokatit të popullit

13.1 Paneli këshillëdhënës, kur është në interes të drejtësisë, mund të ftojë

(a) Një *amicus curiae* që të parashtrojë komentet me shkrim dhe

(b) Avokatin e popullit që të parashtrojë komentet me shkrim nëse ai është duke u marrë me këtë çështje.

13.2 Parashtresat me shkrim nga avokati i popullit do të jenë pa paragjykime mbi autorizimet, përgjegjësitë dhe obligimet e avokatit të popullit sipas ligjit në fuqi.

Neni 14
Seancat verbale

Kur është në interes të drejtësisë Paneli këshillëdhënës mban seanca verbale.

Neni 15
Kërkesat për paraqitjen e personave ose për parashtrimin e dokumenteve

15.1 Paneli këshillëdhënës mund të kërkojë paraqitjen e çdo personi, përfshirë edhe personelin e UNMIK-ut, ose parashtrimin e çdo dokumenti, përfshirë dosjet dhe dokumentet që i posedon UNMIK-u, të cilat mund të jenë të rëndësishme për ankesën.

15.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm bashkëpunon me Panelin këshillëdhënës dhe i ofron atij ndihmën e nevojshme gjatë ushtrimit të pushtetit dhe kompetencave të tij në mënyrë të veçantë për lëshimin e dokumenteve dhe informatave që janë të rëndësishme për ankesën.

15.3 Kërkesat për paraqitjen e personelit të UNMIK-ut ose për parashtrimin e dokumenteve të Kombeve të Bashkuara i bëhen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Gjatë marrjes së vendimit për t‟iu përgjigjur këtyre kërkesave Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm merr parasysh interesin e drejtësisë, promovimin e të drejtave të njeriut dhe interesat e përgjithshme të UNMIK-ut e të Kombeve të Bashkuara.

Neni 16
Seancat publike dhe qasja në dokumentet e deponuara në Panelin këshillëdhënës

16.1 Seancat e Panelit këshillëdhënës janë publike përveç në rastet e jashtëzakonshme kur Paneli këshillëdhënës vendos ndryshe.

16.2 Pas miratimit nga Paneli këshillëdhënës, dokumentet e deponuara në Panelin këshillëdhënës për të drejtat e njeriut mund t‟i vihen në dispozicion çdo personi që ka interes të ligjshëm në çështjen pas paraqitjes së kërkesës me shkrim.

Neni 17
Konkludimet dhe rekomandimet e Panelit këshillëdhënës

17.1 Paneli këshillëdhënës sjell konkludimet mbi atë se a ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut dhe, kur është e nevojshme, bën rekomandime. Këto konkludime dhe çdo rekomandim i Panelit këshillëdhënës i parashtrohen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

17.2 Konkludimet dhe rekomandimet e Panelit këshillëdhënës botohen me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në mënyrën që siguron shpërndarje të gjerë dhe qasje në to.
17.3 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ushtron pushtetin dhe diskrecionin ekskluziv për të vendosur se a duhet vepruar sipas konkludimeve të Panelit këshillëdhënës.

17.4 Vendimet e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm botohen me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në mënyrën që siguron shpërndarje të gjerë dhe qasje në to.

Neni 18
Rregullorja e punës

18.1 Paneli këshillëdhënës miraton rregulloren e punës për procedurat e veta. Rregullorja e punës mund t‟i japë autorizime dhe përgjegjësi Sekretariatit të Panelit këshillëdhënës.

18.2 Pas miratimit nga Paneli këshillëdhënës, rregullorja e punës publikohet me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe me qëllim të shpërndarjes së gjerë dhe qasjes në to.

KAPITULLI 4: Dispozitat përfundimtare

Neni 19
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të shpallë çdo udhëzim të nevojshëm administrativ për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 20
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 23 mars 2006, përveç nenit 10 i cili hyn në fuqi më 23 prill 2006.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

D. Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2009/1

UNITED NATIONS
United Nations Interim Administration Mission in Kosovo

UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration Intérimaire des Nations Unies au Kosovo

UNMIK/DIR/2009/1
17 tetor 2009

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2009/1

PËR IMPLEMENTIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UR NR. 2006/12 MBI THEMELIMIN E PANELIT KËSHILLËDHËNËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP),

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 19 të Rregullores nr. 2006/12 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/3, të datës 12 janar 2007 (Rregullorja),

Duke marrë parasysh Rregulloren e punës të miratuar më 5 shkurt 2008 nga Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, në pajtim me nenin 18 të Rregullores,

Me qëllim të qartësimit të karakterit dhe rregullimit të procedurave të dëgjimeve publike të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, shqyrtimin e pranueshmërisë së ankesave nga ky Panel dhe caktimin e një afati kohor për paraqitjen e ankesave pranë këtij Paneli, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, duke pasur parasysh kapacitetin e zvogëluar të UNMIK-ut që të ushtrojë autoritet ekzekutiv në mënyrë efektive në të gjitha fushat nga ku burojnë çështjet e ankesave për të drejtat e njeriut,

Me anë të kësaj nxjerr këtë Urdhëresë administrative:

Neni 1
Dëgjimet publike

1.1 Dëgjimet publike të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli Këshillëdhënës) do të drejtohen në mënyrën dhe përbërjen që qartazi do të lënë të kuptohet se janë procedura joadversiale dhe që do t'iu përcillen të gjithë pjesëmarrësve si dhe opinionit të gjerë publik, duke përfshirë edhe mediat e pranishme, nëse prania e tyre lejohet nga Paneli Këshillëdhënës.

1.2 Gjatë dëgjimeve publike, ankuesve apo përfaqësuesve të tyre do t'iu lejohet të bëjnë deklarata duke përmbledhur pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut, ashtu siç është paraqitur në parashtresën me shkrim pranë Panelit Këshillëdhënës. Gjatë dëgjimeve publike, Paneli Këshillëdhënës mund t"ju parashtrojë pyetje palëve ose përfaqësuesve të tyre të cilat qartësojnë bazën faktike të ankesës, dhe që për Panelin Këshillëdhënës janë të nevojshme që në tërësi të vlerësojë pohimin për shkeljen e të drejtave të njeriut të paraqitur pranë tij.

1.3 Vendi dhe rregullimi i ulëseve për dëgjimet publike të drejtuara nga Paneli Këshillëdhënës janë në përputhje me natyrën joadversiale të procedurës.

Neni 2
Çështjet e pranueshmërisë

2.1 Në cilëndo fazë të procedurës së një ankese mbi të drejtat e njeriut të paraqitur pranë tij, Paneli Këshillëdhënës shqyrton të gjitha çështjet e pranueshmërisë së ankesës para se të shqyrtojë bazueshmërinë e rastit.

2.2 Çdo ankesë e cila është apo mund të jetë në të ardhmen çështje e procesit të ankesave të palës së tretë ose procedurave sipas nenit 7 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë, të datës 18 gusht 2000, do të konsiderohet e papranueshme për arsye se procesi i ankesave të palës së tretë të KB-së dhe procedura sipas nenit 7 të Rregullores nr. 2000/47 janë mjete në dispozicion sipas nenit 3.1 të Rregullores.

2.3 Komentet mbi bazueshmërinë e një pretendimi për shkelje të të drejtave të njeriut duhet dorëzuar vetëm pasi Paneli Këshillëdhënës të ketë përfunduar shqyrtimin dhe vendosur për pranueshmërinë e ankesës së tillë. Nëse çështjet e pranueshmërisë së një ankese adresohen në çfarëdo kohe pasi që Paneli Këshillëdhënës të ketë marrë një vendim mbi pranueshmërinë e ankesës dhe filluar shqyrtimet e veta të bazueshmërisë, Paneli Këshillëdhënës do të suspendojë shqyrtimet e veta mbi bazueshmërinë deri në një kohë që pranueshmëria e ankesës të rivlerësohet plotësisht dhe vendoset përsëri.

2.4 Pas çdo vendimi të ri mbi pranueshmërinë e rastit, Paneli Këshillëdhënës vendimin e tillë të ri ia referon Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm me qëllim të marrjes së komenteve shtesë për ankesën.

Neni 3
Emërimi dhe dorëheqja e anëtarëve të Panelit

3.1 Kryetari i Gjykatës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut do të propozojë një numër të mjaftueshëm të kandidatëve të përshtatshëm për emërim sipas nenit 5 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2006/12, në pajtim me rregullat e zbatueshme të prokurimit të OKB-së, pas marrjes së kërkesës nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Nëse UNMIK-u nuk merr asnjë propozim apo merr numër të pamjaftueshëm të propozimeve brenda një muaji kalendarik nga kërkesa e tillë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të bëjë emërimin e nevojshëm pa propozimin e kërkuar dhe pas konsultimeve me organet relevante ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

3.2 Nëse një apo më shumë anëtarë të Panelit Këshillëdhënës japin dorëheqje nga postet e tyre, Paneli nuk merr asnjë vendim derisa të bëhen emërimet e reja duke ia mundësuar Panelit të arrijë numrin e parashikuar të anëtarëve.

Neni 4
Publikimet e Panelit Këshillëdhënës

Të gjitha publikimet, njoftimet dhe komunikatat për shtyp të Panelit Këshillëdhënës bëhen përmes zyrës së zëdhënësit të UNMIK-ut dhe informimit publik, që e ndihmon Panelin Këshillëdhënës në njoftimet e tij zyrtare mbi të gjitha çështjet.

Neni 5
Data e prerë për parashtrimin e ankesave

Pavarësisht nga neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, asnjë ankesë dorëzuar Panelit Këshillëdhënës nuk do të jetë e pranueshme nëse pranohet nga Sekretariati i Panelit Këshillëdhënës më vonë se 31 mars 2010.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 17 tetor 2009 dhe është e zbatueshme për të gjitha ankesat e dorëzuara Panelit Këshillëdhënës, duke përfshirë edhe ato të cilat janë në pritje për t"u shqyrtuar nga Paneli Këshillëdhënës.

Lamberto Zannier
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

E. Rregullorja e punës e PKDNJ-së

(e miratuar nga Paneli më 5 shkurt 2008; e ndryshuar më 11 shtator 2009, 21 nëntor 2009 dhe 12 shkurt 2010)

Kapitulli 1. Dispozitat e përgjithshme

Rregulla 1. Qëllimi i rregullave të paraqitura

Rregullat e paraqitura kanë për qëllim përcaktimin e rregullave të cilat do të ndiqen nga Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut dhe ata që paraqiten para tij, në procedurat që përfshihen sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të 23 marsit 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut.

Rregulla 2. Përkufizimet[1]

Rregullat e paraqitura kanë këto kuptime, përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe:

a. termi "Rregullorja nr. 2006/12" nënkupton Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12 e 23 marsit 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut;

a *bis*. termi "Udhëzimi Administrativ nr. 2009/1" nënkupton Udhëzimin Administrativ nr. 2009/1 mbi implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut;

b. termi "Panel" nënkupton Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut;

c. termi "ankues" nënkupton çdo person apo grup personash të cilët kanë parashtruar ankesë apo në emër të të cilëve është parashtruar ankesa;

d. termi "parashtrues i ankesës" nënkupton ankuesin i cili e ka parashtruar një ankesë personalisht, apo anëtari i familjes, organizata joqeveritare apo sindikata që e ka parashtruar një ankesë në emër të ankuesit;

e. termi "përfaqësues" nënkupton personin i cili përfaqëson një palë në procedurat para Panelit, sipas rregullës 17.

Kapitulli 2. Organizimi i Panelit

Rregulla 3. Anëtarët e Panelit

Anëtarët e Panelit shërbejnë vetëm në kapacitetin e tyre personal.

Rregulla 4. Rendi i udhëheqjes[2]

1. Anëtarët e Panelit do ta kenë rendin për të udhëhequr pas kryesuesit duke u bazuar në kohëzgjatjen në detyrë.

2. Anëtarët të cilët kanë kohëzgjatje të njëjtë në detyrë do të renditen për të udhëhequr duke u bazuar në moshën e tyre.

3. Anëtarët e riemëruar do të renditen për të udhëhequr duke pasur parasysh kohëzgjatjen e tyre të mëparshme në detyrë.

Rregulla 5.Dorëheqja[3]

Dorëheqja e një anëtari bëhet e njohur nga kryesuesi i Panelit, i cili do ta njoftojë për këtë Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

---

[1] Pika a *bis* është përfshirë më 12 shkurt 2010.
[2] Fjala "Kryetar" në § 1 është zëvendësuar me "Kryesues" më 12 shkurt 2010.
[3] Fjala "Kryetar" është zëvendësuar me "Kryesues" më 12 shkurt 2010.

Rregulla 6. Zgjedhja e kryesuesit[4]

Paneli e zgjedh kryesuesin e vet me mandat prej një viti. Ai apo ajo mund të rizgjedhet.

Rregulla 7. Funksionet e kryesuesit[5]

Kryesuesi udhëheq punën e Panelit.

Rregulla 8.Zëvendësimi i kryesuesit[6]

Nëse kryesuesi nuk është në gjendje t'i kryejë detyrat e tij apo saj, apo nëse pozita e tij apo saj është e lirë, detyrat e kryesuesit i kryen anëtari tjetër sipas rendit të udhëheqjes të përcaktuar në Rregullën 4.

Rregulla 9. Sekretariati[7]

1. Sekretariati përbëhet nga zyrtari ekzekutiv dhe stafi tjetër profesional dhe administrativ.
2. Zyrtari ekzekutiv, nën mbikëqyrjen e kryesuesit, është përgjegjës për punën e Sekretariatit dhe, në veçanti:
a. duhet të ndihmojë Panelin dhe anëtarët e tij në përmbushjen e detyrave të tyre;
b. duhet të shërbejë si kanal për të gjitha komunikimet lidhur me Panelin;
c. duhet të mbikëqyrë arkivin e Panelit.

Kapitulli 3. Funksionimi i Panelit

Rregulla 10. Selia e Panelit

1. Në pajtim me nenin 4.1 të Rregullores nr. 2006/12, selia e Panelit do të jetë në Prishtinë.
2.Paneli mund të vendosë t'i kryejë funksionet e veta diku tjetër nëse ai mendon se kjo është e përshtatshme.
3. Paneli mund të vendosë, në çdo fazë të shqyrtimit të një ankese, se është e nevojshme që një hetim apo ndonjë funksion tjetër të kryhet diku tjetër nga ai, apo njëri apo më shumë anëtarë të tij.

Rregulla 11. Seancat e Panelit[8]

1. Paneli i cakton datat e seancave të tij.
2. Anëtarët të cilët nuk munden, për shkak të sëmundjes apo arsyeve të tjera, të ndjekin të gjitha apo pjesë të ndonjë seance të Panelit apo nuk mund të kryejnë ndonjë detyrë do ta njoftojnë, sa më shpejt që të jetë e mundshme, për këtë kryesuesin.

Rregulla 12. Tërheqja

1. Një anëtar i Panelit mund të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një rasti nëse:
a. ai ose ajo ka interes personal në rast;
b. ai ose ajo ka shprehur mendime publikisht, përmes medieve, me shkrim, me veprimet publike të tij apo saj apo ndryshe, që janë objektivisht në gjendje të ndikojnë negativisht në paanësinë e tij apo saj;
c. për ndonjë arsye tjetër, pavarësia apo paanësia e tij apo saj mundet në mënyrë legjitime të vihet në dyshim.

[4] Fjala "Kryetar" në titull the tekst është zëvendësuar me "Kryesues" më 12 shkurt 2010.
[5] Fjala "Kryetar" në titull the tekst është zëvendësuar me "Kryesues" më 12 shkurt 2010.
[6] Fjala "Kryetar" në titull the tekst është zëvendësuar me "Kryesues" më 12 shkurt 2010.
[7] Fjala "Kryetar" në § 2 është zëvendësuar me "Kryesues" më 12 shkurt 2010.
[8] Fjala "Kryetar" në § 2 është zëvendësuar me "Kryesues" më 12 shkurt 2010.

2. Në rast të ndonjë dyshimi të ekzistimit të njërës prej arsyeve të përmendura në paragrafin 1, ajo çështje do të vendoset nga Paneli, pa praninë e anëtarit në fjalë.

Rregulla 13. Shqyrtimet[9]

1. Paneli do ta bëjë shqyrtimin në takim të mbyllur. Shqyrtimet e tij mbesin sekrete. Vetëm zyrtari ekzekutiv, anëtarët e Sekretariatit, përkthyesit, dhe personat që i ofrojnë Panelit asistencë teknike apo sekretarie mund të marrin pjesë në takime, përveç nëse Paneli vendos ndryshe.
2. Ku është e nevojshme për Panelin që të vendosë një pikë apo procedurë apo ndonjë çështje tjetër përveç në një takim të caktuar të Panelit, kryesuesi mund të udhëzojë që shqyrtimi të bëhet përmes mjeteve elektronike.

Rregulla 14. Kuorumi[10]

1. Paneli mund të vendosë vetëm nëse të gjithë anëtarët janë të pranishëm apo, në rastin e Rregullës 13 § 2, nëse të gjithë anëtarët marrin pjesë në shqyrtimin përmes mjeteve elektronike.
2. Në rast të tërheqjes së një anëtari apo mungesës së tij apo saj në kuptim të Rregullës 11 § 2, Paneli mund të vendosë me dy anëtarët e tjerë që janë të pranishëm apo marrin pjesë në shqyrtimin përmes mjeteve elektronike.

Rregulla 15. Votimi[11]

Vendimet e Panelit merren nga shumica e anëtarëve që marrin pjesë në votim. Abstenimet nuk lejohen në votimet e fundit mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e rasteve. Në rast të votave të barabarta, vota e kryesuesit është vendimtare.

Kapitulli 4. Procedura

A. Rregullat e përgjithshme

Rregulla 16. Gjuhët

1. Gjuhë zyrtare të Panelit do të jenë gjuha shqipe, serbe dhe angleze.
2. Versioni autentik i vendimeve mbi pranueshmërinë dhe mendimeve mbi bazueshmërinë është ai në gjuhën angleze. Versioni në gjuhën angleze do të përkthehet në gjuhën shqipe dhe serbe.

Rregulla 17. Përfaqësimi i palëve

1. Ankuesit dhe personat të cilët paraqiten në emër të tyre, mund të përfaqësohen para Panelit nga avokatët apo përfaqësuesit e tyre sipas zgjedhjes së tyre.
2. UNMIK-u do të përfaqësohet para Panelit nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm apo ndonjë përfaqësues i caktuar nga ai.

Rregulla 18. Pjesëmarrja e një Amicus Curiae dhe Ombudspersonit

1. Paneli mundet, në pajtim me nenin 13 të Rregullores nr. 2006/12, të ftojë një amicus Curiae apo Ombudspersonin për t'i paraqitur komentet me shkrim.
2. Një ftesë e tillë mund të bëhet nga Paneli duke vepruar me vetiniciativë, apo pas kërkesës me shkrim nga një person apo institucion që është i gatshëm të marrë pjesë si Amicus Curiae, apo nga Ombudspersoni.

[9] Fjala "Kryetar" në § 2 është zëvendësuar me "Kryesues" më 12 shkurt 2010.
[10] Fjalët "dorëheqje apo" në § 2 janë hequr, dhe fjalët "të tjerët" janë përfshirë në mes të fjalëve "me" dhe "dy anëtarë" në § 2 më 12 shkurt 2010.
[11] Fjala "Kryetar" është zëvendësuar me "Kryesues" më 12 shkurt 2010.

Rregulla 19. Veprimi në rastet specifike

1. Paneli mundet, me propozimin e vet apo me kërkesë të një pale, të ndërmarrë çdo veprim që e konsideron të dobishëm apo të nevojshëm për kryerjen e duhur të detyrave të veta sipas Rregullores nr. 2006/12.

2. Paneli mund ta ngarkojë një apo më shumë anëtarë të tij që të ndërmarrin ndonjë veprim të tillë në emër të tij, dhe në veçanti t'i dëgjojnë dëshmitarët apo ekspertët, t'i shqyrtojnë dokumentet apo të vizitojnë ndonjë lokalitet. Anëtari i tillë apo anëtarët e tillë do t'i raportojnë Panelit sipas rregullit.

Rregulla 20. Bashkimi i ankesave

Paneli mundet, nëse e konsideron se është në interes të kryerjes së duhur të procedurave, të urdhërojë bashkimin e dy apo më shumë ankesave.

Rregulla 21. Rendi i trajtimit të ankesave

1. Paneli do t'i trajtojë ankesat sipas rendit, në të cilin ato janë të gatshme për shqyrtim.

2. Paneli mundet, megjithatë, t'i japë përparësi një ankese të caktuar.

Rregulla 22. Masat e përkohshme[12]

1. Paneli apo, ku është e duhur, kryesuesi i tij mundet, me kërkesën e një pale apo ndonjë personi tjetër përkatës, apo me vetë propozimin e tij, t'ua tregojë palëve ndonjë masë të përkohshme, të cilën ai e konsideron se duhet miratuar në interes të palëve apo për kryerjen e duhur të procedurave para tij.

2. Paneli mundet të kërkojë informata nga palët për ndonjë çështje në lidhje me implementimin e ndonjë mase të përkohshme që e ka treguar.

Rregulla 23. Afatet kohore

Në pajtim me nenin 11.3 të Rregullores nr. 2006/12, dhe përveç nëse nuk është zgjatur nga Paneli, afati kohor për UNMIK-un që të japë një përgjigje mbi bazueshmërinë e një ankese të shpallur të pranueshme do të jetë njëzetë ditë nga pranimi i ankesës nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Të gjitha afatet e tjera kohore duhet të caktohen nga Paneli, për ndonjë informatë, vërejtje apo komente të kërkuara nga palët.

Rregulla 24. Shpenzimet

Në pajtim me nenin 10.5 të Rregullores nr. 2006/12, nuk do të bëhet asnjë pagesë për parashtrimin e një ankese.

B. Ankesat

Rregulla 25. Nënshkrimi i ankesave

1. Çdo ankesë e parashtruar sipas nenit 10.2 apo 10.3 të Rregullores nr. 2006/12 do të parashtrohet me shkrim dhe do të nënshkruhet nga parashtruesi i ankesës apo përfaqësuesi i parashtruesit të ankesës.

2. Ku një ankesë parashtrohet nga një person juridik apo një grup personash, ajo duhet të nënshkruhet nga ata persona kompetentë për të përfaqësuar personin e tillë juridik apo grupin. Paneli do të vendosë për çështjen nëse personat që kanë nënshkruar një ankesë janë kompetentë për ta bërë këtë.

[12] Fjala "Kryetar" në § 1 është zëvendësuar me "Kryesues" më 12 shkurt 2010.

3. Ku një parashtrues i ankesës përfaqësohet në pajtim me Rregullën 17 § 1, një autorizim fuqiplotë apo me shkrim duhet të sigurohet nga përfaqësuesi i tij apo saj.

Rregulla 26. Përmbajtja e ankesave

1. Ankesa duhet të përfshijë:

a. identitetin e parashtruesit të ankesës dhe ankuesit, nëse është i ndryshëm nga parashtruesi i ankesës, duke përfshirë, ku është e nevojshme, emrin, datëlindjen, profesionin dhe adresën e personit në fjalë;

b. emrin, profesionin dhe adresën e përfaqësuesit, nëse ka ndonjë;

c. një deklaratë për të gjitha faktet relevante;

d. një deklaratë të përmbledhur të pajtueshmërisë me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nenin 3 të Rregullores nr. 2006/12;

e. një deklaratë të përmbledhur të shkeljeve të pretenduara të instrumenteve të përmendura në nenin 1.2 të Rregullores nr. 2006/12;

f. dëmshpërblimin e kërkuar nga UNMIK-u.

2. Ankuesi mund t'ia bashkëngjisë ankesës ndonjë dëshmi dokumentuese. Parashtruesi i ankesës në çdo rast duhet t'i dorëzojë kopjet e vendimeve, nëse janë gjyqësore apo jo, në lidhje me objektin e ankesës apo që tregojnë se kriteret e pranueshmërisë janë përmbushur.

3. Parashtruesi i ankesës mund të përdorë formularin standard të ofruar nga Sekretariati.

Rregulla 27. Regjistrimi i ankesave

Zyrtari ekzekutiv do të mbajë një regjistër të ankesave, në të cilat duhet të përfshihet data e regjistrimit dhe data e përfundimit të procedurave.

C. Shqyrtimi i pranueshmërisë

Rregulla 28. Caktimi i një raportuesi[13]

1. Kryesuesi do ta caktojë një anëtar si raportues, i cili do ta shqyrtojë ankesën.

2. Në shqyrtimin nga ana e tyre të ankesave, raportuesit

a. mund të kërkojnë nga palët të dorëzojnë, brenda një kohe të caktuar, ndonjë informatë mbi faktet, dokumente apo material tjetër që ata e konsiderojnë të jetë i rëndësishëm;

b. do t'i dorëzojnë raportet e tilla, draftet dhe dokumentet e tjera në mënyrën që mund ta ndihmojë Panelin në kryerjen e funksioneve të veta.

Rregulla 29. Vendimi mbi papranueshmërinë pa e njoftuar UNMIK-un për ankesën

Paneli mundet menjëherë ta shpallë që ankesa është e papranueshme apo ta hedhë atë poshtë.

Rregulla 29bis. Vendimi mbi pranueshmërinë pa e njoftuar UNMIK-un për ankesën

Paneli, po ashtu, mundet menjëherë ta shpallë që ankesa është e pranueshme, ku ankesa ngrit çështjet të cilat janë substancialisht të njëjta si ato që janë ngritur në ankesat e tjera, të cilat tanimë janë shpallur të pranueshme nga Paneli, dhe ku asnjë çështje e re e pranueshmërisë nuk ngritët.[14]

Rregulla 30.Njoftimi i UNMIK-ut për ankesën dhe procedurat me shkrim[15]

1. Alternativisht, Paneli mund të vendosë që

[13] Fjala "Kryetar" në § 1 është zëvendësuar me "Kryesues" më 12 shkurt 2010.
[14] Rregulla 29*bis* është përfshirë më 11 shtator 2009.
[15] Fjalët "lajmëruar për" në § 1 janë zëvendësuar me "njoftuar", fjalët "për ankesën" në § 1 janë zëvendësuar me "mbi pranueshmërinë e ankesës, duke përfshirë çështjen nëse ankesa është qartë e pabazuar,", dhe fjalia e dytë në § 2 është hequr më 12 shkurt 2010.

a. të kërkojë nga palët të paraqesin ndonjë informatë mbi faktet, dokumente apo material tjetër që Paneli e konsideron të jetë i rëndësishëm;

b. ta njoftojë për ankesën Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm dhe ta ftojë UNMIK-ut t'i paraqesë komentet me shkrim mbi pranueshmerinë e ankesës, duke përfshirë çështjen nëse ankesa është qartë e pabazuar, dhe, pas pranimit, të ftojë ankuesin t'i paraqesë komentet në përgjigje;

c. t'i ftojë palët të paraqesin komente të tjera me shkrim.

2. Para marrjes së vendimit të tij mbi pranueshmërinë, Paneli mund të vendosë, me kërkesën e një pale apo me vetë propozimin e tij, të mbajë një seancë dëgjimore nëse ai konsideron se kryerja e funksioneve të tij sipas Rregullores nr. 2006/12 e kërkon këtë.

Rregulla 31. Deklarimi i papranueshmërise[16]

Çdo deklarim i papranueshmërisë duhet në parim që të ngritët nga UNMIK-u në komentet e tij me shkrim mbi pranueshmërinë e ankesës siç përcaktohet në Rregullën 30 § 1 b.

Rregulla 31bis. Çështja e pranueshmërisë e lidhur me bazueshmërinë[17]

Ku Paneli vendos se një çështje e pranueshmërisë është e lidhur ngushtë me bazueshmërinë e ankesës, ai mund t'ia bashkojë çështjen bazueshmërisë. Në atë rast, me kusht që të mos ketë pengesa të tjera për pranueshmërinë, ai do ta shpallë ankesën të pranueshme.

Rregulla 32. Vendimi mbi pranueshmërinë

1. Vendimi i Panelit duhet të përmbajë një përshkrim të shkurtër të fakteve si dhe arsyeve të bazuara në paragrafët e ligjit. Në të ceket nëse është marrë unanimisht apo nga një shumicë.

2. Çdo anëtar i cili ka marrë pjesë në shqyrtimin e rastit, do të ketë të drejtën t'ia shtojë si shtojcë vendimit të Panelit ose një mendim të ndarë, për miratimin apo kundërshtimin e atij vendimi, apo një deklaratë të thjeshtë për kundërshtimin.

Rregulla 33. Çështja e pranueshmërisë është ngritur apo ngritët pasi që ankesa është shpallur e pranueshme[18]

1. Në rast se një çështje e re e pranueshmërisë është ngritur apo ngritet pasi që ankesa është shpallur e pranueshme, Paneli do ta pezullojë, në pajtueshmëri me nenin 2.3 të Udhëzimit Administrativ nr. 2009/1, shqyrtimin e vet mbi bazueshmërinë dhe vendos për çështjen e pranueshmërisë me një vendim të veçantë.

2. Megjithatë, ku është e qartë që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm tanimë e ka diskutuar plotësisht bazueshmërinë e ankesës, Paneli mundet menjëherë të miratojë mendimin e vet mbi bazueshmërinë, në të cilin ai pastaj përfshin vendimin e vet mbi çështjen e pranueshmërisë.

D. Shqyrtimi i bazueshmërisë

Rregulla 34. Procedurat pas pranimit të një ankese[19]

1. Sapo një ankesë të jetë shpallur e pranueshme, apo pas një konfirmimi mbi pranueshmërinë e ankesës menjëherë pas shqyrtimit të një çështje të re të pranueshmërisë sipas Rregullës 33 § 1, Paneli e fton Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të komentojë apo japë komente të tjera mbi bazueshmërinë. Ai mund të ftojë ankuesin të paraqesë dëshmi shtesë dhe vërejtje me shkrim, duke përfshirë vërejtjet mbi komentet e bëra nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

---

[16] Fjalët "duhet, përderisa karakteri dhe rrethanat lejojnë," janë zëvendësuar me "duhet në parim", fjalët "apo me gojë" janë hequr, dhe fjalët "Rregulla 30" janë zëvendësuar me "Rregulla 30 § 1 b" më 12 shkurt 2010.

[17] Rregulla 31*bis* është përfshirë më 12 shkurt 2010.

[18] Rregulla 33 është zëvendësuar më 12 shkurt 2010.

[19] **§** 1 është zëvendësuar më 12 shkurt 2010.

2. Paneli mund të vendosë, me kërkesën e një pale apo me vetë propozimin e tij, që të mbajë një seancë dëgjimore mbi bazueshmërinë nëse ai konsideron se kryerja e funksioneve të tij sipas Rregullores nr. 2006/12 e kërkon këtë.

3. Paneli, ku është e nevojshme, do t'i caktojë procedurat me shkrim dhe me gojë.

Rregulla 35. Mendimi mbi bazueshmërinë

1. Në pajtim me nenin 17.1 të Rregullores nr. 2006/12, Paneli do ta miratojë një mendim që përmban të gjeturat e tij sa i përket asaj nëse ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut të ankuesit.

2. Në pajtim me nenin 17.1 të Rregullores nr. 2006/12, Paneli mundet, kur ai e konsideron të nevojshme, të japë rekomandime duke u bazuar në të gjeturat e veta. Këto rekomandime mund të kenë të bëjnë me, në veçanti, me masat korrigjuese që duhet marrë pas gjetjes së një shkelje të të drejtave të njeriut të ankuesit.

Rregulla 36. Forma e mendimit

1. Mendimi duhet të përmbajë:

a. emrin e anëtarëve të Panelit të cilët kanë marrë pjesë në miratimin e mendimit, dhe emrin e zyrtarit ekzekutiv të Sekretariatit;
b. datën në të cilën ai është miratuar;
c. një përshkrim të palëve dhe përfaqësuesve të tyre;
d. një shpjegim për procedurën e ndjekur;
e. faktet për rastin;
f. një përmbledhje të parashtresave të palëve;
g. arsyet në paragrafët e ligjit;
h. dispozitat në fuqi;
i. numrin e anëtarëve që përbëjnë shumicën.

2. Çdo anëtar, i cili ka marrë pjesë në shqyrtimin e rastit, do të ketë të drejtën t'ia shtojë si shtojcë mendimit të Panelit ose një mendim të ndarë, për miratimin apo kundërshtimin e atij vendimi, apo një deklaratë të thjeshtë për kundërshtimin.

E. Dëshmia

Rregulla 37. Dëshmia në të cilën janë bazuar vendimet dhe mendimet

Paneli do t'i bazojë vendimet dhe mendimet e veta në çdo dëshmi të cilën ai e konsideron të rëndësishme për ankesën, duke përfshirë dëshminë e mbledhur me vetiniciativë.

Rregulla 38. Paraqitja e dëshmive shtesë nga palët

Palët mund të paraqesin dëshmi shtesë në çdo kohë gjatë procedurave, derisa Paneli të ketë përfunduar shqyrtimin e rastit. Paneli mundet, megjithatë, kur është e nevojshme për kryerjen e duhur të detyrave të veta sipas Rregullores nr. 2006/12, të caktojë një afat kohor për paraqitjen e dëshmisë së tillë.

Rregulla 39. Masat hetimore

1. Paneli mundet, me kërkesën e një pale apo me vetë propozimin e tij, të miratojë ndonjë masë hetimore të cilën ai e konsideron të përshtatshme për qartësimin e fakteve të këtij rasti.

2. Paneli mundet, *inter alia*, në pajtim me nenin 15.1 të Rregullores nr. 2006/12, të kërkojë paraqitjen e ndonjë personi, duke përfshirë personelin e UNMIK-ut, si dëshmitar apo ekspert apo në një cilësi tjetër, apo dorëzimin e ndonjë dokumenti, duke përfshirë dosjet dhe dokumentet në posedim të UNMIK-ut, të cilat mund të jenë të rëndësishme për ankesën. Kërkesat për paraqitjen e personelit të UNMIK-ut apo dorëzimin e dokumenteve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara do t'i dorëzohen

Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm dhe ai do të veprojë në pajtim me nenin 15.3 të Rregullores nr. 2006/12.

Rregulla 39bis. Kërkesat për kufizime në zbulimin e dëshmisë[20]

1. Çdo palë mund t'i kërkojë Panelit që të mos i zbulohet palës tjetër dëshmia e dorëzuar nga ajo, me qëllim të mbrojtjes së interesit të rëndësishëm publik apo të mbrojtjes së të drejtave fundamentale të ankuesit apo të ndonjë personi tjetër në fjalë. Çdo kërkesë e tillë duhet të përfshijë arsyet dhe specifikojë nëse kërkohet që zbulimi i të gjitha apo një pjese të informatave të dorëzuara të jetë i kufizuar. Paneli do të vendosë për kërkesën në bazën *ex parte*.

2. Nëse Paneli e miraton kërkesën, ai duhet ta informojë palën tjetër për vendimin e vet, dhe të veprojë në pajtim me këtë. Deri në shkallën që nuk do të vërë në rrezik karakterin konfidencial të informatave të pranuara, Paneli do ta tregojë natyrën e dëshmisë së pranuar në besim. Do të jetë e mundshme për Panelin t'i bazojë vendimet e veta në dëshminë e pranuar në besim.

3. Nëse Paneli, nuk e miraton kërkesën, apo nëse ai e miraton atë vetëm pjesërisht, ai do ta informojë palën kërkuese për vendimin e vet, dhe t'i japë asaj mundësinë ta rikonsiderojë çështjen e paraqitjes së dëshmisë para Panelit.

Rregulla 39ter. Konfidencialiteti i dëshmisë së mbledhur nga Paneli me vetiniciativë[21]

Nëse Paneli pranon dëshmi nga një palë e tretë me kusht të konfidencialitetit, ai nuk do t'ia zbulojë atë dëshmi ndonjërës nga palët. Do të jetë e mundshme që Paneli t'i bazojë vendimet e veta në dëshminë e marrë në besim.

F. Seancat dëgjimore

Rregulla 40. Karakteri publik i seancave dëgjimore

Në pajtim me nenin 16.1 të Rregullores nr. 2006/12, seancat dëgjimore do të jenë publike, përveç nëse Paneli në rrethana të jashtëzakonshme vendos ndryshe.

Rregulla 41.Mbajtja e seancave dëgjimore[22]

1. Kryesuesi i organizon dhe udhëheq seancat dëgjimore.
2. Çdo anëtar i Panelit mund t'i bëjë pyetje secilit person që paraqitet para Panelit.

G. Nënshkrimi, shpërndarja, njoftimi dhe publikimi i vendimeve dhe mendimeve

Rregulla 42.Shpërndarja e vendimeve dhe mendimeve[23]

Vendimet dhe mendimet duhet të shpërndahen me shkrim.

Rregulla 43. Nënshkrimi i vendimeve dhe mendimeve[24]

Vendimet dhe mendimet nënshkruhen nga kryesuesi dhe zyrtari ekzekutiv i Sekretariatit.

Rregulla 44. Njoftimi për vendimet dhe mendimet

Palët njoftohen për vendimet dhe mendimet.

---

[20] Rregulla 39*bis* është përfshirë më 21 nëntor 2009.
[21] Rregulla 39*ter* është përfshirë më 21 nëntor 2009.
[22] § 1 është zëvendësuar më 12 shkurt 2010.
[23] Rregullës së parë 43 i është ricaktuar numri më 12 shkurt 2010.
[24] Fjala "Kryetar" në Rregullën e parë 42 është zëvendësuar me "Kryesues", dhe Rregullës së parë 42 i është ricaktuar numri më 12 shkurt 2010.

Rregulla 45. Publikimi i vendimeve dhe mendimeve

Vendimet dhe mendimet, në pajtim me nenin 17.2 të Rregullores nr. 2006/12, duhet të publikohen me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

H. Rishikimi dhe korrigjimi i gabimeve

Rregulla 46.Kërkesat për rishikimin e një vendimi apo një mendimi

1. Një palë mundet, në rast të zbulimit të një fakti i cili sipas natyrës së vet ka ndikim vendimtar dhe i cili, kur është shpërndarë vendimi apo mendimi, ka qenë i panjohur për Panelin dhe arsyeshëm nuk ka mundur të jetë i njohur për atë palë, që t'i kërkojë Panelit brenda një periudhe prej një muaji pasi ajo palë është vënë në dijeni për faktin, ta rishikojë atë vendim apo mendim.
2. Në kërkesë përmendet vendimi apo mendimi për të cilin kërkohet rishikimi dhe ajo përmban informata të nevojshme për të treguar që është vepruar në pajtueshmëri me paragrafin 1. Ai shoqërohet me një kopje të të gjitha dokumenteve përcjellëse.
3. Paneli mundet të refuzojë kërkesën me arsyetim se nuk ka asnjë arsye për të justifikuar shqyrtimin e saj.
4. Nëse Paneli nuk e refuzon kërkesën, ai do ta njoftojë për atë palën apo palët e tjera dhe do t'i ftojë ato të japin komente me shkrim brenda afatit kohor të caktuar nga Paneli. Paneli, po ashtu, e cakton datën e seancës dëgjimore nëse Paneli vendos ta mbajë një seancë dëgjimore.

Rregulla 47. Korrigjimi i gabimeve dhe rishikimi editorial

1. Pa paragjykuar Rregullën 46, Paneli mundet, me iniciativën e vet apo me kërkesë të një pale të bërë brenda një muaji nga shpërndaja e një mendimi, t'i korrigjojë gabimet e bëra nga nëpunësit administrativë, gabimet në llogaritje dhe gabimet e qarta.
2. Vendimet dhe mendimet i nënshtrohen rishikimit editorial.

I. Përjashtimi

Rregulla 48.Përjashtimi në rastet individuale

Dispozitat e këtij kapitulli nuk ia parandalojnë Panelit që t'i përjashtojë ato për të shqyrtuar një rast të veçantë, kur është e nevojshme për kryerjen e duhur të detyrave të veta sipas Rregullores nr. 2006/12.

Kapitulli 5. Dispozitat përfundimtare

Rregulla 49. Çështjet që nuk rregullohen nga Rregullorja e punës

Çështjet që nuk rregullohen nga Rregullorja aktuale e punës do të përcaktohen nga Paneli, i cili do ta bazojë vendimin e vet në dispozitat e Rregullores nr. 2006/12 dhe, sa të jetë e mundshme, në Rregullat e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rregulla 50. Versionet gjuhësore të Rregullores së punës

Rregullorja aktuale e punës është miratuar në gjuhën angleze, i cili tekst përbën versionin autentik. Teksti duhet të përkthehet në gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe.

F. Bibliografia

- Antonov A., "Post-Conflict Criminal Investigation by International Experts: How Effective? (the Kosovo Example)" ("Hetimet penale pas konfliktit nga ekspertët ndërkombëtarë: Sa ishin efektive?), në L. Early dhe A. Austin (bot..) *The Right to Life under Article 2 of the European Convention on Human Rights. In Honour of Michael O'Boyle (E drejta në jetë sipas nenit 2 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut.Në nder të Michael O'Boyle)*, Oisterwijk, Wolf Legal Publishers, 2016, fq. 135-144.

- Antonov A., "Post-Conflict Criminal Investigation by International Specialists. Standards v. Realities (Kosovo example)" ("Hetimet penale pas konfliktit nga specialistët ndërkombëtarë. Standardet k. realiteteve (Shembulli i Kosovës) [PDF], *Palestra*, Nr. 1-2, 2016, fq. 137-144.

- Balcerzak M., "*Odpowiedzialność Misji Tymczasowej Administracji ONZ w Kosowie za naruszenia praw człowieka. Uwagi na tle działalności Panelu Doradczego ds. Praw Człowieka, in Globalne problemy ochrony praw człowieka*", Varshavë, E. Karska, 2015, fq. 277-296.

- Benedek W., "Kosovo – UNMIK Accountability: Human Rights Advisory Panel Finds Discrimination in Privatization Cases" ("Kosovë-Përgjegjësia e UNMIK-ut: Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut gjen diskriminim në rastet e privatizimit"), *Revistë australiane për të drejtën*, nr. 2, 2015, fq. 277-284.

- Benvenisti E., *The International Law of Occupation (E drejta ndërkombëtare për okupimin)*, Oksford, Oxford University Press, 2012, fq. 288-291.

- Beulay M., "Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut: La décision B.A. c. MINUK, illustration du sérieux d'une solution initialement cosmétique" [PDF], *Lettre « Actualités Droits-Libertés » du CREDOF*, 24 prill 2013.

- Beulay M., "Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut: Un approfondissement inédit de l'obligation des Nations Unies en matière d'enquête" [PDF], *Lettre « Actualités Droits-Libertés » du CREDOF*, 27 shtator 2013.

- Beulay M., *L'applicabilité des droits de l'homme aux organisations internationales*, doctoral thesis, Université Paris Ouest - Nanterre La Défense, dhjetor 2015, fq. 512-519.

- Burke M. and Persi-Vicentic L., "Remedies and Reparations", ("Mjetet juridike dhe dëmshpërblimet") në S. Casey-Maslen (bot.), *Weapons Under International Human Rights Law (Armët sipas të Drejtës së Gjykatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut)*, Kembrixh, Cambridge University Press, 2014, fq. 574-575.

- Chinkin C., "The Kosovo Human Rights Advisory Panel" ("Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut në Kosovë") [PDF], *International Law Meeting Summary (Përmbledhje e takimit për të Drejtën ndërkombëtare)* ((Chatham House (Instituti Mbretëror për Marrëdhënie Ndërkombëtare), Londër, 26 janar 2012).

- Cuni E., "Human Rights Violation in Kosovo: The Consequences of Kosovo Conflict and the Future of the Country" ("Shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë: Pasojat e konfliktit të Kosovës dhe e ardhmja e vendit"), *International Journal of Rule of Law, Transitional Justice and Human Rights (Revistë ndërkombëtare mbi sundimin e ligjit, drejtësinë kalimtare dhe të drejtat e njeriut)*, 2014, fq. 145-155, veç. në fq. 153-154.

- Devereux A., "Selective Universality? Human-Rights Accountability of the UN in Post-Conflict Operations" (Universaliteti selektiv? Përgjegjësia për të drejtat e njeriut në

operacionet e OKB-së pas konfliktit"), në B. Bowden *et al* (bot.), *The Role of International Law in Rebuilding Societies after Conflict. Great Expectations (Roli i drejtësisë ndërkombëtare në rindërtimin e shoqërive pas konfliktit. Pritjet e mëdha),* Kembrixh, Cambridge University Press, 2009, fq. 198-217.

- Everly R., "Reviewing Governmental Acts of the United Nations in Kosovo" ("Shqyrtimi i akteve qeveritare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë"), *German Law Journal (Revistë gjermane mbi të drejtën),* Vëll. 8, nr. 1, 2007, fq. 21-38.

- Istrefi R., "Should the United Nations Create an Independent Human Rights Body in a Transitional Administration? The Case of the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo (UNMIK)" ("A duhet Organizata e Kombeve të Bashkuara të krijojë një organ këshillëdhënës për të drejtat e njeriut në një administrim kalimtar? Rasti i Misionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-ut)), në J. Wouters *et al* (bot.), *Accountability for Human Rights Violations by International Organisations (Përgjegjësia për shkeljet e të drejtave të njeriut nga organizatat ndërkombëtare),* Antverp-Oksford-Portlend, Intersentia, 2010, fq. 355-372.

- Jamet A., "La responsabilité des organisations internationales à partir de l'exemple du Panel consultatif des droits de l'homme de la MINUK", Mémoire de Master 2, Université Paris Sud - Faculté Jean Monnet, Viti akademik 2013-2014.

- Klein P., "Le Panel consultatif des droits de l'homme (Human Rights Advisory Panel) de la MINUK: une étape dans le processus de responsabilisation des Nations Unies?", në M. Kohen *et al* (bot.), *Perspectives of International Law in the 21st century (Perspektivat e të Drejtës ndërkombëtare në shekullin e 21-të). Liber Amicorum Christian Dominicé*, Leiden-Boston, Martinus Nijhoff Publishers, 2012, fq. 225-255.

- Knoll B. dhe Uhl R.-J., "Too little, too late: the Human Rights Advisory Panel in Kosovo" ("Tepër pak, tepër vonë: Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut në Kosovë"), *European Human Rights Law Review (Shqyrtim mbi të Drejtën Evropiane për të Drejtat e Njeriut),* Vëll. 7, nr. 5, 2007, fq. 534-549.

- Lemay-Hébert N., "State-Building from the Outside-In: UNMIK and Its Paradox" ("Shtetndërtimi nga jashtë/brenda: UNMIK-u dhe paradoksi i tij"), *Revistë për çështje publike dhe ndërkombëtare***,** Vëll. 20, 2009, fq. 65-86.

- Momirov A, "Local Impact of 'UN Accountability' Under International Law: The Rise and Fall of UNMIK's Human Rights Advisory Panel" ("Ndikimi lokal i 'Përgjegjësisë së OKB-së' sipas të Drejtës ndërkombëtare: Ngritja dhe rënia e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-ut"), *Paqeruajtja ndërkombëtare*, Vëll. 19, nr. 1, 2012, fq. 3-18.

- Murati G. B., "The Protection of Human Rights Through a Surrogate State Administration: the United Nations Interim Administration in Kosovo/a" ("Mbrojtja e të drejtave të njeriut përmes një administrate shtetërore surrogate: Misioni i Administratës së Përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë"), Disertacion i paraqitur me qëllim të marrjes së gradës së doktoratës në drejtësi, Universiteti i Gentit, tetor 2014.

- Nolte G., "Human Rights Protection Against International Institutions in Kosovo: The Proposals of the Venice Commission of the Council of Europe and their Implementation" ("Mbrojtja e të drejtave të njeriut kundrejt institucioneve ndërkombëtare në Kosovë: Propozimet e Komisionit të Venedikut të Këshillit të Evropës dhe implementimi i tyre"), në Dupuy P.-M. *et al* (bot.), *Common values in international law. Essays in honour of Christian Tomuschat (Vlerat e përbashkëta në të drejtën ndërkombëtare. Ese për nder të Christian Tomuschat),* Kehl, Engel, 2006, fq. 245-258.

- Nowak M., "Enforced Disappearance in Kosovo. Human Rights: Advisory Panel Holds UNMIK Accountable" (Zhdukja e imponuar me forcë në Kosovë. Të drejtat e njeriut: Paneli Këshillëdhënës e konsideron përgjegjës UNMIK-un"), *European Human Rights Law Review (Shqyrtim mbi të Drejtën Evropiane për të Drejtat e Njeriut)*, Vëll. 18, nr. 3, 2013, fq. 275-283.

- Nowicki, M.A., "Kosovë", *The Conscience of Europe: 50 years of the European Court of Human Rights (Ndërgjegjja e Evropës: 50 vjet të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut)*, Londër, Third Millennium Publishing Limited, 2010, fq. 178-179.

- Pacquée D. dhe Dewulf S., "International Territorial Administrations and the Rule of Law: The Case of Kosovo" ("Administrimet territoriale ndërkombëtare dhe sundimi i ligjit: Rasti i Kosovës"), *Essex Human Rights Review (Shqyrtim për të drejtat e njeriut i Eseksit)*, Vëll. 4, nr. 1, 2007, fq. 1-14.

- Reich U.A., *Internationale Verwaltung im Kosovo. Rechtsgrundsätze internationaler Administration am Beispiel der UNMIK*, Baden-Baden, Nomos Verlagsgesellschaft, 2012, fq. 240-241.

- Ryngaert C., "The Accountability of International Organizations for Human Rights Violations: The Cases of the UN Mission in Kosovo (UNMIK) and the UN 'Terrorism Blacklists'" (Përgjegjësia e organizatave ndërkombëtare për shkeljet e të drejtave të njeriut: Rastet e Misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK-ut) dhe 'Listat e zeza për terrorizëm' të OKB-së"), në M. Fitzmaurice dhe P. Markouris (bot.), *The Interpretation and Application of the European Convention on Human Rights. Legal and Practical Implications (Interpretimi dhe aplikimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Implikimet ligjore dhe praktike)*, Leiden – Boston, Martinus Nijhoff Publishers, coll. Queen Mary Studies in International Law (Studimet në Kol. Mbretëresha Mary (Meri) në të Drejtën Ndërkombëtare), Vëll. 12, 2012, fq. 73-91.

- Stahn C., *The Law and Practice of International Territorial Administration: Versailles to Iraq and Beyond (E drejta dhe praktika e administrimit territorial ndërkombëtar: Nga Versaja në Irak dhe më tej)*, Kembrixh, Cambridge University Press, 2008, fq. 308-331.

- Thallinger G., "Sense and Sensibility of the Human Rights Obligations of the United Nations Security Council" ("Ndjenja dhe njdeshmëria për obligimet për të drejtat e njeriut të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara"), *ZaöRV*, Vëll. 67, 2007, fq. 1015-1040, veç. në f. 1038.

- Verdirame G., *The UN and Human Rights: Who Guards the Guardians (OKB-ja dhe të drejtat e njeriut: Kush i mbron mbrojtësit)*, Kembrixh, Cambridge University Press, 2011, fq. 256-266.

- Wilde R., *International Territorial Administration: How Trusteeship and the Civilizing Mission Never Went Away (Administrimi territorial ndërkombëtar: Si kujdestaria dhe misioni civilizues nuk u larguan kurrë)*, Oksford, Oxford University Press, 2010, fq. 144-146.

- Werzer J., "The UN Human Rights Obligations and Immunity: An Oxymoron Casting a Shadow on the Transitional Administrations in Kosovo and East Timor" ("Obligimet dhe imuniteti për të drejtat e njeriut i OKB-së: Një oksimoron (kombinimi i të kundërtave) që hedh hije në administrimet ndërkombëtare në Kosovë dhe Timorin Lindor, *Revistë nordike e të drejtës ndërkombëtare*, Vëll. 77, nr. 1, 2008, fq. 105 et seq.

- Wills S., *Protecting Civilians. The Obligations of Peacekeepers (Mbrojtja e civilëve: Obligimet e paqeruajtësve)*, Oksford, Oxford University Press, 2009, fq.40-51.

G. Tabela statistikore

Ngarkesa me lëndë e PKDNJ-së, Komunikatat&Vendimet (si më 30 maj 2016)													
Numri i lëndëve		**2006**	**2007**	**2008**	**2009**	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**	**Gjithsej**
Të pranuara		3	12	69	353	90[1]	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	**527**
Të mbyllura		0	0	18	11	35[2]	98	95	85	97	79	9	**527**
Në zhvillim e sipër		3	15	66	408	463	365	270	185	88	9	0	**0**
Vendimet sipas llojit		**2006**	**2007**	**2008**	**2009**	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**	**Gjithsej**
Gjithsej		0	0	34	23	79	213	270	91	103	79	10	**902**
Vendimet mbi pranueshmërinë		0	0	30	19	51	164	238	10	3	-	-	**515**
Vendimet për pranueshmëri të pjesshme		0	0	2	0	1	0	0	-	-	-	-	**3**
Heqja nga lista		0	0	0	3	5	2	6	-	-	-	-	**16**
Mendimet mbi bazueshmërinë		0	0	1	0	22	46	23	79	96	79	9	**355**
Mendimet e pjesshme mbi bazueshmërinë		0	0	0	1	0	0	0	-	-	-	-	**1**
Kërkesat për rishikim/ rihapja		0	0	1	0	0	1	3	2	4	-	1	**12**
Vendimet sipas gjetjeve		**2006**	**2007**	**2008**	**2009**	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**	**Gjithsej**
Vendimet	Të pranueshme	0	0	11	2	16	63	112	2	-	-	-	**206**
	Pjesërisht të pranueshme	0	0	2	9	25	51	60	2	2	-	-	**151[3]**
	Të papranueshme	0	0	17	8	10	50	66	6	1	-	-	**158**
Mendimet:Shkelje		0	0	1	0	21	45	21	76	88	74	9	**335**
Mendimet:Nuk ka shkelje		0	0	0	1	1	1	2	3	8	5	-	**21[4]**
Kërkesat për rishqyrtim	Të refuzuara	0	0	1	0	0	1	1	2	4	-	1	**10**
	Të miratuara	0	0	0	0	0	0	2	-	-	-	-	**2**

1 Pas shqyrtimit të Panelit, lënda nr. 25/10 është ndarë në dy lëndë (lënda e re nr. 90/10)
2 Dy lëndë (nr. 04/07 dhe 26/08) të shpallura të papranueshme në vitin 2010, janë rihapur nga Paneli në vitin 2012.
3 Tri nga to janë vendime për"pranueshmëri të pjesshme"
4 Njëra nga to është mendim i pjesshëm mbi bazueshmërinë.

H. Vendimet dhe mendimet e PKDNJ-së të përmendura në këtë Raport
(sipas rendit alfabetik)

1. *Anxhellkoviq*, nr. 277/09, mendimi i 23 janarit të vitit 2014
2. *Antiq*, nr. 100/09, mendimi i 12 shtatorit të vitit 2013
3. *B.A.*, nr. 52/09, mendimi i 1 shkurtit të vitit 2013
4. *Balaj dhe të tjerët*, nr. 04/07, vendimi i 11 majit të vitit 2012
5. *Balaj dhe të tjerët*, nr. 04/07, mendimi i 27 shkurtit të vitit 2015
6. *Baraq*, nr. 149/09, vendimi i 1 tetorit të vitit 2012
7. *B.K.*, nr. 85/10, mendimi i 13 nëntorit të vitit 2015
8. *Bucalo dhe të tjerët*, nr. 148/09 *et al*, mendimi i 4 shkurtit të vitit 2016
9. *Buleviq*, nr. 146/09, mendimi i 13 dhjetorit të vitit 2013
10. *Çunguroviq*, nr. 131/09, mendimi i 6 gushtit të vitit 2014
11. *Demiroviq*, nr. 57/08, vendimi i 17 prillit të vitit 2009
12. *Punëtorët e minierave Kishnicë dhe Novobërdë të Kombinatit Trepça*, nr. 81/10, mendimi i 18 majit të vitit 2016
13. *Pesë ankesa*, nr. 43/09 *et al*, mendimi i 31 korrikut të vitit 2013
14. *Guga*, nr. 47/08, mendimi i 24 janarit të vitit 2014
15. *Ibraj*, nr. 14/09 et *al*, mendimi i 6 gushtit të vitit 2014
16. *Jociq*, nr. 34/09, mendimi i 23 prillit të vitit 2013
17. *Joviçiq*, nr. 233/09, mendimi i 24 qershorit të vitit 2015
18. *Kostiq dhe të tjerët*, nr. 111/09 *et al*, mendimi i 23 tetorit të vitit 2015.
19. *Krasniqi*, nr. 08/10, mendimi i 17 majit të vitit 2016
20. *Kushiq*, nr. 08/07, mendimi i 15 majit të vitit 2010
21. *Kuzmanoviq*, nr. 262/09, mendimi i 21 janarit të vitit 2015
22. *Llaziq*, nr. 261/09, mendimi i 27 shkurtit të vitit 2015
23. *Milenkoviq*, nr. 255/09, mendimi i 26 qershorit të vitit 2015
24. *Millogoriq dhe të tjerët*, nr. 38/08 *et al*, mendimi i 24 marsit të vitit 2010
25. *Miriq dhe të tjerët*, nr. 68/09 *et al*, mendimi i 10 shtatorit të vitit 2015
26. *Mishlen dhe të tjerët*, nr. 58/09 *et al*, mendimi i 13 nëntorit të vitit 2015
27. *Mitroviq dhe të tjerët*, nr. 144/09 *et al*, mendimi i 13 nëntorit të vitit 2014
28. *Mlladenoviq*, nr. 99/09, mendimi i 26 qershorit të vitit 2014
29. *N.M. dhe të tjerët*, nr. 26/08, mendimi i 26 shkurtit të vitit 2016
30. *Nikoliq dhe të tjerët*, nr. 72/09 *et al*, mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2014
31. *Parliq*, nr. 01/07, mendimi i 18 qershorit të vitit 2010
32. *Paviq*, nr. 98/09, mendimi i 26 prillit të vitit 2013
33. *Pejçinoviq*, nr. 89/09, mendimi i 13 marsit të vitit 2014
34. *Remishtar*, nr. 245/09, mendimi i 14 tetorit të vitit 2014
35. *Ristiq*, nr. 224/09 *et al*, mendimi i 11 shtatorit të vitit 2015
36. *Ristiq*, nr. 319/09, mendimi i 30 majit të vitit 2014
37. *S.C.*, nr. 02/09, mendimi i 12 dhjetorit të vitit 2013
38. *S.M.*, nr. 342/09, mendimi i 18 marsit të vitit 2016
39. *Spahiu*, nr. 02/08, mendim i pjesshëm i 20 marsit të vitit 2009
40. *Spasiq dhe të tjerët*, nr. 221/09 *et al*, mendimi i 31 korrikut të vitit 2013
41. *Stevanoviq*, nr. 289/09, mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2014

42. *Stojkoviq*, nr. 87/09, mendimi i 14 dhjetorit të vitit 2013
43. *Tomanoviq dhe të tjerët*, nr. 248/09 *et al*, mendimi i 25 prillit të vitit 2013
44. *Vitosheviq*, nr. 90/09 dhe 103/09, mendimi i 27 nëntorit të vitit 2013
45. *Vitosheviq dhe Majmareviq*, nr. 139/09 *et al*, mendimi i 23 janarit të vitit 2014
46. *Vuçkoviq*, nr. 03/07, mendimi i 13 marsit të vitit 2010
47. *Vuliq*, nr. 05/07, mendimi i 18 marsit të vitit 2011
48. *X*., nr. 326/09 *et al*, mendimi i 6 qershorit të vitit 2013
49. *Zdravkoviq*, nr. 46/08, vendimi i 17 prillit të vitit 2009
50. *Zdravkoviq*, nr. 46/08, mendimi i 25 shkurtit të vitit 2013

I. Raportet apo mendimet në të cilat është diskutuar për PKDNJ-në

- Amnesty International, *Kosovë: Trashëgimia e UNMIK-ut, Dështimi për t'iu ofruar drejtësi dhe kompensime të afërmve të të rrëmbyerve* [PDF], Londër, 2013, fq. 9-21.
- Komisari i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, *Të drejtat e njeriut në Evropë: Nuk ka arsye për vetëkënaqësi* [PDF], Strasburg, 2009, fq. 346-350.
- Komisari i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, *Raport i Komisarit të Këshillit të Evropës për Misionin Special për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (23-27 mars 2009)* [PDF], CommDH(2009)23, Strasburg, 2 korrik 2009, fq. 12-14, §§ 66-79.
- Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit ("Komisioni i Venedikut"), *Mendimi mbi mekanizmat ekzistues për të shqyrtuar pajtueshmërinë me standardet për të drejtat e njeriut të akteve të UNMIK-ut dhe EULEX-it në Kosovë,* Mendimi nr. 545/2009, CDL-AD(2010)051, Strasburg, 21 dhjetor 2010, §§ 18-47.
- Human Rights Watch, *Kosovë: Të helmuar nga plumbi – Një krizë shëndetësore dhe e të drejtave të njeriut në kampet e Mitrovicës me romë* [PDF], qershor 2009, fq. 16-17, 33-34, 68 dhe 70.
- Human Rights Watch, *Raport botëror 2008* [PDF], Nju Jork, 2008, fq. 429.
- Human Rights Watch, *Raport botëror 2009* [PDF], Nju Jork, 2009, fq. 412.
- Human Rights Watch, *Raport botëror 2010* [PDF], Nju Jork, 2010, fq. 448.
- Human Rights Watch, *Raport botëror 2011* [PDF], Nju Jork, 2011, fq. 472-473.
- Human Rights Watch, *Raport botëror 2015* [PDF], Nju Jork, 2015, fq. 473.
- Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Pavarësia e gjyqësorit në Kosovë: Dimensionet institucionale dhe funksionale* [PDF], Prishtinë, janar 2012, fq. 26.
- Zyra e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, *Raport i vitit 2009 mbi aktivitetet dhe rezultatet* [PDF], Gjenevë, 2009, fq. 144-145.
- Zyra e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, *Raport i ZKLDNJ për vitin 2011* [PDF], Gjenevë, 2011, fq. 334.
- Zyra e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, *Raport i ZKLDNJ për vitin 2011* [PDF], Evropa dhe Azia Qendrore, 2011, fq. 145.

J. Përmendjet e PKDNJ-së në raportet e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së

S/2006/45 e 25 janarit të vitit 2006

75. Një rregullore mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut pret miratimin nga Selia e Përgjithshme.

S/2008/211 e 28 marsit të vitit 2008

24. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut ka mbajtur tri seanca pune që nga inaugurimi i tij në nëntor të vitit 2007. Paneli zgjodhi kryesuesin e vet, miratoi Rregulloren e vet të punës dhe vazhdoi me shqyrtimin e ankesave, që kishin të bënin me çështje sikur të drejtat në pronë dhe qasja në gjykata. Ai e mori vendimin e vet të parë në shkurt.

S/2008/458 e 15 korrikut të vitit 2008

23. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut është tani plotësisht funksional. Dërgimi i një eksperti si zëvendësim nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e ka rritur kapacitetin e tij teknik për hulumtim, analizë dhe hartim ligjor të dokumenteve lidhur me të drejtat e njeriut. Një sistem elektronik për menaxhimin e rasteve është krijuar, duke forcuar kapacitetin operacional. Për të promovuar informata publike për mandatin e tij, ai e ka filluar një fushatë informative që përfshin takimet me organizatat joqeveritare dhe grupet e shoqërisë civile, shpërndarjen e broshurave informative, dhe shpalljen e një njoftimi në shërbimin publik në televizionin lokal të Kosovës dhe televizionin e Serbisë. Nga 26 rastet që i ka pranuar deri më tani, Paneli tashmë i ka marrë vendimet mbi pranueshmërinë në 9 raste, duke i shpallur 6 të pranueshme dhe 3 të papranueshme. Rastet kanë të bëjnë me, inter alia, të drejtat pronësore, të drejtën në jetë, lirinë e shprehjes dhe administrimin e drejtësisë. Raste të caktuara akoma ngritin çështjen në lidhje me efektivitetin e mjeteve juridike në dispozicion të ankuesve sipas sistemit ligjor në Kosovë siç qëndron ai tani. Kuvendi i Kosovës është në proces të përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e Ombudspersonit, por ka shqetësime serioze se procesi i përzgjedhjes është bërë tepër i politizuar.

S/2009/149 e 17 marsit të vitit 2009

30. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/12 si një mekanizëm për trajtimin e ankesave për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut që dalin nga çështjet nën përgjegjësinë e UNMIK-ut, u bë funksional në nëntor të vitit 2007 dhe e dha mendimin e vet të parë më 12 nëntor 2008. UNMIK-u mban lidhje me EULEX-in për të siguruar hetime të shpejta dhe të plota policore dhe gjyqësore në rastet para Panelit Këshillëdhënës, dhe është duke shqyrtuar mundësinë e trajtimit të pagesës së kompensimit ku është rekomanduar nga Paneli. Ngarkesa me lëndë e Panelit Këshillëdhënës arriti në 108 raste më 31 janar 2009. Nga këto, 20 raste janë përfunduar, shumica janë hedhur poshtë për shkak të papranueshmërisë së tyre dhe dështimit të ankuesve për të vazhduar me aplikimet e tyre; 88 raste mbesin aktive dhe në zhvillim e sipër. Numri më i madh i ankesave kanë të bëjnë me çështjet banesore dhe pronësore.

S/2009/300 10 qershorit të vitit 2009

26. Përfaqësuesi im Special organizoi konsultime me Komisarin e Lartë për të Drejtat e Njeriut për të gjetur rrugët për të ngritur efektivitetin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut si një mekanizëm kredibil, për t'i trajtuar pretendimet për shkelje të të drejtave të njeriut nën mandatin e UNMIK-ut. Është arritur marrëveshja për nevojën që të riafirmohet karakteri joadversarial i procedurave të Panelit në seancat dëgjimore publike dhe të adresohen aspektet e tjera procedurale të Rregullores së UNMIK-ut 2006/12 mbi themelimin e Panelit. Numri i përgjithshëm i rasteve të pranuara nga Paneli deri më tani është 378, nga të cilat 23 raste janë të mbyllura.

S/2010/5 e 6 janarit të vitit 2010

44. UNMIK-u nxori Udhëzimin Administrativ nr. 2009/1, për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. Udhëzimi e përcakton 31 marsin e vitit 2010 si datën e fundit për paraqitjen e ankesave para Panelit dhe qartëson çështjet që kanë të bëjnë me pranueshmërinë e ankesave, emërimin dhe dorëheqjen e anëtarëve të Panelit dhe organizimin e seancave dëgjimore publike. Deri më tani, Paneli i ka pranuar gjithsej 482 raste, nga të cilat 452 janë në zhvillim e sipër dhe 30 janë mbyllur.

S/2010/169 e 6 prillit të vitit 2010

36. Gjatë periudhës raportuese, është plotësuar vendi i lirë për anëtarin e tretë të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. Për të bërë publike datën e ardhshme të 31 marsit të vitit 2010 për dorëzimin e ankesave në Panel, janë shpallur njoftimet në mediet e Prishtinës dhe Beogradit që kanë tirazh më të madh. Pas një shqyrtimi të shifrave të tij për rastet, Paneli raporton se i ka pranuar gjithsej 439 raste deri më tani, nga të cilat 30 janë mbyllur.

S/2010/562 e 29 tetorit të vitit 2010

53. Në zbatim të mandatit të tij, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i ka dhënë rekomandime Përfaqësuesit tim Special në 62 nga gjithsej 521 ankesa.

S/2011/43 e 28 janarit të vitit 2011

43. Shqyrtimi i rasteve të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut është rritur trefish në vitin 2010, me 32 raste të mbyllura në fund të nëntorit, krahasuar me 11 raste të mbyllura në vitin 2009. Megjithatë, Paneli ende përballet me 460 raste që kanë mbetur të pazgjidhura. Kjo dhe çështjet e tjera procedurale dhe mbi politikat që prekin Panelin janë shqyrtuar në seancën e tetëdhjetë e pestë të Komisionit të Venedikut të Këshillit të Evropës më 17 dhe 18 dhjetor. Komisioni theksoi nevojën për të siguruar burime shtesë dhe marrë në konsideratë opsionet e duhura procedurale për të rritur efikasitetin e Panelit.

S/2011/281 e 3 majit të vitit 2011

51. Deri më 31 mars 2011, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i ka përfunduar 92 nga gjithsej 525 lëndë, duke përfshirë 26 ankesa që ishin mbyllur gjatë periudhës raportuese. Nga 92 lëndë të përfunduara, Paneli i mbylli 41 përmes mendimeve mbi bazueshmërinë dhe pjesën e mbetur prej 51 përmes vendimeve që e shpallin ankesën të papranueshme. Nga 41 lëndët e mbyllura përmes një mendimi mbi bazueshmërinë, Paneli tha që UNMIK-u kishte qenë përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut në 39 lëndë dhe i ka dhënë rekomandime përkatëse Përfaqësuesit Special në përputhje me mandatin e vet.

S/2012/72 e 31 janarit të vitit 2012

47. Deri më 31 dhjetor 2011, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut i ka përfunduar 166 prej gjithsej 525 rasteve. Gjatë vitit 2011, Paneli i mbylli 100 raste, krahasuar me 37 në vitin 2010.

S/2012/603 e 3 gushtit të vitit 2012

39. Në qershor, një anëtar i Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut është emëruar për të shërbyer në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përfaqësuesi im Special i ka kërkuar kryetarit të Gjykatës që të japë rekomandime për zëvendësimin e përshtatshëm për të siguruar vazhdimësi në punën e Panelit.

S/2015/303 e 27 prillit të vitit 2015

45. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i cili është themeluar në vitin 2006 për t'i hetuar pretendimet individuale për shkelje të të drejtave të njeriut të kryera nga UNMIK-u, vazhdoi aktivitetet e veta dhe e nxori Raportin e vet vjetor për vitin 2014 në muajin mars. Deri në fund të marsit të vitit 2015, Paneli i ka mbyllur 454 raste, ndërsa 73 raste mbesin për t'u shqyrtuar.

Procesverbali i takimit të 7448-të të KS të OKB-së (Nju Jork, 26 maj 2015), S/PV.7448, fq. 3-4

Në lidhje me aktivitetin e UNMIK-ut që ka të bëjë me të drejtat e njeriut, më lejoni ta shfrytëzoj këtë mundësi t'ju njoftoj juve për Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, të themeluar në vitin 2006, për t'i hetuar ankesat individuale për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut gjatë viteve të para pas vendosjes së UNMIK-ut. Panel i pranoi 527 ankesa dhe i mbylli 464 nga to, ndërsa 63 raste mbesin për t'u shqyrtuar. Paneli ka rekomanduar në vazhdimësi kompensim për dëmet morale. Megjithatë, rezolutat relevante të Asamblesë së Përgjithshme ndalojnë kompensimin nga Kombet e Bashkuara për humbje joekonomike që rezultojnë nga operacionet paqeruajtëse. Megjithatë, në diskutimet e mia me bashkëbiseduesit lokalë dhe ndërkombëtarë, unë kam përkrahur krijimin e një mekanizmi të përshtatshëm për t'i kompensuar dëmet morale si dhe për hetim të mëtejmë nga autoritetet përkatëse për rastet e papërfunduara.

S/2015/579 e 30 korrikut të vitit 2015

59. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut, i cili shqyrton ankesat për shkelje të të drejtave të njeriut që pretendohet të jenë kryer nga UNMIK-u prej qershorit të vitit 1999 deri në shkurt të vitit 2008, dha 16 mendime për 20 ankesa. Në 15 ankesa, Paneli gjeti se UNMIK-u dështoi të veprojë në pajtim me kërkesat procedurale të nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në 12 ankesa, Paneli po ashtu gjeti se, me dështimin e vet, UNMIK-u i kontribuoi shqetësimit dhe vuajtjes mentale të ankuesve dhe familjeve të tyre, në shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Që nga raporti im i fundit, nuk është shënuar asnjë progres në lidhje me rekomandimet që kanë të bëjnë me pagesën e kompensimit adekuat për dëmin e përjetuar moral si rezultat i atyre shkeljeve. Veç kësaj, EULEX-i informoi UNMIK-un që, për shkak të kufizimeve të tanishme ligjore, ai nuk është në gjendje ta zbatojë rekomandimin e Panelit mbi vazhdimin e hetimeve penale që kanë të bëjnë me rastet para Panelit. Deri në fund të qershorit, Paneli i kishte mbyllur 474 raste ndërsa 53 raste mbesin për t'u trajtuar.

S/2015/833 e 3 nëntorit të vitit 2015

42. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut, i cili shqyrton ankesat për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut të kryera nga UNMIK-u nga 23 prilli i vitit 2005 deri më 31 mars 2010, dha gjashtë mendime për 13 ankesa gjatë periudhës raportuese. Paneli gjeti që në të gjitha këto raste UNMIK-u kishte dështuar t'i përmbushë kërkesat procedurale të nenit 2 (e drejta në jetë) dhe, në 11 raste, të nenit 3 (ndalimi i torturës, trajtimit jonjerëzor dhe degradues) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Deri në fund të shtatorit, Paneli i kishte mbyllur 487 raste; 40 raste mbesin për t'u trajtuar. Paneli planifikon ta përfundojë punën e vet substanciale në ankesa deri në fund të vitit 2015.

S/2016/99 e 1 shkurtit të vitit 2016

42. Gjatë periudhës raportuese, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut dha nëntë mendime për 31 ankesa. Në tetë nga nëntë mendimet, Paneli gjeti se UNMIK-u kishte dështuar t'i përmbushë kërkesat procedurale të përcaktuara në nenin 2 (e drejta në jetë) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak të mungesës së hetimit të duhur penal. Veç kësaj, Paneli konstatoi që, në 22 prej 31 ankesave, obligimet procedurale nuk janë përmbushur siç parashihet në nenin 3 të Konventës (ndalimi i torturës, trajtimit jonjerëzor dhe degradues). Në mendimin e nëntë, Paneli përfundoi që Misioni e kishte shkelur nenin 3 të

Konventës si dhe nenet 9 (e drejta në sigurim social) dhe 11 (e drejta në standard adekuat të jetesës) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore. Që nga raporti im i fundit, nuk është shënuar asnjë progres për sa u përket rekomandimeve të Panelit në lidhje me pagesën e kompensimit adekuat për dëmet e përjetuara morale si rezultat i këtyre shkeljeve. Deri në fund të vitit 2015, Paneli i ka mbyllur 518 raste, ndërsa nëntë kanë mbetur të pazgjidhura. Paneli planifikon ta përfundojë punën e vet substanciale deri në mars të vitit 2016, dhe do të pasojë përgatitja dhe paraqitja e raportit të vet përfundimtar.

S/2016/407 e 29 prillit të vitit 2016

48. Gjatë periudhës raportuese, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut dha katër mendime për shtatë ankesa, duke përfshirë një, në një rast në lidhje me ekspozimin e PZHB-ve romë në kushte të rrezikshme shëndetësore, duke përfshirë kontaminimin nga plumbi, gjatë ditëve të para të administrimit të përkohshëm. Në dy mendime, në lidhje me pesë ankesa, Paneli konstatoi se UNMIK-u kishte dështuar t'i përmbushë kërkesat procedurale të nenit 2 (e drejta në jetë) dhe nenit 3 (ndalimi i torturës, trajtimi jonjerëzor apo degradues) të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Në mendimin tjetër, përveç shkeljeve të neneve 2 dhe 3 të Konventës, Paneli konstatoi një shkelje të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave. Në mendimin që doli nga rasti i ekspozimit të PZHB-ve romë në kontaminim nga plumbi, Paneli gjeti shkelje të shumta jo vetëm të atyre konventave por, po ashtu, edhe të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventës për të Drejtat e Fëmijëve. Që nga raporti im i mëparshëm, nuk është shënuar asnjë progres për sa u përket rekomandimeve të Panelit në lidhje me pagesën e kompensimit adekuat, duke përfshirë atë për dëmet morale që del nga shkeljet e pretenduara të UNMIK-ut. Në fund të periudhës raportuese, Paneli i ka mbyllur 525 raste, me vetëm 2 raste në zhvillim e sipër. Paneli parashihet ta përfundojë punën e vet substanciale deri në fund të qershorit të vitit 2016 dhe të paraqesë një raport përfundimtar pas kësaj.